



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË
SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË” SHA

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I PËRPUTHSHMËRISË
DHE RREGULLSHMËRISË

NË

SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË” SHA

Prill 2023

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
1.Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2.Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinion i auditimit.....	18
II.HYRJA.....	22
1. Objekti i auditimit.....	23
2. Qëllimi i auditimit.....	23
3. Identifikimi i çështjes.....	23
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	23
5. Përgjegjësit e audituesve.....	24
6. Kriteret e vlerësimit.....	24
7. Standartet e auditimit.....	25
8. Metodat e auditimit.....	26
9. Dokumentimi i auditimit.....	26
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	26
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....	26
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejttimeve të auditimit.....	26
2.1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.....	26
2.2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori) vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.....	36
2.3. Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko-financiar të shoqërisë.....	38
2.4. Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.....	48
2.5. Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).....	65
2.6. Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.....	76
2.7. Mbi zbatimin e ligjshmërie në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.....	92
2.8. Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë.....	181
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	204

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Organizmi dhe funksionimi i Shoqërisë është në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, VKM nr. 63, 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura”, me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 510, datë 10.05.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Shoqëria “UKT” SHA ushtron veprimtarinë e saj me Seli në adresën Rruga “Kavajës”. Ndërtesa ku është vendosur Selia e UKT SHA është marrë në përdorim/me qira nga pronari i objektit G dhe Shoqëria “K” Shpk. Ndërtesa 133, kodi postar 1027, Njësia Administrative nr.6, Tiranë, me sipërfaqe trualli 2131 m² dhe sipërfaqe ndërtese 2252 m². Vlera e kontratës është 1.826.320 lekë në muaj.</p> <p>Për përdorimin e objektit/ndërtesës Shoqëria ka lidhur me qiradhënësin, kontratën e qirasë nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019, kontratë e ndryshuar me kontratën nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021 dhe nr.rep 5554, nr.koleksioni 3559, datë 21.09.2022. Për investimet dhe mirëmbajtjen e pronës së marrë me qira, në kontratën e qirasë nr.7 Rep dhe nr.5 Kol, datë 04.01.2019, në nenin 5 “Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit”, pika 5.1, 5.5 dhe 5.8 dhe nenin 8 “Përgjegjësitë e palëve”, janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve me referencë ligjore në nenet 801-825 të Kodit Civil.</p> <p>Sipas kushteve të kontratës së qirasë të rëna dakort nga palët është parashikuar se: Qiramarrësi ka të drejtë, që sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë në qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë (neni 5, pika 5.1) Qiradhënësi nuk bën kompensimin financiar të</p>	Pika 2.8, fq 181-204	E lartë	Organet Drejtuese të Shoqërisë, të marrin masa për të rinegociuar kontratën/marrëveshjen me Qiradhënësin për të bërë amendimet përkatëse me qëllimin e rikuperimit të vlerës 28,329,607 lekë për investimet e kryera por të pakthyeshme (47,986,607 lekë gjithsej-19,657,000 lekë që mund të merren= 28,329,607 lekë), vlerë që t'i mbesë qiradhënësit kundrejt kthimit të shpenzimeve, dhe me të drejtën e marrjes nga “UKT Tiranë” SHA të inventarit ekonomik (pajisjeve kompjuterike, kamera survejimi, mobileri , etj) në vlerën 19,657,000 lekë pas përfundimit të kontratës. Në rast se qiradhënësi nuk do të pranojë këto dy kushte duhet të kërkohet

	<p>investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga qiramarrësi (neni 5, pika 5.5). Nga UKT është shpenzuar vlera 19,000,0000 lekë investime në këtë objekt të marr me qira për kamera survejimi etj, nga këto mund të merren në përfundimin e kontratës pajisje survejimi në vlerën 7,755,400 lekë. Rreferuar kushteve të kontratës së bashku e amendimin, kjo vlerë mbetet për llogari (pronë) të Qiradhënësit.</p> <p>Në kontratës nr.rep 5554, nr.koleksioni 3559, datë 21.09.2022, palët kanë ndryshuar paragrafin 5.5 të nenit 5 të Kontratës, ku përcaktohet se :“Qiramarrësi”, pasi ka marrë më parë miratimin nga “Qiradhënësi”, mund të kryejë investime, rimodelim, shtesë, ndryshim strukturor në objektin e marrë me qira me shpenzimet e tij, dhe në përfundim të kontratës së qirasë ka të drejtë të kërkojë kthimin e vlerës së investuar dhe vlerën e shpenzimeve të kryera që i rrisin vlerën objektit dhe parashikohen në akte ligjore e nënligjore.</p> <p>Sipas këtij paragrafi “Qiramarrësi” ka të drejtë që në përfundim të kontratës së qirasë të kërkojë kthimin e vlerës së investuar apo shpenzimeve të kryera që i rrisin vlerën objektit, për ato investime apo shpenzime që ai i ka kryer pasi ka marrë miratim nga “Qiradhënësi”</p> <p>-Në kontratën nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019 nuk është parashikuar nga palët, detyrimi për sigurimin e pronës në rastet e rreziqeve të shkaktuara nga zjarri, rrufetë, tërmeti, stuhitë, përmbytjet, shpërthimi ose dëme nga uji, shembje dhe çdo rrezik tjetër të parashikuar nga ligji. Me amendamentin nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021 sigurimi i objektit nga rreziqet është parashikuar si e drejte e Qiradhënësit, po polica e sigurimit nuk është pjesë përbërëse e kontratës, siç përcaktohet në nenin 1, pika 1.5, paragrafi i dytë. Pavarësisht se palët kanë vendosur me vullnet të lirë në kontratë detyrimin e palës Qiradhënëse për sigurimin e pronës objekt i kontratës së qirasë, ky detyrim kontraktual dhe ligjor nuk është përmbushur.</p> <p>Në qershor të vitit 2022 në UKT për</p>			<p>në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës 47,986,607 lekë, ose për diferencë sipas realizimit të kushteve.</p> <p>- Organet Drejtuese të Shoqërisë, të marrin masa për të negociuar me Shoqërinë ”K” Shpk për të siguruar pronën objekt qiraje, në një shoqëri të liçensuar sigurimi nga humbja ose dëmtimi nga rreziqet e siguruara. Në rast mos sigurimi të pronës të zgjidhet kontrata e qirasë.</p>
--	--	--	--	---

	<p>shkak shkëndijës elektrike ka rënë zjarr duke krijuar dëm të llogaritur në vlerën 28,986,607 leke. Për shkak të mos pasjes së policës së sigurimit nga zjarri kjo vlerë (shpenzim) është përballuar nga UKT, nga këto mund të merren në përfundimin e kontratës pajisje kompjuterike & mobilje në vlerën 11,931,600 lekë.</p> <p>Për shkak të mos pasjes së policës së sigurimit nga zjarri kjo vlerë është përballuar nga UKT. Nga sqarimet e kërkuara ne UKT, termi ka të drejtë, nuk është konsideruar si një e drejt detyrimore e Qiradhënësit, por si një e drejtë evazive (Polica e sigurimit mund të jetë/ose mund të mos jetë pjesë përbërëse e kontratës).</p> <p>Referuar doktrinën juridike, kodit civil, në rastin konkret (përmbajta e kontratës) termi ka të drejtë duhet të konsiderohet si një e drejt detyrimore e Qiradhënësit, dhe jo si një e drejtë evazive (Polica e sigurimit mund të jetë/ose mund të mos jetë pjesë përbërëse e kontratës). Pra polica e sigurimit duhet të jetë pjesë e kontratës dhe vlera 28,986,607 lekë dhe duhet të likuideohej nga shoqëria e sigurimit.</p> <p>Nga investimi i kryer në vlerën 47,986,607 lekë respektivisht në vlerat 19,000,000 dhe 28,986,607 leke, pajisjeve survejimi, kompjutera, mobile etj të zhmontueshme janë në vlerën 19,657,000 lekë.</p> <p>Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” nenet 801-825.</p>			
2	<p>Në objektin “Spostim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime, sheshi Shqiponja, Loti 1” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UKT sh.a dhe OE “S” sh.p.k me Nr.14332/8Prot datë 22.10.2020 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 227,953,868 lekë pa TVSH ose 273,544,642 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 6 muaj, nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezultuan se; në librezat dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të</p>	Pika 2.7, fq 92-181	E lartë	<p>Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës 10,490,433 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve OE “S” sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr.14332/8Prot datë 22.10.2020 për zbatimin e punimeve civile</p>

	<p>pakryera në fakt për 5 (pesë) zëra punimesh, në shumën 10,490,433 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën-pikat 3.2 dhe 3.3.;- Kontratën e shërbimit Nr.15784/10Prot. datë 22.10.2020 me objekt “Mbikëqyrje të objektit, “Spostim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime, sheshi Shqiponja, Loti 1”, Neni 7</p>			
3	<p>Në objektin “V.N” - Depo 4000m3 në Yzberisht” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe “B” sh.p.k & “E” sh.p.k me Nr.16975/9Prot datë 19.10.2018 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 184,114,778 lekë pa TVSH ose 220,937,734 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 4 mua, nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezultuan se; në librezat dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt për 3 (tre) zëra punimesh, në shumën 262,100 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën-pikat 3.2 dhe 3.3.;- Kontratën e shërbimit Nr.18824/35</p>	Pika 2.7 fq 92-181	E lartë	<p>Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës 8,028,000 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve “B” sh.p.k & “E” sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr.16975/9Prot datë 19.10.2018 për zbatimin e punimeve civile.</p>

	Prot. datë 11.10.2018 me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin, ‘Ndërtim linjë transmetimi ujësjellësi nga rruga ‘V.N’ - Depo 4000m3 në Yzberisht’”, Neni 7.			
4	Në objektin “Rikonstruksion rrjet ujësjellësi Dn-426mm, Dn-200mm në rrugën ‘Xhanfize Keko’” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe OE “B” sh.p.k me Nr.10098/2Prot. datë 17.08.2019 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 50,406,959 lekë pa TVSH ose 60,488,350.8 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 30 ditë, nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezultuan se; në librezat dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt për 5 (pesë) zëra punimesh, në shumën 3,064,212 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.;- Kontratën e shërbimit Nr.10087/42Prot. datë 05.08.2019 me objekt “Mbikëqyrje të objektit, ‘Rikonstruksion rrjet ujësjellësi Dn-426mm, Dn-200mm në rrugën ‘Xhanfize Keko’”, Neni 7	Pika 2.7, fq 92-181	E lartë	Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës 3,064,212 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve OE “B” sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr.10098/2Prot. datë 17.08.2019 për zbatimin e punimeve civile
5	Shoqëria “UKT” Tiranë” Sh.a ka lidhur kontratë nr. 10728 prot., datë 12.06.2019 me K.Q me objekt “Martja me qira e tokës mbi të cilën është ndërtuar depo uji me vendodhje në Fshatin Surel, njësia administrative Daj” me sipërfaqe 511.65 m2 për përdorim toke. Kohëzgjatja 1 vjeçare me të drejt rinovimi me vlerë qiraje 173,961 lekë në muaj. Në këtë përfshihet tatimi mbi qiranë që do ti mbahet qiradhënësit çdo muaj sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.	Pika 2.8, fq 181-204	E lartë	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 1,545,045 lekë nga K.Q. Kjo është përfituar padrejtësisht nga qiradhënësi K.Q, si pasojë e diferencës ndërmjet planimetrisë së kontratës së qirasë dhe sipërfaqes sipas planimetrisë në fakt.

	<p>Rrethimi i depos ujit të ujësjellësit (Depo uji, pusëtë dhe objekt të shërbimit (sistem kamera, manovrator etj) është 401.5 m2, sipërfaqe sipas planimetrisë së kontratës është 511 m2, diferenca =109.5 m2 x 340 lekë m2/muaj =37,230 lekë në muaj x 41.5 muaj (12.06.19 data e lidhjes kontratës deri më 30.11.22 që përfundon auditimi = 1,545,045 lekë përfituar tepër.</p> <p>Vlera 1,545,045 lekë përbënë dëm ekonomik për Shoqërinë “UKT” Sha dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga përfituesi. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, nenet 801-825</p>			
6	<p>Në procedurën e prokurimit “Zhbllokim pusetash”, viti 2022, për vlerën 19,994 mijë lekë, projekt përfshin edhe fond rezervë 5 % në vlerën 952,076 lekë. Ky fond rezervë ka rritur në mënyrë artificiale vlerën e përllogaritjes, duke rënduar koston e këtij shërbimi, në vlerë 960,984 lekë, pasi nuk ka të bëjë me punime ndërtimi të ndërtesave por me shërbim, pasi nuk ka projekt të hartuar nga projektues të licensuar, nuk ka të caktuar mbikëqyrës të punimeve, preventivi nuk ka të përcaktuar vlerën e pastrimit të pusetave duke u bazuar në numrin e pusetave x çmimin/puset, vlerën e zhbllokimit të kanaleve kesoni duke u bazuar në numrin/metrat linear x çmimin/kanal etj. Veprim në kundërshtim me Analizat teknike për punimet e ndërtimit të ndërtesave “Ministria e Ndërtimit” maj 1992, Manualin e preventivimit “Udhëzime dhe kriteret dhe analiza ndihmëse vëllimi i I (1976-1980).</p> <p>Vlera 960,984 lekë është përfituar padrejtësisht nga Shoqëria Shoqërisë “O” Shpk, si pasojë përllogaritjeve të gabuara dhe përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “UKT” Sha dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga kjo Shoqëri, referuar të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655, ku është shprehur në mënyrë eksplcite</p>	Pika 2.8, fq 181-204	E lartë	<p>Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 960,984 lekë, nga Shoqëria “O” Shpk për shkeljet konstatuara në kontratën me objekt “Zhbllokim pusetash”, viti 2022, për arsye se janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht shpenzimet në fazën e hartimit të preventivit dhe të zbatimit të kësaj kontrate, duke rënduar padrejtësisht koston e shërbimit në vlerën 960,984 lekë, vlerë e cila për Shoqërinë “UKT” Sha dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik. Dëmshpërblimi mbështet në Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655 dhe neni 32.</p>

	<p>se “përcaktohet se: “Personi që pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar brenda caqeve të begatimit pa shkak”.</p>			
7	<p>Shoqëria “UKT Tiranë” SHA është penalizuar në vlerën 34,992,188 lekë nga mos zbatimi i procedurave gjyqësore me përfitues Y.V. po në të njëjtën vlerë, për mos respektim të afatit të ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, veprim në kundërshtim Ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë neni 443 dhe 450/1/a.</p> <p>Ky konflikt gjyqësor është krijuar nga përdorimi i pasurisë së paluajtshme e llojit “Pyl” me sipërfaqe 2200 m2 ndodhur në Zonën Kadastrale 2380, me nr.pasurisë.11/21/163 në Lanabregas Tiranë.</p> <p>Ekzekutimi i Vendimit nr. 6133, datë 20.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga përmbaruesi është kryer pasi veprimet procedurale të Drejtorisë Juridike janë kryer me vonesë, duke sjellë si pasojë ekzekutimin e vendimit pa ushtruar detyrimin ligjor për ndjekjen e çështjes në të gjitha shkallëve të gjykimit. Për rrjedhojë mosparaqitja në afat e ankimit në Gjykatën e Apelit i ka dhënë mundësi Paditësit të ekzekutojë vendimin. UKT pavarësisht se ka ekzekutuar detyrimin përmbarimor për këtë çështje ka depozituar ne gjykate kërkesë për disponim ankimi dhe kërkesë për rishikim vendimi. Te dy çështje janë ne proces për t’u gjykuar nga Gjykata e Apelit.</p> <p>Në këtë mënyrë, edhe nëse gjykata do të pranojë rishikimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, kthimi i shumës së ekzekutuar do të ishte me risk, pasi do të duhej një kohë e gjatë nga përfundimi i procesit për rishikimin e vendimit deri në kërkimin e kthimit të shumës me një tjetër padi dhe çështje gjyqësore.Veprim në kundërshtim me Ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë neni 443 dhe 450/1/a</p>	Pika 2.8, fq 181-204	E lartë	<p>- Nga Shoqëria t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale, ndjekjes me përgjegjësi të gjitha procedurat gjyqësore, me përfaqësim tekniko-juridik me profesionist me eksperiencë për minimizuar dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i vendimeve në disfavor të Shoqërisë.</p> <p>Shoqëria “UKT Tiranë” SHA të analizojë vlerësoj çështjen në tërësi, për të zbatuar në mënyrë vullnetare dhe në marrëveshje me subjektin detyrimin e krijuar, si dhe lidhur kontrata, me qëllim uljen e kostove financiare të cilat mund të krijohen nga vendimi gjyqësor dhe shpenzimet përmbarimore. Në marrëveshje të përcaktohen edhe klauzolat në rast të ndryshimit të vendimit gjyqësor duke krijuar garancitë ligjore përkatëse për institucionin.</p>

8	<p>Në objektin "V.N" - Depo 4000m³ në Yzberisht" të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe "B" sh.p.k & "E" sh.p.k me Nr.16975/9 Prot datë 19.10.2018 u konstatua se pesha specifike e tubit çelik Ø (1016x8.8 mm) i h/izoluar në fabrikë sipas certifikatës së prodhimit është 10 kg/ml më shumë se ajo e projektuar dhe e kërkuar në specifikimet teknike, kështu që nga llogaritjet ka rritur koston e projektit, për gjithë gjatësinë e tubit 2186.65 ml në vlerën 3,672,480 lekë pa TVSH (21,86 Ton x168,000 lekë/ton), e cila në gjykimin e grupit të auditimit shpenzim i fondeve të shoqërisë pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me parimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të shprehura në nenin 5.</p>	Pika 2.7, fq 92-181	E lartë	<p>Shoqëria UK Tiranë në bashkëpunim me mbikëqyrësit e punimeve të kryej një kontroll më të detajuar të specifikimeve teknike të kërkuara, të materialeve në realizimin punimeve civile, duke shmangur kështu rritjen e kostove të projekteve në proces dhe atyre që do të zbatohen në vazhdimësi.</p>
9	<p>Për periudhën 06.10.2018-03.03.2021, Shoqëria ka kryer aktivitet pa qenë e licencuar nga Enti Rregullator i Ujit (ERU). Për këtë periudhë kjo shoqëri ka qenë në proces liçensimi, duke shkëmbyer dokumentacion shkresor të njëpasnjëshëm me ERU. Pas datës 04.03.2021 kjo shoqëri është pajisur me Licencë me nr. 19, miratuar me vendim nr. 40, datë 06.10.2017 (afati 06.10.2017-05.10.2018), Licnesa nr. 2 miratuar me vendim nr. 84, date 04.03.2021 me afat 04.03.2021 deri me 03.03.2023; Licensa nr. 2, miratuar me vendim nr. 150, date 01.04.2022 me afat 01.04.2022 deri me 03.03.2023. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, neni 15 dhe VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të liçensimit dhe procedurave për aplikim për liçensë", pika I/a/b/c.</p>	Pika 2.8, fq 181-204	E lartë	<p>Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale, rinovimit në kohë të licencave përkatëse sipas objektit të veprimtarisë saj brenda zonës së shërbimit që ushtron aktivitet.</p>
	<p>Në vendim të Entit Rregullator i Uji nr. 84, date 04.03.2021 është përcaktuar drejtues ligjor E.K dhe drejtues teknik E.O dhe E.C, me liçensim të shoqërisë me kategori A", "Për grumbullimin dhe shpërndarjen e</p>	Pika 2.8, fq 181-204	E lartë	

10	<p>ujit për konsum publik”, kategoria B “Për përpunimin e ujit për konsum publik” dhe kategorinë C”, “Për largimin e ujërave të ndotura.</p> <p>Deri 30.11.2022, datë që përfundon auditimi drejtuesit teknik të shoqërisë E.O, E.C dhe E.M me detyrë drejtor i departament të shitjes, nuk zotërojnë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tyre, sipas detyrës që ushtrojnë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura.</p> <p>Këtë certifikatë nuk e kanë dhe 456 punonjësit që merren me menaxhimin e ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 2972 prot., datë 08.10.2019, i ka kërkuar listën e punonjësve subjekt certifikimi dhe formularët e deklaramit të punësimit dhe arsimit të Shoqërisë “UKT” Sha.</p> <p>Shoqëria me shkresën nr. K-2355/1 prot, datë 11.09.2019 dhe shkresën nr. K-2645/1 prot, datë 21.10.2019, ka dërguar listën emërore të punonjësve, diplomën/dëftesë e noterizuar ose e njësuar me vulën e institucionit dhe formularin e deklaramit.</p> <p>Që nga data 21.10.2019 deri më 30.11.2022 datë që përfundoj auditimi, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, nuk ka dërguar asnjë certifikim. Veprim në kundërshtim me Statutin e Shoqërisë i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 1, datë 08.01.2019, neni 19/c “Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit teknik” dhe Udhëzimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 660, datë 28.09.2018 “Për krijimin dhe zbatimin e programit Kombëtar të Trajnimit dhe Çertififikimin bazuar në testimin në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”, neni 5 pika 2.</p>			<p>Nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë të prezantohet/kërkohej zyrtarisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë pajisjen me certifikatat përkatëse për aftësimin specifik profesional të stafit menaxherial si dhe për 456 punonjësit, sipas detyrës që ushtrojnë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura, ose të lëshimit nga kjo Ministri të vërtetimit për pamundësinë objektive për pajisjen me këto certifikata.</p>
	<p>Shoqëria “UKT” Sh.a për periudhën 2021, ka instaluar 4776 matës inteligjent të ujit të pijshëm. Instalim i matësve inteligjent është realizuar pa kryer më par, vlerësim ekonomik, i</p>			

	<p>cili duhet të kishte marrë në konsideratë të gjitha kostot afatgjata dhe përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, duke përfshirë gjithashtu edhe formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhej/përzgjidhet, e cila duhet të jetë ekonomikisht më efektive dhe me afatin kohor më të përshtatshëm për implementimin e këtij sistemi matjeje.</p> <p>Në bazë të vlerësimit ekonomik të përcaktuar si më sipër Shoqëria, duhet të kishte propozuar në ERU ndryshimet përkatëse ligjore dhe rregullatore, si dhe mbas miratimit të tyre duhet të përgatiste një kalendar për implementimin brenda një periudhë 10-vjeçare të sistemeve inteligjente të matjes. ERU duhet të sigurojë/siguroj ndërvëprimin e sistemeve të ndryshme matëse, që do të implementohen në të gjithë territorin e vendit. Në instalimin e matësve nuk është dokumentuar testimi i kryer pas verifikimit periodik, me rezultatin që matësi nuk kryen funksionet e matjes (Verifikimit periodik të ujëmatësve i nënshtrohen të gjithë ujëmatësit që kanë plotësuar kriterin e datës së vendosjes së tyre 60 muaj, dëmtimi/ose jo fizikisht i tij, kalimi/ose jo j jetëgjatësisë së tij, matësi nuk kryen funksionet e tij etj). Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve SHA”, pika 2/7, Ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë” i shfuqizuar, neni 26, i ndryshuar me Ligjin nr. 126/2020 “Për metrologjinë”, neni 25; VKM nr. 96, datë 21.2.2007 “Për disa ndryshime në VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, pika 3; Vendimin e Enti Rregullator i Ujit nr. 8, datë 04.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip” ndryshuar me Vendimet nr. 15, datë 09.06.2014 “Për zbatimin e kontratës model të miratuar nga KKRR për të gjithë klientët e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura” dhe me Vendimin nr. 25,</p>	<p>Pika 2.7, fq 92-181</p>	<p>E lartë</p>	<p>Në rastet e vendosjes së matësve inteligjent të ujit të pijshëm nga Shoqëria “UKT Tiranë” SHA, të merren masa për të përgatitur paraprakisht vlerësimin ekonomik, i cili duhet të marrë në konsideratë të gjitha kostot afatgjata dhe përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, duke përfshirë gjithashtu edhe formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhej/përzgjidhet, e cila duhet të jetë ekonomikisht më efektive dhe me afatin kohor më të përshtatshëm për implementimin e këtij sistemi matjeje. Në bazë të vlerësimit ekonomik të përcaktuar si më sipër Shoqëria, duhet ti propozoj në ERU ndryshimet përkatëse ligjore dhe rregullatore, si dhe mbas miratimit të tyre duhet të përgatit një kalendar për implementimin brenda një periudhë 10-vjeçare të sistemeve inteligjente të matjes. ERU duhet të siguroj ndërvëprimin e sistemeve të ndryshme matëse, që do të implementohen në të gjithë territorin e vendit.</p>
--	--	----------------------------	----------------	--

	datë 08.07.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën model të shërbimeve ujësjellës kanalizime" Enti Rregullator i Ujit, neni 7			
11	<p>Në procedurën e prokurimit "Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë", viti 2019, për vlerën 99,903 mijë lekë, në preventiv nuk është pasqyruar pajisja hardware e komunikimit DCU, që mundësojnë transmetimin në kohë reale në Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të dhënave, pajisje e cila është në projekt, duke pa mundësuar:</p> <p>-a. Mos efikasitet të plotë të fondit publik të përdorur në këtë prokurim në përputhje me qëllimin e tij, që ka të bëjë me "Sistemi matjes në distancë bazohet në ngritjen e një rrjeti komunikimi të njësisë matëse me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të Dhënave". Kjo lloj teknologji shfrytëzon transmetimet wireless, e cila transformon informacionin mekanik në sinjale elektrike. Përmes instalimit të këtyre ujëmatësve ndërtohet Sistemi i Matjes në Distancë. Sistemi i Matjes në Distance bazohet në ngritjen e një rrjeti komunikimi të njësisë matëse me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të Dhënave. Projekti parashikon që në ofertë të jenë të parashikuara të gjitha kostot në lidhje me programimin e software, zhvillimin me qëllim përfundimtar që të dhënat të përftuara përmes walk-By/Drive-By, ose përmes rrjetit fiks të jenë të disponueshme në sistemin e shfrytëzimit të U.K.T.</p> <p>-b. Mos kalimin e vlerës mbi 100,000,000 lekë, për t'ju nënshtruar projekti, oponentës teknike.</p> <p>-c. Mos shkurtimin e personelit (faturistëve) për faturimin e ujit të pijshëm.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 18.7.2002 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, pika 1, VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 "Për vendosjen e oponentës teknike për projektet e veprave të ndërtimit", Urdhrit e Ministres së Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit E.GJ nr. 7, datë</p>	Pika 2.7, fq 92-181	E lartë	Për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura në lidhje me instalimin e matësve inteligjent del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

	20.1.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”			
12	<p>Për periudhën objekt auditimi mbetjet të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike; tubacione, saraçineska etj) të cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë të projekteve të ndryshme, depozitohen Landfilli Sharrës, Landfill i administruar nga Shoqëria (I.E”).</p> <p>Për vend depozitimin dhera dhe inerte tek Landfilli Sharrës për llogari të Shoqërisë (I.E”, për vitin 2019 është faturuar vlera 12,879,558 lekë, është likuiduar vlera 11,759,763 lekë, për vitin 2020 është faturuar vlerë 490,315 lekë, është likuiduar vlera 1,602,325 (1,119,805 lekë mbetje nga viti 2019 dhe 490,315 nga viti 2020), për vitin 2021 është faturuar vlera 3,102,964 lekë, është likuiduar vlera 390,583 lekë, mbetur në diferencë pa likuiduar vlera 2,720,175 lekë, për periudhën janar-tetor 2022 është faturuar vlera 1,006,084 lekë, është likuiduar vlera 1,006,084 lekë.</p> <p>Për këtë depozitim nuk ka kontratë të lidhur ndërmjet Shoqërisë “UKT” SHA dhe Shoqërisë (I.E”, veprim në kundërshtim me VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, pika 9. Faturim është bërë me çmimi 800 lekë/tonë inerte (mbetje nga ndërtimet dhe prishjet) dhe 246.7 lekë/tonë për dhera dhe shtuf.</p> <p>Këto çmime janë vendosur nga Shoqëria (I.E”, pa miratimin e Bashkisë Tiranë, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, pika 15. Transportimi është bërë nga UKT pa patur Licencën tipit III.2.B e pajisur vet ose nëpërmjet nënkontraktoreve për transport të mbetjeve në destinacionin e përcaktuar, si dhe mjetet e angazhuara për këtë qëllim, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e</p>	Pika 2.7, fq 92-181	E lartë	<p>-Nga organet drejtuese të merren masa që për vend depozitimi i mbetjeve të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike; tubacione, saraçineska etj) të cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë të projekteve të ndryshme, të lidhet kontratë/kontata ndërmjet Shoqërisë “SHA dhe operatorit/operatorëve ekonomik të përzgjedhur për këtë qëllim.</p> <p>-Shoqëria “UKT” ti kërkoj Bashkisë Tiranë miratimin e çmimit të faturimit për/tonë inerte (mbetje nga ndërtimet dhe prishjet) dhe për dhera dhe shtuf etj.</p> <p>- Nga organet drejtuese të merren masa që shoqëria të pajisjet vet me Licencën tipit III.2.B, ose nëpërmjet kontraktorëve për transport të mbetjeve në destinacionin e përcaktuar.</p>

	integrua të mbetjeve”, neni 57 “Transportuesit e mbetjeve”, pika 1 dhe 2			
13	<p>Shoqëria UKT sh.a funksionon me një strukturë pagash të miratuar nga organet drejtuese të saj nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.17, datë 12.12.2016 dhe nr.1, datë 24.01.2018 dhe Asambleja e Aksionarëve me Vendimin nr.18, datë 14.12.2016.</p> <p>Në këtë strukturë vendosja e nivelit të pagës për secilin pozicion nuk është vlerësuar bazuar në kritere të mirë përcaktuar si arsimimi (niveli i diplomës si master shkencor, master professional, bachelor apo diplomë e shkollës së mesme), kualifikimi (njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet etj) përgjegjësia (shkalla e përgjegjësisë në funksion të riskut që mund të ketë puna që kryhet) etj.</p> <p>Niveli i pagave në aneksin B të Rregullores së brendshme ka përcaktuar një sistem pagash sipas ndarjes së klasave dhe niveleve të kualifikimit duke i ndarë ato në dy shkallë ku kategorizohet paga pa vendosur kritere të mirë përcaktuara. Tabela përbëhet nga pesë klasë (klasifikim) KL, KN, A, B,C. Këto klasa nuk janë të ndara më me nënklasa por vetëm me nivele kualifikimi me nga dy shkallë page. Kriteret e përcaktuara në relacionin shpjegues janë: Eksperiencia në profesione; Niveli i diplomës dhe i Master-it; Liçencat; Vështirësitë e vendit të punës dhe Gradat shkencore. Këto kritere nuk janë specifikuar për secilin pozicion pune në tabelën e pagave për të bërë diferencën mes niveleve të pagave. Si shembull marrim një specialist të burimeve njerëzore që është përcaktuar tek kategoria KN/2, nëndarja 1, me shkallë page minimale 62,500 lekë/muaj dhe maksimale 65,500 lekë/muaj dhe një specialist të Sektorit të Projekteve të Huaja që përcaktohet tek kategoria KN/2, nëndarja 2, me pagë minimale 60,000 lekë/muaj dhe maksimale 62,500 lekë/muaj. Kjo diferencë vihet re edhe ndërmjet pozicioneve ku një Përgjegjës Sektori në Njësi (faturimi) kategorizohet me nivel page më të</p>	Pika 2.4, fq 48-65	E lartë	<p>Nga Organet Drejtuese të Shoqërisë të rishikohen dhe llogariten nivelet e pagave të punonjësve duke u bazuar në kritere të mirë përcaktuar si arsimimi (niveli i diplomës si master shkencor, master professional, bachelor apo diplomë e shkollës së mesme), kualifikimi (njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet etj) përgjegjësia (shkalla e përgjegjësisë dhe vështirësisë në funksion të riskut që mund të ketë puna që kryhet) etj, duke shmangur pagesat me diferenca të konsiderueshme për punonjësit me natyrë të njëjtë pune dhe duke synuar motivimin e tyre.</p>

	<p>ulët se një Specialist i Burimeve Njerëzore. Po kështu konstatohet se në tabelën e pagave ka përcaktime të tilla si specialist i parë, specialist i dytë, specialist i tretë, specialist i kualifikuar në detyrë. Për këto ndarje nuk janë vendosur kriteret që duhet të plotësojë një punonjës që të paguhet si i tillë. Ndërkohë që një punonjës të kategorizohet si “Specialist i parë” duhet minimalisht të ketë përfunduar master shkencor, për nivelin e “specialist i dytë” punonjësi duhet që punonjësi të ketë përfunduar master profesional dhe specialist i tretë punonjësi duhet të ketë përfunduar bachelor-in. Po kështu edhe për “Specialist të kualifikuar në detyrë” duhet të ishin vendosur kriteret të tilla si eksperiencia e gjatë në të njëjtin vend pune etj.</p> <p>Brenda një Drejtorie, Përgjegjësit e Sektorit që përbëjnë këtë drejtori nuk kanë të njëjtën shkallë page. Kjo vërehet në rastin e Drejtorisë Juridike ku Përgjegjësi i Sektorit të Aseteve dhe Përgjegjësi i Sektorit të Përfaqësimit Ligjor paguhen me pagë bazë 69,500 lekë/muaj ndërkohë që Përgjegjësi i Sektorit të Asistencës Ligjore paguhet me pagë 76,500 lekë/muaj. Në Drejtorinë e Prokurimeve, specialistët nuk paguhen sipas kategorisë së vendosur në tabelë, KN/1, nëndarja 2, me pagë minimale 65,500 dhe pagë maksimale 69,500, por me pagë më të ulët. Ky veprim bien ë kundërshtim me tabelën e miratuar të pagave. Nga krahasimi i pagave ndërmjet departamenteve rezulton se specialistët e Departamentit të Shitjes kanë paga më të ulëta se specialistët e departamenteve të tjerë. Edhe ky diferencim nuk është i argumentuar me kritere objektive</p>			
	<p>Për periudhën 01.01.2018-26.11.2021, periudhë para miratimit të “Manualit të procedurave të Drejtorisë së Burimeve të shoqërisë “UK Tiranë” sha” me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 25, datë 26.11.2021, u konstatua se mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut</p>	<p>Pika 2.4, fq 48-65</p>	<p>E lartë</p>	<p>-Nga organet drejtuese të bëhen parashikime të detajuara statutore dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. - Nga Administratori i Shoqërisë të përcaktohet në deklaratimet për</p>

14	<p>ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Tiranë, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira. Evidentohen që për të njëjtin pozicion pune nuk janë të njehësura kriteret e nevojshme për punësim. Ndërsa gjatë periudhës 26.11.2021-31.10.2022, u konstatua se Manuali i procedurave të Drejtorisë së Burimeve nuk parashikon procedura mbi shpalljen e vendeve vakante. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, Statuti dhe Rregullorja e brendshme e UK Tiranë Sh.a</p>			<p>pozicione të lira pune, edhe afati brenda të cilit të interesuarit për pozicionin e punës duhet të shprehin interesin dhe paraqesin dokumentacionin e nevojshëm provues.</p>
15	<p>Për periudhën objekt auditimi janë shpërblyer punonjësit në vlerën 126,056,093 lekë. Shpërblimet janë dhënë me Urdhër të Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm, dhe jo me miratim nga Këshilli i Administrimit, pasi janë konsideruar të ezauruara me miratimin e programit ekonomik sipas viteve: Me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 18, datë 12.12.2018 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për vitin 2019, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 16, datë 13.12.2018; me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, datë 19.12.2019 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për vitin 2020, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 11, datë 20.12.2019; me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 9, datë 04.11.2020 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për</p>	Pika 2.4, fq 48-65	E lartë	<p>Nga Organet Drejtuese ti kushtohet vëmendje e duhur Institucionale shpërblimit të punonjësve.</p>

	<p>vitin 2021, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 7, datë 05.11.2020 dhe me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, date 26.11.2021 është miratuar Buxheti i shoqërisë për vitet 2022”, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendimi nr.10, datë 13.12.2021. Veprim në kundërshtim me - Ligjin nr. 10405, datë 24,03,2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, i ndryshuar, neni 6, pika 1, gërma b, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 160 “Shpërblimi”, pika 2.</p>			
--	---	--	--	--

1.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Shoqërisë “UKT” SHA, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.09.2018 deri me datë 31.10.2022. Nga auditimi i ushtruar u konstatua se aktiviteti i Shoqërisë në përgjithësi përputhet me kërkesat dhe kriteret e kuadrit ligjor në fuqi. Pavarësisht sa u citua si më sipër, për periudhën objekt auditimi u konstatuan edhe shkelje të kuadrit nënligjor dhe rregullator të cilat konsistojnë në: Organizimin dhe funksionimin të organeve drejtuese, zbatimin e kontratave për punë publike (pajisjet), marrjes me qira të objekteve, zbatimin e procedurave gjyqësore, hartimin dhe zbatimin e programit ekonomik, pagave dhe shpërblimeve, hartimin e dokumentacionit të tenderimit etj.

Opinion i pamodifikuar, pa kualifikuar¹

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Shoqërisë “UKT” SHA me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të kësaj Shoqërie.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se veprimtaria e Shoqërisë “UKT” SHA, në të gjitha aspektet është kryer në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi dhe justifikon dhënien e një modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë.

Baza për opinionin e pamodifikuar/pakualifikuar të përputhshmërisë.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale.

¹ **Opinion i pamodifikuar** Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar për besueshmërinë e llogarive kur arrin në përfundimin se llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Në mënyrë që të formojë këtë opinion, audituesi duhet të konkludojë se ka marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Konkluzionet dhe opinionit ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Shoqëria UKT” SHA, e cila konsiderohet nga ana e jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme.

Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionit me siguri të arsyeshme.

Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, ISSAI 1500 (ISA 500) dhe ISSAI 1530 (ISA 530); Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit, kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie.

Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinionit të gabuar rreth objektivit të auditimit.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, nga gjetjet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e opinionit të mësipërm, veçojmë:

- Për periudhën 06.10.2018-03.03.2021, Shoqëria ka kryer aktivitetet pa qenë e licencuar nga Enti Rregullator i Ujit (ERU). Për këtë periudhë kjo shoqëri ka qenë në proces licensimi, duke shkëmbyer dokumentacion shkresor të njëpasnjëshëm me ERU. Pas datës 04.03.2021 kjo shoqëri është pajisur me Licencë.

- Në strukturën e pagave vendosja e nivelit të pagës për secilin pozicion nuk është vlerësuar bazuar në kriteret të mirë përcaktuar si arsimimi (niveli i diplomës si master shkencor, master profesional, bachelor apo diplomë e shkollës së mesme), kualifikimi (njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet etj) përgjegjësia (shkalla e përgjegjësisë në funksion të riskut që mund të ketë puna që kryhet) etj.

-Këshilli i Administrimit nuk ka analizuar raportin për ecurinë e shoqërisë, raport që administratori duhet ta paraqesë një herë në muaj në këshill, si dhe nuk ka kryer verifikim dhe kontroll të llogarive vjetore të shoqërisë brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar.

-Në strukturën organizative të shoqërisë, për vitin 2021” janë punësuar 1382 punonjës dhe ndër ta 105 punonjës janë pompistë/pompist klorinues, 6 prej tyre nuk janë të pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

-Nga Organet Drejtuese të Shoqërisë, nuk janë marr masa për të rinegociuar kontratën/marrëveshjen me Qiradhënësin për të bërë amendimet përkatëse me qëllimin e rikuperimit të vlerës 28,329,607 lekë për investimet e kryera por të pa kthyeshme.

- Në kontratën nr. 10728 prot., datë 12.06.2019 me objekt “Marrja me qira e tokës mbi të cilën është ndërtuar depo uji me vendodhje në Fshatin Surrel, u konstatua një diferencë 109.5 m2 duke përfituar padrejtësisht vlerën 1,545,045 lekë.

- Në procedurën e prokurimit “Zhbllokim pusetash”, viti 2022, për vlerën 19,994 mijë lekë, është përfituar padrejtësisht nga Shoqëria vlera 952,076 lekë.

-Në procedurën e prokurimit “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, viti 2019, për vlerën 99,903 mijë lekë, në preventiv nuk është pasqyruar pajisja hardware e

komunikimit DCU që mundësojnë transmetimin në kohë reale në Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të dhënave, pajisje e cila është në projekt.

-Shoqëria “UKT” Sh.a për periudhën 2021, ka instaluar 4776 matës inteligjent të ujit të pijshëm. Instalim i matësve inteligjent është realizuar pa kryer më parë, vlerësim ekonomik.

-Për periudhën objekt auditimi mbetjet të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike; tubacione, saraçineska etj) të cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë të projekteve të ndryshme, depozitohen në Landfill-in e Sharrës, Landfill i administruar nga Shoqëria. Për këtë depozitim nuk ka kontratë të lidhur ndërmjet Shoqërisë “UKT” SHA dhe Shoqërisë. Faturim është bërë me çmimi 800 lekë/tonë inerte (mbetje nga ndërtimet dhe prishjet) dhe 246.7 lekë/tonë për dhera dhe shtuf, çmime të vendosura nga Shoqëria, pa miratimin e Bashkisë Tiranë. Transportimi është bërë nga UKT pa patur Licencën tipit III.2.B e pajisur vet ose nëpërmjet nënkontraktore për transport të mbetjeve në destinacionin e përcaktuar, si dhe mjetet e angazhuara për këtë qëllim.

- Shoqëria “UKT Tiranë” SHA është penalizuar në vlerën 34,992,188 lekë nga mos zbatimi i procedurave gjyqësore po në të njëjtën vlerë, për mos respektim të afatit të ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujë si lëndë të parë”, viti 2021, në vlerën 99,903 mijë lekë, nuk është siguruar kontrata për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta, si dhe Autoriteti Kontraktor, nuk ka zgjatur periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit, ose nuk ka bërë vet siguracionin dhe të zbrësë koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

-Nga auditimi i zbatimit të 6 kontratave për realizim dhe mirëmbajtje sistemesh, është evidentuar dëm ekonomik në vlerën 15,942 mijë lekë dhe efekt negativ financiar në vlerën 5,434 mijë lekë.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të Shoqërisë “UKT” SHA

Strukturat drejtuese të Shoqërisë “UKT” SHA janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e raportit përfundimtar të auditimit. Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur sipas përcaktimeve ligjore është vendosur që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 447/2 prot., datë 03.06.2022, i ndryshuar, nga data 08.06.2022 deri 30.11.2022, në Shoqërinë “UKT” SHA, për periudhën nga data 01.09.2018 deri me datë 31.10.2022, u krye auditim “Përputhshmërie dhe rregullshmërie” me përbërje:

1. F.I, Përgjegjës grupi,
2. I.S, Audituese,
3. S.H, Auditues

4. K.S, Audituese,
5. B.S, Auditues,

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

a. Objekti i auditimit:

- Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: Rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.
- Njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).
- Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

b. Qëllimi i auditimit:

- Është;
- vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Shoqëria “UKT” SHA.
- dhënia e opinionit mbi rregullshmerinë dhe përputhshmërinë apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimet².

c. Identifikimi i çështjes:

Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të Shoqërisë “UKT” SHA, në funksion të zbatimit të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij.

Në funksion të këtij angazhimi, janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e kriterëve mbi administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, vendimmarrja e organeve drejtuese etj. Në fokusin e angazhimit janë përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare Vjetore nga ana e kësajë Shoqërie në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi nënligjore në fuqi në fushën e kontabilitetit të sektorit publik dhe pasqyrave financiare, si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar.

Aktivitetet e vlerësuara nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr. 447/2 prot., datë 03.06.2022, i ndryshuar.

2 -Rregullorja e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar nga Kryetari KLSH me Vendimin nr. 107, datë 8.9.2017, me ndryshimet.

d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike, zbatimin e kuadrit rregullator ligjor dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare. Këto njësi duhet që të menaxhojnë burimet dhe të ushtrojnë autoritetin në përputhje me vendimet dhe kërkesat e legjislacionit.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe për vendosjen dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm, që ai i konsideron të nevojshme, për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa anomali materiale për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Është përgjegjësi e subjektit të audituar për të siguruar besueshmërinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare, si edhe pohimet respektive në pasqyrat vjetore.

Drejtimi ka përgjegjësinë e tij për hartimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kontrollit të brendshëm për të parandaluar, ose për të zbuluar dhe rregulluar gabimet materiale ose mospërputhshmëritë, që të jetë i përshtatshëm për këtë qëllim.

Drejtimi dhe menaxhimi janë përgjegjës për përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisë publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. Ata përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator.

Është përgjegjësi e drejtuesve të njësive publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullative.

Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Në këtë kontekst duhet:

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (*INTOSAI*), bazuar në këto standarde në aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryej në mënyrë efektive auditimin (*ISSAI 1300*)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse (*ISSAI 1500/ISA 300*).

-Të kryej procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në *ISSAI*-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe *ISSAI* 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të vlerësuar përputhshmërinë e aktivitetit. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson

identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

f. Kriteret e vlerësimit: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA)IFAC; (ISSAI) të INTOSAI-t; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Baza Ligjore:

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” , i ndryshuar; Ligji nr. 8901, datë 23.05.20012 “Për falimentin”, i ndryshuar; Ligji nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura si titull ekzekutiv”, i ndryshuar; Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” i ndryshuar; Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve; Ligji nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës, i ndryshuar; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”; Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 26.11.2003 “Për arkivat”; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar”, Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar; Ligji nr. 8116, date 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës e Shqipërisë”, i ndryshuar”; VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UK”; VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar; VKM nr. 63, 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura”, me objekt shërbimi në zbatim të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 510, datë 10.05.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; VKM nr. 914 date 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”; VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, me ndryshimet vijuese të tij; Rregullore, Udhëzues dhe Akte të tjera administrative, në fuqi, objekti i të cilave lidhet me këtë fushë të veprimtarisë.

g. Standardet e auditimit:

- ISSAI 100- (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*);
- ISSAI 4000- (*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*);
- ISSAI 400 - (*Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë*);
- SNA) të IFAC - (*Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*);
- Manual i IDI-t -(*Implementimi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI për auditimet e përputhshmërisë*);
- *Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë*;
- Rregullore e Procedurave të Auditimit në KLSH-së*;
- Kodi etik i KLSH*.

h. Metoda e auditimit:

Auditim i njëpasnjëshëm me zgjedhje dhe ose i plotë sipas gjykimit të audituesit.

i. Dokumentimi i auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur konkluzionet dhe raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e evidencave të marra, akt-konstatimeve të mbajtur, observacioneve të paraqitura u përgatit Raporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Organizmi dhe funksionimi i Shoqërisë është në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, VKM nr. 63, 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura”, me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 510, datë 10.05.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

- Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë së krijuar sipas Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, është:

- Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
- Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm si dhe të impianteve të pastrimit të tyre;
- Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
- Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
- Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre;

-Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi;
-Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

Shoqëria "UKT" sh.a është audituar nga KLSH në bazë të programit të auditimit nr.893/1 prot, datë 31.07.2018, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2017 deri në datë 31.08.2018. Në përfundim të auditimit pranë UKT sh.a është dërguar me shkresën nr.893/6 prot, datë 30.11.2018, regjistruar në UKT sh.a me nr.K-4701 prot, datë 05.12.2018, Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet.

Drejtori i Përgjithshëm ka hartuar Relacionin nr.27551/4 prot, datë 10.12.2018 "Mbi rekomandimet e lëna nga auditimi i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit" drejtuar Këshillit të Administrimit të shoqërisë.

Me vendimin e Këshillit të Administrimit nr.20, datë 12.12.2018 është vendosur zbatimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit të lëna me Raportin Përfundimtar të Auditimit nr.893/6 prot, datë 30.11.2018, sipas Relacionit nr.27551/4 prot, datë 10.12.2018.

Në zbatim të këtij vendimi, me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.644, datë 21.12.2018 "Për miratimin e planit të veprimeve për zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga KLSH, me Raportin përfundimtar nr.893/6 prot, datë 30.11.2018", është miratuar plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Afati ligjor i përcaktuar në nenin 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ku përcaktohet se duhet dërguar informacion brenda 6-muajve nga marrja dijeni, është ezauruar pasi, në bazë të programit të auditimit nr. 429 prot, datë 10.06.2019 të KLSH, në UKT Sh.a është ushtruar auditimi me objekt "Mbi verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditin e mëparshëm me periudhë auditimi nga data 11.06.2019 deri më 09.07.2019, brenda afatit 6-mujor.

Me shkresën nr.429/33 prot., datë 14.08.2019, KLSH ka rikërkuar zbatimin e rekomandimeve të pa pranuar dhe të pa zbatuara.

Shoqëria "UKT" Sh.a, nuk ka zbatuar dhe realizuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH-së të dhëna nga auditimet e mëparshme. Konkretisht janë rekomanduar 9 masa organizative, janë pranuar 9, prej të cilave 5 janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht, dhe 3 masa janë në proces zbatimi.

Janë rekomanduar 4 masa për shpërblim dëmi me vlerë totale 603,629 lekë, nga të cilat nuk janë pranuar dhe zbatuar 2 masa në vlerën 218,388 lekë, 1 masë në vlerën 42,000 lekë është pranuar dhe nuk është zbatuar, 1 masë në vlerën 343,241 lekë e cila është zbatuar pjesërisht.

Për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike janë rekomanduar 4 masa në vlerën 11,911,884 lekë, prej të cilave nuk janë pranuar dhe zbatuar 2 masa në vlerën 2,619,880 lekë, janë pranuar 2 masa në vlerën 9,292,000 lekë, të cilat janë zbatuar plotësisht.

Janë rekomanduar 2 masa për dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi me vlerë totale 26,712,000 lekë nga të cilat 1 masë në vlerën 9,110,000 lekë është pranuar dhe zbatuar plotësisht dhe 1 masë në vlerën 17,602,000 lekë është pranuar dhe është në proces zbatimi. Theksojmë se për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera 78,400,727 lekë.

Në mënyrë të detajuar mos zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

3. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve, u konstatua se:

-Me anë të Urdhrave të Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 720, datë 01.11.2016 dhe nr. 58, datë 24.01.2018, është urdhëruar ndryshimi i orarit zyrtar të punës së shoqërisë nga hëna deri në të enjte do të jetë 08.00-16.00, ditën e premte 08.00-14.00 dhe ditën e shtunë 08.00-12.00. Sipas këtyre urdhrave konstatohet se për periudhën 01.11.2016-12.06.2017 dhe për periudhën 01.02.2018-31.05.2018, gjatë ditëve të javës punonjësit e shoqërisë kanë punuar 36 orë në javë, ndërsa 4 orët e mbetura janë zëvendësuar ditën e shtunë, duke punuar 4 orët të plota. Por zëvendësimi i kryer gjatë ditës së shtunë, e cila është një nga ditët e pushimit javore dhe si e tillë duhej kryer me një pushim shtesë jo më pak se 25% të kohëzgjatjes së punës. Për sa më sipër, konstatohet se për periudhën 01.11.2016-12.06.2017 (32 javë) dhe për periudhën 01.02.2018-31.05.2018 (17 javë), për një total prej 49 javësh, punonjësit e administratës së shoqërisë janë paguar me 1 orë më pak në javë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 87, pika 1.

-Gjithashtu në pikën 1/b, të nenit 8, të Rregullores së Brendshëm të shoqërisë, përcaktohet i njëjti orar, i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 87, pika 1, për arsye se nuk parashikohet një pushim shtesë jo më pak se 25% të kohëzgjatjes së punës.

-Nga auditimi i rekrutimit të punonjësve, konstatohet se në zbatim të nenit 7/a, të Rregullores së Brendshëm, rekrutimi i nënshtrohet dispozitave të Kodit të Punës. Duke qenë se Kodi i Punës nuk përcakton se si duhet të kryhet rekrutimi i punonjësve, UKT ka hartuar një pyetësor për procedurat e rekrutimit dhe dokumentacionin që duhet paraqitur nga punëmarrësit. Por kjo rregullore nuk parashikohen procedura mbi shpalljen e vendeve vakante, por vetëm të atyre personave që kanë dorëzuar pranë Burimeve Njerëzore të shoqërisë kërkesë për punësim.

-Për 4 punonjës, është shtyrë ndërprerja e marrëdhënieve të punës për punonjës të shoqërisë pas mbushjes së moshës së daljes në pension me mbi 6 muaj, në kundërshtim me VKM nr. 478, datë 16.06.2010 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie”, pika 4, e cila përcakton se: “*Organet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, me plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në zbatim të dispozitës së mësipërme ligjore, me mbushjen e moshës së daljes në pension, nga UKT duhej kryer ndërprerja e marrëdhënieve të punës.*

-Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë dhënë shpërblime në 3 raste (1 rast për festat e fundvitit dhe 2 raste për festën e 8 marsit), vetëm me urdhrat e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm, pa u marrë më parë miratimet në Këshillin Mbikëqyrës (Këshillin e Administrimit), në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, i ndryshuar, neni 6, pika 1, gërma b.

-Nga auditimi me zgjedhje për 37 dosje personeli u konstatua se: në 5 raste (3 nga këto staf drejtues), mungonte dëshmia e penalitetit; në 4 raste (2 nga këto staf drejtues), mungonte jetëshkrimi (CV); në 4 raste, mungonte adresa e punëmarrësit; në 4 raste (të gjithë staf drejtues), mungonin kërkesat për punësim të punëmarrësit; dhe në 6 raste (të gjithë staf drejtues), mungonte raporti mjekësor që është i aftë për punë për punëmarrësit. Veprime këto në kundërshtim me Kontratën Kolektive nr. 1902/1, datë 03.06.2013, neni 13 dhe Kontratën Kolektive nr. 949, datë 25.07.2018, neni 8.

3.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masat për sistemimin dhe plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas Kontratës Kolektive nr. 949, datë 25.07.2018.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit:

Drejtorja e Burimeve Njerëzore ka marrë masat për sistemimin dhe plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas Kontratës Kolektive të Punës nr.949 prot, datë 25.07.2018, neni 8, por nga auditimi u konstatua se ka dosje të pa plotësuara, në mënyrë të detajuar pasqyrohen në akt konstatimin nr. 18, datë 30.11.2022.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të shoqërisë, u konstatua se:

-Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion për grupin e auditimit u konstatua se audituesit e pavarur të pasqyrave financiare, nuk kanë dorëzuar dokumentin Letra për Drejtimin e cila përmban rekomandimet për përmirësimin e situatës në kundërshtim me Kontratën nr. 4767 prot., datë 08.02.2018.

Gjithashtu në bazë të Shtojcës nr. 1, Letra e Angazhimit (pjesë integrale e kontratës së shërbimit) audituesit deklarojnë se auditimi dhe puna e kryer prej tyre mbështetet mbi SNA. Nga auditimi i dokumenteve të vendosura në dispozicion u konstatua se audituesit e pasqyrave financiare, nuk janë shprehur për zbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 250 “Mbajtja Parasysh e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare”, për arsye se në bazë të gjetjeve të auditimit të ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, janë konstatuar parregullsi të shumta, si psh në prokurimet publike, në pagesat e kryera në paga. Në raportet e auditimit të sipërcituara, nuk gjejnë vend rezerva në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, së transaksioneve dhe llogarive që përbëjnë këto pasqyra financiare, çka nënkupton se auditimi nuk është kryer plotësisht në përputhje me SNA. Për pasojë grupi i auditimit shprehet me rezervë në dhënien e një opinionit të plotë dhe të saktë mbi zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi të cilin kanë ushtruar aktivitetin e tyre ekspertët kontabël të autorizuar.

-Për llogarinë Aktive Afatgjata Jomateriale përfshin edhe llogarinë “Emri i mirë” në vlerën 717,064 mijë lekë, të njohur nga përthithja e fiskal njësisë “H” SHA. Gjatë vitit 2017 UKT SHA nuk ka njohur zhvlerësim për këtë zë të bilancit i cili në bazë të SNK 36 “Zhvlerësimi i aktiveve” duhet të testohet për vlerën e tij çdo vit.

-Për llogarinë “Aktive Afatgjata Materiale” përfshin vlerën 1,026,003 mijë lekë të mbartura nga periudhat e mëparshme për punime të kryera nga nënkontraktorët të AKUK (ish-DPUK). Nga dokumentacioni i venë në dispozicion nga UKT SHA nuk krijohet besueshmëri e arsyeshme në lidhje me vlerën 1,026,003 mijë lekë.

-Për llogarinë “Inventarët” përmban vlerën e materialeve tërësisht apo pjesërisht të vjetruar për shkak të kohës dhe ndryshimeve teknologjike në vlerën 81,275 mijë lekë. Ndërkohë që vlera e zhvlerësimin të inventarëve është 44,017 mijë lekë. Në bazë të SNK 2 “Inventarët” duhet të llogaritet shuma e zhvlerësimit shtesë, por në bazë të dokumentacionit të venë në dispozicion grupi i auditimit nuk mund të llogaritet dhe mund të sillte pasoja mbi vlerën e inventarëve dhe rrjedhimisht në vlerën e rezultatit në pasqyrat financiare të konsoliduara.

-Për Llogari të arkëtueshme me vlerën 2,690,010 mijë lekë konstatohet se UKT SHA ka përdorur si metodologji çmuarjen dhe zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme bazuar mbi përqindje të paracaktuara mbi 4 klasa të riskut në bazë të numrit të faturave të papaguara për çdo kategori klientësh. Metodologjia e përdorur nuk përfshin ndonjë analizë mbështetëse për të justifikuar masën e përqindjeve të përdorura për provigjionimin e llogarive të arkëtueshme. Për më tepër,

metodologjia e aplikuar nuk është në përputhje me kërkesat e SNK 39, standard i cili kërkon vlerësim individual për llogaritë e arkëtueshme individualisht dhe vlerësim kolektiv për llogaritë e tjera bazuar në të dhëna të plota historike.

-Për llogarinë “Huamarrje afatshkurtra” në vlerën 1,804,645 mijë lekë, një pjesë e kësaj shume (vlera 1,205,077 mijë lekë) nuk është contabilizuar në monedhën origjinale por vetëm në lekë dhe për pasojë nuk reflektohen ndryshimet në vlerë si pasojë e ndryshimit të kursit të këmbimit në datën 31.12.2017, në kundërshtim me SNK 21 “Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit”.

-Për llogarinë “Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime” me vlerë 465,222 mijë lekë, nga të cilat 463,122 mijë lekë grante afatgjata, 1,777 mijë lekë grante afatgjata rrjet kanalizime dhe 323 mijë lekë grante dhurata pajisje informatike. Nga informacioni i vendosur në dispozicion konstatohet se është i pamjaftueshëm për shprehjen e një sigurie të mjaftueshme në lidhje me këto vlera.

-Për sa i përket detyrimeve tatimore konstatohet se në datë 28.05.2018 Drejtoria e Përgjithshme ka lëshuar raportin e kontrollit tatimor për periudhën deri në 20.11.2017 (përpara ndarjes së shoqërisë), detyrimi që ka rezultuar nga ky akt kontroll dhe e konfirmuar edhe nga Komisioni të Shqyrtimit të Apelimit Tatimor Vendim nr. 42, datë 22.10.2018 është 13,116 mijë lekë. Shoqëria mëmë nuk ka paraqitur në pasqyrat e konsoliduara të datës 31.12.2017 nuk ka reflektuar këtë ngjarje pas datës së bilancit e cila do të ndryshojë rezultatin financiar.

-Në seksionin e kapitalit të shoqërisë mëmë përpara ka qenë e përfshirë rezerva e rivlerësimit prej 3,219,601 mijë lekë, ndërkohë që me krijimin e shoqërisë së re të UKT SHA pjesa e tepricës së rivlerësimit që i takon kësaj shoqërie i është bashkuar kapitalit aksioner duke e rritur atë. Kjo mënyrë rritje kapitali nuk është e parashikuar në asnjë nga format e rritjes së kapitalit në kundërshtim me Kapitullin Zmadhimi i Kapitalit dhe nenet përkatëse të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Gjithashtu teprica e rivlerësimit duhet të evidentohet më vete sipas kërkesave të SNK 16 “Aktiveve Afatgjata Materiale” dhe të përdorej në vijim në përputhje me kërkesat e këtij standardi. Ne nuk jemi në përputhje me kërkesat e këtij standardi.

-Bazuar në shënimin 1.1 të pasqyrave financiare të konsoliduara menaxheriale, raporti i ndarjes së shoqërisë është bazuar mbi pasqyrat financiare të shoqërisë të datës 31.12.2016 (të pa audituara).

-Grupi i auditimit ka shkuar në inspektim në magazinën e UKT SHA në Brar dhe u konstatua se kjo magazine ka një numër shumë të madh artikujsh dhe gjendja dhe organizimi i saj nuk linte mundësinë e identifikimit të artikujve pasi janë pa barkode dhe jo të vendosura nëpër rafte. Grupi i auditimit shpreh rezerva në lidhje me procesin e inventarizimit të kryer në këtë magazine dhe përputhjen e vlerës kontabël (vlerës në bilanc) me atë fizike.

-Nga auditimi rezulton se në pasqyrat financiare të shoqërisë UKT SHA nuk është pasqyruar vlera e kredisë së marrë nga qeveria japoneze për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, është ratifikuar me ligjin nr. 9964, date 24.07.2008 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë për financimin e projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”. Për këtë kredi UKT SHA ka nënshkruar marrëveshjen e nën-Huasë me Ministrinë e Financave datë 12.02.2009 për të cilën UKT SHA ka rënë dakord për marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve financiare si përfitues fundor i projektit.

-Llogaritja e pagave dhe shpërblimeve mbahen jashtë programit financiar por në Excel, dhe hidhet me veprim ekstrakontabël.

-Në magazinat e UKT SHA ka pjesët rezervë të projektit “Rehabilitimi i rrjetit hidrik në Tiranë”, të lëna në ambientet e magazinës pa u bërë hyrje, pa u marrë në dorëzim nga përgjegjësi i

magazinës dhe pa asnjë dokumentacion dëshmues. Nuk ka asnjë dokument ku të trajtohet se si janë apo kush i ka sjellë këto materiale, si dhe kush i ka pranuar në magazinë pa kryer veprimet ligjore.

4.3 Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa për kontabilizimin e vlerës së kredisë së marrë nga qeveria japoneze për projekti “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, ratifikuar me ligjin nr. 9964, date 24.07.2008 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë për financimin e projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”. Për këtë kredi UKT SHA ka nënshkruar marrëveshjen e nën-Huasë me Ministrinë e Financave datë 12.02.2009 për të cilën UKT SHA ka rënë dakord për marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve financiare si përfitues fundor i projektit.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit:

Nuk është kontabilizuar, pasi është bërë një ndryshim marrëveshje nënë huaje me MF dhe Ekonomisë me nr.17786/5 prot ,datë 02.04.2019 dhe UKT me nr.6896 prot ,date 04.04.2019 Për projektin “Përmirësim i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e Madhe”. Kontabilizimi duhet të bëhet me marrjen në dorëzim te projektit.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

6. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave, u konstatua se:

- Nga UKT janë kryer procedura prokurimi, të cilat kanë rezultuar në marrëdhënie kontraktuale me transaksione në vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhën e vitit ushtrimor, bazuar në vlerën e materialitetit të përlllogaritur (365,464,680 lekë), deri më tani janë filtruar 9 procedura prokurimi, në vlerën totale 527,585 mijë lekë.

Nga auditimi u konstatua se përgjithësisht është zbatuar Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Pavarësisht nga sa cituam më sipër, nga auditimi i këtyre procedurave u konstatuan, shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi në fazën e përgatitjes së dokumentacionit të tenderimit, zhvillimit të procedurave të tenderimit dhe zbatimit të kontratave, kryesisht si më poshtë vijon:

-Në 5 raste është konstatuar vendosja e specifikimeve teknike kufizuese për mallrat që do prokurohen, duke mos i argumentuar vendosjen e tyre, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20.

-Në 6 raste, përlllogaritja e vlerës së kontratës është kryer në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2, për arsye se grupi i punës nuk ka dokumentuar arsyen e zgjedhjes së OE për studimin e tregut, si dhe nuk ka dokumentuar komunikimin me këta OE.

-Në 9 raste janë vendosur kërkesa dhe kriteret për kualifikim, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 20, 26, 27 dhe 28.

-Në 2 raste nuk është argumentuar vendosja e kriterëve dhe kërkesave për kualifikim, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në 9 raste, Raporti Përmbledhës është hartuar në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 68, për arsye se nuk përmban gjithë informacionin e kërkuar si numër reference, përshkrim i mallrave/shërbimeve/punëve që do prokurohen, si dhe informacion mbi ankesat.

-Në 3 raste procesi i vlerësimit është kryer në tejkalim të afatit kohor prej 15 ditësh, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 66, pika 2.

-Në 7 raste, procesi i vlerësimit është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pika 1 dhe nenin 53, pika 3, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73, pika 1.

6.1 Rekomandimi: Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballeshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj, titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste vlerësimi i ofertave konstatohet jo korrekt.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit:

Nga audimi u konstatuan raste të mos llogaritjes të saktë të fondit limit, përcaktimit të kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është realizuar pjesërisht.

7. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i prokurimeve me vlerë të vogël, u konstatua se:

- Për vitin 2017 është konstatuar problematika e copëzimit të fondit për blerje pjesë këmbimi automjetesh ku vlera totale e kontratave të nënshkruara me operatorët fitues është 2,618,057.6 lekë dhe për blerje materiale ku vlera totale e kontratave të nënshkruara me operatorët fitues është 2,328,659 lekë, veprime këto në kundërshtim me nenin nr.40 dhe nenin nr.59, të VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe nenin 28 dhe 29/5 të ligjit nr.9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

- Në 3 raste për operatorët ekonomik fitues mungon vërtetimi nga OSHEE për mospasjen e asnjë detyrimi të maturuar për pagesën e energjisë elektrike edhe pse nga titullari është konsideruar se mosdorëzimi i një prej dokumentave të kërkuara, është kusht për skualifikimin e operatorit fitues, në kundërshtim me DT.

7.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë të marri masa, që procedurat e prokurimit “Blerje me vlera të vogla”, të bëhen vetëm mbi bazën e një argumentimi ligjor për domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj procedure.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit:

Nga audimi u konstatuan raste të coptimit të fondeve dhe nuk është përshkruar në formë të detajuar objekti i prokurimit

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është realizuar pjesërisht.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje makineri pajisje (automjete)”, viti 2018, konstatohet se z. M.Q, i cili ka qenë në pozicionin e kryetarit të KVO për të dy procedurat, ka mbajtur dy qëndrime të ndryshme (dy standarde), në dy procedura të ndryshme, ku të njëjtën mangësi e kualifikon në procedurën e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i linjës DN-150mm gize dhe rikonstruksion rrjet kanalizimi i rrugës “Mihal Grameno””, ndërsa e skualifikon në procedurën e zhvilluar me objekt “Blerje makineri pajisje (automjete)”. Në këto kushte **vlera 180,000 lekë**, që përbën diferencën midis B “T” SHPK & “P”

SHPK të skualifikuar në kundërshtim me LPP dhe ofertës së OE “L” SHPK të shpallur fitues, përbën **dëm ekonomik për shoqërinë UKT SHA.**

1.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë **vlerën 180,000 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e zhvilluar me objekt “Blerje makineri pajisje (automjete)”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shoqërisë.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit:

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.

2. Gjetje nga Auditimi: Nga kontrolli fizik i tollonave që mbaheshin në kasafortën e magazinës ishte që nga numërimi i tyre rezultoi se 110 litra naftë, me vlerë 20,108 lekë, ishin të pavlefshëm pasi nuk kishin Bar Code, duke i bërë të pavlefshëm pasi ato nuk pranohen nga pikat e furnizimit. Vlera **20,108 lekë** përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë. Gjithashtu u konstatua se 100 litra nuk ishin të UKT pasi ishin me logo të institucioneve të ndryshme, një fenomen ky i pa justifikuar sesi kanë përfunduar te kasaforta e UKT. Nga dokumentacioni i paraqitur nuk mund të vërtetohet plotësisht kryerja e shpenzimeve për këto 100 litra naftë me vlerë **18,280 lekë.**

2.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **38,388 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në administrimin e karburantit të shoqërisë, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shoqërisë.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit:

Sipas Urdhrit nr.206, datë 13.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë “Për shpalljen debitorë të punonjësve dhe ish-punonjësve të shoqërisë për dëmin e shkaktuar në bazë të konstatimeve të KLSH-së me Raportin nr.893/6 prot, datë 30.11.2018”, pika 2, janë shpallur debitorë solidarë punonjësit e shoqërisë Z.M.V/Përgjegjës i Sektorit të Transportit, Z.M.M/Magazinier Magazina nr.2 për dëmin e shkaktuar në vlerën 38,388 (tridhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë) lekë, konstatuar nga KLSH në auditimin e procesit të administrimit të karburantit.

Vlera 38,388 lekë është kontabilizuar, po nuk është arkëtuar nga punonjësit përgjegjës.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

3. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve për kompanitë telefonike ka rezultuar se deri më datën 31.08.2018 kur mbaroj auditimi rezultoi se për UKT Sh.a detyrimi në total ndaj kompanive celulare është **343,241 lekë**, detyrime nga punonjësit e larguar. Kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë.

3.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe Drejtoria Ekonomike, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **343,241 lekë**, ndaj punonjësve të larguar për detyrimin e tyre ndaj kompanive celulare, për arsye se kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shoqërisë.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit:

Në zbatim të Urdhrit nr.644, datë 21.12.2018 “Për miratimin e Planit të veprimeve për zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga KLSH, me Raportin përfundimtar nr.893/6 prot, datë 30.11.2018” është arkëtuar vlera **299,698 lekë** dhe ka mbetur pa arkëtuar vlera **43,542 lekë.**

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje elektropompë”, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik fitues “A G” Sh.p.k është 330,000 lekë pa TVSH. Në datën 15.02.2017 është bërë Akt-Kolaudimi për mallin e dorëzuar në ambientet e UKT. Nga shqyrtimi i dosjes të procedurës së prokurimit është konstatuar se me faturën tatimore me nr. 37, datë 15.02.2017 për këtë elektropompë është paguar shifra 365,000 lekë pa TVSH (438,000 lekë me TVSH), kur oferta e OE ishte 330,000 lekë pa TVSH, pra është paguar më shumë dhe në mënyrë të pajustificuar më shumë vlera **42,000 lekë** me TVSH, vlerë kjo e cila përbën **dëm ekonomik për buxhetin e UKT SHA**.

4.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **42,000 lekë** vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e zhvilluar me objekt “Blerje elektropompë”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shoqërisë.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit:

Sipas Urdhrit nr.206, datë 13.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë “Për shpalljen debitorë të punonjësve dhe ishpunonjësve të shoqërisë për dëmin e shkaktuar në bazë të konstatimeve të KLSH-së me Raportin nr.893/6 prot, datë 30.11.2018”, pika 3, janë shpallur debitorë solidarë, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të kolaudimit, punonjësit e shoqërisë Z.E.Ç, Z.K.I dhe Z.A.A, për dëmin e shkaktuar në vlerën **42,000 (dyzetedy mijë) lekë**, konstatuar nga KLSH në auditimin për pagesën në mënyrë të pajustificuar të operatorit ekonomik “A G”.

Vlera 42,000 lekë është kontabilizuar, po nuk është paguar nga punonjësit përgjegjës

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga Auditimi: Për vitin 2017, Këshilli Mbikëqyrës është mbledhur 3 herë dhe ka marrë 22 vendime dhe përkatësisht në datat 06.07.2017, 25.09.2017, 13.12.2017. **Vlera 1,515,600 lekë**, që përbën pagesën e kryer për Këshillin Mbikëqyrës për 9 muajt që ky organ kolegjal nuk është mbledhur, përbën **efekt financiar negativ** për UKT SHA, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore”, pika 8.

1.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **1,515,600 lekë** vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në pagesat e kryera ndaj Këshillit Mbikëqyrës, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **efekt financiar negativ** për Shoqërinë.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit:

Pagesa e Këshillit Mbikëqyrës është bërë bazuar në VKM Nr.642, datë 11.10.2005 në pikën 7 të të cilit përcaktohet se: Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është mujor dhe jepet nga mbledhja e pare e këshillit. Efektet përballohen nga vetë shoqëria anonime.

Ky akt nënligjor përcakton qartë se pagesa e këshillit është mujore dhe jepet nga mbledhja e parë (konstitutimi/emërimi) i këtij këshilli dhe nuk është pagesë që kryhet në bazë të numrit të mbledhjeve, pasi nëse do të ishte e tillë ky këshill duhet të paguhej më tepër kur mbledhjet i bën me intervale më të shpeshta se një herë në katër muaj. Në këto kushte, bazuar në faktin që Këshilli ka marrë të gjitha vendimet që përcaktohen si kompetenca të tij, në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në Statutin e saj dhe në interesat e shoqërisë, pagesa e tij është një shpenzim me efektivitet të plotë.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.

3. Gjetje nga Auditimi: Nga kontrolli në magazinën e UKT është konstatuar një sasi e konsiderueshme litar amianti e cila ishte e papërdorur asnjë herë nga UKT. Në vitin 2011 është bërë hyrje në magazinë sasia prej 1,200 kg litar amianti me vlerë 1,170,000 lekë. Deri më datën 20.10.2017, kur ky mall është propozuar për jashtë përdorimit, nga sasia prej 1,200 kg janë përdorur vetëm 72 kg. Mos përdorimi i këtij produkti ka bërë që në magazinë të jenë në gjendje stoku 1,128 kg në vlerën **1,104,280 lekë**, vlerë kjo e cila ka sjellë **efekt negativ financiar** për buxhetin e UKT SHA.

3.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **1,104,280 lekë** vlerë e cila ka të bëjë me vlerën e litarit të amiantit të prokuruar në vitin 2011 dhe të papërdorur, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **efekt financiar negativ** për Shoqërinë.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar

D. DËM EKONOMIK PA MUNDËSI ARKËTIMI

1. Gjetje nga Auditimi: Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë e paditur, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën 01.04.2017-31.12.2017, janë humbur 112 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 46,099,758.40 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbare dhe për periudhën 01.01.2018- 31.08.2018, janë humbur 53 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 32,300,969.16 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbare. Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës **vlera 78,400,727.56 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi për buxhetin e shoqërisë**. Gjithashtu konstatohet se janë në proces gjykimi (në Gjykatën e Apelit) dhe 39 çështje të tjera, për të cilat kërkohet vlera **17,602,000 lekë**, vlerë e cila do të rëndojnë akoma më shumë rezultatin ekonomiko-financiar të UKT.

1.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtorja Juridike e shoqërisë, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi. Më hollësisht është trajtuar në akt konstatimin nr.19, datë 30.11.2022.

1. Titulli i gjetjes:	Nuk janë zbatuar dhe realizuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH
Situata:	Shoqëria “UKT” Sh.a, nuk ka zbatuar dhe realizuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH-së të dhëna nga auditimet e mëparshme. Konkretisht janë rekomanduar 9 masa organizative, janë pranuar 9, prej të cilave 5 janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht, dhe 3 masa janë në proces zbatimi. Janë rekomanduar 4 masa për shpërblim dëmi me vlerë totale 603,629 lekë, nga të cilat nuk janë pranuar dhe zbatuar 2 masa në vlerën 218,388 lekë, 1 masë në vlerën 42,000 lekë është pranuar dhe nuk është zbatuar, 1

	<p>masë në vlerën 343,241 lekë e cila është zbatuar pjesërisht.</p> <p>Për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike janë rekomanduar 4 masa në vlerën 11,911,884 lekë, prej të cilave nuk janë pranuar dhe zbatuar 2 masa në vlerën 2,619,880 lekë, janë pranuar 2 masa në vlerën 9,292,000 lekë, të cilat janë zbatuar plotësisht.</p> <p>Janë rekomanduar 2 masa për dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi me vlerë totale 26,712,000 lekë nga të cilat 1 masë në vlerën 9,110,000 lekë është pranuar dhe zbatuar plotësisht dhe 1 masë në vlerën 17,602,000 lekë është pranuar dhe është në proces zbatimi. Theksojmë se për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera 78,400,727 lekë.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30.
Ndikimi/Efekti:	Risk menaxherial.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Shoqëria “UKT” Sh.a, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimet kanë rezultuar të pazbatuara, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

2.2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, (Këshilli Drejtues dhe Administratori) vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Shoqëria “UKT” sh.a është e organizuar dhe funksionon në bazë të dispozitave të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe Statutit të hartuar sipas statutit tip të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

Referuar dispozitave të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, kreu II, Këshilli i Administrimit, “Sistemi me një nivel” dhe VKM nr.63, datë 27.01.2016, organet drejtuese të shoqërisë janë organizuar sipas sistemit me një nivel.

Në bazë të nenit 5 të Statutit të shoqërisë organet e shoqërisë së “Ujësjetllës-Kanalizimeve Tiranë” sh.a., janë; Asambleja e Përgjithshme; Këshilli i Administrimit.

Asambleja e Përgjithshme (AP), referuar nenit 6, pika 1 të Statutit përfaqësohet nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, i cili merr vendime brenda kompetencave të parashikuara nga ligji për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

Këshilli i Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë një nga të cilët është edhe Drejtori i Përgjithshëm i cili është emëruar me Vendimin nr.8, datë 27.09.2017 të Asamblesë së Aksionarëve të UKT sh.a dhe Vendimin nr.5, datë 16.10.2020 “Për lirimin, mandatimin dhe rimandatimin e Këshillit të Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë “UKT” sh.a. Shpërblimi i Këshillit të Administrimit është vendosur me Vendim nr.18, datë 14.12.2017 “Për miratimin e pagesës së Këshillit të Administrimit të shoqërisë UKT sh.a”, të Aksionarit të vetëm të shoqërisë referuar kompetencave të përcaktuara në nenin 135, pika 2, gërma “d” të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, në Statutin e shoqërisë të hartuar

sipas statutit tip miratuar me VKM Nr.63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” neni 7 dhe 17, si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 3.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, pika 10. Ndërmjet Këshillit të Administrimit përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe Asamblesë/Aksionarit të vetëm janë lidhur kontratat si në vijim:

Kontratë Performance nr.5395 prot, date 14.02.2018;

Marrëveshje e shërbimit publik “Për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Bashkinë e Tiranës” nr.18006 prot., datë 29.10.2020.

Kryetari, Zv.Kryetari dhe Sekretari i Këshillit të Administrimit është emëruar me Vendimin nr.19, date 13.12.2017 “Mbi zgjedhjen e Kryetarit, Zv/Kryetarit dhe sekretarit të Këshillit të Administrimit të shoqërisë “UKT sh.a” të Këshillit të Administrimit, sipas kompetencave të përcaktuara në nenin 11, pika 5 të Statutit, vendim në të cilin është përcaktuar dhe masa e shpërblimit. Kryetari, Zv.Kryetari dhe Sekretari i Këshillit të Administrimit janë konfirmuar në këtë detyrë në mbledhjen e datës 04.11.2020, sipas procesverbalit nr.9/1 prot., datë 04.11.2020.

Për periudhën objekt auditimi Këshilli i Administrimit i UKT Sh.a është mbledhur në total 40 herë dhe ka marrë gjithsej 100 vendime, ndërsa Asambleja e Përgjithshme është mbledhur në total 27 herë dhe ka marrë gjithsej 48 vendime.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se organizimi, funksionimi i Këshillit Administrimit dhe Asamblesë, si dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra prej Tij, përgjithësisht është bërë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore dhe rregullatorë të nxjerra në zbatim të tyre.

Pavarësisht nga sa u deklarua mësipërm, u konstatuan shkelje të dispozitave dhe ligjore dhe mangësi të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

1.Në mbledhjet e Këshillit të Administrimit nuk është analizuar raporti për ecurinë e shoqërisë që administratori duhet ta paraqesë një herë në muaj në këshill, siç përcaktohet në Statutin tip, neni 18, pika 7, gërma ç , miratuar me VKM nr.63, datë Nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

2. Këshilli i Administrimit nuk ka kryer verifikim dhe kontroll të llogarive vjetore të shoqërisë brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar siç përcaktohet në Statutin tip, neni 18, pika 7, gërma ç , miratuar me VKM nr.63, datë Nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

3. Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Aksionarëve nuk kanë miratuar brenda afatit 6 mujor nga data e mbylljes së vitit financiar rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinimin e fitimit. Ky veprim bien ë kundërshtim me nenin 33/1, pika 1, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohet: *1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi.*

1.Titulli i gjetjes	Këshilli i Administrimit nuk ka analizuar raportin për ecurinë e shoqërisë, si dhe nuk ka kryer verifikim dhe kontroll të llogarive vjetore të shoqërisë brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar.
----------------------------	--

Situata:	Këshilli i Administrimit nuk ka analizuar raportin për ecurinë e shoqërisë, raport që administratori duhet ta paraqesë një herë në muaj në këshill, si dhe nuk ka kryer verifikim dhe kontroll të llogarive vjetore të shoqërisë brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar.
Kriteri:	VKM nr.63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” neni 18, pika 7, gërma ç.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos realizimin e objektivave të performancës dhe besueshmëri të rezultatit financiar.
Shkaku:	Mos zbatim i VKM nr.63, datë 27.1.2016
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandimi:	- Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrës të analizojë një herë në muaj raportin e ecurisë së shoqërisë për realizuar performancën/objektivat në terma vjetorë të parashikuar. - Nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrës të merren masa për të bërë verifikimin dhe kontrollin e llogarive vjetore të shoqërisë brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar.

2.Titulli i gjetjes:	Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Aksionarëve nuk kanë miratuar brenda afatit 6 mujor nga data e mbylljes së vitit financiar rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinacionin e fitimit.
Kriteri:	Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar neni 33/1, pika 1
Situata:	Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Aksionarëve nuk kanë miratuar brenda afatit 6 mujor nga data e mbylljes së vitit financiar rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinacionin e fitimit.
Ndikimi/Efekti:	
Shkaku:	Keq interpretime të dispozitave ligjore të ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrës dhe Asambleja e Aksionarëve të merren masa për të miratuar brenda afatit 6 mujor nga data e mbylljes së vitit financiar, rezultatit financiar të vitit paraardhës dhe destinacionin e fitimit.

2.3. Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë.

Në hartimin dhe zbatimin e programit ekonomik, përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” dhe Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, dhe statuti i shoqërisë.

Për vitin 2019 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr.18, datë 12.12.2018 "Mbi miratimin e Buxhetit të shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2019", i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 16, datë 13.12.2018. Për vitin 2020 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, datë 19.12.2019 "Mbi miratimin e Buxhetit të shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2020", i konfirmuar nga

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 11, datë 20.12.2019. Për vitin 2021 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 9, datë 04.11.2020 "Mbi miratimin e Buxhetit të shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2021", i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 7, datë 05.11.2020. Për vitin 2022, programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, date 26.11.2021 "Për miratimin e Buxhetit të shoqërisë UKT sh.a për vitet 2022", i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendimi nr.10, datë 13.12.2021.

-Për vitin 2019 dhe 2020 nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit të Administrimit dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve. Konkretisht: Për vitin 2019 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr.18, datë 12.12.2018 "Mbi miratimin e Buxhetit të shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2019". Ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim nr. 16, datë 13.12.2018 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve. Për vitin 2020 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, datë 19.12.2019 "Mbi miratimin e Buxhetit të shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2020". Ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim nr. 11, datë 20.12.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve.

Në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 2.5.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror", kapitulli III, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: "Drejtoritë e shoqërive ku shteti ka mbi 50% të aksioneve, hartojnë projekt programet dhe dërgojnë kopje të tyre, me relacionin shpjegues pranë këshillave mbikëqyrëse, brenda datës 1 dhjetor të çdo viti".

-Analiza e treguesve për programet ekonomike për periudhën objekt auditimi, në mënyrë të përmbledhur trajtuar si më poshtë:

Programet ekonomike të miratuara nga Asambleja Aksionare për periudhën objekt auditimi, në mënyrë të detajuar tabela si më poshtë vijon:

Nr .	Emërtimi	Njësia e matjes	Program i	Program i	Program i	Program i	Program i
			2018	2019	2020	2021	(Janar-Shtator 2022)
1	Të ardhura gjithsej	në mln lekë	4,711.05	4,777.92	4,741.53	4,617.60	3,465.34
2	Shpenzime gjithsej	në mln lekë	3,059.67	3,287.33	3,370.21	3,298.8	2,590.40
3	Investime gjithsej	në mln lekë	3,386.65	3,002.60	1,195.94	1,134.23	771.95

Burimi: "UK Tiranë" sha.

Për vitin 2018, të ardhurat janë planifikuar në vlerën 4,711.05 mln lekë dhe realizuar në vlerën 4,580.44 mln lekë ose në masën 97.23%, me diferencë mosrealizimi në vlerën 130.61 mln lekë. Për vitin 2019, të ardhurat janë planifikuar në vlerën 4,777.92 mln lekë dhe realizuar në vlerën 4,454.92 mln lekë ose në masën 93.24%, me diferencë mosrealizimi në vlerën 323 mln lekë. Për vitin 2020, të ardhurat janë planifikuar në vlerën 4,741.53 mln lekë dhe realizuar në vlerën 4,020.51 mln lekë ose në masën 84.8%, me diferencë mosrealizimi në vlerën 721.02 mln lekë. Për vitin 2021, të ardhurat janë planifikuar në vlerën 4,617.6 mln lekë dhe realizuar në vlerën 4,266.02 mln lekë, ose në masën 92.39%, me diferencë mosrealizimi në vlerën 351.58 mln lekë.

-Për vitin 2018 shpenzimet e Shoqërisë për vitin 2018 janë planifikuar në shumën 3,059.67 milion lekë dhe realizuar në shumën 3,372.90 milion lekë, me diferencë mosrealizimi në shumën 313.23 milion lekë, pra 110.24 %. Për vitin 2019 shpenzimet e Shoqërisë për vitin 2019 janë planifikuar në shumën 3,287.33 mln lekë dhe realizuar në shumën 3,414.21 mln lekë, me diferencë mosrealizimi në shumën 126.88 mln lekë, pra 103.86%. Për vitin 2020 shpenzimet e Shoqërisë janë planifikuar në shumën 3,370.21 mln lekë dhe realizuar në shumën 3,510.63 mln lekë, me diferencë mosrealizimi në shumën 140.42 mln lekë, pra 104.17 %. Për vitin 2021 shpenzimet e Shoqërisë janë planifikuar në shumën 3,298.8 mln lekë dhe realizuar në shumën 3,171.01 mln lekë, me diferencë mosrealizimi në shumën 127.79 mln lekë, pra 96.13 %. Për vitin 2022 shpenzimet e Shoqërisë janë planifikuar në shumën 2,590.40 mln lekë dhe realizuar në shumën 2,189.41 mln lekë, me diferencë mosrealizimi në shumën 400.99 mln lekë, pra 84.52 %.

-Nga Shoqëria nuk është kryer një planifikim i saktë, ku t'i referohet kërkesave reale të shoqërisë. Nga auditimi i hartimit, shqyrtimit, zbatimit dhe raportimit të programit ekonomiko-financiar u konstatua se ka zëra të cilët kanë patur mosrealizim të vlerave të miratuara. Konkretisht zërat: -Arkëtimi nga shërbimet e tjera për vitin 2018 është planifikuar 4,780.18 mln lekë dhe është realizuar 4,546.40 mln lekë, pra kemi një realizim në masën 95.1% kundrejt planifikimit vjetor; për vitin 2019 është planifikuar 4,841.26 mln lekë dhe është realizuar 4,312.24 mln lekë, pra kemi një realizim me 89.07%; për vitin 2020 është planifikuar 4,772.17 mln lekë dhe është realizuar 4,176.69 mln lekë, pra kemi një realizim me 87.52% kundrejt planifikimit vjetor. -Zëri Roje Objektsh: për vitin 2018 Plani 489.28 mln lekë, fakti 518.34 mln lekë ose realizuar në masën 105.94 %; për vitin 2019 Plani 489.28 mln lekë, fakti 518.34 mln lekë ose realizuar në masën 105.94%; për vitin 2021 Plani 45.70 mln lekë, fakti 286.45 mln lekë ose realizuar në masën 626.8%. -Zëri Qira zyra: për vitin 2018 Plani 27.82 mln lekë, fakti 34.66 mln lekë ose realizuar në masën 124.59%. -Zëri Konsulencë tekniko-ekonomike: për vitin 2018 Plani 37.35 mln lekë, fakti 76.34 mln lekë ose realizuar në masën 204.39%; për vitin 2019 Plani 23.35 mln lekë, fakti 45.11 mln lekë ose realizuar në masën 193.16%; për vitin 2020 Plani 13.20 mln lekë, fakti 18.15 mln lekë ose realizuar në masën 137.48%; për vitin 2021 Plani 12.15 mln lekë, fakti 16.58 mln lekë ose realizuar në masën 136.46%. -Zëri Shpenzime postare: për vitin 2018 Plani 0.30 mln lekë, fakti 0.33 mln lekë ose realizuar në masën 109.33%; për vitin 2020 Plani 0.2 mln lekë, fakti 0.22 mln lekë ose realizuar në masën 109.59%; për vitin 2021 Plani 0.2 mln lekë, fakti 0.27 mln lekë ose realizuar në masën 135%. -Zëri Shpenzime të përgjithshme: për vitin 2018 Plani 4.5 mln lekë, fakti 184.58 mln; për vitin 2019 Plani 38.68 mln lekë, fakti 153.87 mln lekë ose realizuar në masën 397.8%; për vitin 2020 Plani 18.05 mln lekë, fakti 65.86 mln lekë ose realizuar në masën 364.9%; për vitin 2021 Plani 19.8 mln lekë, fakti 77.24 mln lekë ose realizuar në masën 390.1%. -Zëri taksa vendore dhe pasurie: për vitin 2018 Plani 3 mln lekë, fakti 3.73 mln lekë ose realizuar në masën 124.33%; për vitin 2021 Plani 3 mln lekë, fakti 5.98 mln lekë ose realizuar në masën 199.3%. -Zëri Gjoba penalitete dhe dëmshpërblime: për vitin 2018 Plani 38.01 mln lekë, fakti 73.77mln lekë ose realizuar në masën 194.08%; për vitin 2019 Plani 22.59 mln lekë, fakti 52.09 mln lekë ose realizuar në masën 230.54%; për vitin 2020 Plani 40 mln lekë, fakti 51.02 mln lekë ose realizuar në masën 127.55%.

Mosrealizimi i treguesve ekonomik në raport me programin tregon se shoqëria nuk ka arritur të plotësojë objektivat e saj.

Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 15, datë 02.05.2018 “Mbi programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë tregtare me kapital shtetëror”.

-Për vitin 2018, investimet kapitale janë planifikuar në vlerën 3,386.65 mln lekë dhe realizuar në vlerën 1,850.86 mln lekë ose në masën 54.65 %, me diferencë mosrealizimi në vlerën 1,535.79

mln lekë. Për vitin 2019, investimet kapitale janë planifikuar në vlerën 3,002.60 mln lekë dhe realizuar në vlerën 2,625.36 mln lekë ose në masën 87.44 %, me diferencë mosrealizimi në vlerën 377.24 mln lekë. Për vitin 2020, investimet kapitale janë planifikuar në vlerën 1,195.94 mln lekë dhe realizuar në vlerën 2,428.33 mln lekë ose në masën 203.05 %, me diferencë mosrealizimi në vlerën 1,232.39 mln lekë. Për vitin 2021, investimet kapitale janë planifikuar në vlerën 1,134.23 mln lekë dhe realizuar në vlerën 1,418.31 mln lekë, ose në masën 125.05 %, me diferencë mosrealizimi në vlerën 284.07 mln lekë. Për vitin 2022, investimet kapitale janë planifikuar në vlerën 771.95 mln lekë dhe realizuar në vlerën 1,375.65 mln lekë, ose në masën 178%, me diferencë mosrealizimi në vlerën 603.7 mln lekë. Investimet kapitale kanë ndjekur një *trend zbritës* nga viti 2019 deri në vitin 2022.

Analiza e performancës së Shoqërisë “UKT” sha

Për periudhën e auditimit, përqindjet e arkëtimit vjetor total krahasuar me faturimin vjetor, janë në rritje nga viti në vit krahasuar me vitin 2018 (fillimi i periudhës së auditimit). Megjithatë arkëtimi korrent është ai që tregon arkëtimin e faturimit të viteve përkatëse dhe në fakt pavarësisht rritjes progresive është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU etj.

Nga auditimi mbi prodhimin dhe faturimin e ujit, u konstatua se për vitin 2018 janë prodhuar gjithsej 93 milion m³ ujë dhe nga këto vetëm 35.5 milion m³ ujë janë faturuar, çka ka rezultuar në humbje teknike në masën 61.8% e ujit të prodhuar. Për vitin 2019 janë prodhuar gjithsej 91.2 milion m³ ujë dhe nga këto vetëm 36.2 milion m³ ujë janë faturuar, çka ka rezultuar në humbje teknike në masën 60.27% e ujit të prodhuar. Për vitin 2020 janë prodhuar gjithsej 93.2 milion m³ ujë dhe nga këto vetëm 35.4 milion m³ ujë janë faturuar, çka ka rezultuar në humbje teknike në masën 61.98% e ujit të prodhuar. Për vitin 2021 janë prodhuar gjithsej 99.8 milion m³ ujë dhe nga këto vetëm 38.36 milion m³ ujë janë faturuar, çka ka rezultuar në humbje teknike në masën 61.56% e ujit të prodhuar. Për vitin 2022 nga data 01.01.2022 deri në 31.10.2022, janë prodhuar gjithsej 81 milion m³ ujë dhe nga këto vetëm 29.6 milion m³ ujë janë faturuar, çka ka rezultuar në humbje teknike në masën 63.5% e ujit të prodhuar.

Uji pa të ardhura mbetet problem serioz, pasi norma është shumë e lartë.

Përsa i përket arkëtimit të debive të prapambetura, shoqëria ka akoma një vlerë të konsiderueshme të debisë për të mbledhur, pavarësisht përpjekjeve të saj për lidhjen e aktmarrëveshjeve me debitorët apo dërgim në përmbarim. Shoqëria duhet të ketë në konsideratë se Norma e arkëtimit është një nga treguesit më të rëndësishëm të shoqërisë e cila lidhet me qëndrueshmërinë financiare të Shoqërisë dhe me aftësinë e saj paguese.

Konkretisht në vitin 2018 arkëtimet totale janë në vlerën 3,580,578.7 lekë, ku arkëtimet korrente janë në vlerën 3,050,137.19 lekë ose 85.19% dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 530,441.51 lekë ose 14.81%. Në vitin 2019, arkëtimet totale janë në vlerën 3,677,567.58 lekë, ku arkëtimet korrente janë në vlerën 3,285,232.98 lekë ose 89.33% dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 392,724.88 lekë ose 10.67%. Në vitin 2020, arkëtimet totale janë në vlerën 3,294,391.56 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 3,127,150.78 lekë ose 94.92%, ndërsa arkëtimet e prapambetura në vlerën 167,240.78 lekë ose 5.08%. Në vitin 2021, arkëtimet totale janë në vlerën 3,617,808.51 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 3,226,312.65 lekë ose 89.18%, ndërsa arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 391,495.87 lekë ose 10.82 %. Në periudhën 01.01.2022-31.10.2022, arkëtimet totale janë në vlerën 3,054,052 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 2,793,901.41 lekë ose 91.48 %, ndërsa arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 260,150.59 lekë ose 8.52 %.

Tabelë: Treguesit e performancës në total për periudhën e auditimit

Nr	Treguesit e Performances	2018	2019	2020	2021	Treguesi i pranueshëm nga ERRU
1	Uji pa të ardhura (%)	62	60.2	61.84	59	30
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	186	160.40	150.17	164	100
3	Mbulimi i Kostove Totale (%)	148	119	109.06	121	80
4	Norma e arkëtimit të përgjithshëm (%)	96.6	96.1	85.16	94.7	82
5	Norma e arkëtimit korente (%)	87.1	84.90	81.06	84.5	82
6	Niveli i matjes (%)	86	88.20	88.84	90	85
7	Eficienta e stafit (nr)	3.81	3.82	3.70	3.87	4.6.10
8	Kohëzgjatja e furnizimit me ujë (Orë)	10.10	13.30	15.44	17	18
9	Mbulimi me kanalizime KUN (%)	89	90.50	90.10	90.7	75
10	Mbulimi me furnizim me ujë	99	96.9	96.5	97.03	n/a

Burimi: “UK Tiranë” sha.**Tabelë:** Tabelë përmbledhëse për Prodhimin, faturimin dhe ujin pa të ardhura përgjatë periudhës së auditimit.

(në mln lekë)

000/ m3	2018		2019		2020		2021		2022 - 9 muji	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Prodhim	95,03 6.17	93,02 4.60	95,06 6.00	91,15 9.82	109,59 9.00	93,21 8.34	109,59 9.07	99,80 9.06	82,19 9.31	81,07 7.61
Faturim	96,22 3.28	89,74 5.02	96,37 0.44	89,73 2.30	97,218. 87	84,18 9.46	98,295. 02	87,55 0.19	74,18 3.81	67,40 8.96
Faurim ujë i pijshëm	38,17 1.82	35,52 5.96	38,46 4.56	36,21 4.39	38,981. 52	35,44 5.96	39,566. 24	38,36 2.22	29,92 3.44	29,59 7.02
Faurim ujë i përdorur	32,85 1.46	30,02 2.36	32,68 2.88	29,49 2.83	32,761. 51	28,12 0.66	33,252. 93	29,50 5.43	25,15 3.47	22,79 1.80
Hec	25,20	24,19	25,22	24,02	25,475.	20,62	25,475.	19,68	19,10	15,02

	0.00	6.70	3.00	5.09	85	2.85	85	2.54	6.91	0.13
% uji pa te ardhura	60.00	61.81	59.53	60.27	63.90	61.98	63.90	61.56	62.80	63.50

Burimi: “UK Tiranë” sha.

Arkëtimi në “UKT” SHA

Faturimi korent është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU. Për periudhën e auditimit, përqindjet e arkëtimit vjetor total krahasuar me faturimin vjetor, janë në rritje nga viti në vit krahasuar me vitin 2018 (fillimi i periudhës së auditimit). Megjithatë arkëtimi korrent është ai që tregon arkëtimin e faturimit të viteve përkatëse dhe në fakt pavarësisht rritjes progresive është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU etj.

Përsa i përket arkëtimit të debive të prapambetura, shoqëria ka akoma një vlerë të konsiderueshme të debisë për të mbledhur, pavarësisht përpjekjeve të saj për lidhjen e aktmarrëveshjeve me debitorët apo dërgim në përmbarim. Shoqëria duhet të ketë në konsideratë se Norma e arkëtimit është një nga treguesit më të rëndësishëm të shoqërisë e cila lidhet me qëndrueshmërinë financiare të Shoqërisë dhe me aftësinë e saj paguese. Konkretisht në vitin 2018 arkëtimet totale janë në vlerën 3,580,578.7 lekë, ku arkëtimet korrente janë në vlerën 3,050,137.19 lekë ose 85.19% dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 530,441.51 lekë ose 14.81%. Në vitin 2019, arkëtimet totale janë në vlerën 3,677,567.58 lekë, ku arkëtimet korrente janë në vlerën 3,285,232.98 lekë ose 89.33% dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 392,724.88 lekë ose 10.67%. Në vitin 2020, arkëtimet totale janë në vlerën 3,294,391.56 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 3,127,150.78 lekë ose 94.92%, ndërsa arkëtimet e prapambetura në vlerën 167,240.78 lekë ose 5.08%. Në vitin 2021, arkëtimet totale janë në vlerën 3,617,808.51 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 3,226,312.65 lekë ose 89.18%, ndërsa arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 391,495.87 lekë ose 10.82 %. Në periudhën 01.01.2022-31.10.2022, arkëtimet totale janë në vlerën 3,054,052 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 2,793,901.41 lekë ose 91.48 %, ndërsa arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 260,150.59 lekë ose 8.52 %.

Në kundërshtim me:

-VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UK”, pjesa II pika 4;

-VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, neni 1;

-Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, pika 6,

-Kontratën e Shërbimeve Ujësjiellës Kanalizime, miratuar me vendim të KKRR Nr. 25, datë 08.07.2015 “Kontratë për shërbime Ujësjiellës – Kanalizime e përditësuar”.

Tabelë: Arkëtimi në “UKT” SHA për vitet 01.09.2018-31.10.2022.

(në lekë)

ARKETIM U+K+T+KAMATE	2018		%	2019		%
	Parashikim	Fakt		Parashikim	Fakt	
Total	4,290,896.55	3,580,578.70	83%	4,263,567.58	3,677,957.86	86%
Korent	2,928,146.60	3,050,137.19	104%	3,333,663.06	3,285,232.98	99%
I prapambetur	1,362,749.96	530,441.51	39%	929,904.52	392,724.88	42%
% arketim koherent	68%	85%		78%	89%	
% arketim prapambetur	32%	15%		22%	11%	

ARKETIM U+K+T+KAMATE	2020		%	2021		%
	Parashikim	Fakt		Parashikim	Fakt	
Total	4,305,017.70	3,294,391.56	77%	4,271,482.35	3,617,808.51	85%
Korent	3,491,305.57	3,127,150.78	90%	3,551,801.70	3,226,312.65	91%
I prapambetur	813,712.13	167,240.78	21%	719,680.65	391,495.87	54%
% arketim koherent	81%	95%		83%	89%	
% arketim prapambetur	19%	5%		17%	11%	

ARKETIM U+K+T+KAMATE	01.01- 31.10.2022		%
	Parashikim	Fakt	
Total	3,336,295.59	3,054,052.00	84%
Korent	3,039,589.99	2,793,901.41	92%
I prapambetur	296,705.60	260,150.59	88%
% arketim koherent	91.11%	91.48%	
% arketim prapambetur	8.89%	8.52%	

-Treguesit e mbulimit të kostove të O&M (Kostot e Operim & Mirëmbajtjes) dhe ato Totale

Treguesit e mbulimit të kostove të O&M dhe ato Totale kanë një përkeqësim të ndjeshëm nga viti 2018 deri në 2020, ndërsa 2021 ka pësuar një përmirësim të lehtë. Kostot e Operim & Mirëmbajtjes janë rritur me 87.95 milion lekë në vitin 2019 krahasuar me 2018 dhe rritur me 111.01 milion lekë në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Ndërsa në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, kostot e operim dhe mirëmbajtje, janë ulur me 170.82 milion lekë. Me rritje janë të gjithë zërat e kostove të Operim & Mirëmbajtje.

Kosto e punës ka pasur rritje me 36.77 milion lekë në vitin 2019, rritje me 37.3 milion lekë në vitin 2020 dhe rritje me 141.22 milion lekë në vitin 2021.

Shoqëria “UK Tiranë” sha ka rritur ndjeshëm numrin e stafit me 148 punonjës në vitin 2021 krahasuar me vitin 2018 (referuar numrit mesatar faktik të punonjësve). Pavarësisht se brenda normës së pranueshme për numrin e stafit për 1000 lidhje UK, shoqëria duhet të analizojë hollësisht numrin e punonjësve dhe pozicionet në organigramë, përskrimet e punës dhe ngarkesa reale për çdo pozicion pune. Në total rritja e numrit të stafit, por edhe rishikimi i nivelit të pagave ka sjellë rritjen e përmendur më sipër të Kostove të Punës. Menaxhimi i Burimeve njerëzore duhet të jetë prioritet për stafin menaxhues të Shoqërisë, pasi kostot e punës zënë respektivisht 37% të kostos O&M për vitet 2018, 2019, 2020; rreth 44.5% për vitin 2021 dhe rreth 45% për 9 mujorin e 2022. Numri i stafit duhet të jetë në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të shoqërisë.

Kosto e energjisë ka qenë në ulje nga viti 2018 e më tej. Në vitin 2019 është ulur me 106.84 milion lekë, në vitin 2020 është ulur me 27.46 milion lekë krahasuar me vitin paraardhës. Ndërsa në vitin 2021, kosto e energjisë është ulur me 16.46 milion lekë krahasuar me vitin 2020. Kostot e energjisë në vitin 2018 zënë 17.46% të kostove O&M, zënë rreth 13% në vitin 2019 dhe rreth 12% në vitin 2020 dhe 2021. Problem për Shoqërinë vazhdojnë të mbeten detyrimet e prapambetura ndaj OSHEE-së.

Rritje progresive ka pasur dhe zëri kosto lëndë të para ku përfshihen: kimikate, lëndë djegëse etj (përveç vitit 2019 ku ky zë ka pësuar një rënie të lehtë). Në vitin 2019, zëri kosto lëndë të para ka pësuar një zbritje të lehtë me 6.83 milion lekë, krahasuar me vitin 2018. Në vitin 2020, zëri kosto

lëndë të para ka pësuar një rritje me 56.28 milion lekë, krahasuar me vitin 2019. Ndërsa në vitin 2021, zëri kosto lëndë të para ka pësuar një rritje me 10.35 milion lekë, krahasuar me vitin 2020. Edhe zëri Kosto e shërbime të kontraktuara roje, ka një rritje të ndjeshme prej 53.07 milion lekë në vitin 2019 dhe rreth 25.77 milion në vitin 2020 krahasuar me vitin paraardhës. Ndërsa në vitin 2021, ky zë ka pësuar një zbritje të konsiderueshme në vlerën 310.72 milion lekë krahasuar me vitin 2020.

Shoqëria duhet të parashikojë zgjidhje alternative si teknike dhe logjistike, në mënyrë që të ulët kostoja e këtij shërbimi, gjithmonë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi për ruajtjen e objekteve me rëndësi strategjike.

Zëri Kosto të tjera, ku përfshihen kostot e riparim mirëmbajtjes, kostot e përmbarimit, kostot e tjera, u konstatua se ky zë ka pësuar rritje të vazhdueshme gjatë periudhës së auditimit përkatësisht me 111.79 milion lekë në vitin 2019, me 19.12 milion në vitin 2020 dhe me 4.78 milion lekë në vitin 2021 krahasuar me vitin paraardhës. Rritje kanë kostot e riparimeve, për shkak të rritjes së numrit të defekteve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes, apo nevojës për riparime të pompave dhe motorëve të prodhimit të ujit të pijshëm.

Kostot totale përbëhen nga kosto të O&M, kosto kapitale, kostot e amortizimit dhe kostot e tjera financiare si tatime dhe taksa. Kostot e amortizimit kanë pësuar ulje nga viti 2018 deri në 2021. Kostot e amortizimit janë ulur me 265.91 milion lekë në vitin 2019 dhe me rreth 188 milion lekë në vitin 2020 krahasuar me vitin paraardhës. Ndërsa në vitin 2021, ky zë ka pësuar një rritje me 37.68 milion lekë krahasuar me vitin paraardhës.

Kostot financiare kanë rritje në vitin 2019 me 219.26 milion lekë, rritje në vitin 2020 me 173.42 milion lekë dhe ulje në vitin 2021 me 206.49 milion lekë krahasuar me vitin paraardhës.

Kostot kapitale kanë pësuar rënie në vitin 2019 me 559.39 milion lekë, rritje në vitin 2020 me 860.56 milion lekë dhe rënie në vitin 2021 me 873.77 milion lekë krahasuar me vitin paraardhës.

Kostot Totale të shoqërisë kanë pësuar një rënie në vitin 2019 me 559.39 milion lekë, rritje në vitin 2020 me 956.98 milion lekë dhe rënie në vitin 2021 me 1213.39 milion lekë krahasuar me vitin paraardhës.

Tabelë: Zërat e kostove Operim dhe mirëmbajtje O&M dhe kostove Totale për periudhën e auditimit.

(në mln lekë)

Nr.	Kostot	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Diferenca 2018-2019	Diferenca 2019-2020	Diferenca 2020-2021
1	Kostot e punës	976.73	1,013.49	1,050.79	1,192.02	36.77	37.30	141.22
2	Kosto e energjisë	462.42	355.58	328.11	311.66	(106.84)	(27.46)	(16.46)
3	Kosto lëndë të para (materiale të para, lëndë djegëse , klor)	315.57	308.74	365.02	375.38	(6.83)	56.28	10.35
4	Kosto e shërbime të kontraktuara roje	518.34	571.40	597.17	286.45	53.07	25.77	(310.72)
5	Kosto të tjera	375.12	486.91	506.03	510.81	111.79	19.12	4.78
	Total Kosto O&M	2,648.17	2,736.12	2,847.13	2,676.31	87.95	111.01	(170.82)
6	Kostot e amortizimit	855.08	589.17	401.17	438.85	(265.91)	(188.00)	37.68
7	Kosto financiare, taksa tatime	(130.34)	88.91	262.33	55.85	219.26	173.42	(206.49)
8	Kosto kapitale	1,817.68	1,258.29	2,118.85	1,245.08	(559.39)	860.56	(873.77)
9	Kosto Totale	5,190.59	4,672.49	5,629.48	4,416.08	(518.09)	956.98	(1,213.39)

Burimi: “UK Tiranë” sha.

Nisur nga parashikimi për vitin 2018, ka mosrealizim të “Kosto e shërbime të kontraktuara roje” në vlerën 29.06 mln lekë, duke u nisur dhe nga fakti që prodhimi ka një rritje nga parashikimi

dhe kjo përkthehet në kosto të energjisë së shtuar dhe kosto e shtuar për “shërbime të kontraktuara roje”. Nga parashikimi për vitin 2019, ka mosrealizim tek “kosto të tjera” në vlerën 39.88 mln lekë, duke u nisur dhe nga fakti që prodhimi ka një rritje nga parashikimi dhe kjo përkthehet në kosto të shtuara për kosto të tjera. Nga parashikimi për vitin 2020, ka mosrealizim në disa zëra, të cilët janë kosto e punës në vlerën 50.79 mln lekë, kosto e energjisë në vlerën 28.11 mln lekë, kosto të tjera në vlerën 41.4 mln lekë, kosto e amortizimit në vlerën 58.5 mln lekë, kosto financiare tatime taksa në vlerën 126.97 mln lekë dhe kosto kapitale në vlerën 953.23 mln lekë. Nga parashikimi për vitin 2021, ka mosrealizim në disa zëra, të cilët janë kosto e punës në vlerën 79.85 mln lekë, kosto të tjera në vlerën 12.96 mln lekë, kosto e amortizimit në vlerën 78.85 mln lekë dhe kosto kapitale në vlerën 141.17 mln lekë. Nga parashikimi për vitin 2022, deri më tani, ka mosrealizim në disa zëra, të cilët janë: kosto e punës në vlerën 54.88 mln lekë dhe kosto e shërbime të kontraktuara roje në vlerën 12.21 mln lekë.

-Niveli i matjes së klientëve (faturim me matësa/pa matësa)

Përsa i përket numrit të lidhjeve të ujit gjithsej për vitin 2018 konstatohen 252,261 lidhje gjithsej, nga të cilat 223,675 janë me matësa dhe 29,586 janë pa matësa. Pra, vetëm 88,66% e lidhjeve janë me matësa, nga e cila 85.30% janë familjarë, 98% janë ente private dhe jo buxhetorë dhe 94,6% janë institucione (buxhetor).

Përsa i përket numrit të lidhjeve të ujit gjithsej për vitin 2019 konstatohen 251,886 lidhje gjithsej, nga të cilat 222,064 janë me matësa dhe 29,822 janë pa matësa. Pra, vetëm 88,16% e lidhjeve janë me matësa, nga e cila 86,48% janë familjarë, 98,23% janë ente private dhe jo buxhetorë dhe 95,36% janë institucione (buxhetor).

Përsa i përket numrit të lidhjeve të ujit gjithsej për vitin 2020 konstatohen 254,796 lidhje gjithsej, nga të cilat 226,368 janë me matësa dhe 28,428 janë pa matësa. Pra, vetëm 88,84% e lidhjeve janë me matësa, nga e cila 87,22% janë familjarë, 98,47% janë ente private dhe jo buxhetorë dhe 95,87% janë institucione (buxhetor).

Përsa i përket numrit të lidhjeve të ujit gjithsej për vitin 2021 konstatohen 259,345 lidhje gjithsej, nga të cilat 232,137 janë me matësa dhe 27,208 janë pa matësa. Pra, vetëm 89,51% e lidhjeve janë me matësa, nga e cila 87,96% janë familjarë, 98,66% janë ente private dhe jo buxhetorë dhe 96,56% janë institucione (buxhetor).

Përsa i përket numrit të lidhjeve të ujit gjithsej për periudhën 01.01.2022 deri 31.10.2022 konstatohen 263,312 lidhje gjithsej, nga të cilat 237,418 janë me matësa dhe 25,894 janë pa matësa. Pra, rreth 90.17% e lidhjeve janë me matësa, nga e cila 88,72% janë familjarë, 98,74% janë ente private dhe jo buxhetorë dhe 96,84% janë institucione (buxhetor).

1. Titulli i gjetjes:	Nuk janë respektuar afatet për dërgimin dhe miratimin e programit ekonomik nga Bashkia Tiranë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme.
Situata:	Për vitin 2019 dhe 2020 nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit të Administrimit dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve. Konkretisht: Për vitin 2019 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr.18, datë 12.12.2018 "Mbi miratimin e Buxhetit të shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2019". Ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim nr. 16, datë 13.12.2018 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve. Për vitin 2020 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, datë 19.12.2019 "Mbi miratimin e Buxhetit të shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2020".

	Ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim nr. 11, datë 20.12.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 2.5.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, kapitulli III, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Kjo ka sjellë mungesë të programeve dhe të objektivave afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë.
Shkaku:	Mos vlerësim sa dhe si duhet të afateve të hartimit dhe miratimit të buxheteve.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Organet Drejtuese të Shoqërisë të miratojnë në kohë programin ekonomik financiar (buxhetin vjetor) për një menaxhim me një efektivitet më të lartë të shoqërisë.

2. Titulli i gjetjes:	Ka diferenca dukshme midis parashikimit dhe realizimit të programit ekonomik.
Situata:	Nga auditimi i hartimit, shqyrtimit, zbatimit dhe raportimit të programit ekonomik-financiar u konstatua se ka zëra të cilët kanë patur mosrealizim të vlerave të miratuara. Konkretisht zërat: -Arkëtimi nga shërbimet e tjera për vitin 2018 është planifikuar 4,780.18 mln lekë dhe është realizuar 4,546.40 mln lekë, pra kemi një realizim në masën 95.1% kundrejt planifikimit vjetor; për vitin 2019 është planifikuar 4,841.26 mln lekë dhe është realizuar 4,312.24 mln lekë, pra kemi një realizim me 89.07%; për vitin 2020 është planifikuar 4,772.17 mln lekë dhe është realizuar 4,176.69 mln lekë, pra kemi një realizim me 87.52% kundrejt planifikimit vjetor. -Zëri Roje Objektsh: për vitin 2018 Plani 489.28 mln lekë, fakti 518.34 mln lekë ose realizuar në masën 105.94 %; për vitin 2019 Plani 489.28 mln lekë, fakti 518.34 mln lekë ose realizuar në masën 105.94%; për vitin 2021 Plani 45.70 mln lekë, fakti 286.45 mln lekë ose realizuar në masën 626.8%. -Zëri Qira zyra: për vitin 2018 Plani 27.82 mln lekë, fakti 34.66 mln lekë ose realizuar në masën 124.59%. -Zëri Konsulencë tekniko-ekonomike: për vitin 2018 Plani 37.35 mln lekë, fakti 76.34 mln lekë ose realizuar në masën 204.39%; për vitin 2019 Plani 23.35 mln lekë, fakti 45.11 mln lekë ose realizuar në masën 193.16%; për vitin 2020 Plani 13.20 mln lekë, fakti 18.15 mln lekë ose realizuar në masën 137.48%; për vitin 2021 Plani 12.15 mln lekë, fakti 16.58 mln lekë ose realizuar në masën 136.46%. -Zëri Shpenzime postare: për vitin 2018 Plani 0.30 mln lekë, fakti 0.33 mln lekë ose realizuar në masën 109.33%; për vitin 2020 Plani 0.2 mln lekë, fakti 0.22 mln lekë ose realizuar në masën 109.59%; për vitin 2021 Plani 0.2 mln lekë, fakti 0.27 mln lekë ose realizuar në masën 135%. -Zëri Shpenzime të përgjithshme: për vitin 2018 Plani 4.5 mln lekë, fakti 184.58 mln; për vitin 2019 Plani 38.68 mln lekë, fakti 153.87 mln lekë ose realizuar në masën 397.8%; për vitin 2020 Plani 18.05 mln lekë, fakti 65.86 mln lekë ose realizuar në masën 364.9%; për vitin

	<p>2021 Plani 19.8 mln lekë, fakti 77.24 mln lekë ose realizuar në masën 390.1%. -Zëri taksa vendore dhe pasurie: për vitin 2018 Plani 3 mln lekë, fakti 3.73 mln lekë ose realizuar në masën 124.33%; për vitin 2021 Plani 3 mln lekë, fakti 5.98 mln lekë ose realizuar në masën 199.3%. -Zëri Gjoha penalitete dhe dëmshpërblime: për vitin 2018 Plani 38.01 mln lekë, fakti 73.77mln lekë ose realizuar në masën 194.08%; për vitin 2019 Plani 22.59 mln lekë, fakti 52.09 mln lekë ose realizuar në masën 230.54%; për vitin 2020 Plani 40 mln lekë, fakti 51.02 mln lekë ose realizuar në masën 127.55%.</p> <p>Mosrealizimi i treguesve ekonomik në raport me programin tregon se shoqëria nuk ka arritur të plotësojë objektivat e saj.</p>
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 2.5.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”.
Ndikimi/Efekti:	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara nga Shoqëria.
Shkaku:	Mos vlerësim sa dhe si duhet të planifikimit në programin ekonomik.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandim:	<p>-Organet Drejtuese të Shoqërisë të marrin masa në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të programit ekonomik, për hartimin e një programi real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.</p> <p>-Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e programeve ekonomike paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet sipas zërave përkatës.</p>

3. Titulli i gjetjes:	Faturimi korent është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU.
Situata:	<p>Për periudhën e auditimit, përqindjet e arkëtimit vjetor total krahasuar me faturimin vjetor, janë në rritje nga viti në vit krahasuar me vitin 2018 (fillimi i periudhës së auditimit). Megjithatë arkëtimi korent është ai që tregon arkëtimin e faturimit të viteve përkatëse, dhe në fakt pavarësisht rritjes progresive është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU etj.</p> <p>Përsa i përket arkëtimit të debive të prapambetura, shoqëria ka akoma një vlerë të konsiderueshme të debisë për të mbledhur, pavarësisht përpjekjeve të saj për lidhjen e aktmarrëveshjeve me debitorët apo dërgim në përmbarim. Shoqëria duhet të ketë në konsideratë se Norma e arkëtimit është një nga treguesit më të rëndësishëm të shoqërisë e cila lidhet me qëndrueshmërinë financiare të Shoqërisë dhe me aftësinë e saj paguese.</p> <p>Konkretisht në vitin 2018 arkëtimet totale janë në vlerën 3,580,578.7 lekë, ku arkëtimet korrente janë në vlerën 3,050,137.19 lekë ose 85.19% dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 530,441.51 lekë ose 14.81%. Në vitin 2019, arkëtimet totale janë në vlerën 3,677,567.58 lekë, ku arkëtimet korrente janë në vlerën 3,285,232.98 lekë ose</p>

	89.33% dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 392,724.88 lekë ose 10.67%. Në vitin 2020, arkëtimet totale janë në vlerën 3,294,391.56 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 3,127,150.78 lekë ose 94.92%, ndërsa arkëtimet e prapambetura në vlerën 167,240.78 lekë ose 5.08%. Në vitin 2021, arkëtimet totale janë në vlerën 3,617,808.51 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 3,226,312.65 lekë ose 89.18%, ndërsa arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 391,495.87 lekë ose 10.82 %. Në periudhën 01.01.2022-31.10.2022, arkëtimet totale janë në vlerën 3,054,052 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 2,793,901.41 lekë ose 91.48 %, ndërsa arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 260,150.59 lekë ose 8.52 %.
Kriteri:	-VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UK”, pjesa II pika 4; -VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, neni 1; -Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, pika 6; -Kontratën e Shërbimeve Ujësjiellës Kanalizime, miratuar me vendim të <u>KKRR Nr. 25, datë 08.07.2015</u> “Kontratë për shërbime Ujësjiellës – Kanalizime e përditësuar”.
Ndikimi/Efekti:	Risk për vështirësi financiare
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore që lidhen me shitjen e ujit të pijshëm.
Rëndësia:	I Lartë
Rekomandimi 4.1:	Organet Drejtuese të Shoqërisë “UKT” SHA, (Drejtori i Përgjithshëm, Këshilli i Administrimit, Asambleja e Përgjithshme) të marrin masa për rritjen e arkëtimeve duke reduktuar humbjet menaxheriale të shoqërisë.

2.4. Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.

Marrëdhëniet e punës rregullohen me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kontratën individuale të punës për secilin punonjës dhe kontratën kolektive lidhur midis Shoqërisë “UKT” Sha dhe Sindikatës, me nr. 7720/4 prot., datë 16.07.2018, e nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. R.M dhe Kryetari i Sindikatës së punonjësve të UKT sha Z. L.G.

Struktura Organizative

Me vendimet respektive të Këshillit Mbikëqyrës janë miratuar strukturat organizative për çdo vit, konkretisht:

Për periudhën shtator-dhjetor 2018:

- Me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.13, datë 08.11.2018 u miratuan ndryshimet në strukturën organizative të shoqërisë me 1230 punonjës dhe ndryshimet në Rregulloren e Brendshme.

- Me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.17, datë 12.12.2018 u miratuan ndryshimet në strukturën organizative të shoqërisë dhe ndryshimet në Rregulloren e Brendshme.

Për vitin 2019

- Me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.1, datë 30.01.2019 u miratuan ndryshimet në strukturën organizative të shoqërisë, me 1300 punonjës, ku u shtua Drejtoria e Taksave me 50 punonjës.

Për vitin 2020

- Me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.10, datë 04.11.2020 u miratuan ndryshimet në strukturën organizative të shoqërisë me 1350 punonjës.

Për vitin 2021

- Me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.6, datë 27.05.2021 u miratuan ndryshimet në strukturën organizative të shoqërisë, ku numri i punonjësve të shoqërisë bëhet 1351 punonjës dhe fondi i pagave nuk ndryshohet. Më anë të këtij vendimi të Këshillit të Administrimit shtohet pozicioni i "Mjekut të punës" në strukturën organizative të Shoqërisë.

- Me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.12, datë 15.07.2021 u miratuan ndryshimet në strukturën organizative të shoqërisë, ku numri i punonjësve të shoqërisë bëhet 1366 punonjës dhe fondi i pagave kalon për miratim me ndryshimet në buxhetin e Shoqërisë për vitin 2021.

- Me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.23, datë 26.11.2021 u miratuan ndryshimet në strukturën organizative të shoqërisë, me përbërje: *Këshilli i Administrimit (3); Drejtori i Përgjithshëm (1); Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Çështjet Administrative (1); Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Çështjet Operative (1); As./zv. Drejtorit të Përgjithshëm (1); Staf i Mbështetës i Drejtorit të Përgjithshëm (20)* nga të cilët: 6 punonjës janë këshilltarë, 2 koordinatorë, 1 Asistente e Drejtorit të Përgjithshëm, 3 punonjës të Sektorit të Statistikave, 5 punonjës të Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Mediat, 3 punonjës të Sektorit të Koordinimit të Projekteve të Huaja; *Njësia e Auditimit të Brendshëm (3); Drejtoria e Kujdesit ndaj Klientit (78); Drejtoria e Taksave (50); Departamenti i Shitjes (140)* nga të cilët: 1 punonjës Drejtor i Departamentit, 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë së Faturim-Arkëtimit, 58 punonjës të Drejtorisë së Faturim-Arkëtimit, 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë së Kontratave dhe Koordinimit me Njësitë, 37 punonjës të Drejtorisë së Kontratave dhe Koordinimit me Njësitë, 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë së Biznesit dhe Riskut, 41 punonjës të Drejtorisë së Biznesit dhe Riskut.

Drejtoria Ekonomike (27) nga të cilët: 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, 2 punonjës specialistë dhe 1 përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe Raportimit Financiar, 2 punonjës specialistë dhe 1 përgjegjës i Sektorit të Planifikimit Financiar, 2 punonjës specialistë dhe 1 përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit dhe Taksave, 2 punonjës specialistë dhe 1 përgjegjës i Sektorit të Analizës Financiare, 2 punonjës specialistë dhe 1 përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Mjeteve Monetare, 2 punonjës specialistë dhe 1 përgjegjës i Sektorit Tatimor, 1 punonjës përgjegjës i Sektorit të Logjistikës, 4 magazinier, 1 ekonomist, 1 specialist dhe 1 kartelist i Sektorit të Logjistikës.

Departamenti i Prodhim-Shpërndarjes (198) nga të cilët: 1 punonjës Drejtor i Departamentit, 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë së Prodhimit, 100 punonjës të Drejtorisë së Prodhimit, 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë së Shpërndarjes, 95 punonjës të Drejtorisë së Shpërndarjes.

Departamenti Inxhinierik (91) nga të cilët: 1 punonjës Drejtor i Departamentit, 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë së Kanalizimeve dhe Rrjeteve, 12 punonjës të Drejtorisë së Kanalizimeve dhe Rrjeteve, 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë së Nyjve Bovillë, 44 punonjës të Drejtorisë së Nyjve Bovillë, 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë Teknike, 18 punonjës të Drejtorisë Teknike.

Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse (121) nga të cilët: 1 punonjës Drejtor i Departamentit, 22 punonjës të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, 1 Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, 7 punonjës të Drejtorisë së IT, 1 Drejtor i Drejtorisë së IT, 88 punonjës të Drejtorisë së Transportit dhe Oficinës, 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë së Transportit dhe Oficinës.

Departamenti Ligjor dhe Prokurimeve (24) nga të cilët: 1 punonjës Drejtor i Departamentit, 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve, 11 punonjës të Drejtorisë së Prokurimeve, 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë Juridike, 10 punonjës të Drejtorisë Juridike.

Departamenti Operacional (175) nga të cilët: 1 punonjës Drejtor i Departamentit, 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë së Investimeve, 33 punonjës të Drejtorisë së Investimeve, 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë së Mirëmbajtjes së Ujësllësit, 68 punonjës të Drejtorisë së Mirëmbajtjes së Ujësllësit, 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë së Kanalizimeve, 67 punonjës të Drejtorisë së Kanalizimeve, 1 punonjës përgjegjës i Sektorit Teknik, 1 punonjës specialist Inxhinier, 1 punonjës Inxhinier Sigurimi Teknik.

Njësitë Zonale Nr.1, Nr.2, Nr.3, Nr.4, Nr.5 (254); Drejtoria Rajonale Nr.1 (105); Drejtoria Rajonale Nr.2 (86).

Për vitin 2022

- Me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.01, datë 27.01.2022 u miratuan ndryshimet në strukturën organizative të shoqërisë, rregulloren e brendshme dhe tabelën e klasifikimit të pagave, me 1377 punonjës.

- Me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.20, datë 29.09.2022 u miratuan ndryshimet në strukturën organizative të shoqërisë, me 1382 punonjës.

Struktura e miratuar dhe ajo faktike për periudhën objekt auditimi, paraqitet në tabelën si më poshtë:

-Nuk është tejkalluar numri i fuqisë punëtore në asnjë rast për periudhën e auditimit.

-Niveli i pagave i aplikuar nga UKT Sh.a nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja Aksionare (Bashkia Tiranë), por vetëm me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 1 të KA, datë 30.01.2019, ku është bashkëlidhur tabela e pagave. Organet drejtuese të Shoqërisë, Këshilli i Administrimit dhe Administratori e kanë quajtur të ezauruar miratimin e nivelit të pagave për vitet 2018-2021, vetëm me miratimin e programit ekonomik ku pjesë e tij është edhe fondi i pagave. Në opinionin e grupit të auditimit ka keq interpretim nga organet drejtuese të Shoqërisë të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” i ndryshuar, neni 6, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

Neni 6, pika 1: “Organet kolegjiale drejtuese të njëjësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërive tregtare, me kapital mbi 50% shtetëror, miratojnë nivelin e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga Ministri përkatës”.

Shoqëria UKT sh.a funksionon me një strukturë pagash të miratuar nga organet drejtuese të saj nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.17, datë 12.12.2016 dhe nr.1, datë 24.01.2018 dhe Asambleja e Aksionarëve me Vendimin nr.18, datë 14.12.2016.

Në këtë strukturë vendosja e nivelit të pagës për secilin pozicion nuk është vlerësuar bazuar në kritere të mirë përcaktuar si arsimimi (niveli i diplomës si master shkencor, master profesional, bachelor apo diplomë e shkollës së mesme), kualifikimi (njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet etj) përgjegjësia (shkalla e përgjegjësisë në funksion të riskut që mund të ketë puna që kryhet) etj.

Niveli i pagave në aneksin B të Rregullores së brendshme ka përcaktuar një sistem pagash sipas ndarjes së klasave dhe niveleve të kualifikimit duke i ndarë ato në dy shkallë ku kategorizohet paga pa vendosur kritere të mirë përcaktuara. Tabela përbëhet nga pesë klasë (klasifikim) KL, KN, A, B,C. Këto klasa nuk janë të ndara më me nënklasa por vetëm me nivele kualifikimi me nga dy shkallë page. Kriteret e përcaktuara në relacionin shpjegues janë: Eksperiencia në profesione; Niveli i diplomës dhe i Master-it; Liçencat; Vështirësitë e vendit të punës dhe Gradat shkencore. Këto kritere nuk janë specifikuar për secilin pozicion pune në tabelën e

pagave për të bërë diferencën mes niveleve të pagave. Si shembull marrim një specialist të burimeve njerëzore që është përcaktuar tek kategoria KN/2, nëndarja 1, me shkallë page minimale 62,500 lekë/muaj dhe maksimale 65,500 lekë/muaj dhe një specialist të Sektorit të Projekteve të Huaja që përcaktohet tek kategoria KN/2, nëndarja 2, me pagë minimale 60,000 lekë/muaj dhe maksimale 62,500 lekë/muaj. Kjo diferencë vihet re edhe ndërmjet pozicioneve ku një Përgjegjës Sektori në Njësi (faturimi) kategorizohet me nivel page më të ulët se një Specialist i Burimeve Njerëzore. Po kështu konstatohet se në tabelën e pagave ka përcaktime të tilla si specialist i parë, specialist i dytë, specialist i tretë, specialist i kualifikuar në detyrë. Për këto ndarje nuk janë vendosur kriteret që duhet të plotësojë një punonjës që të paguhet si i tillë. Ndërkohë që një punonjës të kategorizohet si “Specialist i parë” duhet minimalisht të ketë përfunduar master shkencor, për nivelin e “specialist i dytë” punonjësi duhet që punonjësi të ketë përfunduar master profesional dhe specialist i tretë punonjësi duhet të ketë përfunduar bachelor-in. Po kështu edhe për “Specialist të kualifikuar në detyrë” duhet të ishin vendosur kriteret të tilla si eksperiencia e gjatë në të njëjtin vend pune etj.

Brenda një Drejtorie, Përgjegjësit e Sektorit që përbëjnë këtë drejtori nuk kanë të njëjtën shkallë page. Kjo vërehet në rastin e Drejtorisë Juridike ku Përgjegjësi i Sektorit të Aseteve dhe Përgjegjësi i Sektorit të Përfaqësimit Ligjor paguhet me pagë bazë 69,500 lekë/muaj ndërkohë që Përgjegjësi i Sektorit të Asistencës Ligjore paguhet me pagë 76,500 lekë/muaj. Në Drejtorinë e Prokurimeve, specialistët nuk paguhet sipas kategorisë së vendosur në tabelë, KN/1, nëndarja 2, me pagë minimale 65,500 dhe pagë maksimale 69,500, por me pagë më të ulët. Ky veprim bien ë kundërshtim me tabelën e miratuar të pagave. Nga krahasimi i pagave ndërmjet departamenteve rezulton se specialistët e Departamentit të Shitjes kanë paga më të ulëta se specialistët e departamenteve të tjerë. Edhe ky diferencim nuk është i argumentuar me kriterë objektive.

-Shoqëria “UK Tiranë” sha nuk operon me një Drejtor Tregtar, pasi detyrat e tij kryhen nga Drejtoria Ekonomike (27) e cila përbëhet nga: 1 punonjës Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, 2 punonjës specialistë dhe 1 përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe Raportimit Financiar, 2 punonjës specialistë dhe 1 përgjegjës i Sektorit të Planifikimit Financiar, 2 punonjës specialistë dhe 1 përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit dhe Taksave, 2 punonjës specialistë dhe 1 përgjegjës i Sektorit të Analizës Financiare, 2 punonjës specialistë dhe 1 përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Mjeteve Monetare, 2 punonjës specialistë dhe 1 përgjegjës i Sektorit Tatimor, 1 punonjës përgjegjës i Sektorit të Logjistikës, 4 magazinierë, 1 ekonomist, 1 specialist dhe 1 kartelist i Sektorit të Logjistikës dhe Departament i Shitjes.

Veprim në kundërshtim me nenin 20, pika 2/c të VKM nr.63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, ku citohet: *“Drejtori Tregtar harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv”*.

- Neni 20, pika 2/c në Statutin e “UKT” sha me nr. 08/2 prot., datë 13.12.2021, ku citohet: *“Drejtori Tregtar harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv”*.

-Sipas programit ekonomik për vitin 2018, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 1230 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar 1211 punonjës, pra 19 punonjës më pak. Fondi i pagave është 651.47 milion lekë, pra 4.47 milion lekë më pak se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin 2019, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 1300 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në

të vitit 2019 është realizuar 1249 punonjës, pra 51 punonjës më pak. Fondi i pagave është 672.44 milion lekë, pra 24.46 milion lekë më pak se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin 2020, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 1300 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2019 është realizuar 1284 punonjës, pra 16 punonjës më pak. Fondi i pagave është 706.41 milion lekë, pra 9.49 milion lekë më pak se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin 2021, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 1366 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2019 është realizuar 1359 punonjës, pra 7 punonjës më pak. Fondi i pagave është 756.62 milion lekë, pra 5.09 milion lekë më pak se programi.

-Për periudhën 01.01.2022-31.10.2022, numri mesatar i punonjësve i planifikuar është 1,376 punonjës, paga mesatare e planifikuar është 46,057.11 lekë dhe fondi i pagave i planifikuar është 570.35 mln lekë.

▬ Referuar strukturës organizative të “UKT” sha, të miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr.20, datë 29.09.2022 “Për miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të shoqërisë UKT sha, për vitin 2021” ku janë miratuar 1382 punonjës dhe ndër ta 105 punonjës janë pompistë/pompist klorinues, ku 6 prej tyre nuk janë të pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, konkretisht janë:

-S. F. me detyrë Specialist saldator, A.XH me detyrë saldator, A.G me detyrë saldator, E.D me detyrë saldator, Gj.A me detyrë saldator dhe B.L me detyrë Mekanik-Elektriçist.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, neni 9, pika 1, gërma “a”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

Neni 9: Formimi i punëmarrësve.

Pika 1: Punëdhënësi merr masat e nevojshme që:

Gërma a: Përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrësi që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja nga komisioni i miratuar prej saj.

Dosjet e Personelit

Në 19 raste mungon Autorizimi, në 16 raste mungon Deklarata e Konfidencialitetit, në 3 raste mungon diploma e fakultetit, në 14 raste mungon dokumenti “Pyetjet gjatë intervistës”, në 3 raste mungon Libreza e Punës, në 11 raste mungon Lista e Notave dhe në 3 raste mungon Kontrata Individuale e Punës. Në rastet e dhënies së masave disiplinore për punonjësit, në 50% të rasteve mungon procesverbali.

Veprim në kundërshtim me VKM nr.833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, pika II, lidhja nr.1 dhe nr.2; dhe me “Manualin e procedurave të Drejtorisë së Burimeve të shoqërisë” të miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 25, datë 26.11.2021.

Procedura e Rekrutimit të Punonjësve

Për periudhën 01.09.2018-26.11.2021, periudhë deri në miratimin e “Manualit të procedurave të Drejtorisë së Burimeve të shoqërisë me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 25, datë 26.11.2021, mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e

emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklarimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Tiranë, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira. Evidentohen që për të njëjtin pozicion pune nuk janë të njehësuar kriteret e nevojshme për punësim. Ndërsa gjatë periudhës 26.11.2021-31.10.2022, Manuali i procedurave të Drejtorisë së Burimeve nuk parashikon procedura mbi shpalljen e vendeve vakante.

Veprim në kundërshtim me pikën 7/1, neni 18 i VKM nr.63 datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".

Përshkrimi i procedurave për orët jashtë kohës normale të punës:

-Orët shtesë të punës janë orë pune të cilat kryhen në rastet e emergjencave të ndryshme të paparashikuara, si p.sh: avari në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm ose në rrjetin e kanalizimeve, në rastet e përmytjeve ose të disa rrethanave/avarive të natyrave të ndryshme.

-Kryerja e orëve shtesë justifikohet me anë të një procesverbali që nënshkruhet nga drejtuesi i sektorit përkatës dhe nga punonjësi.

Duke u bazuar te relacionet i procesverbaleve, Drejtori i Përgjithshëm i "UKT" SHA, vendos për kompensimin e orëve shtesë të kryera ose ditë pushimi. Pas nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm procesverbali depozitohet në Drejtorinë Ekonomike.

Për periudhën objekt auditimi shoqëria ka paguar në total 818,755 orë jashtë orarit dhe 324,265,529 lekë në total. Nëse krahasojmë periudhat, në periudhën 01.01.2022-31.10.2022 (edhe pse pa përfunduar ende si vit) ka numër më të lartë të orëve jashtë orarit, pra 254,174 orë dhe 102,184,929 lekë; e cila vijohet nga viti 2019 ku arrin numrin e orëve jashtë orarit në 215,963 orë dhe 87,210,546 lekë.

Masat Disiplinore

Për periudhën objekt auditimi në total janë dhënë 1228 masa disiplinore nga këto: 28 "prerje të pagës për ditë pune kur nuk respektohet orari i punës ose largohesh pa leje", 613 "vërejtje me shkrim", 87 "vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna", 500 "pushime nga puna", 0 "gjobë nja jo më pak se 1000 lekë deri në një pagë mujore" dhe 0 "transferime nga vendi i punës dhe caktimi në një vend tjetër me pagë më të ulët deri në 6 muaj".

-Në kontratën individuale të punës, Neni 13 "Masat disiplinore", shkallëzohen në: prerje e pagës për ditë pune kur nuk respektohet orari i punës ose largohesh pa leje, vërejtje me shkrim, gjobë nja jo më pak se 1000 lekë deri në një pagë mujore, vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna, transferim nga vendi i punës dhe caktimi në një vend tjetër me pagë më të ulët deri në 6 muaj, pushim nga puna".

- Në kontratën kolektive, Neni 22 "Masat disiplinore", pika , "Për të garantuar zbatimin e plotë të kontratës së punës dhe për të siguruar një veprimtari sa më normale e ligjore të marrëdhënieve të punës, për shkeljet e ndryshme të disiplinës dhe për moszbatim të kushteve të kontratës palët ranë dakord të përcaktohen këto masa disiplinore:

- a) Vërejtje me shkrim,
- b) Mbajtja e pagës kur punëmarrësi largohet pa leje nga vendi i punës,
- c) Transferim nga vendi i punës dhe caktim në një vend tjetër me pagë më të ulët deri në 6 muaj,
- d) Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna,
- e) Largim nga puna."

Referuar kontratave të përmendura më sipër konstatohet se ka mospërputhje midis kontratës kolektive dhe kontratës individuale të punës në lidhje me shkallëzimin (klasifikimin) e masave disiplinore.

Në manualin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk është e cituar tek llojet e masave disiplinore: “gjobë nja jo më pak se 1000 lekë deri në një pagë mujore”, ndërkohë që në kontratën individuale të punës është një nga llojet e masave disiplinore.

Baza ligjore: Kontrata kolektive e UKT sha, në Nenin 4 “Fusha e zbatimit”, pika 3 “Çdo dispozitë e kontratës individuale të punës që është në kundërshtim me kontratën kolektive apo më pak e favorshme për punëmarrësin se dispozita e kontratës kolektive, është e pavlefshme dhe zëvendësohet nga dispozita përkatëse e kontratës kolektive”.

Në manualin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të shoqërisë së “UK Tiranë” sha, pika 1.11 “Vlerësimi i performancës në punë”, faqe 38, ku citohet se vlerësimi i performancës në punë duhet të bëhet çdo vit. Ndërkohë, u konstatua se vlerësimet e performancës së punonjësve ruhen jashtë dosjeve të personelit dhe në asnjë nga rastet e kontrolluara nuk ishin të firmosura nga Drejtori i Përgjithshëm i UKT sha.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se në Gjykatën e Lartë janë 31 çështje, nga të cilat 25 çështje janë për dëmshpërblim page dhe 6 çështje për pavlefshmëri titulli. Ndërsa në Gjykatën e Apelit janë 79 çështje nga të cilat 10 çështje janë për dëmshpërblim dëmi, 64 çështje për pavlefshmëri titulli dhe 5 çështje për shpërblim dëmi.

Tabelë: Përmbledhëse e vendimeve gjyqësore.

Nr.		Në Gjykatën e Lartë	Në Gjykatën e Apelit
1	Dëmshpërblim page	25	10
2	Pavlefshmëri titulli + të tjera	6	64
3	Shpërblim dëmi	0	5
	Total	31	79

Burimi: Drejtoria Juridike.

Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për periudhën shtator 2018- tetor 2022, në shoqërinë “UKT” sha kanë qënë 25 persona që kanë përfituar vlerën 11,673,854 lekë, ndërkohë që vlera e shpenzimeve përmbartimore dhe gjyqësore është 2,066,182 lekë. Pra, totali i likujduar për këta 25 punonjës është 13,66,012 lekë.

Nga auditimi u konstatua se janë likujduar 24 punonjës nga vendimet gjyqësore dhe ka ngelur pa u likujduar akoma një punonjëse - M.H, vetëm për vlerën e shpenzimeve përmbartimore dhe gjyqësore prej 36,000 lekë. Ndërkohë punonjësja M.H me vendim Nr.1319, datë 04.10.2018 të formës së prerë, është likujduar tashmë për vlerën e përfituar nga punonjësi prej 452,820 lekë (siç është paraqitur dhe në tabelën më sipër).

Ndërsa punonjësi A.M me vendim Nr.277, datë 05.10.2020 të formës së prerë, **nuk** i është likujduar akoma vlera e përfituar prej 74,024 lekë, pasi nuk ka ardhur nga përmbartuesi.

Dhënia e shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore

Shoqëria “UK Tiranë” sha për periudhën shtator-dhjetor 2018 ka dhënë shpërblime në vlerën 16,920,529 lekë, për vitin 2019 ka dhënë shpërblime në vlerën 19,562,101 lekë, për vitin 2020 ka dhënë 26,122,809 lekë dhe për vitin 2021 ka dhënë 54,742,674 lekë.

-Shpërblimet në total të ndara sipas kategorive janë: Shpërblime Tërmeti në vlerën 1,187,500 lekë, shpërblime për 8-Marsin në vlerën 10,839,000 lekë, shpërblime martese në vlerën 415,000 lekë, shpërblime për punë të mirë në vlerën 27,799,786 lekë, shpërblime lindje në vlerën 1,590,000 lekë, shpërblime vdekje në vlerën 440,000 lekë, leje të pakryer në vlerën 6,269,646 lekë, shpërblim për fundvit në vlerën 64,255,681 lekë, shpërblim për sëmundje në vlerën 100,000 lekë. Pra në total përgjatë periudhës së auditimit (shtator 2018 deri dhjetor 2021) janë dhënë 117,348,113 lekë shpërblime për punonjësit e shoqërisë “UKT” sha.

-Shpërblimet janë dhënë me Urdhër të Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm, dhe jo me miratim nga Këshilli i Administrimit, pasi janë konsideruar të ezauruara me miratimin e programit ekonomik sipas viteve: Me vendim të Këshillit të Administrimit nr.18, datë 12.12.2018 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për vitin 2019, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 16, datë 13.12.2018; me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, datë 19.12.2019 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për vitin 2020, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 11, datë 20.12.2019; me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 9, datë 04.11.2020 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për vitin 2021, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 7, datë 05.11.2020; dhe me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, date 26.11.2021 është miratuar Buxheti i shoqërisë për vitet 2022”, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendimi nr.10, datë 13.12.2021.

Në total këto shpërblime për periudhën 01.09.2018-31.12.2021 janë në vlerën 117,348,113 lekë dhe 8,707,980 lekë për periudhën 01.01.2022-31.10.2022.

Shpërblimet janë dhënë me Urdhër të Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm, dhe jo me miratim nga Këshilli i Administrimit. Në total këto shpërblime për punonjësit për periudhën 01.09.2018-31.12.2021 janë në vlerën 117,348,113 lekë. Referuar vendimit të Këshillit të Administrimit dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve për miratimin programit ekonomik të viteve respektive të zëri shpenzime personeli (shpërblim), paraqiten në tabelën si më poshtë:

Përsa i përket periudhës 01.01.2022 deri 31.10.2022 janë dhënë shpërblime në vlerën 8,707,980 lekë, ku: 4,040,000 lekë janë dhënë për ditën e 8 Marsit, rreth 1,123,000 lekë janë dhënë për dalje në pension, rreth 2,174,730 lekë janë dhënë për leje të pakryer dhe pjesa tjetër për punë të mirë, shpërblim lindje dhe vdekje.

Ndalesat për Sindikatën

-Ndalesat për sindikatën, bazohen në Kodin e Punës, Neni 117, pika 2. Nga auditimi i borderove të pagës me përzgjedhje, ndalesat për sindikatën nuk janë mbajtur nga paga për të gjithë punonjësit, por vetëm për ata punonjës që kanë firmosur autorizimin për mbajtjen e kuotës prej 100 lekë nga paga e tyre mujore, për t’u derdhur më tej në llogarinë e sindikatës.

Konkretisht, u audituan ndalesat për sindikatën dhe xhirimet. Nga auditimi rezultoi që shoqëria “UK Tiranë” sha nuk ka detyrime ndaj Sindikatës.

Në muajin Prill 2022 ka ndodhur një gabim me 500 lekë dhe është sistemuar në muajin maj. Në prill vlera e ndalur ka qenë 97,000 lekë, ndërsa vlera e xhiruar 96,500 lekë. Për të bërë rregullimin e saj, në maj janë ndalur 97,000 lekë dhe për të xhiruar 97,500 lekë. Pra, rezulton se veprimi është rregulluar. Në bazë të auditimit të xhirimeve me përzgjedhje për llogari të Federatës Sindikale të Ndërtim Drurit dhe Punëve Publike u konstatua se nuk ka detyrime për sindikatën, pasi pagesat janë kryer.

-Plotësimi i listë pagesave nga punonjësi i caktuar për pagat, si dhe mbështetja në të dhënat e dokumentacionit bazë (listë prezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Kontrolli dhe nënshkrimi nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.

Nga auditimi në tërësi të listë pagesave për periudhën e përcaktuar në program, rezultoi se shuma e përgjithshme e listë pagesave është e njëjtë me urdhër xhirimin e përgatitur për këtë qëllim. Përmbledhëset e listë pagesës në çdo rast janë të nënshkruara nga eprori direkt dhe drejtori i departamentit etj. Listë pagesat janë të shoqëruara me listë prezencat përkatëse për çdo drejtori. Listë pagesat paraqesin nga paga bruto, shtesat, ndalesat deri në pagën neto.

Në procedurën e pagesës hartohet listë prezenca dhe nënshkruhet nga drejtorët e drejtorive më pas hartohet listë pagesa mbi bazën e klasifikimit të pagave, shtesa për pozicione të veçanta pune

të cilat janë të miratuara nga Këshilli i Administrimit, duke kryer llogaritjet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, plotësohet listë-pagesa përkatëse dhe dërgohet në bankë për pagesë.

Janë kryer ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi sipas përcaktimeve në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe janë paguar brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

Është përllogaritur, ndalur dhe derdhur në organet tatimore kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e pagës minimale dhe maksimale si dhe përqindjeve përkatëse punëdhënës e punëmarrës sipas VKM nr. 1114, datë 30.7.2008 i ndryshuar “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11. 5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligji nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 26, datë 16.4.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” i ndryshuar, dhe pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 457, datë 09.07.2014, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008, të këshillit të ministrave, “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i përcaktuar *jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës*. Pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Përsa i përket detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale, në vitin 2018 janë në vlerën 53,700,003 lekë, në vitin 2019 në vlerën 56,121,191 lekë, në vitin 2020 në vlerën 57,631,586 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 70,064,787 lekë. Pra, themi se detyrimet për tatimin mbi të ardhurat personale përgjatë periudhës së auditimit kanë ndjekur një trend rritës.

Përsa i përket kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në vitin 2018 janë në vlerën 227,189,842 lekë, në vitin 2019 në vlerën 236,156,031 lekë, në vitin 2020 në vlerën 242,895,165 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 269,843,685 lekë. Pra, themi se kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përgjatë periudhës së auditimit kanë ndjekur një trend rritës.

Viti 2018: Nga auditimi i Urdhër-transfertave për llogari të Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe faturave nga tatimet, me përzgjedhje muajt: tetor, dhjetor 2018, për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat, u konstatua se detyrimet me shtetin janë likuiduar nga shoqëria “UKT” SHA. Konkretisht, pagesa e muajit tetor është bërë në B (23,102,214 lekë). Pagesa e muajit dhjetor është bërë në B (21,961,002 lekë). U vërtetua gjithashtu se këto vlera korrespondojnë përkatësisht me listëpagesat e nxjerra nga sistemi ESIG.

Viti 2019: Nga auditimi i Urdhër-transfertave për llogari të Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe faturave nga tatimet, me përzgjedhje muajt: shkurt, prill, tetor, dhjetor 2019, për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat, u konstatua se detyrimet me shtetin janë likuiduar nga shoqëria “UKT” SHA. Konkretisht, pagesa e muajit

shkurt është bërë pjesërisht në R. (13,000,000 lekë) dhe pjesërisht në C (10,657,227 lekë). Pagesa e muajit prill është bërë pjesërisht në bankën R. (13,000,000 lekë) dhe pjesërisht në B K (diferenca e faturës, 11,161,027 lekë). Pagesa e muajit tetor është bërë në B (25,455,479 lekë). Pagesa e muajit dhjetor është bërë në B (24,314,242 lekë). U vërtetua gjithashtu se këto vlera korrespondojnë përkatësisht me listëpagesat e nxjerra nga sistemi ESIG.

Viti 2020: Nga auditimi i Urdhër-transfertave për llogari të Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe faturave nga tatimet, me përzgjedhje muajt: shkurt, prill, tetor, dhjetor 2020, për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat, u konstatua se detyrimet me shtetin janë likuiduar nga shoqëria “UKT” SHA. Konkretisht, pagesa e muajit shkurt është bërë në dt 25.03.2020 në B.(26,693,993 lekë) dhe jo brenda datës 20 të muajit pasardhës.

Veprim në kundërshtim me nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës”.

Pagesa e muajit prill është bërë në B (22,327,163 lekë). Pagesa e muajit tetor është bërë në R (25,826,590 lekë). Pagesa e muajit dhjetor është bërë në B (27,295,668 lekë). U vërtetua gjithashtu se këto vlera korrespondojnë përkatësisht me listëpagesat e nxjerra nga sistemi ESIG.

Viti 2021: Nga auditimi i Urdhër-transfertave për llogari të Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe faturave nga tatimet, me përzgjedhje muajt: shkurt, prill, tetor, dhjetor 2021, për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat, u konstatua se detyrimet me shtetin janë likuiduar nga shoqëria “UKT” SHA. Konkretisht, pagesa e muajit shkurt është bërë në C (27,927,067 lekë). Pagesa e muajit prill është bërë në B (28,500,448 lekë). Pagesa e muajit tetor është bërë në B (28,515,798 lekë). Pagesa e muajit dhjetor është bërë në C (31,187,442 lekë). U vërtetua gjithashtu se këto vlera korrespondojnë përkatësisht me listëpagesat e nxjerra nga sistemi ESIG.

Janë audituar me zgjedhje listë-pagesat e periudhës objekt auditimi 01.09.2018 - 31.10.2022 nga të cilat rezulton se janë hartuar në rregull dhe nuk ka probleme me llogaritjen e ndalesave të tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Detyrimet janë derdhur pranë institucioneve përkatëse dhe institucioni nuk është penalizuar me gjoba apo interesa të paguara për pagesë të vonuar, përveç një rasti ku është paguar një kamatëvonesë në vlerën 4,388 lekë, pasi fatura tatimore e muajit shkurt 2020 nuk është paguar brenda afatit të lejuar (data 20 mars 2020).

-Bazuar në strukturën organizative të vitit 2018 të shoqërisë “UK Tiranë” sha është miratuar që numri i punonjësve të jetë 1230 punonjës në total. Faktikisht përgjatë vitit 2018, “UKT” SHA ka operuar me 1211 punonjës, Pra, kemi një mosrealizim të planit me 19 punonjës më pak. Pra, është realizuar në masën 98,46%.

Tabelë: Shpenzimet e pagave dhe kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2018.

Viti	2018			
	Plan	Fakt	Diferenca	%
Shpenzime paga dhe shpërblime	849,68	840,76	(8,92)	98,95
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	136,10	135,97	(0,13)	99,90
Nr. i miratuar I punonjësve	1,230	1,211	(19)	98,46

Burimi: Sektori i Financës, “UK Tiranë” sha

Bazuar në strukturën organizative të vitit 2019 të shoqërisë “UK Tiranë” sha është miratuar që numri i punonjësve të jetë 1300 punonjës në total. Faktikisht përgjatë vitit 2019, “UKT” SHA ka operuar me 1249 punonjës, Pra, kemi një mosrealizim të planit me 51 punonjës më pak. Pra, është realizuar në masën 96,08%.

Tabelë: Shpenzimet e pagave dhe kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2019.

Viti	2019			
	Plan	Fakt	Diferenca	%
Shpenzime paga dhe shpërblime	869,83	871,54	1,71	100,20
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	138,43	141,95	3,52	102,54
Nr. i miratuar i punonjësve	1,300	1,249	(51)	96,08

Burimi: Sektori i Financës, “UK Tiranë” sha.

Bazuar në strukturën organizative të vitit 2020 të shoqërisë “UK Tiranë” sha është miratuar që numri i punonjësve të jetë 1350 punonjës në total. Faktikisht përgjatë vitit 2020, “UKT” SHA ka operuar me 1284 punonjës. Pra, kemi një mosrealizim të planit me 16 punonjës më pak. Pra, është realizuar në masën 98,77%.

Tabelë: Shpenzimet e pagave dhe kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2020.

Viti	2020			
	Plan	Fakt	Diferenca	%
Shpenzime paga dhe shpërblime	866,51	905,41	38,90	104,49
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	133,49	145,38	11,89	108,91
Nr. i miratuar i punonjësve	1,300	1,284	(16)	98,77

Burimi: Sektori i Financës, “UK Tiranë” sha.

Bazuar në strukturën organizative të vitit 2021 të shoqërisë “UK Tiranë” sha është miratuar që numri i punonjësve të jetë 1366 punonjës në total. Faktikisht përgjatë vitit 2021, “UKT” SHA ka operuar me 1359 punonjës, Pra, kemi një mosrealizim të planit me 7 punonjës më pak, është realizuar në masën 99,49%.

Tabelë: Shpenzimet e pagave dhe kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2021.

Viti	2021			
	Plan	Fakt	Diferenca	%
Shpenzime paga dhe shpërblime	969,42	1,030,50	61,08	106,30
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	142,75	161,52	18,77	113,15
Nr. i miratuar i punonjësve	1,366	1,359	(7)	99,49

Burimi: Sektori i Financës, “UK Tiranë” sha.

Bazuar në strukturën organizative të vitit 2022 nga 01.01.2022-31.10.2022 të shoqërisë “UK Tiranë” sha është miratuar që numri i punonjësve të jetë 1376 punonjës në total. Faktikisht përgjatë vitit 2021, “UKT” SHA ka operuar me 1370 punonjës, Pra, kemi një mosrealizim të planit me 6 punonjës më pak, është realizuar në masën 99.56%.

Tabelë: Shpenzimet e pagave dhe kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2022.

Viti	2022-9 mujori			
	Plan Janar-Shtator	Fakt Janar-Shtator	Diferenca	%
Shpenzime paga dhe shpërblime	720.47	764.35	43.88	106.09
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	114.30	125.30	11.00	109.63
Nr, i miratuar I punonjësve	1,376	1,370	(6.00)	99.56

Burimi: Sektori i Financës, “UK Tiranë” sha.

1. Titulli i gjetjes:	Ndryshimet në nivelin e pagave nuk janë miratuar specifikisht nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve (Bashkia Tiranë).
Situata:	Niveli i pagave është miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 1, datë 30.01.2019, por jo nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve (Bashkia Tiranë). Këshilli i Administrimit dhe Drejtori i Përgjithshëm e kanë quajtur të ezauruar miratimin e nivelit të pagave për periudhën kohore 01.09.2018-31.10.2022, referuar Vendimit të Assamblesë së përgjithshme nr. 18, datë 14.12.20216, si dhe me miratimin e programit ekonomik të çdo viti, ku pjesë e tij është edhe fondi i pagave. Në opinionin e grupit të auditimit ka keq interpretim nga organet drejtuese të Shoqërisë të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” i ndryshuar, neni 6, pika 1.
Kriteri:	Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” i ndryshuar, neni 6.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos vendimmarrjen e duhur
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore përkatëse.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit në të ardhmen të merren masat për miratimin e nivelit të pagave nga Asambleja Aksionare (Bashkia Tiranë) duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet ligjore në mirëorganizimin dhe mirëfunksionimin e Shoqërisë.

2. Titulli i gjetjes:	Vendosja e nivelit të pagës për secilin pozicion nuk është vlerësuar bazuar në kriteret të mirë përcaktuar.
Situata:	Shoqëria UKT sh.a funksionon me një strukturë pagash të miratuar nga organet drejtuese të saj nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.17, datë 12.12.2016 dhe nr.1, datë 24.01.2018 dhe Asambleja e Aksionarëve me Vendimin nr.18, datë 14.12.2016. Në këtë strukturë vendosja e nivelit të pagës për secilin pozicion nuk është vlerësuar bazuar në kriteret të mirë përcaktuar si arsimimi (niveli i

	<p>diplomës si master shkencor, master professional, bachelor apo diplomë e shkollës së mesme), kualifikimi (njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet etj) përgjegjësia (shkalla e përgjegjësisë në funksion të riskut që mund të ketë puna që kryhet) etj. Niveli i pagave në aneksin B të Rregullores së brendshme ka përcaktuar një sistem pagash sipas ndarjes së klasave dhe niveleve të kualifikimit duke i ndarë ato në dy shkallë ku kategorizohet paga pa vendosur kriteret të mirë përcaktuara. Tabela përbëhet nga pesë klasë (klasifikim) KL, KN, A, B,C. Këto klasa nuk janë të ndara më me nënklasa por vetëm me nivele kualifikimi me nga dy shkallë page. Kriteret e përcaktuara në relacionin shpjegues janë: Eksperiencia në profesione; Niveli i diplomës dhe i Master-it; Liçencat; Vështirësitë e vendit të punës dhe Gradat shkencore. Këto kriteret nuk janë specifikuar për secilin pozicion pune në tabelën e pagave për të bërë diferencën mes niveleve të pagave. Si shembull marrim një specialist të burimeve njerëzore që është përcaktuar tek kategoria KN/2, nëndarja 1, me shkallë page minimale 62,500 lekë/muaj dhe maksimale 65,500 lekë/muaj dhe një specialist të Sektorit të Projekteve të Huaja që përcaktohet tek kategoria KN/2, nëndarja 2, me pagë minimale 60,000 lekë/muaj dhe maksimale 62,500 lekë/muaj. Kjo diferencë vihet re edhe ndërmjet pozicioneve ku një Përgjegjës Sektori në Njësi (faturimi) kategorizohet me nivel page më të ulët se një Specialist i Burimeve Njerëzore. Po kështu konstatohet se në tabelën e pagave ka përcaktime të tilla si specialist i parë, specialist i dytë, specialist i tretë, specialist i kualifikuar në detyrë. Për këto ndarje nuk janë vendosur kriteret që duhet të plotësojë një punonjës që të paguhet si i tillë. Ndërkohë që një punonjës të kategorizohet si “Specialist i parë” duhet minimalisht të ketë përfunduar master shkencor, për nivelin e “specialist i dytë” punonjësi duhet që punonjësi të ketë përfunduar master profesional dhe specialist i tretë punonjësi duhet të ketë përfunduar bachelor-in. Po kështu edhe për “Specialist të kualifikuar në detyrë” duhet të ishin vendosur kriteret të tilla si eksperiencia e gjatë në të njëjtin vend pune etj.</p> <p>Brenda një Drejtorie, Përgjegjësit e Sektorit që përbëjnë këtë drejtori nuk kanë të njëjtën shkallë page. Kjo vërehet në rastin e Drejtorisë Juridike ku Përgjegjësi i Sektorit të Aseteve dhe Përgjegjësi i Sektorit të Përfaqësimit Ligjor paguhen me pagë bazë 69,500 lekë/muaj ndërkohë që Përgjegjësi i Sektorit të Asistencës Ligjore paguhet me pagë 76,500 lekë/muaj. Në Drejtorinë e Prokurimeve, specialistët nuk paguhen sipas kategorisë së vendosur në tabelë, KN/1, nëndarja 2, me pagë minimale 65,500 dhe pagë maksimale 69,500, por me pagë më të ulët. Ky veprim bien ë kundërshtim me tabelën e miratuar të pagave. Nga krahasimi i pagave ndërmjet departamenteve rezulton se specialistët e Departamentit të Shitjes kanë paga më të ulëta se specialistët e departamenteve të tjerë. Edhe ky diferencim nuk është i argumentuar me kriteret objektive.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së

	Shqipërisë” i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Risk për keqmenaxhim të burimeve njerëzore.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në menaxhimin e burimeve njerëzore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të Shoqërisë të rishikohen dhe llogariten nivelet e pagave të punonjësve duke u bazuar në kritere të mirë përcaktuar si arsimimi (niveli i diplomës si master shkencor, master professional, bachelor apo diplomë e shkollës së mesme), kualifikimi (njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet etj) përgjegjësia (shkalla e përgjegjësisë dhe vështirësisë në funksion të riskut që mund të ketë puna që kryhet) etj, duke shmangur pagesat me diferenca të konsiderueshme për punonjësit me natyrë të njëjtë pune dhe duke synuar motivimin e tyre.
3. Titulli i gjetjes:	Mos unifikimi ndërmjet strukturës, statutit dhe VKM nr. 63, datë 27.01.2016.
Situata:	Shoqëria “UK Tiranë” sha nuk operon me Drejtor Tregtar, pasi detyrat e tij kryhen nga Drejtoria Ekonomike dhe Departamenti i Shitjes.
Kriteri:	- Neni 20, pika 2/c të VKM nr.63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, ku citohet: <i>“Drejtori Tregtar harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv”</i> . - Neni 20, pika 2/c në Statutin e “UKT” sha me nr. 08/2 prot., datë 13.12.2021, ku citohet: <i>“Drejtori Tregtar harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv”</i> .
Ndikimi/Efekti:	Risk për keq menaxhim të shoqërisë
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore përkatëse.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të Shoqërisë të bëhet unifikimi i strukturës organizative me statutin e Shoqëris dhe dhe VKM nr. 63, datë 27.01.2016.

4. Titulli i gjetjes:	Punonjës me profesion elektrikistë/elektropompist, pa dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.
Situata:	Referuar strukturës organizative të “UKT” sha, të miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 20, datë 29.09.2022 “Për miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të shoqërisë, për vitin 2021” janë punësuar 1382 punonjës dhe ndër ta 105 punonjës janë pompistë/pompist klorinues, 6 prej tyre nuk janë të pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.
Kriteri:	Ligji nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, neni 9, pika 1, gërma “a”.

Ndikimi/Efekti:	Risk i lartë për aksidente në punë.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	I Lartë.
Rekomandimi:	Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore të merren masa për pajisjen e punonjësve me profesion elektrikistë/elektropompist me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, në përputhje sipas dispozitave ligjore.

5. Titulli i gjetjes:	Mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.
Situata:	Për periudhën 01.01.2018-26.11.2021, periudhë para miratimit të “Manualit të procedurave të Drejtorisë së Burimeve të shoqërisë “UK Tiranë” sha” me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 25, datë 26.11.2021, u konstatua se mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Tiranë, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira. Evidentohen që për të njëjtin pozicion pune nuk janë të njehësuar kriteret e nevojshme për punësim. Ndërsa gjatë periudhës 26.11.2021-31.10.2022, u konstatua se Manuali i procedurave të Drejtorisë së Burimeve nuk parashikon procedura mbi shpalljen e vendeve vakante.
Kriteri:	VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, neni 18 pika 7/1, Statuti dhe Rregullorja e brendshme e UK Tiranë Sh.a.
Ndikimi/Efekti:	Mos evidentim i procedurave të rekrutimeve, parregullsi në përzgjedhjen e punëmarrësve.
Shkaku:	Mungesa e parashikimeve specifike lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Moszbatimi i parashikimeve të bëra në deklaratat për pozicionin e lirë të punës lidhur me kriteret për disa pozicione pune.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga organet drejtuese të bëhen parashikime të detajuara statutores dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me

	transferimet dhe ngritjet në detyrë.
Rekomandimi:	Nga Administratori i Shoqërisë të përcaktohet në deklaratimet për pozicione të lira pune, edhe afati brenda të cilit të interesuarit për pozicionin e punës duhet të shprehin interesin dhe paraqesin dokumentacionin e nevojshëm provues.

6. Titulli i gjetjes:	Shpërblim i punonjësve pa u miratuar nga Asambleja.
Situata:	Për periudhën objekt auditimi janë shpërblyer punonjësit në vlerën 126,056,093 lekë. Shpërblimet janë dhënë me Urdhër të Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm, dhe jo me miratim nga Këshilli i Administrimit, pasi janë konsideruar të ezauruara me miratimin e programit ekonomik sipas viteve: Me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 18, datë 12.12.2018 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për vitin 2019, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 16, datë 13.12.2018; me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, datë 19.12.2019 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për vitin 2020, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 11, datë 20.12.2019; me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 9, datë 04.11.2020 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për vitin 2021, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 7, datë 05.11.2020 dhe me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, date 26.11.2021 është miratuar Buxheti i shoqërisë për vitet 2022”, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendimi nr.10, datë 13.12.2021.
Kriteri:	Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, i ndryshuar, neni 6, pika 1, gërma b - Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 160 “Shpërblimi”, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos vendimmarrjen e duhur
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese t’i kushtohet vëmendje e duhur Institucionale shpërblimit të punonjësve.

7. Titulli i gjetjes:	Mospërputhje mes kontratës kolektive dhe kontratës individuale në lidhje me klasifikimin (shkallëzimin) e masave disiplinore.
Situata:	Ka mospërputhje midis kontratës kolektive dhe kontratës individuale të punës në lidhje me shkallëzimin (klasifikimin) e masave disiplinore. Konkretisht në kontratën individuale të punës, Neni 13 “Masat disiplinore”, të cilat shkallëzohen në: prerje e pagës për ditë pune kur nuk respektohet orari i punës ose largohesh pa leje, vërejtje me shkrim, gjobë nja jo më pak se 1000 (një mijë) lekë deri në një pagë mujore, vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna, transferim nga vendi i punës dhe caktimi në një vend tjetër me pagë më të ulët deri në 6 muaj, pushim nga puna”.

	<p>-Në kontratën kolektive, Neni 22 “Masat disiplinore”, pika , “Për të garantuar zbatimin e plotë të kontratës së punës dhe për të siguruar një veprimtari sa më normale e ligjore të marrëdhënieve të punës, për shkeljet e ndryshme të disiplinës dhe për moszbatim të kushteve të kontratës palët ranë dakord të përcaktohen këto masa disiplinore: Vërejtje me shkrim; Mbajtja e pagës kur punëmarrësi largohet pa leje nga vendi i punës; Transferim nga vendi i punës dhe caktim në një vend tjetër me pagë më të ulët deri në 6 muaj; Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna; Largim nga puna” . Në manualin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk është e cituar tek llojet e masave disiplinore: “gjobë nja jo më pak se 1000 (një mijë) lekë deri në një pagë mujore”, ndërkohë që në kontratën individuale të punës është një nga llojet e masave disiplinore.</p>
Kriteri:	Kontrata kolektive e lidhur midis Shoqërisë “UKT” Sha dhe Sindikatës, me nr. 7720/4 prot., datë 16.07.2018e UKT sha, në Nenin 4 “Fusha e zbatimit”, pika 3.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos menaxhimin e duhur të burimeve njerëzore
Shkaku:	Keq interpretim i legjislacionit të punës
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandimi :	Nga Organet Drejtuese të merren masa për të bërë unifikimin e kontratës kolektive dhe kontratës individuale të nënpunësve në lidhje me klasifikimin (shkallëzimin) e masave disiplinore.

Titulli i gjetjes:	Vlerësime pune të performancës së punonjësve të pa firmosura nga Drejtori i Përgjithshëm i UKT sha.
8. Situata:	Nga auditimi u konstatua se vlerësimet e performancës së punonjësve ruhen jashtë dosjeve të personelit dhe në asnjë nga rastet e kontrolluara nuk ishin të firmosura nga Drejtori i Përgjithshëm i UKT sha. Në manualin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të shoqërisë së “UK Tiranë” sha, pika 1.11 “Vlerësimi i performancës në punë”, faqe 38, ku citohet se vlerësimi i performancës në punë duhet të bëhet çdo vit.
Kriteri:	Manuali i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të shoqërisë së “UK Tiranë” sha, pika 1.11 “Vlerësimi i performancës në punë”, faqe 38, ku citohet se vlerësimi i performancës në punë duhet të bëhet çdo vit.
Ndikimi/Efekti:	Risk për vendimmarrje të gabuara
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur institucionale
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi .1:	Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që vlerësimet e performancës në punë të punonjësve të bëhen çdo vit dhe të firmosen nga Eprori Direkt dhe Drejtori i Përgjithshëm, pasi ato janë tregues mjaft të rëndësishëm për performancën e shoqërisë.

2.5. Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).

Auditimi u ushtrua me zgjedhje³, konkretisht u audituan urdhër transfertat (Shpenzimet me anë të bankës), për muajin tetor, dhjetor 2019, maj, dhjetor 2020, qershor, dhjetor 2021 dhe maj 2022. Nga auditimi i veprimeve të kryera, nëpërmjet bankës dh arkës, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se përgjithësisht transaksionet/veprimet janë kryer konformë Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit 83/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij.

Veprimet financiare janë regjistruar në regjistrat e kontabilitetit, bazuar në dokumente vërtetues. Dokumentacioni është i sistemuar në mënyrë kronologjike.

Ajo që konstatohet është se UKT SHA nuk ka të hartuar një program mbi likuidimin e pagesave sipas periudhës së ardhjes së tyre por, pa ndonjë rregull dhe përgjithësisht likuidimet janë pjesore.

Qershor 2021

Bashkëlidhur ditari i veprimeve të bankës për periudhën 1-30 qershor 2021 si dhe ekstrakti i bankës për periudhën 1-30 qershor 2021.

Me urdhër transfertën e B date 02.06.2021 është kryer pagesa prej 16,610 lekë kundrejt Filialit të P. SHA, bashkëlidhur fatura.

Me urdhër transfertën e B date 02.06.2021 është kryer pagesa prej 19,723.44 lekë kundrejt A për numrin e gjelbër të telefonit, bashkëlidhur fatura.

Me urdhër transfertën e B date 02.06.2021 është kryer pagesa prej 8,600 lekë kundrejt A për shërbime telefonie, bashkëlidhur fatura. Konstatohet se brenda pagesës prej 8,600 lekë është paguar 600 lekë kamat vonesë.

Me urdhër transfertën e B date 02.06.2021 është kryer pagesa prej 22,798.8 lekë kundrejt A për shërbime telefonie, bashkëlidhur fatura. Konstatohen detyrime të prapambetura nga kësaj shoqërie.

Me urdhër transfertën e B date 03.06.2021 është kryer pagesa prej 15,000,000 lekë kundrejt V. konstrukcion është kryer pagesa pjesore e situacionit përfundimtar në vlerën 57,392,970 lekë. Bashkëlidhur shkresa përcjellëse nr. 299, date 25.01.2021 e Drejtorit të Departamentit Inxhinierik, fatura tatimore nr. 44, date 30.12.2020 me vlerë 57,392,970 lekë, situacionin përfudimtar, Akt-Kolaudimi datë 23.12.2020, kontrata nr. 6091/6, date 24.06.2020.

Me urdhër transfertën e B date 03.06.2020 është kryer pagesa prej 79,977 lekë, është kryer pagesa për dëmshpërbim për zhdëmtim. Bashkëlidhur kontrata nr. 619, date 27.05.2021 e lidhur midis Njësisë Administrative Shëngjergj dhe banorëve të zonës. Bashkëlidhur mungon dokumentacioni që tregon marrjen përsipër të këtyre detyrimeve.

Me urdhër transfertën e B date 08.06.2021 është kryer pagesa prej 97,000 lekë kundrejt Federata Sindikale e Ndërtimit të Durrësit dhe Publike.

³ *Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit”, i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.*

Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampinonët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur” .

Me urdhër transfertën e B date 10.06.2021 është kryer pagesa prej 2,071,052 lekë kundrejt 14 pronarëve të ambienteve që UKT SHA ka marrë me qera. Bashkëlidhur ka vetëm autofaturat e UKT SHA.

Me urdhër transfertën e B date 10.06.2021 është kryer pagesa prej 1,000,000 lekë kundrejt Fastech si pagesë pjesore e faturës nr. 259, date 21.10.2020. Bashkëlidhur vetëm fatura.

Me urdhër transfertën e B date 18.06.2021 është kryer pagesa prej 1,611,900 lekë kundrejt C sh.p.k. Bashkëlidhur vetëm fatura tatimore nr. 108, date 04.05.2021 dhe lista e automjeteve nga C sh.p.k. Bashkëlidhur mungon relacion mbi shërbimin e marrë dhe konformiteti me kushtet e kontratës.

Me urdhër transfertën e B datë 22.06.2021 është kryer pagesa prej 58,809,307 lekë kundrejt G sh.p.k. Bashkëlidhur relacion dhe procesverbalet e kryerjes së shërbimit.

Me urdhër transfertën e B date 21.06.2021 (782-792) janë kryer pagesat e energjisë elektrike.

Me urdhër transfertën e B datë 18.06.2021 është kryer pagesa prej 1,534,879.2 lekë kundrejt X M shpk. Bashkëlidhur 4 fatura:

Fatura nr. 10, date 01.04.2019 vlere 642,258 lekë

Fatura nr. 8, date 01.04.2019 vlere 1,031,204,4 lekë

Fatura nr. 9, date 01.04.2019, vlere 271,800 lekë

Fatura nr. 17, date 10.06.2019, vlere 562,248 lekë

Totali 2,507,510.4 lekë.

Bashkëlidhur praktikës shkresa nr. 1687, date 06.05.2019 që përcjell dokumentacionin tek financa, dhe kontratat respektive. Nuk ka asnjë relacion bashkëlidhur mbi konformitetit të kryerjes së shërbimit.

Me urdhër transfertën e B datë 22.06.2021 është kryer pagesa prej 8,857,886 lekë (pagesë pjesore) kundrejt G sh.p.k. bashkëlidhur vetëm fatura tatimore nr. 102, date 15.04.2021, e cila ka vlerën 25,113,564 lekë. Pas kërkesës së Grupit të auditimit u plotësua praktika me dokumentacion justifikues.

Me urdhër transfertën e C datë 03.06.2021 është kryer pagesa prej 9,801,551 lekë kundrejt G sh.p.k bashkëlidhur vetëm fatura tatimore nr. 2465, date 30.04.2021, procesverbalet e kryerjes së shërbimit dhe Akt-kolaudimi nr. 4179/12, date 29.04.2021.

Me urdhër transfertën e C datë 09.06.2021 është kryer pagesa prej 6,395,492 lekë kundrejt "S" sh.p.k. bashkëlidhur fatura tatimore nr. 22, date 15.06.2020, e cila ka vlerën 8,437,680 lekë. Bashkëlidhur kontrata,, situacioni përfundimtar, marrja në dorëzim.

Me urdhër transfertën e C datë 15.06.2021 është kryer pagesa prej 25,000,000 lekë kundrejt B S sh.p.k. bashkëlidhur faturat tatimore për kontratë të vitit 2015. Bashkëlidhur faturat, kontratat dhe situacionet përkatëse.

Dhjetor 2021

Me urdhër transfertën e B datë 03.12.2021 është kryer pagesa prej 11,400 lekë kundrejt F.M. bashkëlidhur faturat tatimore. Nuk ka dokumentacion justifikues pagese.

Me urdhër transfertën e B date 03.12.2021 është kryer pagesa prej 2,638,807 lekë kundrejt A shpk për garanci të mbajtura për kontrata të realizuara në vitin 2014-2016.

Me urdhër transfertën e B date 06.12.2021 është kryer pagesa prej 51,800 lekë kundrejt I S D (2 muaj). Bashkëlidhur nuk ka asnjë dokumentacion që verifikon kryerjen e shërbimit "Asistencë dhe mirëmbajtje e programit Financa 5", Kontrata e lidhur nr. 18515/4, date 11.11.2020 me vlerë 259,000 lekë për një vit.

Me urdhër transfertën e B date 06.12.2021 është kryer pagesa prej 15,000,000 lekë kundrejt "L" sh.p.k. bashkëlidhur fatura tatimore nr. 37, date 20.10.2020 me vlerë 8,718,000 lekë dhe fatura

tatimore nr. 38, date 20.10.2021 me vlerë 8,718,000 lekë (pjesore). Akt kolaudimi nr. 320/1, date 20.10.2020 nuk tregon asnjë verifikim të kryer.

Me urdhër transfertën e B date 07.12.2021 është kryer pagesa prej 20,000,000 lekë kundrejt V sh.p.k. pagesë pjesore dhe bashkëlidhur vetëm fature nr. 57, date 30.06.2021 me vlerë 37,333,422 lekë.

Me urdhër transfertën e B K date 15.12.2021 është kryer pagesa prej 3,500,000 lekë kundrejt B shpk, pagesë pjesore e faturës nr. 203, date 15.12.2021.

Me urdhër transfertën e B date 15.12.2021 është kryer pagesa prej 5,000,000 lekë kundrejt I shpk, pagesë pjesore e faturës nr. 143, date 06.01.2021.

Me urdhër transfertën e B date 15.12.2021 është kryer pagesa prej 15,000,000 lekë kundrejt W C, pagesë për disa fatura të furnizimit me klor.

Me urdhër transfertën e B K date 24.12.2021 është kryer pagesa prej 3,043,069 lekë kundrejt V Z, pagesë për rroba pune, pagesë pjesore. Bashkëlidhur vetëm fatura.

Dhjetor 2020

Me urdhër transfertën e C date 10.12.2020 është kryer pagesa prej 10,000,000 lekë kundrejt W C, pagesë për Hipoclorit Natriumi. Bashkëlidhur gjithë marrjet në dorëzim. Pagesa e kryer për 10 fatura.

Me urdhër transfertën e C date 10.12.2020 është kryer pagesa prej 5,000,000 lekë kundrejt AT sh.p.k për likuidim faturash për furnizimet me karburant. Bashkëlidhur mungojnë Akt-marrje në dorëzim dhe analiza e çmimit.

Me urdhër transfertën e C date 23.12.2020 është kryer pagesa prej 10,000,000 lekë kundrejt I. sh.p.k., likuidim pjesor i faturës nr. 27, date 07.09.2020. Bashkëlidhur kontrata dhe situacioni dhe Akt-kolaudimi.

Me urdhër transfertën e C date 23.12.2020 është kryer pagesa prej 5,826,026 lekë kundrejt S sh.p.k për faturën nr. 303, date 20.02.2019 dhe kontratën nr. 17938/7, date 30.10.2018.

Me urdhër transfertën e B K date 30.12.2020 është kryer pagesa prej 705,033 lekë kundrejt S C, për garanci të punimeve e cila ka përfunduar që në qershor 2019.

Maj 2022

Me urdhër transfertën e B K date 20.05.2022 është kryer pagesa prej 1,035,893 lekë kundrejt E Shpk për kontrata punimesh të vitit 2017.

Me urdhër transfertën e B K date 09.05.2022 është kryer pagesa prej 1,289,123 lekë kundrejt V K, Akt-marrje në dorëzim nr. 36/1, date 15.02.2019. Pagesë e kryer 2 vite e 3 muaj me vonesë.

Shpenzimet për automjetet

Nga auditimi u konstatua se UKT SHA ka një numër të konsiderueshëm automjeteve në përdorim për të cilat u vendosën në dispozicion normativat, ku konstatohet se:

Për disa prej automjeteve nuk janë testuar për konsumi i karburantit a disa deklaratat të marra nga kompanitë ku janë blerë, disa deklaratat janë pa datë dhe një është e 4 viteve më parë.

Gjithashtu u vendosën në dispozicion normat e konsumit në tabela.

Nga sektori i Transportit është hartuar edhe një relacion mbi miratimin e distancave kilometrike brenda Tiranës.

Çdo muaj hartohen tabelat me km e përshkruar dhe bëhet kuadrimi i harxhimit të karburantit.

Shpenzime për sponsorizime

Për periudhën objekt auditimi nuk ka praktika të shpenzimeve për sponsorizimet, referuar kjo edhe deklaratës së Drejtorisë Ekonomike dhe Kontabilitetit.

Shpenzime dieta brenda dhe jashtë vendit

Nga auditimi rezulton se shpenzimet për udhëtime dieta janë minimale kjo si pasojë e periudhës së COVID – 19 dhe ato praktika që ka nuk rezultuan me probleme.

Për sa më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 22, datë 30.11.2022.

Në lidhje me observacionet e paraqitura nr. 21075/1, datë 07.12.2022 i paraqitur nga zj. E.C mbi vendosjen e dokumentacionin shtesë të pavendosur në dispozicion në auditim ju sqarojmë se u morrën parasysh dhe u bënë reflektimet në material.

Blerjet e vogla

1. Titulli i gjetjes:	Mbi copëzimin e fondeve për procedurat e blerjeve të vogla
Situata:	Nga auditimi dhe analizimi i regjistrave të parashikimit dhe realizimit për periudhën objekt auditimit konstatohet se në 80% të rasteve fondi limit i parashikuar që në hartimit e regjistrat ka qenë 800,000 lekë, pra në kufirin maksimal të lejimit të zhvillimit të kësaj procedure, çka tregon se nuk kemi një planifikim nevoje të mirëfilltë i cili duhet të vijë nga nevoja konkrete. Gjithashtu konstatohet se ka një copëzim fondesh me qëllim e përdorimit të procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla duke anashkaluar procedurat e tjera.
Kriteri:	<p>nenin 40 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël” të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar:</p> <p><i>1. Autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbim, kur vlera e përlllogaritur është më e ulët se 800.000 (tetëqind mijë) lekë në vit. Autoriteti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.</i></p> <p><i>Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup – mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.</i></p> <p><i>2. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në fillim të vitit kalendarik, ngre një komision të veçantë, të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh, nga të cilët njëri është kryetar.</i></p> <p><i>3. Kur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre.</i></p> <p><i>Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës duhet të përlllogaritë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 59 të këtyre rregullave, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme.</i></p> <p><i>Urdhri i prokurimit duhet të shoqërohet me ftesën për ofertë, që u drejtohet operatorëve ekonomikë, në të cilën përcaktohen të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit”.</i></p>
Ndikimi/Efekti:	Përdorimi i procedurave të prokurimit jo në përputhje me procedurat e

	prokurimit.
Shkaku:	Copëzimi i fondit limit
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	UKT Sha dhe njësia përkatëse e planifikimit të procedurave të prokurimit të marrin masa që në të ardhmen të parashikojnë saktë dhe përzgjedhin procedurat e duhura duke rritur konkurrencën dhe përdorimin me efektivitet të fondeve.

Nga auditimi rezulton se:

Nga auditimi rezulton se për vitin 2018 janë realizuar 39 prokurime me vlera të vogla me fond limit 26,378,272 lekë dhe kontrata të lidhura në vlerën 23,627,666 lekë.

Nga auditimi rezulton se për vitin 2019 janë realizuar 56 prokurime me vlera të vogla me fond limit 41,496,620 lekë dhe kontratat e lidhura me vlerën 37,488,519 lekë.

Nga auditimi rezulton se për vitin 2020 janë realizuar 54 prokurime me vlera të vogla me fond limit 40,830,000 lekë dhe kontratat e lidhura me vlerën 36,441,437 lekë.

Nga auditimi rezulton se për vitin 2021 janë realizuar 60 prokurime me vlera të vogla me fond limit 45,354,158 lekë dhe kontratat e lidhura me vlerën 41,176,353 lekë.

Nga auditimi dhe analizimi i regjistrave të parashikimit dhe realizimit për periudhën objekt auditimit konstatohet se në 80% të rasteve fondi limit i parashikuar që në hartimit e regjistrat ka qenë 800,000 lekë, pra në kufirin maksimal të lejimit të zhvillimit të kësaj procedure, çka tregon se nuk kemi një planifikim nevojë të mirëfilltë i cili duhet të vijë nga nevoja konkrete. Gjithashtu konstatohet se ka një copëzim fondesh me qëllim e përdorimit të procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla duke anashkaluar procedurat e tjera, konkretisht:

Viti 2021

26	Blerje pjesë këmbimi për makineri speciale (eskavator,autobote)	Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash	800,000.00	743,000.00
29	Blerje pjesë këmbimi për vinçat e elektropompave	Pjesë këmbimi për motorë	800,000.00	720,000.00
30	Blerje pjesë këmbimi sistem frenimi -drejtimi dhe amortizimi	Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash	800,000.00	739,900.00
40	Riparim dhe mirëmbajtje e sistemeve hidraulike dhe te komandimit te mjeteve teknologjike	Riparime, mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me automjete dhe pajisje të lidhura	800,000.00	759,600.00
41	Riparim dhe mirëmbajtje e sistemeve të komandimit të mjeteve të renda	Riparime, mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me automjete dhe pajisje të lidhura	800,000.00	744,000.00
44	Riparim i pjesëve të ndryshme për autovetura tek të tretët	Riparime, mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me automjete dhe pajisje të lidhura	800,000.00	748,000.00
45	Riparim i pompave te presionit te larte per fadroma dhe sondë	Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash	800,000.00	760,000.00
46	Riparim i sistemeve rrotulluese për kamionçina	Riparime, mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me automjete dhe pajisje të lidhura	800,000.00	778,000.00
47	Riparim i sistemeve të vecanta të kontrollit të mjeteve tip kamioncina , pick	Riparime, mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me automjete dhe pajisje të lidhura	800,000.00	758,000.00

	up, furgona			
48	Riparim i sistemit te agregateve per autobot	Riparime, mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me automjete dhe pajisje të lidhura	800,000.00	749,900.00
49	Riparim i sistemit të injektimit për eskavatorë dhe kamionë	Riparime, mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me automjete dhe pajisje të lidhura	800,000.00	740,000.00
50	Riparim i sistemit të shpërndarjes për fadroma	Riparime, mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me automjete dhe pajisje të lidhura	800,000.00	750,000.00
51	Riparim, mirëmbajtje e sistemeve hidraulike dhe të komandimit të mjeteve të renda	Riparime, mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me automjete dhe pajisje të lidhura	800,000.00	777,700.00

Janë zhvilluar 13 procedura të cilat kanë të njëjtin qëllim riparim automjetesh, ndër të cilat vlen të theksohet se në ftesën për ofertë nuk specifikohet lloji i defektit dhe a riparohet apo vendosen pjesë të reja.

Kjo situatë është e përsëritur edhe në vitet e tjera.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 40 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël” të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar:

4. Autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbim, kur vlera e përlogaritur është më e ulët se 800.000 (tetëqind mijë) lekë në vit. Autoriteti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup – mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.

5. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në fillim të vitit kalendarik, ngre një komision të veçantë, të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh, nga të cilët njëri është kryetar.

6. Kur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre.

Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës duhet të përlogaritet fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 59 të këtyre rregullave, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukturë të posaçme.

Urdhri i prokurimit duhet të shoqërohet me ftesën për ofertë, që u drejtohet operatorëve ekonomikë, në të cilën përcaktohen të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit”.

Viti 2018

Me Urdhrin nr. 19/4, date 07.09.2018 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël” është ndryshuar komisioni i përbërë nga A, K dhe A.

“Projektor led 150 wat”

Bazuar në kërkesën e ardhur nga sektori elektromekanik nr. 4671, date 22.11.2018.

Proceverbal mbi llogaritjen e fondit limit nr. 26895/3, datë 27.11.2018, përlllogaritje e bazuar mbi mesataren e tre ofertave të marra. Bashkëlidhur mungon mënyra e komunikimit e ndjekur me tre operatorët si përshkrimi i saktë i proceseve që do të kryhen.

Urdhri i Prokurimit nr. 26895/4, datë 27.11.2018 “Projektor led 150w”, pa fond limit.

Ftesa për ofertë nr. 26895/5, datë 27.11.2018, pa fond limit, me afat lëvrimi 2 ditë, nuk përshkruhet lloji i shërbimit që duhet të kryhet.

Procesverbali nr. 1, nr. 26895/6, datë 04.12.2018 ku pas hapjes së sistemit janë konstatuar se kanë marrë pjesë 19 operatorë, janë kualifikuar 10:

Është njoftuar nga sistemi operatori i renditur i pari më datë 04.12.2018

Në datën 04.12.2018 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 2, nr. 26895/7, datë 05.12.2018 është vijuar me operatorin e renditur të dytë.

Në datën 05.12.2018 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 3, nr. 26895/8, datë 06.12.2018 është vijuar me operatorin e renditur të tretë.

Në datën 06.12.2018 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 4, nr. 26895/9, datë 11.12.2018 është vijuar me operatorin e renditur të katër.

E në vijim deri tek operatori i 8-të.

Është lidhur kontrata e shërbimit nr. 26895/14, datë 19.12.2018 me V shpk.

Akt – kolaudimi nr. 26895/15, datë 19.12.2018, ku grupi i kolaudimit i përbërë nga K.I, E.A dhe A.A. ka pranuar produktet.

“Malli përputhet me standardet e kërkuara. Shërbimi i kryer nga firma është shërbimi i kërkuar në sasi dhe cilësi”.

Viti 2019

Me Urdhrin nr. 41/1, date 13.02.2019 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël” është ndryshuar komisioni i përbërë nga A.K, K.T dhe A.S.

Me Urdhrin nr. 41/2, date 09.09.2019 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël” është ndryshuar komisioni i përbërë nga A.K, E.C dhe A.S.

“Shërbime tek të tretët për autobote, kamiona, vinç”

Bazuar në kërkesën e ardhur nga ofiçina nr. 736, date 21.02.2019, kërkesë e cila nuk specifikon konstatimin e difekteve.

Proceverbal mbi llogaritjen e fondit limit nr. 4388, datë 27.02.2019, përlllogaritje e bazuar mbi mesataren e tre ofertave të marra. Bashkëlidhur mungon mënyra e komunikimit e ndjekur me tre operatorët si përshkrimi i saktë i proceseve që do të kryhen.

Riparim i sondës kryesore të mjetit

Riparim i pompës thithëse

Riparim i karrelit të mjetit

Urdhri i Prokurimit nr. 4388/1, datë 27.02.2019 “Për shërbime tek të tretët për autobote, kamiona, vinç”, pa fond limit.

Ftesa për ofertë nr. 4388/2, datë 27.02.2019, pa fond limit, me afat lëvrimi 2 ditë, nuk përshkruhet lloji i shërbimit që duhet të kryhet.

Procesverbali nr. 1, nr. 4388/3, datë 01.03.2019 “Shërbime tek të tretët ...” ku pas hapjes së sistemit janë konstatuar se kanë marrë pjesë 8 operatorë:

- D.G 645,000 lekë
- A.G 723,000 lekë
- A.M 745,000 lekë

- J 750,000 lekë
- A 769,000 lekë
- SH.K 780,000 lekë
- T.K 789,900 lekë
- D.Xh 798,000 lekë

Është njoftuar nga sistemi operatori i renditur i pari më datë 01.03.2019.

Në datën 01.03.2019 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 2, nr. 4388/4, datë 01.03.2019 është vijuar me operatorin e renditur të dytë.

Në datën 01.03.2019 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 3, nr. 4388/5, datë 01.03.2019 është vijuar me operatorin e renditur të tretë.

Është lidhur kontrata e shërbimit nr. 4388/6, datë 04.03.2019 me A.M.

Akt – kolaudimi nr. 4388/7, datë 05.07.2019, ku grupi i kolaudimit i përbërë nga K.I, M.V dhe K.A.

Ka pranuar shërbimin e kryer,

“Shërbimi përputhet me standardet e kërkuara. Shërbimi i kryer nga firma është shërbimi i kërkuar në sasi dhe cilësi”.

“Blerje materiale higjeno - sanitare”

Bazuar në kërkesën e ardhur nga Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse nr. 2834, date 01.08.2019.

Proceverbali mbi llogaritjen e fondit limit nr. 16476/3, datë 09.09.2019, përlllogaritje e bazuar mbi mesataren e tre ofertave të marra. Bashkëlidhur mungon mënyra e komunikimit e ndjekur me tre operatorët.

Urdhri i Prokurimit nr. 16476/4, datë 09.09.2019 “Blerje materiale higjenosanitare”, pa fond limit.

Ftesa për ofertë nr. 16476/5, datë 09.09.2019, pa fond limit, me afat lëvrimi 2 ditë.

Procesverbali nr. 1, nr. 16476/6, datë 11.09.2019 “Blerje materiale higjeno - sanitare” ku pas hapjes së sistemit janë konstatuar se kanë marrë pjesë 28 operatorë (20 janë kualifikuar dhe 8 janë skualifikuar).

Është njoftuar nga sistemi operatori i renditur i pari më datë 11.09.2019.

Në datën 11.09.2019 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 2, nr. 16476/7, datë 12.09.2019 është vijuar me operatorin e renditur të dytë.

Në datën 13.09.2019 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 3, nr. 16476/8, datë 13.09.2019 është vijuar me operatorin e renditur të tretë.

Në datën 13.09.2019 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 4, nr. 16476/9, datë 16.09.2019 është vijuar me operatorin e renditur të katërt.

Është lidhur kontrata e shërbimit nr. 16476/10, datë 17.09.2019 me M.H.

Akt – kolaudimi nr. 16476/11, datë 17.09.2019, ku grupi i kolaudimit i përbërë nga K.I, M.V dhe K.A.

Ka pranuar mallrat e shoqëruara me faturën nr. 43, datë 17.09.2019.

“Blerje panel lëshimi për elektropompë 90 kw”

Bazuar në kërkesën e ardhur nga ofiçina nr. 4487, date 03.12.2019, kërkesë e cila nuk specifikon konstatimin e difekteve dhe lindjen e nevojës.

Proceverbal mbi llogaritjen e fondit limit nr. 28371/3, datë 10.12.2019, përlllogaritje e bazuar mbi mesataren e tre ofertave të marra. Bashkëlidhur mungon mënyra e komunikimit e ndjekur me tre operatorët si përshkrimi i saktë i proceseve që do të kryhen.

Urdhri i Prokurimit nr. 28371/4, datë 10.12.2019 “Panel lëshimi për elektropompë 90 kw”, pa fond limit.

Ftesa për ofertë nr. 28371/5, datë 10.12.2019, pa fond limit, me afat lëvrimi 2 ditë.

Procesverbali nr. 1, nr. 28371/6, datë 12.12.2019 ku pas hapjes së sistemit janë konstatuar se kanë marrë pjesë 18 operatorë (10 u kualifikuan dhe 8 u skualifikuan):

Është njoftuar nga sistemi operatori i renditur i pari më datë 12.12.2019.

Në datën 13.12.2019 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 2, nr. 28371/7, datë 13.12.2019 është vijuar me operatorin e renditur të dytë.

Në datën 13.12.2019 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 3, nr. 28371/8, datë 16.12.2019 është vijuar me operatorin e renditur të tretë.

Në datën 16.12.2019 edhe ky operator është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 28371/9, datë 17.12.2019 është vijuar me operatorin e renditur të katërt.

Është lidhur kontrata e shërbimit nr. 28371/10, datë 18.12.2019 me “A.C”.

Akt – kolaudimi nr. 28371/11, datë 19.12.2019, ku grupi i kolaudimit i përbërë nga K.I, M.V dhe K.A.

Ka pranuar shërbimin e kryer.

“Shërbimi përputhet me standardet e kërkuara. Shërbimi i kryer nga firma është shërbimi i kërkuar në sasi dhe cilësi”.

“Blerje kushineta”

Proceverbal mbi llogaritjen e fondit limit nr. 27610/3, datë 27.11.2019, përlllogaritje e bazuar mbi mesataren e tre ofertave të marra. Bashkëlidhur mungon mënyra e komunikimit e ndjekur me tre operatorët si përshkrimi i saktë i proceseve që do të kryhen.

Urdhri i Prokurimit nr. 27610/4, datë 27.11.2019 “Blerje Kushineta”, pa fond limit.

Ftesa për ofertë nr. 27610/5, datë 27.11.2019, pa fond limit, me afat lëvrimi 2 ditë.

Procesverbali nr. 1, nr. 27610/6, datë 27.11.2019 ku pas hapjes së sistemit janë konstatuar se kanë marrë pjesë 10 operatorë:

Është njoftuar nga sistemi operatori i renditur i pari më datë 27.11.2019.

Në datën 27.11.2019 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 2, nr. 27610/7, datë 27.11.2019 është vijuar me operatorin e renditur të dytë.

Në datën 27.11.2019 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 3, nr. 27610/8, datë 27.11.2019 është vijuar me operatorin e renditur të tretë.

Është lidhur kontrata e shërbimit nr. 27610/9, datë 06.12.2019 me “A”.

Akt – kolaudimi nr. 27610/10, datë 06.12.2019, ku grupi i kolaudimit i përbërë nga K.I, M.V dhe K.A.

Ka pranuar shërbimin e kryer.

“Shërbimi përputhet me standardet e kërkuara. Shërbimi i kryer nga firma është shërbimi i kërkuar në sasi dhe cilësi”

“Blerje bileta avioni”

Bazuar në kërkesën e ardhur nr. 2869, date 05.08.2019, ka nisur procedura.

Urdhri i Prokurimit nr. 13962, datë 06.08.2019 “Për sistemin dinamik të biletave të avionit”, pa fond limit.

Ftesa për ofertë nr. 13962/1, datë 06.08.2019, pa fond limit.

Procesverbali nr. 1, nr. 13962/2, datë 06.08.2019 ku pas hapjes së sistemit janë konstatuar se kanë marrë pjesë 5 operatorë:

Është njoftuar nga sistemi operatori i renditur i pari më datë 06.08.2019.

Në datën 06.08.2019 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 2, nr. 13962/3, datë 06.08.2019 është vijuar me operatorin e renditur të dytë.

Në datën 06.08.2019 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 3, datë 07.08.2019 është vijuar me operatorin e renditur të tretë, i cili ka realizuar edhe shërbimin.

Viti 2021

Me Urdhrin nr. 38, date 29.01.2021 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël” është ndryshuar komisioni i përbërë nga A.K, E.C dhe A.S.

Me Urdhrin nr. 38/1, date 06.04.2021 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël” është ndryshuar komisioni i përbërë nga A.K, R.K dhe A.S.

Me Urdhrin nr. 38/2, date 17.05.2019 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël” është ndryshuar komisioni i përbërë nga A.K, E.C dhe A.S.

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 13, datë 15.01.2021 “Mbi ngritjen e komisionit të kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të furnizuara”.

“Shërbime për asgjësimin e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit”

Bazuar në kërkesën e ardhur nga D nr. 4813, date 24.12.2021, nga nisur procedura.

Proceverbali mbi llogaritjen e fondit limit nr. 23083/3, datë 24.12.2021, përllogaritje e bazuar mbi mesataren e tre ofertave të marra. Bashkëlidhur mungon mënyra e komunikimit e ndjekur me tre Urdhri i Prokurimit nr. 23083/4, datë 24.12.2021 “Shërbim për asgjësimin e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit”, pa fond limit.

Ftesa për ofertë nr. 23083/5, datë 24.12.2021, pa fond limit, me afat lëvrimit për kryerjen e shërbimit 10 ditë.

Procesverbali nr. 1, nr. 23083/6, datë 29.12.2021 ku pas hapjes së sistemit janë konstatuar se kanë marrë pjesë 7 operatorë (4 janë skualifikuar):

Është njoftuar nga sistemi operatori i renditur i pari më datë 29.12.2021.

Në datën 29.12.2021 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 2, nr. 23083/7, datë 30.12.2021 është vijuar me operatorin e renditur të dytë.

Në datën 30.12.2021 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 3, nr. 23083/8, datë 05.01.2021 është vijuar me operatorin e renditur të tretë.

Është lidhur kontrata e shërbimit nr. ska, datë 06.01.2022 me A.P.

Akt – kolaudimi nr. 23083/10, datë 09.01.2022, ku grupi i kolaudimit i përbërë nga K.I, E.C dhe N.T.

Ka pranuar shërbimin e kryer.

“Shërbimi përputhet me standardet e kërkuara. Shërbimi i kryer nga firma është shërbimi i kërkuar në sasi dhe cilësi”.

“Pjesë speciale ndriçimi”

Bazuar në kërkesën e ardhur nga Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse nr. 2253, date 03.06.2021.

Proceverbal mbi llogaritjen e fondit limit nr. 9903/3, datë 09.06.2021, përlllogaritje e bazuar mbi mesataren e tre ofertave të marra. Bashkëlidhur mungon mënyra e komunikimit e ndjekur me tre operatorët.

Urdhri i Prokurimit nr. 9903/4, datë 09.06.2021 “Blerje pjesë speciale”, pa fond limit.

Ftesa për ofertë nr. 9903/5, datë 09.06.2021, pa fond limit, me afat lëvrimi 3 ditë.

Procesverbali nr. 1, nr. 9903/6, datë 11.06.2021, ku pas hapjes së sistemit janë konstatuar se kanë marrë pjesë 20 operatorë.

Është njoftuar nga sistemi operatori i renditur i pari më datë 11.06.2021.

Në datën 11.06.2021 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 2, nr. 9903/8, datë 14.06.2021 është vijuar me operatorin e renditur të dytë.

Në datën 14.06.2021 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 3, nr. 9903/8, datë 15.06.2021 është vijuar me operatorin e renditur të tretë.

Në datën 15.06.2021 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 4, nr. 9903/9, datë 16.06.2021 është vijuar me operatorin e renditur të katërt.

Në datën 16.06.2021 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 4, nr. 9903/10, datë 16.06.2021 është vijuar me operatorin e renditur të katërt.

Është lidhur kontrata e shërbimit nr. 9903/11, datë 18.06.2019 me T A.

Akt – kolaudimi nr. 9903/12, datë 21.06.2021, ku grupi i kolaudimit i përbërë nga K.I, E.C dhe N.T.

Ka pranuar mallrat e shoqëruara me faturën nr. 31, datë 21.06.2021.

“Shërbim për fiskalizimin e faturave”

Bazuar në kërkesën e ardhur nga Drejtoria IT nr. 3423, date 19.08.2021, kërkesë e cila ka iniciuar procedurën.

Proceverbal mbi llogaritjen e fondit limit nr. 14642/3, datë 23.08.2021, përlllogaritje e bazuar mbi mesataren e tre ofertave të marra. Bashkëlidhur mungon mënyra e komunikimit e ndjekur me tre operatorët si përshkrimi i saktë i proceseve që do të kryhen.

Urdhri i Prokurimit nr. 14642/4, datë 23.08.2021 “Shërbim për fiskalizimin e faturave”, pa fond limit.

Ftesa për ofertë nr. 14642/5, datë 23.08.2021, pa fond limit.

Procesverbali nr. 1, nr. 14642/6, datë 25.08.2021 ku pas hapjes së sistemit janë konstatuar se kanë marrë pjesë 3 operatorë:

Në datë 25.08.2021 është lajmëruar në sistem operatori i renditur i pari.

Është lidhur kontrata e shërbimit nr. 14642/7, datë 26.08.2021 me “T.S”.

“Shërbime me pajisje profilaktike për mirëmbajtjen e depove”

Proceverbal mbi llogaritjen e fondit limit nr. 20529/3, datë 16.11.2021, përlllogaritje e bazuar mbi mesataren e tre ofertave të marra. Bashkëlidhur mungon mënyra e komunikimit e ndjekur me tre operatorët si përshkrimi i saktë i proceseve që do të kryhen.

Urdhri i Prokurimit nr. 20529/4, datë 16.11.2021 “Për shërbime me pajisje profilaktike për mirëmbajtjen e depove”, pa fond limit.

Ftesa për ofertë nr. 20529/5, datë 16.11.2021, pa fond limit, me afat lëvrimi 5 ditë.

Procesverbali nr. 1, nr. 20529/6, datë 18.11.2021 ku pas hapjes së sistemit janë konstatuar se kanë marrë pjesë 14 operatorë:

Është njoftuar nga sistemi operatori i renditur i pari më datë 18.11.2021.

Në datën 18.11.2021 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 2, nr. 20529/7, datë 19.11.2021 është vijuar me operatorin e renditur të dytë.

Në datën 19.11.2021 operatori është tërhequr.

Me procesverbalin nr. 3, nr. 20529/8, datë 22.11.2021 është vijuar me operatorin e renditur të tretë.

Është lidhur kontrata e shërbimit nr. 20529/9, datë 23.11.2021 me “H C”.

Akt – kolaudimi nr. 20529/10, datë 01.12.2021, ku grupi i kolaudimit i përbërë nga K.I, E.C dhe A.A.

Ka pranuar shërbimin e kryer,

“Shërbimi përputhet me standardet e kërkuara. Shërbimi i kryer nga firma është shërbimi i kërkuar në sasi dhe cilësi”.

“Blerje aparat për matje topogjeodezike”

Bazuar në kërkesën e ardhur nr. 4680, date 09.11.2021, ka nisur procedura.

Urdhri i Prokurimit nr. 20257/4, datë 10.11.2021 “Blerje aparat për matje topogjeodezike”, pa fond limit.

Ftesa për ofertë nr. 20257/5, datë 10.11.2021, pa fond limit.

Procesverbali nr. 1, nr. 20257/6, datë 12.11.2021 ku pas hapjes së sistemit janë konstatuar se kanë marrë pjesë 16 operatorë:

Është njoftuar nga sistemi operatori i renditur i pari më datë 12.11.2021.

Në datën 12.11.2021 operatori është tërhequr.

Është kaluar me radhë tek 10 operatorë pasi janë tërhequr nga procedura.

Me Procesverbalin nr. 10, datë 03.12.2021 është kaluar te operatori O T.

Kontrata nr. 20257/16, datë 06.12.2021.

Akt – kolaudimi nr. 20257/17, datë 13.12.2021, ku grupi i kolaudimit i përbërë nga K.I, E.C dhe A.A.

Ka pranuar shërbimin e kryer,

“Shërbimi përputhet me standardet e kërkuara. Shërbimi i kryer nga firma është shërbimi i kërkuar në sasi dhe cilësi”.

Nga auditimi konstatohet se dokumentimi i procesit të marrjes në dorëzim bëhet formal dhe pa specifikuar verifikimet e kryera për plotësimin e kushteve të furnizimit qoftë mall apo shërbim.

Për sa më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr.22, datë 30.11.2022.

Në lidhje me observacionin e paraqitur nr. 21077/1, datë 07.12.2022 i paraqitur nga A.K, A.S, E.C, K.T, ku pretendoni se:

“Prashikimet nuk janë kryer nga ju dhe se bazohen në projekt-puxhetin e vitit përkatës, por që do të merni parasysht rekomandimet ...”

Ju sqarohet se nuk jeni ngarkuar me përgjegjësi dhe nuk keni sjell asnjë dokumentacion shtesë apo pretendim të bazuar në ligj.

2.6. Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.

Referuar periudhës objekt auditimi, janë marrë në analizë pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe 2021 dhe janë krahasuar.

Me Vendimin nr. 10, datë 07.07.2021 Këshilli i Administrimit ka miratuar pasqyrat financiare të vitit 2020.

Me Vendimin nr. 02, datë 08.07.2022 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve ka miratuar pasqyrat financiare të vitit 2021.

Me Vendimin nr. 18, datë 21.07.2022 Këshilli i Administrimit ka miratuar pasqyrat financiare të vitit 2021.

Me Vendimin nr. 07, datë 22.07.2022 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve ka miratuar pasqyrat financiare të vitit 2021.

Pasqyrat Financaire Viti 2021

Pasqyra financiare të konsoliduara 2021 janë krahasuar me pasqyrat financiare të konsoliduara dhe të miratuara për periudhën 31 Dhjetor 2020 që përfshijnë shoqërinë UKT sh.a. dhe HEC Lanabregas sh.a.

Aktivet në vitin 2021 janë rritur me 4% krahasuar me vitin 2020 duke kapur vlerën 27,468,910 mijë lekë sipas zërave të cilët paraqiten në tabelën si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVE		
Aktivet afatgjata		
Aktivet afatgjata material	21,384,678	20,362,567
Te drejta ne perdorim	125,576	131,211
Parapagime për aktive te tjera afatgjata	19,351	19,351
Totali i aktiveve afatgjata	21,529,605	20,513,129
Aktivet afatshkurtra		
Inventarë	401,648	471,155
Llogarite e arketueshme	4,753,662	4,561,564
Llogari të arkëtueshme të tjera	350,582	387,366
Tatimi mbi fitimin	5,042	87,252
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	58,452	61,941
Mjetet monetare në arkë e në bankë	369,919	356,203
Totali i aktiveve afatshkurtra	5,939,305	5,925,481
Totali i aktiveve	27,468,910	26,438,610

Aktivet Afatgjata

Aktivet afatgjata gjatë vitit 2021 janë rritur me 5% (21,529,605 mijë lekë në vitin 2021 nga 20,513,129 mijë lekë në vitin 2020) paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVE		
Aktivet afatgjata		
Aktivet afatgjata material	21,384,678	20,362,567
Te drejta ne perdorim	125,576	131,211
Parapagime për aktive te tjera afatgjata	19,351	19,351
Totali i aktiveve afatgjata	21,529,605	20,513,129

Aktivet Afatgjata materiale

Aktivet Afatgjata materiale janë rritur gjatë vitit 2021 me 5% (21,384,678 mijë lekë në vitin 2021 nga 20,362,567 mijë lekë në vitin 2020).

Gjatë vitit 2021 është bërë disbursimi i kredisë italiane, **F.Rot/Aid-99/004/00**, 53,200,000,000 lit ose 27,475,507.03 euro e cila përbëhet nga dy faza, ku faza e parë përbëhet nga **20.3** miliard lireta-për projektin asistencë teknike për ndërmarrjen e zgjeruar të UKT – sh.a. Faza e dytë **32.9** miliard lireta është për projektin ndërhyrje e mëtejshme në sektorin hidrik. Gjatë vitit 2021 është bërë disbursim në vlerën 1,372,118 Euro ku ekuivalenti në lekë është i barabartë me shumën 165,697,028 lekë e cila ka sjellë rritje në Aktivet Afatgjata materiale.

Parapagime për aktive afatgjata materiale

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Parapagime për aktive afatgjata materiale	19,351	19,351
	19,351	19,351

Zëri “**Parapagime për aktive Afatgjata Materiale**” vjen nga marrëveshja midis Bashkisë Tiranë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit për “Ndërtim i Ujësjetësimit për fshatin Vilëz dhe rikonstrukcion ujësjetësi për fshatrat Shëngjin i vogël, Belsh, Zall-Bastar, Zall-Dajt dhe Sanitete në fshatin Vilëz” ku UKT sh.a. ka paguar 6% të projektit FSHZH.

Të drejta në përdorim

	Asete me të drejtë përdorimi	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2020	133,069	133,069
Shtesa	75,979	75,979
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	209,048	209,048
Shtesa	42,338	42,338
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	251,386	251,386
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2020	38,000	38,000
Amortizimi i vitit	39,837	39,837
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	77,837	77,837
Amortizimi i vitit	47,974	47,974
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	125,811	125,811
Gjendja neto më 31 dhjetor 2020	131,211	131,211
Gjendja neto më 31 dhjetor 2021	125,576	125,576

UKT sh.a. ka aplikuar sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), aplikim i SNRF 16 “Qiratë”, duke filluar më 1 janar 2019. Standarti ka vendosur parimet për njohjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qerasë. Qiramarrësit do ti kërkohet të njohin:

(a) aktive dhe detyrime për të gjitha qiratë me afat më shumë se 12 muaj, përveç rasteve kur aktivi ka vlerë të ulët. Detyrimet janë matur në vlerën e drejtë të mbetur të pagesave të qerasë, të skontuara me normën rritëse të huamarrjes më 1 janar 2020. Norma e interesit të huamarrjes e aplikuar në detyrimet e qerasë më 1 janar 2020 janë marrë nga normat në fuqi nga Banka e Shqipërisë me atë date.

(b) amortizimin e aktiveve të qerasë të ndarë nga interesi i detyrimit të qerasë në pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. UKT sh.a e ka njohur detyrimin e qerasë në lidhje me qiranë që ka qenë fillimisht klasifikuar si “qira operationale”.

<i>Qiraja Financiare</i>	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Detyrimet afatshkurtra të qirasë	31,368	35,573
Detyrimet afatgjata të qirasë	100,553	99,819
	131,921	135,392

Shuma të njohura në të ardhura dhe shpenzime

Shuma të njohura në të ardhura dhe në shpenzime

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime amortizimi të aktiveve me të drejta në përdorim	47,974
Shpenzimet e interesit(të përfshira në koston e financimit)	8,073
Shpenzime qiraje që lidhen me qira afatshkurtra	45,021
Shpenzime që lidhen me qiradhëniet e aktiveve me vlerë të ulët	
Shpenzime në lidhje me pagesat e qerasë së ndryshueshme që nuk përfshihen në detyrimet e qerasë	
	101,068

Analiza e maturitetit.

	31 dhjetor 2021
Deri në një vit	37,587
1-5 vite	78,150
mbi 5 vite	-
Totali i detyrimit për qira financiare i paskontuar	115,737

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar të UKT SHA përfshin Aktive në proces në vlerën 2,352,832 mijë lekë (2020: 2,187,135 mijë lekë) të mbartura nga periudhat e mëparshme për punime të kryera nga nënkontraktorët e DPUK. Shoqëria ka aktive të tjera në proces në vlerën 2,909,166 mijë lekë të krijuara në periudha të mëparshme por ende të pa marra në dorëzim. Këto aktive janë të vlerësuara ne kosto. Sipas SNK 36 “Zhvlerësimi i aktiveve”, duhet të vlerësohen sipas faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm si edhe mund të zhvlerësohen.

Aktive afatshkurtra

Aktivet Afatshkurtra janë rritur me 0.23% (5,939,305 mijë Lekë në vitin 2021 nga 5,925,481 mijë lekë në vitin 2020) paraqitur në tabelën si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Aktivet afatshkurtra		
Inventarë	401,648	471,155
Llogarite e arketueshme	4,753,662	4,561,564
Llogari të arkëtueshme të tjera	350,582	387,366
Tatimi mbi fitimin	5,042	87,252
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	58,452	61,941
Mjetet monetare në arkë e në bankë	369,919	356,203
Totali i aktiveve afatshkurtra	5,939,305	5,925,481

Inventarët

Inventarët janë ulur me 15% (401,648 mijë lekë në vitin 2021 nga 471,155 mijë lekë në vitin 2020,) paraqitur në tabelën si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Materiale - rrjetet	345,036	358,896
Pjesë këmbimi	53,238	59,405
Materiale konsumi	18,208	27,893
Materiale kancelari	5,778	5,300
Kimikate	0	1,625
Karburant	12,705	6,765
Inventar i imët	24,420	21,033
Të tjera	14,358	21,929
Materiale jashtë përdorimit	71,155	71,155
Humbje vlere e aktivitet afatshkurtër	-143,250	-102,846
	401,648	471,155
<u>Lëvizjet në zhvlerësimin e inventarëve</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Çelje	102,846	112,953
Rimarrje për vitin	0	-10,495
Zhvlerësimi për vitin	40,404	388
Gjendja më 31 dhjetor	<u>143,250</u>	<u>102,846</u>

Siç shifet dhe nga tabela, zërat që kanë pasur më shumë ndikim te inventarët janë kimikatet me gjendje në fund të vitit me 0 mijë lekë ose variancë në lekë duke e krahasuar me vitin 2020 - 1,625 mijë lekë.

Llogaritë e Arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë rritur me 4% (4,753,662 mijë lekë në vitin 2021 nga 4,561,564 mijë Lekë në vitin 2020). Në këtë llogari UKT sh.a ka përfshirë si më poshtë detyrimet e të tretëve:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Konsumator familjar	3,067,298	2,927,043
Subjekte private	713,244	723,760
Ente buxhetore	145,242	132,025
Komuna/ Njësi administrative	379,671	289,027
Të tjerë	1,318,627	1,244,466
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	-889,173	-774,042
Llogari te arketueshme neto UKT	4,734,909	4,542,279
Llogari të arketueshme neto të HEC Lanabregas	18,753	19,285
	4,753,662	4,561,564
	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Çelje	774,042	628,875
Rimarrje për vitin	-	-97,863
Zhvlerësimi për vitin	115,131	243,030
Gjendja më 31 dhjetor	<u>889,173</u>	<u>774,042</u>

Zërat që kanë pasur më shumë ndikim në rritjen e debisë janë:

- Konsumatorë familjarë*, kemi rritje të debisë në masën 5% e cila vjen si pasojë e pagesave më vonesë të faturave.
- Entet Buxhetorë*, kemi rritje të debisë në masën 10% e cila vjen si pasojë e pagesave më vonesë të faturave.
- Te zëri *Komuna* (ujë me shumicë), kemi një rritje të debisë në masën 31%, ku pesha më e madhe e debisë vjen nga Bashkia Kamëz dhe Ujësjetësi Kamëz si pasojë e pagesave me vonesë të faturave nga viti 2013.
- Te zëri *Llogari të arkëtueshme HEC Lanabregas* janë pasqyra të konsoliduara që paraqesin aktivitetin e shoqërisë UKT sh.a. që është shoqëria mëmë dhe HEC Lanabregas sh.a. tek të cilat kemi ulje të debisë në masën 3% dhe në vlerë 532 mijë lekë.

Llogaritë e arkëtueshme të tjera

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Debitorë dhe paradhënie për personelin	9,713	9,681
Zhvlerësime për debitorë personeli	-9,527	-9,527
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	32,926	17,587
TVSH	60,539	71,826
Diferenca nga nipti i ndarjes për UK Kamzën	241,201	241,201
Debitore të tjerë Përmbartimi	73,835	73,869
Zhvlerësime për debitorë të tjerë	-58,105	-17,271
	350,582	387,366

Zërat që kanë pasur më shumë ndikim janë:

- Pagesë TVSH (gjendje kreditore) në vlerën 60,539 mijë lekë.
 - Diferenca e krijuar nga ndarja UKT sh.a. me Ujësjetësi Kanalizime Kamzë sh.a. ku UKK sh.a. i detyrohet UKT sh.a. nga ndarja e cila është e pasqyruar në kontabilitet si e drejtë dhe detyrim midis palëve në vlerën 241,201 mijë lekë.
 - Debitorë të tjerë përmbartimi në vlerën 73,835 mijë lekë, tarifë paraprake dhe përfundimtare për debinë e krijuar nga sektori i riskut dhe Drejtoria Juridike.
- Llogaria e arkëtueshme në vlerën bruto 5,625,082 mijë lekë, bazuar edhe në natyrën e aktivitetit, kjo llogari është zhvlerësuar por metodologjia e përdorur nuk përfshin ndonjë analizë mbështetëse për të justifikuar masën e përqindjeve të përdorura për provigjionim sipas SNRF 9. Gjithashtu ka një mospërputhje midis vlerës së debitorëve të raportuar nga sistemi i faturimit me vlerën e kontabilizuar, vlera e raportuar nga sektori i shitjes me kontabilitetin si dhe nuk ka një rakordim.

Tatim mbi fitimin

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Te drejta për tatim fitimin HEC	5,042	6,872
Te drejta për tatim fitimin UKT	0	80,380
	5,042	87,252

Pagesa e tatim fitimit (gjendje kreditore) është në vlerën 5,042 mijë lekë e cila i përket tatim fitimit Hec lanabregas sh.a.

Parapagime dhe shpenzime të shtyra

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Parapagime	330	330
Shpenzime të shtyra komisione disbursimie kredie	56,546	58,701
Shpenzime të shtyra te tjera	<u>1,576</u>	<u>2,910</u>
	<u>58,452</u>	<u>61,941</u>

a) Shpenzime të shtyra janë shpenzime të periudhave të ardhshme nga furnitori i shpk, për periudhën janar-prill 2022 dhe furnitori K shpk për periudhën janar-maj 2022.

b) Shpenzim të shtyra për komisionet e disbursimit të kredisë BERZH sipas kontratës së lidhur.

Mjete monetare në arkë dhe në bankë	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Likuiditete në bankë	348,390	340,482
Mjete monetare në transit	<u>21,529</u>	<u>15,721</u>
	<u>369,919</u>	<u>356,203</u>

Likuiditete në bankë është gjendja e bankave më 31.12.2021 ku UKT sh.a. është në vlerën 338,874 mijë lekë dhe gjendja e bankave Hec Lanabregas më 31.12.2021 është 31,045 mijë lekë.

➤ **Pasivet** në vitin 2021 janë rritur me 4% krahasuar me vitin 2020 duke kapur vlerën 27,468,910 mijë lekë sipas zërave të cilët paraqiten në tabelën si më poshtë:

Pasivet përbëhen nga Kapitali, Detyrimet Afatgjata dhe Detyrimet Afatshkurtra.

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
KAPITALI		
Kapitali aksionar	6,792,760	6,792,760
Rezerva të tjera	1,234,494	841,251
Rezerva rivlerësimi	109,541	109,541
Rezerva ligjore	132,721	110,603
Fitime të mbartura	1,724,830	1,759,840
Fitimi i ushtrimit	846,596	380,136
Totali i kapitalit	10,840,942	9,994,131
DETYRIMET		
Detyrime afatgjata		
Hua afatgjata	5,830,873	6,235,121
Detyrime afatgjata të qirasë financiare	100,553	99,819
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	2,034,494	1,701,176
Totali i detyrimeve afatgjata	7,965,920	8,036,116
Detyrime afatshkurtra		
Hua afatshkurtra	3,373,391	3,124,003
Detyrime afatshkurtrë të qirasë financiare	31,368	35,573
Llogari të pagueshme tregtare	4,804,789	4,867,771
Detyrime ndaj personelit	59,748	62,344
Të pagueshme të tjera	30,504	34,203
Provizione	47,350	39,624
Tatimi mbi fitimin	67,684	0
Detyrime tatimore	32,851	30,482
Tatim fitimi i shtyrë	214,363	214,363

Totali i detyrimeve afatshkurtra	8,662,048	8,408,363
Totali i detyrimeve	16,627,968	16,444,479
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	27,468,910	26,438,610

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2021 është në vlerën 6,792,760 mijë lekë. Aksionet zotërohen 100% nga Bashkia Tiranë.

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
KAPITALI		
Kapitali aksionar	6,792,760	6,792,760
Rezerva të tjera	1,234,494	841,251
Rezerva rivlerësimi	109,541	109,541
Rezerva ligjore	132,721	110,603
Fitime të mbartura	1,724,830	1,759,840
Fitimi i ushtrimit	846,596	380,136
Totali i kapitalit	10,840,942	9,994,131

	<u>31 dhjetor 2021</u>
Numri i aksioneve	6,792,760
Vlera nominale (në mijë lekë)	<u>1</u>
	<u>6,792,760</u>

Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 846,597 mijë lekë përfaqëson fitimin e ushtrimit përgjatë vitit 2021.

<u>Fitimi</u>	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
UKT sha	864,805	413,908
hec lanabregas sha	36,325	55,738
Veprime eliminuese	(54,533)	-89,510
	846,597	380,136

Detyrimet në vitin 2021 janë rritur me 1% krahasuar me vitin 2020 duke kapur vlerën 16,627,968 mijë lekë sipas zërave të cilët paraqiten në tabelën si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
DETYRIMET		
Detyrime afatgjata		
Hua afatgjata	5,830,873	6,235,121
Detyrime afatgjata të qirasë financiare	100,553	99,819
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	2,034,494	1,701,176
Totali i detyrimeve afatgjata	7,965,920	8,036,116
Detyrime afatshkurtra		
Hua afatshkurtra	3,373,391	3,124,003
Detyrime afatshkurtër të qirasë financiare	31,368	35,573

Llogari të pagueshme tregtare	4,804,789	4,867,771
Detyrime ndaj personelit	59,748	62,344
Të pagueshme të tjera	30,504	34,203
Provizione	47,350	39,624
Tatimi mbi fitimin	67,684	0
Detyrime tatimore	32,851	30,482
Tatim fitimi i shtyrë	214,363	214,363
Totali i detyrimeve afatshkurtra	8,662,048	8,408,363
Totali i detyrimeve	16,627,968	16,444,479

Detyrimet afatgjata

Detyrimet afatgjata janë ulur me 1% krahasuar me vitin 2020 duke kapur vlerën 7,965,920 mijë lekë.

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
DETYRIMET		
Detyrime afatgjata		
Hua afatgjata	5,830,873	6,235,121
Detyrime afatgjata të qirasë financiare	100,553	99,819
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	2,034,494	1,701,176
Totali i detyrimeve afatgjata	7,965,920	8,036,116

a) Zëri huamarrje afatgjata është ulur me 6%, për shkak të kredisë hec lanabregas e cila mbaron në maj të vitit 2022.

b) Zërat që ka pasur rritje janë detyrime afatgjata të qerasë financiare ku gjatë vitit 2021 kemi pasur kontrata të reja qiramarrje mbi një vit.

c) *Grante*, pasi gjatë vitit 2021 janë rritur me 20% të cilat janë grante nga IPA (projekti Italian) për ujësjellësin e kasallës dhe nga AKUM për linjën e transmetimit nga puseta Yzberisht – depo Katund, Katund i ri & Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në Depo Qytet nxënësve, Bashkia Tiranë.

Detyrimet afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra janë rritur me 3% krahasuar me vitin 2020 duke kapur vlerën 8,662,048 mijë lekë.

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Detyrime afatshkurtra		
Hua afatshkurtra	3,373,391	3,124,003
Detyrime afatshkurtër të qirasë financiare	31,368	35,573
Llogari të pagueshme tregtare	4,804,789	4,867,771
Detyrime ndaj personelit	59,748	62,344
Të pagueshme të tjera	30,504	34,203
Provizione	47,350	39,624
Tatimi mbi fitimin	67,684	0
Detyrime tatimore	32,851	30,482
Tatim fitimi i shtyrë	214,363	214,363
Totali i detyrimeve afatshkurtra	8,662,048	8,408,363

Zërat që kanë pasur rritje janë:

a. Huat afatshkurtra të cilat janë rritur me 8% krahasuar me vitin 2020 duke kapur vlerën 3,373,391 mijë lekë e cila vjen nga principali i kredive italiane si dhe Kredia me limit kreditimi me kufi/overdraft nga B K ku Shoqëria “UKT sh.a.” ka nënshkruar Kontratën e Kredisë (Me kufi/Overdraft) Nr 1567 Rep, Nr. 1019/1 Kol., datë 04.09.2020 me limit kreditimi me Kufi/Overdraft 850,000,000 (tetëqind e pesëdhjetëmilionë) lekë, pranë B K Dega “Rruga Elbasanit”, Tiranë e cila është përdorur për blerje malli sipas nevojave të kompanisë/kapital punues, me afat 12 (dymbëdhjetë) mujorë.

Duke mos patur mundësi paguese nga ana e UKT sh.a. këstet e principalit janë paguar nga Ministria e Financave gjatë vitit 2021, gjë e cila sjell detyrimin që shoqëria ka ndaj Ministrisë së Financave.

b. Llogaritë e pagueshme të cilat janë ulur me 1% krahasuar me vitin 2020 duke kapur vlerën 4,804,789 mijë lekë nga 4,867,771 mijë lekë që ishte në vitin 2020. Zërat që kanë pasur ulje janë detyrimet ndaj furnitorëve.

c. Detyrime afatshkurtra të qerasë financiare.

Zërat që kanë pasur rritje janë detyrime afatshkurtra të qerasë financiare në vlerën 31,368 mijë lekë nga 35,573 mijë lekë gjatë vitit 2020.

d. Detyrime ndaj personelit të cilat pasqyrojnë pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2020 të punonjësve të cilat paguhën në muajin janar 2022.

e. Të pagueshme të tjera të cilat janë ulur me 11% krahasuar me vitin 2020 duke kapur vlerën 30,504 mijë lekë në 2021 nga 34,203 mijë lekë në vitin 2020 e cila vjen nga zëri kreditorë të tjerë në vlerën 15,825 mijë lekë dhe detyrimi 1% për të përndjekurit politik nga viti 2020 në vlerën 11,141 mijë lekë.

➤ **Fitimi neto** është rritur me 123% (nga 380,136 mijë lekë në vitin 2020 në 846,597 mijë lekë në vitin 2021).

- Fitimi neto i UKT sh.a. për vitin 2021 është në vlerën 864,805 mijë lekë dhe për HEC Lanabregas fitimi neto është 36,325 mijë lekë, si edhe veprimi eliminues në vlerën -54,533 mijë lekë (shpërndarja e dividendit nga Hec Lanabregas gjatë vitit 2021).

- Fitimi neto që paraqitet në pasqyrat financiare të vitit 2021 përbën shumën e disponueshme nga ana e shoqërisë në pajtim me rregullat ligjore dhe statutoare.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi/humbja para tatimit	1,040,351	483,845
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-193,755	-103,709
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	-193,755	-105,795
Tatim i shtyrë	0	2,086
Fitimi/humbja e vitit	846,597	380,136

- Rezultati kontabël (fitime ose humbje) paraqitet në pasqyrat financiare në formë llogarie dhe vë në dukje, nga njëra anë të ardhurat e realizuara gjatë ushtrimit, dhe shpenzimet për arritjen e këtyre të ardhurave.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi		
Të ardhurat totale	4,418,469	4,140,407
Shpenzimet totale	3,366,610	3,630,762

Pasqyra e konsoliduar menaxheriale e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave gjithëpërfshirëse.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	4,169,674	3,920,921
Të ardhura të tjera	160,944	134,797
Total të ardhura	4,330,618	4,055,718
Shpenzimet e prodhimit	-818,108	-801,041
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	-446,695	-413,391
Shpenzime zhvlerësimi konsum i inventarit të imët	-40,404	-389
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	-585,592	-924,561
Rimarrje/(Shpenzime) provizione llogari të arkëtushme	-115,131	-145,167
Rimarrje/(Shpenzime) provizione për shitje gjyqësore	-48,560	18,379
Shpenzime personeli	-1,215,936	-1,075,017
Total shpenzime	-3,270,426	-3,341,187
Shpenzimet financiare	-167,551	-163,910
Fitim (humbje) nga këmbimet valutore	147,710	-66,776
Fitimi/humbja para tatimit	1,040,351	483,845
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-193,755	-103,709
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	-193,755	-105,795
Tatim i shtyrë	0	2,086
Fitimi/humbja e vitit	846,596	380,136
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	0	-48,781
Zëra nuk do të klasifikohen në fitim ose humbje	0	-48,781
Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja	-	-
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-	-
Tatim i shtyrë nga rivlerësimi	0	-48,781
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	0	-48,781
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	846,596	331,355

Të Ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit paraqiten sipas zërave më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga konsumatorë familjar	1,882,110	1,846,625
Të ardhura nga subjekte private	727,988	576,401
Të ardhura nga institucione buxhetore	356,323	330,056
Të ardhura nga institucione jo - buxhetore	33,640	48,286
Të ardhura shitje uji HEC + KESH	221,146	229,848
Të ardhura nga tarifa fikse e shërbimit	615,700	610,829
Të ardhura shitje uji me shumicë	83,702	70,711
Të ardhura nga klientë të veçantë	43,312	37,913
Të ardhura nga prodhimi i aktiveve	48,587	60,436
Të ardhura nga tarifa e pastrimit	34,670	32,553
Të ardhura nga taksa e ndërtesës	27,226	25,942
Të ardhura vendosje matësish	45,201	18,104
Të ardhura nga pikë lidhjet	20,332	9,506
Të ardhura azhornime rrjeti	8,673	5,206
Të ardhura shitje uji me bote dhe shitje uji	1,318	3,470

Të ardhura të tjera	19,746	15,035
	4,169,674	3,920,921

Zërat që kanë ndikuar te të ardhurat janë:

- *Të ardhura shitje uji me shumicë* rezultojnë me rritje në vlerën 12,991 mijë lekë pasi kemi faturim më shumë duke e krahasuar me vitin 2020.
- *Të ardhura nga azhornim rrjeti* rezultojnë me rritje në vlerën 3,467 mijë lekë pasi kemi pasur fluks kërkesash nga subjekte private duke e krahasuar me vitin 2020.
- *Të ardhura nga taksa e ndërtesës* rezultojnë me rritje 1,284 mijë lekë sipas marrëveshjes bashkëpunimit për agjentin tatimor, datë 21.06.2019 midis Bashkisë Tiranë dhe UKT sh.a për taksën e ndërtesës ku nga të ardhurat e arkëtuara për vjeljen e kësaj takse 95% i takojnë Bashkisë Tiranë dhe vlera e mbetur 5% do të përfitohet në favor të agjentit tatimor.
- *Të ardhura nga subjekte private* rezultojnë me rritje prej 151,587 mijë lekë krahasuar me vitin 2020 për shkak të formalizimeve nga kontrollet e vazhdueshme të kryer nga Task Forca si dhe rikthimit në normalitet të aktiviteteve private me orar të plotë.
- *Të ardhura vendosje matësash* rezultojnë me rritje prej 27,097 mijë lekë si rezultat i hapjes së kontratave të reja.

Të ardhura të tjera

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga kamatvonesa, gjoba e penaltete	109,426	82,862
Të ardhura nga grantet afatgjata	46,956	47,396
Shitje kontratash për subvencion	4,276	2,449
Të ardhura të tjera	286	2,009
Te ardhura nga kontaktat e sigurimeve	0	81
	160,944	134,797

Kamat vonesat njihen si të ardhura vetëm pasi ato paguhen nga debitorët dhe jo në momentin e lindjes së tyre.

- Të ardhura nga grantet afatgjata ose kuota pjesë e amortizimit, është amortizimi i granteve që ka UKT sh.a, llogaritja e tyre është bërë me përqindje sipas aktiveve që u përkasin këtyre granteve.
- Kemi rritje të kamatës krahasuar me vitin 2020 për shkak të shlyerjes së faturave të prapambetura.

Shpenzimet e prodhimit

Përfaqësojnë shpenzimet direkte që përballon UKT sh.a. në lidhje me prodhimin e produkteve të saj, Uji i Pijshëm dhe Uji i Përdorur, këto detajohen të veçanta si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime materiale të para - mirëmbajtje rrjeti	163,161	196,901
Shpenzime materiale - kimikate	191,793	152,843
Shpenzime energjie elektrike	311,657	328,114
Shpenzime karburanti	88,376	79,438
Shpenzime materiale - matësat	28,291	15,282
Lënda e parë e shpenzime HEC	4,752	18,786
Shpenzime kancelarie	4,199	4,016
Shpenzime per prodhim	23,735	4,115
Shpenzime per transmetim	0	746

Shërbime të tjera

2,144	800
818,108	801,041

Zërat që kanë pasur më shumë ndikim në shpenzimet e prodhimit duke parë dhe nga tabela janë:

- *Shpenzime materiale - kimikate* janë rritur në vlerën 38,950 mijë lekë në vitin 2021 duke e krahasuar me vitin 2020 për shkak trajtimi të ujit gjatë gjithë vitit me kimikate.

- *Shpenzime materiale - matësat* kemi rritje në vlerën 13,009 mijë lekë duke e krahasuar me vitin 2020 për shkak të hapjes së kontratave të reja.

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

Përfaqësojnë shpenzimet për konsulenca, udhëtime për dieta personeli, telefoni, penalitete, gjoba etj.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shërbimi i rojes private	290,712	597,172
Shpenzime mirëmbajtjeje dhe riparime	65,611	68,767
Shpenzime të përgjithshme	41,715	48,482
Penalitete Gjoba	20,587	51,038
Taksa, Tatime të ngjashme dhe tarifa të tjera	38,243	35,438
Qera	39,739	29,403
Shpenzime printime dhe fotokopje	17,587	21,504
Marketing dhe të ngjashme	17,043	13,650
Transferta, udhëtime	979	0
Komisione Shërbime Bankare	8,952	5,427
Shpenzime telefonike, postare ,internet	6,612	4,420
Të tjera	7,323	30,048
Shpenzime kërkimore	15,329	9,372
Konsulencë tekniko ekonomike	15,160	9,575
Shpenzime për COVID-19	0	265
	585,592	924,561

Zërat që kanë pasur më shumë ndikim në shpenzimet e përgjithshme dhe administrative janë paraqitur më poshtë:

- *Shërbimi i rojeve private* janë ulur, kjo për shkak të implementimit të kamerave nëpër depo.

- *Shpenzime për mirëmbajtje dhe riparime* ku janë përfshirë riparimi i pajisjeve informatike, shërbimet për mirëmbajtjen e Financës 5 dhe mirëmbajtjen e serverit.

- *Shpenzime për qira zyresh* janë rritur për arsye të hapjes së zyrave të reja për marrëdhënie me konsumatorin.

- *Shpenzime kërkimore dhe konsulencë tekniko ekonomike* janë rritur për shkak të biznes planit për periudhën 2020-2024.

Shpenzimet e personelit

- Shpenzimet e personelit janë rritur me 140,919 mijë lekë krahasuar me vitin 2020 si rezultat i rritjes së numrit të punonjësve.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime për paga	893,419	802,439
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	165,664	149,480
Kompensim ushqimore	101,766	96,709

Shpërblime dhe të ngjashme

55,087	26,389
<u>1,215,936</u>	<u>1,075,017</u>

Numri mesatar i punonjësve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 është 1,359 punonjës. Lista e numrit mesatar të punonjësve sipas kategorisë është si më poshtë:

	31 dhjetor 2021
Drejtori i përgjithshëm dhe stafi mbështetës i tij	28
Drejtoria ekonomike, e taksave dhe prokurimit	92
Departamenti i shitjes	139
Drejtoria e prodhim- shpërndarjes	189
Departamenti inxhinierik	86
Departamenti operacional	164
Drejtoria e kujdesit ndaj klientit dhe shërbimeve mbështetëse	193
Drejtoritë rajonale dhe njesitë zonale 1, 2, 3, 4, 5	465
Auditi i brendshëm	3
	1,359

Shpenzimet financiare

Në këtë zë përfshihen shpenzimet nga interesi mbi huatë të cilat po i paraqesim sipas tabelës si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime interesa - Kreditë 22 Mld FROT/AID-95/007/00	3,975	4,761
Shpenzime interesa - Kredia 13 Mld FROT/AID-94/006/00	1,776	2,102
Shpenzime interesa - Kredia 53.2 Mld FROT/AID-99/004/00	16,370	15,426
Shpenzime interesa - Kredia 6.8 Mld FROT/AID-99/010/00	2,140	2,184
Shpenzime për interesa – HEC	6,917	15,290
Shpenzime interesa - Kredia comm 98.22 Mld FROT/AID-98/001/00	288	314
Shpenzime interesi për rikonceptimin e burimeve të Shën Mërisë	26,750	33,513
Shpenzime për interesa -Administratë overdrafti	29,998	26,858
Shpenzime interesa per kredine BERZH	32,944	30,336
Shpenzime interesa -Kredia Japoneze	36,450	25,959
Shpenzime interesi SNRF 16	9,943	7,171
Te ardhura financiare	0	-4
	167,551	163,910

Shpenzimet financiare janë rritur si rezultat i rritjes së:

- Shpenzime interesa kredia BERZH e cila është dizbursuar gjatë vitit 2020.
- Shpenzime interesa të kredisë Japoneze sipas ndryshimit të marrëveshjes së nënhuasë për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”.

Fitim humbjet nga këmbimet valutore

Fitim (humbje) nga këmbimet valutore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitim nga këmbimet valutore	155,566	-140
Humbje nga këmbimet valutore	-7,856	-66,636
	147,710	-66,776

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
EUR/LEK	120.76	123.7
USD/LEK	106.54	100.84

Detyrimet e UKT SHA në vite:

Përsa i përket detyrimeve ndaj furnitorëve, shoqëria “UKT” SHA ka ende detyrime të prapambetura ndaj furnitorëve që nga viti 2015- 2022.

Kjo është paraqitur edhe në tabelat më poshtë:

Tabelë: Totali i detyrime deri në 31.12.2021 dhe vlera e likuiduar për këto detyrime deri në 30.09.2022.

Detyrim/Likuidim	Detyrim i mbetur në datën 31.12.2021	Shlyer deri me 30.09.2022	Detyrim i mbetur me 30.09.2022
Viti 2015	357,720,771	76,438,186	281,282,585
Viti 2016	34,285,444	1,568,627	32,716,817
Viti 2017	39,197,848	1,111,364	38,086,484
Viti 2018	35,008,789	10,027,381	24,981,408
Viti 2019	229,146,678	47,268,601	181,878,077
Viti 2020	1,115,613,887	153,222,625	962,391,262
Viti 2021	1,234,214,904	700,461,773	533,753,131
Detyrimi me 31.12.2021	3,045,188,321	990,098,557	2,055,089,764

Burimi: DEK, UKT SHA

Tabelë: Totali i detyrime gjatë vitit 2022 dhe vlera e likuiduar për këto detyrime deri në 30.09.2022.

DETYRIM/LIKUJDIM	DETYRIMI DERI ME 30.09.2022	SHLYER DERI ME 30.09.2022	DETYRIMI I MBETUR ME 30.09.2022
VITI 2022	2,108,985,269	1,141,661,776	967,323,492
Total detyrim i mbetur me 30.09.2022			3,022,413,256

Burimi: DEK, UKT SHA

Tabelë: Totali i detyrime deri në 30.09.2022.

SHLYERJE TOTAL GJATE VITIT 2022	2,131,760,333
DETYRIMI NË DATËN 31.12.2021 PËR VITET 2015-2021 ËSHTË	2,055,089,764
DETYRIMI I VITIT 2022	967,323,492
TOTALI I DETYRIMIT MË 30.09.2022 ËSHTË	3,022,413,256

Burimi: DEK, UKT SHA

Totali i detyrimeve të UKT SHA deri në 30.09.2022 është 3,022,413,256 lekë.

Detyrimet ndaj OSHEE SHA

- Për faturat e palikujduara me OSHEE të viteve të mëparshme është bërë një marrëveshje me nr. 28953 prot., datë 18.12.2019 ndërmjet UKT sha dhe OSHEE për t'i paguar ato me këste.

-Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se detyrimet ndaj OSHEE SHA nuk janë likuiduar në shumën 191,568,271.62 lekë. Në opinionin e grupit të auditimit, shoqëria

“UKT” SHA nuk ka ndjekur një rradhë kronologjike në likuidimin e faturave, ndërkohë që janë likuiduar fatura të mëvonshme të furnitorëve të tjerë, duke neglizhuar likuidimin e detyrimeve ndaj OSHEE për vitin 2021, 2022 ku ka një vlerë ende të papaguar.

Detyrim/Likujdim	Furnitori/Fshu (Oshe)
Detyrimi 2015	477,885,957
Shlyer 2015	243,999,278
Mbetje Detyrimi 2015	233,886,679
Detyrim 2016	455,131,875
Shlyerje 2016	439,539,715
Mbetje Detyrimi 2016	15,592,160
Detyrimi 2017	455,476,366
Shlyerja 2017	442,495,423
Mbetje Detyrimi 2017	12,980,943
Detyrimi 2018	387,045,369
Likujdim 2018	385,315,832
Mbetje Detyrimi 2018	1,729,537
Detyrimi 2019	443,875,845
Likujdimi I 2019	443,875,845
Mbetje Detyrimi 2019	0
Detyrimi 2020	389,388,632
Likujdimi 2020	389,388,052
Mbetje Detyrimi 2020	580
Detyrimi 2021	363,232,720
Likujdim 2021	313,818,078
Mbetje Detyrimi 2021	49,414,642
Total Detyrim Deri 31.12.2021	313,604,541
Detyrimi 2022	314,152,280.97
Likujdim 2022	287,716,523.04
Mbetje Detyrimi 2022	26,435,757.93
Total Detyrim Deri 31.10.2022	191,568,271.62

Burimi: “UK Tiranë” sha.

Sipas të dhënave, detyrimet ndaj OSHEE deri në datë 31.10.2022 janë 191,568,271.62 lekë ose 6.3% të detyrimeve të akumuluar deri në 31.10.2022.

Vlerat 49,414,642 lekë dhe 26,435,757.93 lekë janë likuiduar në janar 2022 dhe nëntor 2022.

Kamatëvonesat e faturave të OSHEE

Për shkak të mos pagesës në kohë të detyrimeve për energjinë elektrike ndaj OSHEE SHA, UKT SHA është ngarkuar edhe me detyrime nga kamatëvonesat.

Periudha	Detyrimi në fillim të periudhës	Paguar	Gjendje në fund
31.12.2019	316,190,252.09	32,533,952	283,656,300.19
31.12.2020	288,656,300.19	23,661,056.40	259,995,243.79
31.12.2021	259,995,243.79	35,491,586.20	224,503,659.57
30.10.2022	224,503,659.57	27,480,295.91	197,023,361.68

Vlera prej **197,023,361.68 lekë** nuk është e përfshirë në totalin e detyrimeve ndaj furnitorëve.

Detyrime ndaj Tatimeve

-Për shkak të faturave të mbartura të palikujduara ndër vite nga UKT sha, është bërë një marrëveshje për pagesë me këste të detyrimeve tatimore ndërmjet Drejtorisë së Tatimpaguesve të

Mëdhenj dhe tatimpaguesit UKT sha me shkesë me nr. 3193/1 prot., datë 29.03.2019, si detyrime që kanë rrjedhur pas një kontrolli tatimor.

Nr	Lloji i tatimit	Detyrim kryesor (në lekë)	Gjoha (në lekë)	Interes (në lekë)	Total (në lekë)
1.	Tatimi mbi fitimin	120,640,944	0	0	140,640,944
	Total	120,640,944	0	0	140,640,944

Kjo vlerë detyrimi është shlyer në 12 këste nga data 25.04.2019 deri në 25.03.2020 dhe si vlerë është zëruar.

Për sa më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr, 23, datë 30.11.2022.

Në lidhje me observacionin nr. 21076/1, datë 07.12.2022 të paraqitur nga zj. E.C dhe R.S ku keni paraqitur disa saktësime në lidje me vlerat e dhëna grupit të auditimit ju sqarojmë se u morrë parasysh dhe u bënë reflektimet në material

2.7. Mbi zbatimin e ligjshmërie në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Auditimi u krye me zgjedhje⁴.

Për periudhën 01.09.2018-31.12.2018 janë zhvilluar 79 procedura prokurimi me vlerë 1,667,328,062 mijë lekë.

Për vitin 2019, janë zhvilluar 123 procedura prokurimi me vlerë 2,412,877,784 mijë lekë.

Për vitin 2020, janë zhvilluar 122 procedura prokurimi me vlerë 3,311,626,891 mijë lekë.

Për vitin 2021, janë zhvilluar 108 procedura prokurimi me vlerë 4,476,882,398 mijë lekë,

Për periudhën 01.01.2022-31.10.2018 janë zhvilluar 79 procedura prokurimi me vlerë 821,007,918 mijë lekë.

Në total për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar 511 procedura me vlerë 11,689,723,053 mijë lekë.

Për periudhën 01.09.2018-31.12.2018

Nr	Procedura	Nr i procedurave	Fondi limit	Vlera e kontrates	Diferenca	
					Vlere	%
1	Procedura e hapur	25	1,594,128,989.97	1,417,810,051.86	176,318,938.11	11.1%
2	Procedura Kerkese per propozim	13	40,324,101	33,344,073.98	6,980,027.02	17.31%
3	Procedura Negocim pa shpallje	2	6,496,700	5,848,693	648,007	9.97%

⁴ Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) "Kampioni i auditimit", i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.

Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: "Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur"

4	Procedure Blerje e vogel	39	26,378,272	23,627,666	2,750,606	10.43%
	Shuma	79	1,667,328,062.97	1,480,630,484.84	186,697,578.13	12,6

Burimi: UKT Tiranë.

Viti 2019

lekë

Nr	Procedura	Nr i procedurave	Fondi limit	Vlera e kontrates	Diferenca	
					Vlere	%
1	Procedure e hapur	38	2,233,368,411.1	2,090,657,154.02	142,711,257.08	6.38%
2	Procedure Kerkese per propozim	24	119,631,363.38	110,126,484.29	9,504,879.09	7.94%
3	Procedure Negocim pa shpallje	2	18,381,390	18,380,920	470	0.003%
4	Procedure Blerje e vogel	55	39,496,620	36,493,139	3,003,481	7.6%
5	Sistem dinamik (Blerje bileta per udhetime)	4	2,000,000	995,380	1,004,620	50.2%
	Shuma	123	2,412,877,784.48	2,256,653,077.31	156,224,707.17	6,9

Burimi: UKT Tiranë.

Viti 2020:

lekë

Nr	Procedura	Nr i procedurave	Fondi limit	Vlera e kontrates	Diferenca	
					Vlere	%
1	Procedure e hapur	37	3,137,056,290.9	2,687,812,414.32	449,243,876.58	14.3%
2	Procedure Kerkese per propozim	24	87,714,055.8	72,013,078.29	15,700,977.51	17.9%
3	Procedure Negocim pa shpallje	7	41,526,544.3	39,003,277.1	2,523,267.2	6%
4	Procedure Blerje e vogel	54	40,830,000	36,441,437	4,388,563	10.7%
5	Sistem dinamik (Blerje bileta per udhetime)	0	4,500,000	0	4,500,000	
	Shuma	122	3,311,626,891	2,835,270,206.71	476,356,684.29	16,8

Burimi: UKT Tiranë.

Viti 2021:*lekë*

Nr	Procedura	Nr i procedurave	Fondi limit	Vlera e kontrates	Diferenca	
					Vlere	%
1	Procedure e hapur	23	4,293,567,438.69	4,071,995,638.91	221,571,799.78	5.2%
2	Procedure e hapur e thjeshtuar	17	75,013,360	65,985,891.9	9,027,468.1	12%
3	Procedure Kerkese per propozim	2	11,700,000	11,465,000	235,000	2%
4	Procedure Negocim pa shpallje	-	-	-	-	-
5	Modifikim Kontrate	2	48,247,442.00	48,247,442.00	0	0
6	Procedure Blerje e vogel	60	45,354,158	41,176,353	4,177,805	9.2%
7	Sistem dinamik (Blerje bileta per udhetime)	4	3,000,000	467,660	2,532,340	84.4%
	Shuma	108	4,476,882,398.69	4,239,337,985.81	237,544,412.88	5,6

000/lekë

Burimi: UKT Tiranë.

Për periudhën 01.01.2022-30.11.2022*lekë*

Nr	Procedura	Nr i procedurave	Fondi limit	Vlera e kontrates	Diferenca	
					Vlere	%
1	Procedure e hapur	14	656,970,496	526,703,465	130,267,031	19.8%
2	Procedure e hapur e thjeshtuar	9	44,212,442	36,413,449	7,798,993	17.6%
3	Procedure Kerkese per propozim	-	-	-	-	-
4	Procedure Negocim pa shpallje	4	83,132,506	80,826,443	2,306,063	2.8%
5	Modifikim Kontrate	1	242,474	242,474	0	0
6	Procedure Blerje e vogel	38	33,450,000	27,497,990	5,952,010	17.8%
7	Sistem dinamik (Blerje bileta per udhetime)	6	3,000,000 (Fond i parashikuar per gjithe vitin)	687,040	2,312,960	77%
	Shuma	70	821,007,918	672,370,861	148,637,057	

Burimi: UKT Tiranë.

Në procedurat e audituara, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimi në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se përgjithësisht është zbatuar Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, me ndryshimet vijuese të tij, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në funksion të tyre, në lidhje me përzgjedhjen e procedurave të prokurimit, llogaritjen e fondit limit, argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim, kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik, si dhe lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Pavarësisht nga sa u citua më sipër u konstatuan dhe shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore, të cilat në mënyrë të detajuar për çdo procedurë prokurimi paraqiten si më poshtë vijon:

1. Procedura e prokurimit me objekt “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, viti 2019.

Zhvillimi i Procedurës së Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 15437 prot, datë 03.09.2021	3. Njësia e prokurimit Urdhër 15437 prot, datë 03.09.2021 -I.G; inxhinier mekonik - K.H; juriste -D.K; ekonomiste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Kacidhja nr. 1094/2 prot., datë 30.05.2019 -L.R; juriste -O.D; ing. hidro -E.T; gjuhete huaja
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 99,902,997 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 93,970,962 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 5,932,035 leke
8. Data e hapjes së tenderit 05.07.2021	9. Burimi Financimit Fond nga Te ardhurat e shoqërisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 OE b) S’kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik -
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 10094/6 prot., datë 02.09.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 112,765,154 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me vendim të Asamblesë nr. 16, datë 13.12.2018 “Për miratimin e Buxhetit të Shoqërisë ‘UKT Sh.a, për vitin 2019” në zërin investime është planifikuar “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, do të përfshihet vendosja e matëse inteligjent në kosumatorët specifik (buxhetor, biznese të mëdha që konsumojnë shumë ujë) me qëllim matjen sa më të saktë në distancë dhe në kohë reale. Kjo gjë do të minimizojë në maksimum ndërhyrjet në matës. Vlera e fondit limit për vitin 2019 është në vlerën 30,000,000 lekë, për vitin 2020 në vlerën 40,000,000 lekë dhe për vitin 2021 në vlerën 30,000,000 lekë. Vlera totale 100,000,000 lekë.

Me vendim të Asamblesë nr. 11, datë 13.12.2019 “Për miratimin e Buxhetit të Shoqërisë ‘UKT Sh.a, për vitin 2020” në zërin investime është planifikuar “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, do të përfshihet vendosja e matëse inteligjent në kosumatorët specifik (buxhetor, biznese të mëdha që konsumojnë shumë ujë) me qëllim matjen

sa më të saktë në distancë dhe në kohë reale . Kjo gjë do të minimizojë në maksimum ndërhyrjet në matës, vlera është 37,588,384 lekë.

Me vendim të Asamblesë nr. 07, datë 05.12.2010 “Për miratimin e Buxhetit të Shoqërisë ‘UKT Sh.a, për vitin 2020”, është përcaktuar vlera 474,747,295 lekë me përshkrimin “Shuma e mbartur e buxheteve të ndarë ndër vite”, ndërsa në detajimin nga Departamenti Inxhinjerik, për zërin investime është planifikuar “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, do të përfshihet vendosja e matëse inteligjent në konsumatorët specifik (buxhetor, biznese të mëdha që konsumojnë shumë ujë) me qëllim matjen sa më të saktë në distancë dhe në kohë reale, në vlerë 28,191,298 lekë, referuar detajimit që është bërë me shkresën nr. 3402/7 prot., datë 23.10.2020 të Departamentit Inxhinjerik, për projektbuxhetin e viti 2021.

Me shkresën nr. 1836/1 prot., datë 23.05.2019, O.DH me detyrë Drejtor i Departamentit Inxhinjerik, i dërgon L.R me detyrë drejtore e prokurimeve, projekt preventivin, raportin teknik dhe specifikimet teknike “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”.

Projekti është hartuar nga inxhinierët e ujësjellësit E.P (liçensuar, kat Kat.4/a Kat.5/c), ing. A.B dhe P.B, miratuar nga përgjegjësi i sektorit të projektimit A.M (liçensuar, kat Kat.4/a Kat.5/c), drejtor Dep. Teknik H.G dhe Drejt Departamentit inxhinjerik O.D, si dhe miratuar nga Drejtor i Përgjithshëm.

Preventivi është në vlerën 99,902,997 lekë me TVSH 119,883,597 lekë, firmosur projektues/preventivuesit E.P dhe A.Q, A.M, drejtor Dep. Teknik H.G dhe Drejt Departamentit inxhinjerik O.D, si dhe miratuar nga Drejtor i Përgjithshëm.

Punimet janë projektuar dhe preventivuar me inxhinier pa pasur të gjithë zotësinë profesionale për të projektuar (teknike dhe ligjore) pasi nuk kanë pasur licencat profesionale përkatëse të miratuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 759, datë 12.11.2014 ‘Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’, i ndryshuar, pika 1 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “1. Çdo individ apo subjekt juridik, që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, duhet të pajiset me licencën profesionale përkatëse sipas përcaktimeve të rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale, bashkëlidhur këtij vendimi”.

Neni 16/1 “Licenca – kategoritë e punimeve”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të tij të ushtrojë veprimtari të caktuar profesionale sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim duke u mbështetur kryesisht në profilin e diplomës së arsimit të lartë, vitet e eksperiencës, eksperiencën në punë, kushtet e kriteret e përcaktuara në këtë rregullore”.

Neni 2/2 “Përkufizimi i termave” “Licencë profesionale” -dokument me të cilin pajiset çdo individ ose subjekt juridik vendas ose i huaj që dëshiron të ushtrojë profesionalisht studimin dhe/ose projektimin dhe mbikëqyrjen dhe/ose kolaudimin në fushën e ndërtimit”.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi O.DH me detyrë ish-Drejtor i Departamentit Inxhinierik.

Në preventiv nuk është pasqyruar pajisja hardware e komunikimit DCU që mundësojnë transmetimin në kohe reale në Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të dhënave, **duke pa mundësuar:**

-a. Mos efikasitet të plotë të fondit publik të përdorur në këtë prokurim në përputhje me qëllimin e tij, që ka të bëjë me “Sistemi Matjes në Distancë bazohet në ngritjen e një rrjeti komunikimi të njësisë matëse me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të Dhënave”. Kjo lloj teknologji shfrytëzon transmetimet wireless, e cila transformon informacionin mekanik në sinjale elektrike.

Përmes instalimit të këtyre ujëmatëseve ndërtojmë Sistemin e Matjes në Distançë. Sistemi i Matjes në Distançë bazohet në ngritjen e një rrjeti komunikimi të njësisë matëse me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të Dhënave. Projekti parashikon që në ofertë të jenë të parashikuara të gjitha kostot në lidhje me programimin e software, zhvillimin me qëllim përfundimtar që të dhënat të përftuara përmes walk-By/Drive-By, ose përmes rrjetit fiks të jenë të disponueshme në sistemin e shfrytëzimit të U.K.T.

-b. Mos kalimin e vlerës mbi 100,000,000 lekë, për t'ju nënshtuar projekti, oponentës teknike në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 18.7.2002 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, pika 1 dhe 2, VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponentës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, Urdhrin Ministres së Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit E.GJ nr. 7, datë 20.1.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponentës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

-c. Mos shkurtimin e personelit (faturistëve) për faturimin e ujit të pijshëm.

Investimi është kryer pa deklaratë paraprake punimesh, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 3 pika 21, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Ndërtim/punim pa leje” janë ato procese dhe/ose objekte ndërtimore të kryera në mungesë të lejes së ndërtimit, deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve ose të kryera në kushtet e një lejeje të shfuqizuar”, VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar neni 7 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Punime riparimi, zëvendësimi dhe mirëmbajtjeje të rrjeteve të infrastrukturës publike dhe komunikimeve elektronike, që nuk prekin sistemin konstruktiv të tyre, nuk ndryshojnë përdorimin dhe përmasat e infrastrukturës, si dhe kushtet e zhvillimit në zonën përreth”.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi O.DH me detyrë ish-Drejtor i Departamentit Inxhinjrik, preventivuesit E.P me detyrë specialist i Drejtorisë Teknike, A.Q ish- drejtor i IT dhe A.M me detyrë përgjegjëse e sektorit të projektimit.

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 1094 prot., datë 30.05.2019 është ngritur njësia e prokurimit e përbërë i përbërë nga I.G me profesion ing. mekanik, K.H me profesion juriste dhe D.K me profesion ekonomiste, ku është përcaktuar procedurë prokurimi e hapur me vlerë 99,902,997 lekë, me datë zhvillimi tenderi 22.09.2021 ora 9.00.

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 1094/2 prot., datë 30.05.2019 është ngritur komisioni i vlerësimit i përberë nga L.R me profesion juriste, O.DH me profesion inxhinier hidro dhe E.T me profesion gjuhë të huaja, ku është përcaktuar vlera 99,902,997 lekë, me datë zhvillimi tenderi 03.07.2019 ora 11.00.

Kërkesat për kualifikim dhe specififikimet teknike janë miratuar me procesverbalin e datës 30.05.2019 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë I.G, K.H dhe D.K, ku është përcaktuar kriteri i përzgjedhjes, “ Çmimi më i ulët”.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët operatorë ekonomike.

Shoqëria “E” Shpk, me ofertë në vlerën 97,903,419 lekë.

-Shoqëria “A” Shpk, me ofertë në vlerën 89,315,199 lekë.

-Shoqëria “I ” Shpk, me ofertë në vlerën 93,970,962 lekë.

-Shoqëria “M” Shpk, me ofertë në vlerën 99,902,745 lekë.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit, është hartuar me nr. 10094/3 prot., datë 16.07.2019, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, ku është kualifikuar dhe shpallur fitues Operatori ekonomik “I ” Shpk, duke u s’kualifikuar 3 operatorët e tjerë.

Në datën 16.07.2019 në S.P.E. e A.P.P, është kryer njoftimi i fituesit, nga ku A.P.P e ka bërë aktive publikimin e njoftimit të fituesit po në këtë datë, si dhe ka bërë shpalljen në buletin e APP nr. 29, datë 22.07.2019.

Kontrata është lidhur me nr. 10094/6 prot., datë 02.09.2019 ndërmjet UKT përfaqësuar nga R.M në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit/e Shoqërisë (I) Shpk në vlerën 93,970,962 lekë pa TVSH dhe 112,765,154 lekë me TVSH, me afat ekzekutimi 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, me mbikëqyrës operatorin ekonomik “A ” shpk.

Nuk është siguruar kontrata për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta, si dhe deri në datën e hartimit të këtij konstatimi Autoriteti Kontraktor, nuk ka zgatur periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose nuk ka bërë vet siguracionin dhe të zbresë koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

Veprim në kundërshtim me neni 28 të kontratës së lidhur, pika 1 dhe 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se **Neni 28 “Sigurimi”**.

28.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktori nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

28.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbreri koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

Kontrata është amendur me nr. 10094/10 prot., datë 28.04.2020, duke e shtyrë afatin nga 12 muaj dhe për 46 ditë të tjera, për shkak të Covid-2019.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi E.B me detyrë ish-drejtores e drejtorisë juridike.

Me shoqërinë “L” Shpk nuk është lidhur një kontrata e sigurimit të përgjegjësive profesionale për çdo dëm që mund të shkaktohet, veprim në kundërshtim me: Ligjin nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se

“1. Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendës apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore.

3. Çdo zbatues punimesh është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësive profesionale për çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij dhe duhet të mbulojë të paktën çdo shpenzim të nevojshëm e të domosdoshëm për kryerjen e punimeve të reja, si dhe shpenzimet shtesë të kryera nga zhvilluesi ose organet e administratës publike, që kanë rrjedhur si pasojë e zbatimit të punimeve në kundërshtim me kontratën përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit, me dokumentet e planifikimit dhe zhvillimit, si dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit”.

-Ligjin nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “5. Zhvilluesit, krahas dokumentacionit tekniko-ligjor, duhet të dorëzojnë edhe kontratën e sigurimit, me përfitues autoritetin publik përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit. Kontrata e sigurimit duhet të mbulojë çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e kryerjes së punimeve të ndërtimit në kundërshtim me lejen e ndërtimit ose lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit, legjislacionin

në fuqi që rregullon fushën e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, si dhe çdo shpenzim të nevojshëm e të domosdoshëm për kryerjen e punimeve të reja ose përfundimin e punimeve në rastet kur zhvilluesi nuk përfundon punimet, sipas lejes së miratuar nga autoriteti publik përgjegjës.

Shoqëria e sigurimit, në rast se ndodh ngjarja e siguruar, është e detyruar të paguajë dëmin brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së autoritetit publik përgjegjës. Në çdo rast, shuma e sigurimit duhet të jetë e barabartë me koston e parashikuar të ndërtimit të objektit, sipas preventivit përkatës”.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi O.D me detyrë ish-Drejtor i Departamentit Inxhinierik.

Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar është bërë me nr. 10094/7 prot., datë 03.09.2019.

Në datën 03.09.2019 në S.P.E. e A.P.P. është kryer publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës, nga ku A.P.P. e ka bërë aktive këtë publikim me buletin nr. 36, datë 09.09.2019.

Në nenin 13.2 është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Pjesët përbërëse të kësaj kontrate të cilave do tu referohen palët gjatë zbatimit të saj janë: Formulari i ofertës; relacioni; projekt/preventivi, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, formulari i sigurimit të kontratës.*

Është likuiduar në vlerën 77,416,443 lekë, pa likuiduar në vlerën 29,978,942 lekë dhe është mbajtur garanci për punime vlera 4,144,162 lekë.

Vendosja e matëseve inteligjent është në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve SHA”, pika 2/7, Ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë” i shfuqizuar, neni 26, i ndryshuar me Ligjin nr. 126/2020 “Për metrologjinë”, neni 25; VKM nr. 96, datë 21.2.2007 “Për disa ndryshime në VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, pika 3; Vendimi i Enti Rregullator i Ujit nr. 8, datë 04.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip” ndryshuar me Vendimet nr. 15, datë 09.06.2014 “Për zbatimin e kontratës model të miratuar nga KKRR për të gjithë klientët e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe me Vendimin nr. 25, datë 08.07.2015 ”Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën model të shërbimeve ujësjellës kanalizime” Enti Rregullator i Ujit, neni 7.

Koment i grupit të auditimit

Referuar dispozitave ligjore dhe rregullore të përmendur si mësipër, zëvendësimi i instrumentit ujëmatës mund të kryhet në kushtet si vijon:

-Në rast se nga testimi i kryer pas verifikimit periodik rezulton se matësi nuk kryen funksionet e matjes (Verifikimit periodik të ujëmatësve i nënshtrohen të gjithë ujëmatësit që kanë plotësuar kriterin e datës së vendosjes së tyre 60 muaj, përcaktuar në Urdhrin 195, datë 09.03.2009 “Për verifikimin fillestar dhe pasardhës të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara” të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në nenin 26 të Ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë” i shfuqizuar, në Ligjin nr. 126/2020 “Për metrologjinë”, neni 25.

-Kur dëmtohet fizikisht, me njoftim të palëve që konstatojnë dëmtimin (sipas përcaktimeve në Vendimin e Entit Rregullator të Ujit nr. 8, datë 04.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip” ndryshuar me Vendimet nr. 15, datë 09.06.2014 “Për zbatimin e kontratës model të miratuar nga KKRR për të gjithë klientët e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe me Vendimin nr. 25, datë 08.07.2015 ”Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën model të shërbimeve të ujësjellës kanalizime” Enti Rregullator i Ujit, neni 7.

-Kur ka kaluar jetëgjatësinë e tij sipas përcaktimeve në VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, pjesa

e dytë “Sistemi i furnizimit me ujë” pika 2, nënpika 2.7 “Ujëmatësit”, paragrafi 5 ku parashikohet se: “*Jetëgjatësia e një ujëmatësi është 7-10 vjet, kështu konsumatori në bashkëpunim me ndërmarrjen do ta ndërrojë atë kundrejt pagesës për shërbimin e kryer nga ana e shoqërisë. Shoqëria e njofton konsumatorin një muaj më parë duke u bazuar tek lista e ujëmatësve që ajo harton dhe rifreskon nëpërmjet zyrës së faturimeve dhe arkëtimeve në vite. Në këto raste UKT ka detyrimin të njoftojë konsumatorin 30 ditë para demontimit të ujëmatësit.*

-Kur ka dyshime të arsyeshme se ujëmatësi nuk funksionon, si duket dhe nga rezultati i verifikimit që kryen subjekti i autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, rezulton se matësi nuk kryen funksionet e tij, sipas përcaktimeve në Vendimin nr. 8, datë 04.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip” ndryshuar me Vendimet nr. 15, datë 09.06.2014 “Për zbatimin e kontratës model te miratuar nga KKRR për të gjithë klientët e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe me Vendimin nr. 25, datë 08.07.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën model të shërbimeve ujësjellës kanalizime” Enti Rregullator i Ujit, neni 7.

Detyrimi dhe procedurat për sigurimin, vendosjen, zëvendësimin, verifikimin fillestar, periodik dhe rastet e verifikimit të jashtëzakonshëm të ujëmatësit (kur konsumatori ka ankesë për funksionimin e tij) përcaktohen në Vendimin nr. 8, datë 04.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip” ndryshuar me Vendimet nr. 15, datë 09.06.2014 “Për zbatimin e kontratës model te miratuar nga KKRR për të gjithë klientët e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe me Vendimin nr. 25, datë 08.07.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën model të shërbimeve ujësjellës kanalizime” të Entit Rregullator i Ujit, neni 7 ku shprehimisht përcaktohet:

NENI 7 “Ujëmatësit”

- 1. Operatori duhet të instalojë ujëmatësin për çdo Konsumator sipas legjislacionit në fuqi.*
- 2. Operatori detyrohet të furnizoje, të instalojë, të mbikëqyrë dhe të zëvendësojë ujëmatësin.*
- 3. Operatori merr masat e nevojshme për cilësinë dhe funksionimin e ujëmatësit sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Operatori është përgjegjës për jetëgjatësinë e ujëmatësit sipas kësaj kontrate.*
- 4. Konsumatori detyrohet për shpenzimet e furnizimit dhe të instalimit të ujëmatësit sipas faturës që jepet nga Operatori.*
- 5. Operatori duhet të njoftojë një muaj përpara Konsumatorin për zëvendësimin e ujëmatësit në fund të jetëgjatësisë së tij, sipas listës së ujëmatësve që ka hartuar vetë Operatori.*
- 6. Operatori që ofron shërbimin e furnizimit me ujë ka përgjegjësinë ligjore të bëjë të mundur kryerjen e verifikimit periodik për matësit e ujit nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar nga kjo e fundit, sipas legjislacionit shqiptar për metrologjinë.*
 - b. Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë që Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar të kryejë një testim të jashtëzakonshëm të matësit në përdorim dhe të hartojë një raport testimi, kur dyshohet për një funksionim jo korrekt të matësit. Operatori e njofton Konsumatorin me shkrim për përfundimin e procedurave të verifikimit.*
 - c. Kostot që dalin gjatë testimit të jashtëzakonshëm të matësit do të paguhet nga:*
 - I. Kërkuesi, në rastin kur matësi ka shenjë të verifikimit të vlefshme dhe nga testimi rezulton në përputhje me kërkesat metrologjike;*
 - II. Përdoruesi i matësit, kur nga testimi rezulton jo në përputhje me kërkesat metrologjike.*
 - ç. Nëse vërtetohet se ujëmatësi nuk ka funksionuar si duhet për arsye teknike dhe si pasojë vlerësimi i sasisë së ujit të konsumuar është bërë mbi bazën e leximeve të pasakta, Operatori*

është përgjegjës për vlerën e faturës së fundit tatimore. Nëse vërtetohet se ujëmatësi funksionon si duhet, Konsumatori detyrohet për vlerën e faturës së fundit tatimore."

7. Nëse ujëmatësi dëmtohet pa dashje nga Konsumatori apo si pasoje e kushteve atmosferike, Konsumatori duhet të njoftojë Operatorin brenda 5 ditëve. Operatori regjistron raportimin dhe i jep Konsumatorit një konfirmim zyrtar me shkrim me datën e raportimit dhe datën kur ka ndodhur dëmtimi.

a. Operatori duhet të marrë masa që të zëvendësojë ujëmatësin brenda 30 ditëve nga data e raportimit.

b. Konsumatori që nuk njofton Operatorin brenda 5 ditëve detyrohet të paguajë:

i. Konsumatori Jo familjar - pesëfishin e vlerës së faturës tatimore të muajit të fundit;

ii. Konsumatori Familjar - dyfishin e vlerës së faturës tatimore të muajit të fundit.

c. Shpenzimet për heqjen, rivendosjen ose zëvendësimin e ujëmatësit janë përgjegjësi e Konsumatorit në rastet e dëmtimit pa dashje.

8. Konsumi i ujit gjatë kohës që mungon ujëmatësi do të llogaritet sipas konsumit mesatar mujor të llogaritur gjatë 12 muajve të fundit nga momenti i mungesës së matësit.

VKM nr. 96, datë 21.2.2007 "Për disa ndryshime në VKM nr. 236, datë 10.5.1993 "Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë" pika 3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Konsumatorët jofamiljarë, shtetërorë ose privatë, që furnizohen me ujë të pijshëm, i sigurojnë, administrojnë dhe ruajnë vetë matësit e ujit. Në rast dëmtimi konsumatori jofamiljar duhet të njoftojë, me shkrim, ndërmarrjen e ujësjellësit dhe të marrë masa për ta zëvendësuar matësin e ujit, brenda 30 ditëve. Pagesa e konsumit të ujit për këtë periudhë bëhet në bazë të normave të konsumit mesatar mujor të konsumatorit. Nëse ndërmarrja e ujësjellësit nuk njoftohet për dëmtimin e matësit ose matësi nuk vendoset brenda afatit të caktuar, konsumatori (jofamiljar) detyrohet të paguajë konsumin mesatar të ujit me 5-fishin e çmimit".

Detyrimi financiar për verifikimin/ kolaudimin periodik të ujëmatësit është i Shoqërisë "UKT" SHA bazuar në nenin 26 pika 3 të Ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008 "Për metrologjinë" (i shfuqizuar) dhe në Ligjin nr. 126/2020 "Për metrologjinë", neni 25.

Në opinionin e grupit të auditimit, Shoqëria "UKT" SHA duhet të përgatiste vlerësimin ekonomik, i cili duhet të kishte marrë në konsideratë të gjitha kostot afatgjata dhe përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, duke përfshirë gjithashtu edhe formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhej/përzgjidhet, e cila duhet të jetë ekonomikisht më efektive dhe me afatin kohor më të përshtatshëm për implementimin e këtij sistemi matjeje.

Në bazë të vlerësimit ekonomik të përcaktuar si më sipër Shoqëria, duhet të kishte propozuar në ERU ndryshimet përkatëse ligjore dhe rregullatore, si dhe mbas miratimit të tyre duhet të përgatiste një kalendar për implementimin brenda një periudhë 10-vjeçare të sistemeve inteligjente të matjes.

ERU duhet të sigurojë/siguroj ndërveprimin e sistemeve të ndryshme matëse, që do të implementohen në të gjithë territorin e vendi.

2. Proçedura e prokurimit me objekt "Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike", viti 2021.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike"		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 648 prot, datë14.01.2021	3. Njësia e prokurimit Urdhër 648 prot, datë14.01.2021 -A.Q; juriste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 648 prot, datë14.01.2021 -L.R; juriste

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin monetra”	- I.G; inxhinjer mekanik -A.Q; ing.eletronik	- E.O; ing.mjedisi -F.V; jurist
5. Fondi Limit (pa tvsh) 999,800,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 989,172,392 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 10,627,608 leke
8. Data e hapjes së tenderit 08.03.2021	9. Burimi Financimit Fond nga te ardhurat e shoqerise	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 5 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 4 OE
11. Ankimime- E G” shpk	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik -
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 648/163 prot., datë 16.04.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 1,187,006,870 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.)të A.P.P, u konstatua se:

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 257, datë 30.07.2020 është ngritur grupi i punës për hartimin e detyrës së projektimit të objektit “Shërbime të projektuara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”, i përbërë nga A.Q, E.I, L.G, D.Q, A.K dhe E.B.

Me shkresën nr. 2284 datë 20.07.2020 Drejtori i Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse F.V i drejtohet O.DH me detyrë Drejtor i Departamentit Inxhinjerik, për dijeni Drejtorit të Përgjithshëm, i kërkon hartimin e projektit dhe preventivit për “Ndërtimin e sistemit të survejimit dhe monitorimit me sisteme të integruara të sigurisë me pajisje elektronike”.

Me shkresën nr. 2284/1 prot., datë 17.08.2020, O.DH me detyrë Drejtori i Departamentit Inxhinjerik i drejtohet Drejtorisë së Prokurimeve (sektori i blerjeve të vogla) i kërkon informacion mbi çmimet sipas 3 ofertave të ndryshme, për 51 zëra të cilat nuk disponohen në buletin e çmimeve, duke përfshirë dhe “Kabinet metalik +transformator 220 v 5 A”.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 272, datë 21.09.2020, është ngritur grupi i punës për testimin e tregut për zërat e preventivit të projektit “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”, i përbërë nga A.K, E.C dhe A.S.

Me shkresën nr. 2284/2 prot., datë 24.08.2020 A.K me detyrë përgjegjës i sektorit të blerjeve me vlera të vogla kthen përgjigje O.DH me detyrë Drejtori i Departamentit Inxhinjerik, pas testimit të tregut në disa kompani të certifikuar për këto zëra po ju dërgojmë 3 oferta për materialet me çmimet përkatëse për njësi.

Me shkresën nr. 2284/3 prot., datë 09.10.2020, projekti dhe preventivi për “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike Tiranë 2020, i firmosur nga grupi i punës i përbërë nga A.Q, E.I, L.G, D.Q, A.K dhe E.B. Detyra e projektimit është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Me shkresën nr. 4237/1 prot., datë 14.07.2020, relacioni për vlerësimin e kostos së shërbimit survejim me monitorim të sistemeve të integruara të sigurisë, me pajisje elektronike, në raport me ruajtjen e objekteve me roje fizike”. Ky grup ka propozuar: T’i kërkohej departamentit inxhinjerik hartimi i projektit dhe preventivit për instalimin e sistemit të survejimit dhe monitorimit të sistemeve të integruara të sigurisë me pajisje elektronike (me kamera) të objekteve të UKT. Vetëm pas hartimit të projektit, grupi i punës mund të vijojë në analizën tekniko-ekonomike dhe nxjerrjen e përfitimeve nga ky shërbim.

Me shkresën nr. 2284/3 prot., datë 09.10.2020 Drejtori i Departamentit Inxhinjerik, O.DH dhe Drejtori i Përgjithshëm ka miratuar projektin “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”.

Me shkresën nr. 2284/4 prot., datë 09.10.2020 Drejtori i Departamentit inxhinjerik O.DH i ka dërguar F.V me detyrë drejtor i departamentit të Shërbimeve Mbështetëse projekt-preventivin e zbatimi të objektit “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”, ku ndër të tjera është shprehur “Objekti është shqyrtuar dhe miratuar në Këshillin Tekniko-Ekonomik të shoqërisë UKT sh.a me nr. 30, datë 09.10.2020” . Objekti do të pajiset me oponencë nga Instituti i Ndërtimit referuar VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit. Dosja e zbatimit të objektit: Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike” shoqërohet:

-Projekt-preventivin e plot, relacioni teknik, specifikimet teknike, vendimin e Këshillit Tekniko Ekonomik, CD.

Projekti është hartuar nga UKT, A.Q, S Ç, K.A, E.Ç, E.P dhe R D, po ashtu dhe preventivi në vlerën 581,938,537 lekë. Punimet janë projektuar dhe preventivuar me inxhinier pa pasur zotësinë profesionale (teknike dhe ligjore) për të projektuar pasi nuk kanë pasur licencat profesionale përkatëse të miratuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 759, datë 12.11.2014 ‘Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’, e ndryshuar, pika 1 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “1. Çdo individ apo subjekt juridik, që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, duhet të pajiset me licencën profesionale përkatëse sipas përcaktimeve të rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale, bashkëlidhur këtij vendimi”.

Neni 16/1 “Licenca – kategoritë e punimeve”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të tij të ushtrojë veprimtari të caktuar profesionale sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim duke u mbështetur kryesisht në profilin e diplomës së arsimit të lartë, vitet e eksperiencës, eksperiencën në punë, kushtet e kriteret e përcaktuara në këtë rregullore”.

Neni 2/2 “Përkufizimi i termave” “Licencë profesionale” dokument me të cilin pajiset çdo individ ose subjekt juridik vendas ose i huaj që dëshiron të ushtrojë profesionalisht studimin dhe/ose projektimin dhe mbikëqyrjen dhe/ose kolaudimin në fushën e ndërtimit”.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi O.D me detyrë ish-Drejtor i Departamentit Inxhinjerik .

Me shkresën nr. 2284/5 prot., datë 12.10.2020, E.V me detyrë drejtor i departamentit të Shërbimeve Mbështetëse i vë në dispozicion grupit të punës të përbërë nga A. Xh, K. T, E. I, L.S dhe S.S, projektin dhe preventivin për “Shërbime te integruara dhe furnizim vendosje te pajisjeve elektronike”.

Me memo nr. 3912 prot., datë 04.12.2020 A.P i është drejtuar L.R, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve (e cila nuk e ka firmosur këtë Memo, miratuar nga E.K me detyrë drejtor i përgjithshëm, nëpërmjet F.V me detyrë Drejtor i Departamenti të Shërbimeve Mbështetëse (i cili nuk e ka firmosur këtë memo), ku është shprehur “Dërgim dokumentacioni i përgatitur nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 237, datë 07.07.2020 dhe nga Departamenti Inxhinjerik.

Me memo nr. 2059 prot., datë 02.07.2020, F.V me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, E.T me detyrë Drejtor i Departamentit të Shitjes, K.L me detyrë Drejtor i Departamentit të Prodhim Shpërndarjes dhe O.DH me detyrë Drejtor i Departamentit Inxhinjerik i është drejtuar Drejtorit të

Përgjithshëm dhe për dijeni E.G me detyrë zv/Drejtor i Përgjithshëm për çështjet administrative, ku i argumentojnë nevojën e investimit për këtë shërbim. Ku ndër të tjera është shprehur se “UKT” ka rreth 230 objekte, që janë objektet të rëndësishme, për të cilat garantohet ruajtje 24 orë nga shërbime të specializuara. Kostoja e ruajtjes është shumë e lartë, vetëm për vitin 2020 janë planifikuar 596 milion lekë.

Vendimi i Këshillit Tekniko Ekonomik nr. 30, datë 09.10.2020 ka vendosur “Të miratoj në parim nga ana teknike projekt preventivin e objektit “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”, me vlerë totale 484,948,781 lekë pa tvsh ose më tvsh 581,938,537 lekë.

- Në dokumentet e tenderit dhe në kontratë, zëri mirëmbajta nuk është i specifikuar për vlerën përkatëse, si dhe nuk është hartuar plani i mirëmbajtës.

Në nenin 8 të kontratës “Detyrimet e veçanta të kontraktuesit”, pika 8.3 është planifikuar “Kontraktuesi duhet të siguroj raportet e lidhura me zbatimin e punëve, shërbimeve siç kërkohet në kontratë”.

Ndërsa në zbatim për çdo muaj është hartuar akt kolaudimi dhe procesverbali i marrjes në dorëzim. Konkretisht për muajin janar 2022. Aktkolaudimi me nr. 4119/3 prot., datë 20.10.2022 i firmosur nga “P ” Shpk dhe grupi i marrjes në dorëzim R.L, D.Q dhe E.Q “ Ku është shprehur “Grupi i kolaudimit u njohë me kontratën të kolaudojë dhe të marr në dorëzim shërbimin e kryer sipas faturës nr.8/2022, datë 20.01.2022 (bashkëlidhur) është në përputhje me kërkesat e paraqitura në kontratë dhe në specifikimet teknike sipas kontratës. Operatori “P ” Shpk ka kryer shërbimin sipas dokumenteve bashkëngjitur”. Procesverbal me nr. 1012 prot., datë 20.01.2022 i firmosur I.H dhe grupi i punës R.L, D.Q dhe E.Q, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Shpk “P ” Shpk për periudhën 15.12.2021-15.01.22 ka realizua me sukses monitorimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të sigurisë për 76 objekte sipas kontratës dhe termave të referencës”, por nuk cilëson çfarë mirëmbajta ka bërë specifikisht. Po ashtu dhe për dy operatorët e tjerë “E.S.

Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e M F nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 23 gërma g, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Masat që duhet të ndërmerren në raport me riskun për kufizimin e humbjeve financiare, mund të përfshijnë:*

g) Mirëmbajtja e planifikuar. Aktivitet afatgjatë materiale duhen mbikëqyrur rregullisht në drejtim të jetëgjatësisë së pjesëve përbërëse të tyre (p.sh. çatisë, sistemit të ngrohjes, etj.). Në një program mirëmbajtjeje të planifikuar, ky informacion përdoret për t'i orientuar shpenzimet drejt punës parandaluese sesa drejt riparimit të avarive. Çdo njësi publike duhet të hartojë planin e mirëmbajtjes së aktiveve me qëllim planifikimin e fondeve të nevojshme, si dhe sigurimin e efikasitetit në përdorimin e aktiveve”.

Pika 34. Ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike, si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi”.

Me shkresën nr. 237/2 prot., datë 15.10.2020 grupi i punës i përbërë A.Xh, K.T, E.I, L.S dhe S.S, i relatton Drejtorit të Përgjithshëm, relacionin i cili miratohet prej tij “Për vlerësimin e kostos së shërbimit me survejim e monitorim të sistemeve të integruara të sigurisë, me pajisje elektronike, në raport me ruajtjen e objekteve fizike” Projektin dhe preventivin për “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”. Llogaritja e vlerës për mirëmbajtje dhe monitorim i sistemit të sigurisë është bërë në vlerën 514,851,219 lekë duke marr mesataren e tre ofertave, pas ofertës në çmim më të ulët nga operatorët “P S” Shpk në vlerën 72,099

lekë/muaj, “G S” Shpk në vlerën 72,000 lekë, “I ” Shpk në vlerën 71,500/muaj. Vlera gjithsej 199 x 36 muaj x 71,866.45 lekë/muaj (çmimi mesatar) = 514,851,219 lekë.

Në këtë relacion në pikën 2 “Kosto shërbim në një objekt lekë pa tvsh, 80,000 lekë në muaj, nga këto: 60,000 lekë survejim që i takon 75 % të vlerës dhe 20,000 lekë mirëmbajtjeje që i takon 25 % të vlerës. Nga grupi i punës nuk është dhënë asnjë referencë për këto vlera.

Me shkresën nr. 2753/2 prot., datë 04.12.2020 Instituti i Ndërtimit i ka dërguar opionencën teknike UK Tiranë, për projektin e zbatimit me konkludimin “Projekti plotëson kushtet teknike, konkluzionet e dhëna në këtë opionencë teknike të plotësohen gjatë zbatimit të punimeve”.

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 648 prot., datë 14.01.2021 është urdhëruar të kryhet prokurimi i fondit 999,800,000 lekë pa tvsh, lloji i procedurës së prokurimit “E hapur mbi kufirin monetar”, njësia e prokurimit A.Q, I.G dhe A.Q.

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 648/1 prot., datë 14.01.2021 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përberë nga L.R me profesion juriste, O.DH me profesion inxhinier hidro dhe F.V me profesin jurist ku është përcaktuar vlera 999,800,000 lekë pa tvsh lekë.

Me procesverbal me nr. 648/1 prot., datë 14.01.2021 njësia e prokurimit ka miratuar dokumentet e tenderit (kërkesat për kualifikim dhe argumentimi i tyre,), data e dorëzimit të ofertave është përcaktuar datë 02.03.2021 ora 10.00.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës është bërë me shkresën nr. 648/3 prot., datë 14.01.2021 nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, duke përcaktuar si afat të fundit të paraqitjes së ofertave datë 02.03.2021 ora 10.00 dhe me shkresën nr. 648/4 prot., datë 14.01.2021 në gjuhën angleze dhe është bërë aktive në SPP në 14.01.2021 dhe është publikuar në Buletinin e APP nr. 8, datë 18.01.2021.

Me urdhër nr. 648/5., datë 21.01.2021 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për arsye të ankesës së operatorit ekonomik “E G” shpk me nr. 20 prot., datë 21.01.2021 , ankesë që ka të bëjë me përcaktimin e kërkesave për kualifikim.

Me urdhër nr. 648/6., datë 21.01.2021 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës të operatorit ekonomik “E G” shpk, i përberë nga L.R, O.DH dhe F.V.

Me shkresën nr. 648/7, datë 25.01.2021 komisioni informon Titullarin e Autoritetit kontraktor, se pretendimi nuk qëndron.

Me shkresën nr. 1062/1 prot, datë 26.01.2021, njoftohet operatori ekonomik “E G” shpk se pretendimi nuk qëndron, për pasojë nuk është marr në konsideratë.

Me urdhër nr. 648/8., datë 08.02.2021 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, hiqet pezullimi i procedurës së prokurimit.

Me procesverbal datë 08.02.2021 njësia e prokurimit ka bërë argumentimin e sugjerimeve të APP në përcaktimin e kërkesave për kualifikim.

Me shtojcën, nga njësia e prokurimit afati i dorëzimit të ofertave nga data 02.03.2021 ora 10.00 në datën 08.03.2021 ora 10.00.

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 648/9 prot., datë 12.12.2021 ka ndryshuar komisioni i vlerësimit, dhe përbehet nga L.R me profesion juriste, E.O me profesion inxhinier dhe F.V me profesion jurist.

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues bashkimi i operatorëve “P ” Shpk & “G ” & “E ” & “E” shpk “E” në vlerën 989,172,392 lekë pa TVSH.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit, është hartuar me nr. 648/9 prot., datë 12.12.2021, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Në datën 30.03.2021 në S.P.E. e A.P.P, është kryer njoftimi i fituesit, nga ku A.P.P e ka bërë aktive publikimin e njoftimit të fituesit në datën 30.03.2021, publikuar me Buletinin e APP nr. 49, datë 06.04.2021.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomik si më poshtë vijon:

-Operatori ekonomik "F S" sh.p.k, i cili nuk ka paraqitur asnjë dokument, përveç bilancit te vitit 2018, as dhe ofertë ekonomike;

- Bashkimi i operatorëve "G S" sh.p.k & E S sh.p.k & "E" sh.p.k & "PC S" sh.p.k & "E" sh.p.k në vlerën 989.172.392 lekë.

Referuar të dhënave si më sipër disa nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, ndonëse paraqesin oferta për vlerësimin e tregut secila më vehte, në procesin e realizimit të procedurës marrin pjesë si bashkim operatorësh ekonomike, duke bërë të mundur mospasjen e konkurrencës në tender. Kështu, nga 5 operatorë ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë, 4 janë paraqitur bashkërisht ndërsa njëri ka paraqitur vetëm një dokument.

Veprim në kundërshtim me;

- Ligjin nr. 9121, datë 28. 07. 2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar, neni 4 "Marrëveshjet e ndaluara", pika 1/a ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "*Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që: a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi*".

-Ligjin nr. 9643, dt. 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i cili ka për objekt përcaktimin e rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore dhe fokusohet në rregullimin e procedurave të prokurimit publik në mënyrë të atillë që këto procedura të jenë sa më eficente dhe efikase; fondet publike të përdoren sa më mirë që të jetë e mundur; pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë të jetë sa më e madhe dhe të ketë konkurrencë midis tyre, si dhe trajtimi i tyre të jetë i barabartë dhe jo diskriminues, etj (neni 1 dhe 2 i ligjit).

Ligji "Për prokurimin publik" përcakton si të drejtat ashtu edhe detyrimet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit publik, respektimi dhe përmbushja e të cilave duhet të bëhet objekt shqyrtimi nga institucionet kompetente të përcaktuara në këtë ligj.

Konkluzioni:

Referuar sa më sipër vërtetohet katërçipërisht se operatorët ekonomik, kanë përdorur skemën e marrëveshjeve te ndaluara duke rënë dakord që me përpara që të mos paraqiten secili më vehte në procesin e prokurimit, por të gjithë së bashku, si bashkim operatorësh.

Për të maksimizuar e efijencën, nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës në procedurat e shërbimeve të integruara, nisur nga problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të kontratave, kjo situatë duhet ti ishte bërë prezent Autoritetit të Konkurrencës për ushtrimin e kompetencave të tyre.

Kontrata është lidhur me nr. 648/163 prot., datë 16.04.2021 ndërmjet UKT përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe bashkimit të operatorit/e shoqërisë "P S" Shpk & "G S" & "E S" & "E" shpk & "E" në vlerën 1,187,006,870 lekë, me afat ekzekutimi 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës, me garanci të objektit për 24 muaj nga data e marrjes në dorëzim të objektit", në nenin 15 të kontratës "Afatet e pagesës" është përcaktuar: pika 15.6. Pagesa do të bëhet në llogarinë e kontraktuesit përkatësisht "P S" pranë R.B. Pika 15.7; Burimi i financimit të ardhurave e UKT Sh.a vënë në dispozicion sipas projektbuxhetit nr. 18016/2 pro., datë 29.10.2020.

Kontrata ka të përcaktuar vlerën në vlerën 989,172,392 lekë pa TVSH dhe 1,187,006,870 lekë me TVSH .

Në preventiv dhe situacion për 211 objekte është përfshirë zëri “Instalimi i sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit” në vlerën 49,042,692 lekë me TVSH (vlerë e situacionuar për 211 objekte).

Investimi në qendrën e monitorimit (Zyrat Qëndrore UKT) instalimi i sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit është në vlerën 54,360,240 lekë me TVSH.

Në total vlera për instalimin e sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit është 103,402,932 lekë (49,042,692 + 54,360,240 = 103,402,932).

Duke marr në konsideratë:

-Investimin e bërë për punime rrethimi depo & punime për furnizimin me energji & ndërtim sistem alarm+kamera në vlerën 522,237,830 lekë me TVSH në vlerat respektive 140,407,914 lekë, 46,612,456 lekë dhe 335,253,459 lekë.

-Vlerën 103,402,932 lekë për instalimin i sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit.

-Personelin e disponueshëm të UKT, pasi në strukturë organizative të shoqërisë është Sektori Call Centër me 9 punonjës në organik, dispeçeria 5 punonjës, IT me personel 8, drejtues mjeti 56, punonjës të taks forcës 31, si dhe automjete 42 autovetura, 30 motor 36 minifugon.

-Zbatimin e VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”, SHTOJCA VI “ZONAT E MBROJTJES SANITARE”. Pika 2. Mbrojtja sanitare e burimeve të ujërave nëntokësore (Për furnizim publik ose individual) ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Mbrojtja e saj me roje të armatosur sigurohet nga administratori i ujësjellësit”.

Investimi nuk është maksimalizuar me efektivitet të plotë në përputhje me qëllimin e tij.

Deri datë 02.10.2022 që përfundon auditimi, monitorimi (survejimi) kryhet nga bashkimi i operatorit/e shoqërisë “P ” Shpk & “G S” & “E S” & “E” shpk & “E” me aktmarrëveshje nr. 869 repertori, nr. 284 koleksioni datë 03.03.2021. Konkretisht referuar kësaj aktmarrëveshje 77 objekte ose 38.6 % i monitoron (survejon) dhe mirëmban shoqëria “P ” Shpk”, 77 objekte ose 38.6 % i monitoron (survejon) dhe mirëmban shoqëria “G S” Shpk”, 45 objekte ose 22,62 % i monitoron (survejon) dhe mirëmban shoqëria “E S” shpk.

Përsëri në mbarim të afatit 3-vjeçar, edhe pse është shpenzuar për mirëmbajtje dhe monitorim vlera 610,372,800 lekë me TVSH do të kërkohet dhe po kjo vlerë për të kryer këtë shërbim, duke ç vlerësuar në këtë mënyrë investimin e bërë në vlerën 576,634,070 lekë.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur si më sipër ngarkon me përgjegjësi O.D me detyrë ish-drejtor i Departamentit Inxhinjerik, E.O me detyrë drejtor i Departamentit Inxhinjerik .

Zbatimi i kontratës

Atkkollaudimi është mbajtur datë 07.12.2021 i firmosur nga E.O me detyrë drejtor i Departamentit Inxhinjerik, A.M me detyrë përgjegjëse e sektorit të projektimit, E me detyrë përgjegjëse e sektorit të menaxhimit dhe koordinimit të projekteve, L S me detyrë specialist sektori i IT. Të gjitha anëtarët e grupit të kollaudimit janë të pa pajisur me licencë përkatëse për kollaudimin e punimeve. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 759, datë 12.11.2014 ‘Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kollaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’, e ndryshuar, pika 1 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “1. Çdo individ apo subjekt juridik, që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kollaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, duhet të pajiset me licencën profesionale përkatëse sipas përcaktimeve të rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale, bashkëlidhur këtij vendimi”.

Neni 16/1 “Licenca – kategoritë e punimeve”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të tij të ushtrrojë veprimtari të caktuar profesionale sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim duke u mbështetur kryesisht në profilin e diplomës së arsimit të lartë, vitet e eksperiencës, eksperiencën në punë, kushtet e kriteret e përcaktuara në këtë rregullore”.

Neni 2/2 “Përkufizimi i termave” “Licencë profesionale” - dokument me të cilin pajiset çdo individ ose subjekt juridik vendas ose i huaj që dëshiron të ushtrrojë profesionalisht studimin dhe/ose projektimin dhe mbikëqyrjen dhe/ose kolaudimin në fushën e ndërtimit”.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi E.O me detyrë drejtor i departamentit inxhinierik.

Likuidimet

Me urdhër transfertë datë 06.04.2020 nëpërmjet R është likuiduar Shoqëria “P S” Shpk për vlerën 31,000,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura elektronike nr. 78, datë 15.12.2021 në vlerën 490,022,556 lekë me përshkrimin e malli ose shërbimit “Furnizim vendosje sipas situacionit përfundimtar”.

Me urdhër transfertë datë 07.04.2022 nëpërmjet R B është likuiduar Shoqëria “P S” Shpk për vlerën 9,000,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura elektronike nr. 78, datë 15.12.2021 në vlerën 490,022,556 lekë me përshkrimin e malli ose shërbimit “Furnizim vendosje sipas situacionit përfundimtar”.

Me urdhër transfertë pa datë nëpërmjet T është likuiduar Shoqëria “PC S” Shpk për vlerën 16,000,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura elektronike nr. 78, datë 15.12.2021 në vlerën 490,022,556 lekë me përshkrimin e malli ose shërbimit “Furnizim vendosje sipas situacionit përfundimtar”.

Me urdhër transfertë datë 08.04.2022 nëpërmjet R B është likuiduar Shoqëria “PC” Shpk për vlerën 4,000,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura elektronike nr. 78, datë 15.12.2021 në vlerën 490,022,556 lekë me përshkrimin e malli ose shërbimit ”Furnizim vendosje sipas situacionit përfundimtar”.

Me urdhër transfertë datë 08.02.2022 nëpërmjet R B është likuiduar Shoqëria “P S” Shpk për vlerën 30,000,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura elektronike nr. 78, datë 15.12.2021 në vlerën 490,022,556 lekë me përshkrimin e malli ose shërbimit “Furnizim vendosje sipas situacionit përfundimtar”.

Me urdhër transfertë datë 08.02.2022 nëpërmjet R B është likuiduar Shoqëria “P S” Shpk për vlerën 30,000,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura elektronike nr. 78, datë 15.12.2021 në vlerën 490,022,556 lekë me përshkrimin e malli ose shërbimit “Furnizim vendosje sipas situacionit përfundimtar”.

Me urdhër transfertë datë 07.01.2022 nëpërmjet R B është likuiduar Shoqëria “P S” Shpk për vlerën 3,000,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura elektronike nr. 78, datë 15.12.2021 në vlerën 490,022,556 lekë me përshkrimin e malli ose shërbimit ”furnizim vendosje sipas situacionit përfundimtar”.

Me urdhër transfertë datë 07.01.2022 nëpërmjet R B është likuiduar Shoqëria “P S” Shpk për vlerën 17,000,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura elektronike nr. 78, datë 15.12.2021 në vlerën 490,022,556 lekë me përshkrimin e malli ose shërbimit “Furnizim vendosje sipas situacionit përfundimtar”.

Me urdhër transfertë datë 31.12.2021 nëpërmjet R B është likuiduar Shoqëria “P S” Shpk për vlerën 10,000,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura elektronike nr. 78, datë 15.12.2021 në vlerën 490,022,556 lekë me përshkrimin e malli ose shërbimit “Furnizim vendosje sipas situacionit përfundimtar”.

Me urdhër transfertë datë 9.11.2021 nëpërmjet R B është likuiduar Shoqëria “P S” Shpk për vlerën 37,676,480 lekë. Dokumenti justifikues fatura elektronike nr. 49, datë 08.09.2021 në vlerën 72,176,262 lekë me përshkrimin e malli ose shërbimit “Furnizim vendosje” sipas situacionit nr.1.

3. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje elektropompa”, viti 2019.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Blerje elektropompa”, viti 2019”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. nr. 28,689 prot., datë 13.12.2019	3. Njësia e prokurimit nr. 28,689 prot., datë 13.12.2019 -A.Q; juriste - A.S; inxhinjer mekanik -K T; ekonomist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 20469/1 datë 15.11.2021 -L.R; juriste -F.V; ekonomist -E.T; ekonomist
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur-marrëveshje kuader”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 12,352,566 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 9,881,799 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,470,767 leke
8. Data e hapjes së tenderit 22.09.2021	9. Burimi Financimit Fond nga Te ardhurat e shoqerise	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>7</u> OE b) S’kualifikuar <u>1</u> OE, c) Kualifikuar <u>6</u> OE
11. Ankimime N”, “2” Shpk	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik -
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës 28,689/27 prot., datë 03.08.2020	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 14,383,998 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me kërkesën nr. 4636 prot., datë 13.12.2019, OD me detyrë Drejtori i D I i është drejtuar Drejtorisë së Prokurimeve, për dijëni Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me kërkesë për blerje elektropompa.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 459prot., datë 25.11.2019, është ngritur grupi i punës për të përlloritur vlerën e kontratës (testimin e tregut) dhe specifikimeve teknike i përbërë nga D M, E.Ç me profesion inxhinier dhe A.A me profesion inxhinier.

Me dokument (relacion) të protokolluar nr. 4459/1 prot., datës 04.12.2019 i grupi i punës ka përlloritur vlerën e kontratës 14,596,911 lekë. Përlloraritja e vlerës së kontratës është përcaktuar, pas çmimit mesatar zë për zë (pompat) ofruara nga operatorët “W” Shpk, “A ” Shpk, “A V” Shpk.

Nga grupi i punës për llogaritjen e vlerës së kontratës, nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë shoqëria n.q.s ka, ose i ujësjellësit e tjerë, si dhe pse një numër kaq i kufizuar operatorësh, pra pse tre dhe jo mbi pesë.

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përlloraritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: Çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera

kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Si konkluzion, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme, çmimet e realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, ujësjellësve të tjerë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2,

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi ngritur grupi i punës për të përlllogaritur vlerën e kontratës (testimin e tregut) dhe specifikimeve teknike i përbërë nga D.M, E.Ç dhe A.A.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 28,689 prot., datë 13.12.2019, është përcaktuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur-marrëveshje kuadër”, me vlerë 14,596,911 lekë, njësia e prokurimit e përbërë nga A.Q me profesion juriste, A.S me profesion inxhinier mekanik dhe K.T me profesion ekonomist.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 28,689/1 prot., datë 13.12.2019, është ngritur komision të vlerësimit të ofertave i përbërë nga L.R me profesion juriste/kimist me detyrë drejtor i departamentit ligjor dhe prokurimeve, F.V me profesion jurist, E.T me profesion ekonomist.

Kërkesat për kualifikim dhe kriteri i vlerësimit janë miratuar me procesverbalin e datës 13.12.2019 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga A.Q, A.S me K.T.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës është bërë me shkresën nr. 28,689/3, datë 13.12.2019 nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, publikuar nga APP në buletin nr. 51, datë 23.12.2019, duke përcaktuar si afat të fundit të paraqitjes së ofertave datë 08.01.2019 ora 11.00.

Me kërkesën nr. K-3259 prot., datë 20.12.2019 operatori ekonomik “A” shp, ka kërkuar të përcaktohet ndryshim i dokumenteve të tenderimit, konkretisht përcaktimi i seksionit të fllanxhave për secilën pompë.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 28,689/4 prot., datë 20.12.2019, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit për shqyrtimin e ankesës së bërë nga operatori ekonomik “A” Shpk.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 28,689/5 prot., datë 20.12.2019, është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës së bërë nga D.M, E.Ç dhe A.A.

Me relacion nr. 28,689/6 prot., datë 24.12.2019 komisioni i shqyrtimit të ankesës informon E.G me detyrë zv/Drejtor i Përgjithshëm duke mos marr në konsideratë ankesën.

Me shkresën nr. K3259/1 prot., datë 24.12.2019 E G i drejtohet operatorit ekonomik “A” shpk, duke e informuar mos marrjen në konsideratë ankesën.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 28,689/7 prot., datë 20.12.2019 është hequr pezullimi i ankesës.

Është bërë ndryshimi i dokumenteve të tenderit me shtojcën datë 06.11.2019, ku është përcaktuar se dorëzimi i ofertave do të bëhet datë 24.01.2020 ora 9.00.

Nga njësia e prokurimit nuk është kërkuar:

-Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë sanitare të lëshuara nga institucione të akredituara që vërteton se elektropompat dhe elektromotorët se bashku me kabllin janë të lejuara për pompim uji të pijshëm.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët operatorë ekonomike.

-Shoqëria “W” Shpk, me ofertë në vlerën 9,881,799 lekë.

-Shoqëria “N” Shpk, me ofertë në vlerën 11,111,111 lekë.

Shoqëria “A M” Shpk, me ofertë në vlerën 12,226,000 lekë

-Shoqëria “AC” Shpk, me ofertë në vlerën 9,672,555 lekë.

-Shoqëria “AM” Shpk, me ofertë në vlerën 11,341,500 lekë.

-Shoqëria “KC” me ofertë në vlerën 7,440,000 lekë

-Shoqëria “RC” Shpk, me ofertë në vlerën 10,248,200 lekë.

Me shkresën nr. 28,689/8 prot., datë 30.01.2020 komisioni i vlerësimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik “K C” shpk sqarim për ofertën anomalisht të ulët.

Më shkresën nr. 398 prot., datë 10.02.2020 operatorit ekonomik “KC ” shpk ka dërguar analizën e detajuar të ofertës së paraqitur.

Pas vlerësimit të KVO datë 05.02.2020, është skualifikuar “KC”, “N” Shpk.

Me shkresën nr. 3363 prot., datë 07.02.2020, është bërë ankesë nga operatori ekonomik “RC” Shpk, për rivlerësimin e procedurës së prokurimit për tu shpallur fitues.

Me urdhër nr. 28,689/9 prot., datë 07.02.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit.

Me urdhër nr. 28,689/10 prot., datë 07.02.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “RC” Shpk, i përbërë nga A S, A Q dhe K.

Me shkresën nr. 28,689/10 prot., datë 07.02.2020, komisioni i shqyrtimit të ankesës informon Titullarit të Autoritetit Kontraktor, mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik “RC” Shpk.

Me shkresën nr. 3363/1 prot., datë 12.02.2020, i është kthyer përgjigje operatorit ekonomik “RC” mbi vendimin e marrë nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën nr. K-406 prot., datë 11.02.2020, është bërë ankesë nga operatori ekonomik “AM” Shpk, për kualifikimin e operatorit ekonomin “AC” Shpk.

Me shkresën nr. 28,689/12 prot., datë 12.02.2020, komisioni i shqyrtimit të ankesës informon Titullarit të Autoritetit Kontraktor, mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik “K C”.

Me shkresën nr. 3363/1 prot., datë 12.02.2020, i është kthyer përgjigje operatorit ekonomik “K C” mbi vendimin e marrë nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën nr. 28,689/13 prot., datë 14.02.2020, komisioni i shqyrtimit të ankesës informon Titullarit të Autoritetit Kontraktor, mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik “AM)” shpk.

Me shkresën nr. K-406/1 prot., datë 12.02.2020, i është kthyer përgjigje operatorit ekonomik “AM)” shpk mbi vendimin e marrë nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Komisionit i prokurimit publik me vendim nr. 205/1 prot., datë 24.02.2020, ka bërë pezullimin e procedurës së prokurimit, duke kërkuar dokumentacionin e nevojshëm.

Me shkresën nr. K-739/1 prot., datë 02.03.2020 Autoriteti Kontraktor i dërgon Komisionit të Prokurimit Publik, informacionin e kërkuar.

Me shkresën nr. 28,689/14 prot., datë 06.04.2020 Titullari i Autoritetit Kontraktor ka bërë heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit.

Me shkresën nr. 28,689/15 prot., datë 07.04.2020 komisioni i vlerësimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik “K C” Shpk sqarim për ofertën anomalisht të ulët.

Komisionit i Prokurimit Publik me vendim nr. 119/2020 prot, dërguar me shkresën nr.119/1 prot., datë 01.04.2020, ka pranuar kërkesën e operatorit ekonomik “K C”, duke detyruar Autoritetin Kontraktor të zbatoj neni 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006.

Me shkresën nr. K-930/1 prot., datë 07.04.2020 Titullari i Autoritetit Kontraktor ka informuar Komisionit i prokurimit publik, se ka kërkuar nga ky operator sqarim për ofertën anomalisht të ulët.

Më shkresën nr.6505 prot., datë 10.04.2020 (protokoll i UK) operatori ekonomik “K C” shpk ka dërguar analizën e detajuar të ofertës së paraqitur.

Pas rivlerësimit të KVO datë 16.04.2020, është s’kualifikuar “K C”, “N” Shpk dhe shpall fitues Shoqëria “W” Shpk, me ofertë në vlerën 9,881,799 lekë .

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit, është hartuar me nr. 28,689/16 prot., datë 24.04.2020, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën nr. 28,689/17 prot., datë 24.04.2020 është bërë njoftimi i fituesit.

Me shkresën nr. 7209 prot., datë 29.04.2020, si dhe me shkresën K-930/2 prot., datë 27.05.2020 i është kërkuar Komisionit i Prokurimit Publik heqje e procedurës së pezullimit.

Komisionit i Prokurimit Publik me vendim nr. 119/5/2020 prot., dërguar me shkresën nr.1378 prot., datë 04.06.2020, ka bërë heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit

Me shkresën nr. 28,689/18 prot., datë 08.06.2020 u është kërkuar operatorëve ekonomik të kualifikuar “AC” “RC”, “AM”, “W” dhe “A M” depozitimin e dokumentacionit.

Me shkresën nr. 9408 prot., datë 10.06.2020 operatori ekonomik “RC” shpk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar.

Me shkresën nr. 9449 prot., datë 10.06.2020 operatori ekonomik “W” shpk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar.

Me shkresën nr. 9591 prot., datë 12.06.2020 operatori ekonomik “AC” shpk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar.

Me shkresën nr. 9448prot., datë 10.06.2020 operatori ekonomik “A M” shpk ka paraqitur dokumentacionin.

Komisioni i vlerësimit të ofertave më datë 10.06.2020 ka bërë verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomik,

Me shkresën nr. 28,689/19 prot., datë 15.06.2020 është bërë njoftimi i operatorit ekonomik “AMU”, si kandidat i suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër.

Me datë 23.06.2020, me nr. nr. 28,689/20 prot. , është nënshkruar draft marrëveshja kuadër (ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara për punë/mallra/shërbime) ndërmjet UK Tiranë dhe Operatorëve Ekonomik “AC” “RC”, “W” dhe “A M”.

Me shkresën nr. 1984 prot., datë 29.06.2020, E.Ç me detyrë përgjegjës i sektorit të elektromekanikës i është drejtuar Drejtorisë së Prokurimeve , për dijeni Titullarit të Autoritetit Kontraktor, ka bërë kërkesë për lidhje kontrate.

Me shkresën nr. 70 prot., datë 27.06.2020, është bërë ankesë nga operatori ekonomik “A ” Shpk, për përjashtim nga marrëveshja kuadër edhe pse është njoftuar si operatori më i suksesshëm.

Me shkresën nr. 28,689/21 prot., datë 01.07.2020 i kërkohet operatorit ekonomik “AM” Shpk rregullim i formës së ankesës.

Me shkresën nr. K-1674 prot., datë 02.07.2020, operatori ekonomik “AM” Shpk, ka bërë riformulimin e ankesës.

Me shkresën nr. K-1674 /1 prot., datë 02.07.2020, i është kthyer përgjigje operatorit ekonomik “AM” mbi vendimin e marrë nga ana e Autoritetit Kontraktor, duke cilësuar se nuk është njoftuar për lidhjen e marrëveshjes kuadër për shkak të mos dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar.

Me shkresën nr. 28,689/22 prot., datë 13.07.2020 ju bëhet ftesë për ofertë operatorëve ekonomik “A C” “R C”, “E” dhe “A M”.

Me shkresën nr. 28,689/23 prot., datë 21.07.2020 njoftohet për s'kualifikim Operatori Ekonomik "AC", pasi nuk dorëzoi ofertën ekonomike për zhvillimin e minikonkurrencës.

Procesverbali i vlerësimit të operatorëve ekonomik mban datën 21.07.2020, duke bërë klasifikimin e ofertave me ofertë në vend të par operatorin ekonomik "W" me vlerën 9,881,799 lekë.

Raporti përmbledhës nr. 28,689/25 prot., datë 30.07.2020, i firmosur nga KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor

Me nr. 28,689/26 prot., datë 30.07.2020 në S.P.E. e A.P.P, është kryer njoftimi i fituesit.

Kontrata është lidhur me nr. 28,689/27 prot., datë 03.08.2020 ndërmjet UK T përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë "W" Shpk në vlerën 14,383,998 lekë.

Në lidhjen e kontratës nuk ka gjetur zbatim:

- pika 2.7 e kërkesave për kualifikim ku është përcaktuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik një deklaratë me anë të së cilës duhet të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit pranë AK do të paraqesë çertifikatën origjinale të origjinës së mallrave ose fotokopje të noterizuar të saj dhe deklaratën e paraqitjes çetifikatë origjine nga operatori ekonomik, datë 24.01.2020, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Un i nënshkruari L.K në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të operatorit ekonomik "W" shpk, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Në momentin e dorëzimit të mallit pranë AK do të paraqesë çertifikatën orgjinale të origjinës së mallrave ose fotokopje të noterizuar.

Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar bërë me nr. 29469/29 prot., datë 15.09.2021.

Në datën 21.01.2021 në S.P.E. e A.P.P, është kryer publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës, nga ku A.P.P. e ka publikuar me buletin nr.11, datë 25.01.2021.

Me memo 28,689/28 prot., datë 03.08.2020 A Q me detyrë përgjegjës e sektorit të mallrave dhe shërbimeve i drejtohet A S me detyrë drejtor i drejtorisë ekonomike me kërkesë për çelje financimi për kontratën "Blerje elektropompa për nevoja të shoqërisë".

Me urdhër transfertë datë 09.10.2020 nëpërmjet B B është likuiduar Shoqëria "W" shpk për vlerën 4,311,282 lekë. Dokumenti justifikues, faturë tatimore shitje me numër 24, datë 03.09.2020 për vlerën 14,363,1497 lekë. Ku është cilësuar sipas listës bashkëngjitur dhe kontratës e lidhur me marrëveshjen kuadër datë 23.06.2020 me nr. 28689/2 prot.

Me urdhër transfertë datë 01.10.2020 nëpërmjet B B është likuiduar Shoqëria "W" shpk për vlerën 10,000,000 lekë. Dokumenti justifikues, faturë tatimore shitje me numër 24, datë 03.09.2020, firmosur për vlerën 14,363,1497 lekë. Ku është cilësuar sipas listës bashkëngjitur dhe kontratës e lidhur me marrëveshjen kuadër datë 23.06.2020 me nr. 28689/2 prot.

Fletë hyrje nr. 01, datë 03.09.2020, aktkolaudimi i marrjes në dorëzim datë 03,09,2020 është firmosur nga E.C, A.M dhe K.I. Në këtë aktkolaudim është cilësuar "Malli përputhet me standartet e kërkuara me të gjitha parametrat e përshkruara në kontratë. Përfundimisht, grupi i kolaudimit përfundon kolaudimin e këtyre materialeve me konkluzionin se: Malli i ardhur nga firma "W" shpk sipas tabelës më sipër është malli i kërkuar sipas kontratës.

Pajisjet nuk janë të shoqëruara me çertifikatën origjinale të origjinës së mallrave ose fotokopje të noterizuar. Për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për zbatimin e ofertës teknike me nr.2.9, datë 24.01.2020 (dokument tenderi), ku ka të përcaktuar tipin e pajisjes dhe kompaninë prodhuese.

Pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 60, pika 1, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690, Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 "Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore", neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe neni 10, Udhëzimin e Ministrisë

Financave nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35.

4. Procedura e prokurimit me objekt “Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjellësi dhe kanalizimi në zonën e kufizuar nga rrugët Tefta Tashko”, “Luigj Gurakuqi”, viti 2021.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjellësi dhe kanalizimi në zonën e kufizuar nga rrugët Tefta Tashko”, “Luigj Gurakuqi”.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 15437 prot, datë 03.09.2021	3. Njësia e prokurimit Urdhër 15437 prot, datë 03.09.2021 -I.G; inxhinier - R D; inxhinier -D.K; ekonomiste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 20469/1 datë 15.11.2021 -L.R; jurist -E O; ing. Mjedisi dhe energjie -K L; ing. ndertimi
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 45,639,388 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 30,952,641 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 14,686,747 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 22.09.2021	9. Burimi Financimit Fond nga Te ardhurat e shoqërisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër <u>14</u> OE b) S’kualifikuar <u>3</u> OE, c) Kualifikuar <u>11</u> OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik -
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 20469/7 prot., datë 17.01.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 37,143,169 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me vendim të Këshillit Tekniko Ekonomik nr. 13, datë 03.06.2020 është miratuar në parim ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjellësi dhe kanalizimi në zonën e kufizuar nga rruga “Tefta Tashko”, “Luigj Gurakuqi në vlerën 45,639,388 lekë, duke përfshirë dhe fondin rezervë.

Me shkresën nr. 11,304 prot., datë 03.09.2020 Drejtori i Përgjithshëm ka miratuar projektin e paraqitur nga Drejtori i Departamentit Inxhinjerik O.DH.

Detyra e projektimit është hartuar nga inxhinier V.G, H.G dhe A.M, e cila është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Relacioni teknik dhe specifikimet teknike janë të hartuar nga inxhinieri N.D dhe A.M.

Investimi është kryer pa deklaratë paraprake punimesh, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 3 pika 21, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Ndërtim/punim pa leje” janë ato procese dhe/ose objekte ndërtimore të kryera në mungesë të lejes së ndërtimit, deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve ose të kryera në kushtet e një lejeje të shfuqizuar”, VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, neni 7 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Punime riparimi, zëvendësimi dhe mirëmbajtjeje të rrjeteve të infrastrukturës publike dhe komunikimeve elektronike, që nuk prekin sistemin konstruktiv të tyre, nuk ndryshojnë përdorimin dhe përmasat e infrastrukturës, si dhe kushtet e zhvillimit në zonën përreth”.

Në kushtet që për këtë investim nuk është marr deklaratë paraprake punimesh në zbatim të Vendimit Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015, të “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar”, neni 7, në opinionin e grupit të auditimit ky projekt nuk vlerësohet projekt teknik i zbatimit, për pasojë nuk duhet të ishte dokument tenderimi.

Domosdoshmëria e kryerjes së rikonstruksionit me leje ndërtimi, është bazuar në zërat e ofertës fituese në zërin transport dheu zë një volum 5320 m³, e cila ka në vetvete mbeturinat e prerjes se

asfaltit në 2375 ml dhe prishje shtrese betoni 79 m³, në referencë të VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e Kërkesave për Menaxhimin e Mbetjeve Inerte”.

Pika 6, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Zotëruesi i mbetjeve inerte është i detyruar t'i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Pika 8, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Njësitë e qeverisjes vendore, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave të këtij vendimi brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte”.

Pika 13, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Njësitë e qeverisjes vendore, në planet e përgjithshme vendore, të hartuara sipas nenit 20, të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe planet vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve të hartuara sipas nenit 13, të Ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, duhet të parashikojnë vende për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve inerte dhe lëndfillet për mbetjet inerte”.

Ligjin Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” KREU XIV, “Ndalimet, Sanksionet dhe ndëshkimet” neni 61 “Ndalimet” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Ndalohen:

a) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në vende publike;

b) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në parcelat bujqësore të mbjella ose jo, në anë të kanaleve kulluese e ujitëse, si dhe në çdo vend tjetër ku dëmtohen toka, bima dhe kafsha;

c) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në toka bujqësore;

ç) djegia e të gjitha llojeve të mbetjeve në kundërshtim me këtë ligj;

d) braktisja, depozitimi apo asgjësimi i pakontrolluar i mbetjeve”

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura mësipër ngarkon me përgjegjësi E.O me detyrë Drejtor i Departamentit Inxhinjerik.

Preventivi në vlerën 45,639,388 lekë pa TVSH dhe 54,767,265 lekë me TVSH, është i hartuar nga e O.DH me detyrë Drejtori i Departamentit Inxhinjeri H.G, A.M, N.D, S.G, si dhe i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës është bërë me shkresën nr. 15437/1 prot., datë 03.09.2021 nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, duke përcaktuar si afat të fundit të paraqitjes së ofertave datë 22.09.2021 ora 9.00.

Në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” është përcaktuar të kërkohet: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. 1 (një) Inxhinier Hidroteknik drejtues teknik në licencën e shoqërisë.

Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i Shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë.

Ky kriter është i ekzagjeruar dhe i pa argumentuar, pasi: Zotësia profesionale e operatorëve ekonomik është e ezauruar në kategoritë e zërave të punimeve të kërkuara si:

NP-1A “Punime gërmimi në tokë,” NP-4A “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale” dhe NP-7A “Ujësjellësa, Gazsjellësa”, etj.

Në opinionin e grupit të auditimit, referuar sa më sipër, licenca që operatori ekonomik disponon dhe paraqet, janë dëshmia se ai është vlerësuar nga institucionet e autorizuar me ligj, se disponon kapacitetet dhe eksperiencën e mjaftueshme (edhe të drejtuesve teknik) për të kryer punimet e specifikuar në formularin e licencës që disponon, dhe për rrjedhim plotësimi i kërkesave të vendosura nga autoritetet kontraktorë në lidhje me kategoritë dhe klasifikimet respektive që licencat profesionale duhet të përmbajnë, është kusht i mjaftueshëm për autoritetin kontraktor.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, pika 4, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar, neni 39, pika 6/a ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore*”, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, kreu III, pika 1/a , ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

"1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës,

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë”.

Në pikën 2.3.11 “Kapaciteti teknik” kërkohet: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës minimum 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton për secilin kamion 4 copë. Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës minimum 12 ton dhe maksimumi 17 ton për secilin kamion. Në procesverbalin e argumentimit të kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike nuk është dhënë asnjë argument përse është bërë limitimi i kapacitetit të mjeteve 3.5-5 ton dhe 12-17 ton. Çfarë do të pengonte realizimin e kontratës n.q.s mjetet do të ishin me kapacitet 3.5-17 ton. Në opinionin e grupit të auditimit kërkesa nuk është proporcionale me objektin e kontratës. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar, neni 39, pika 6/d ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*”.

Në pikën 2.3.10 “Kapaciteti teknik” kërkohet: Shoqëria duhet të paraqesë çertifikatën e cilësisë se punimeve ISO 9001- 2015 (e vlefshme). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

a. Shoqëria duhet të paraqesë Certifikate ISO 14001-2015 (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

b. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë OHSAS 18001-2007(e vlefshme) ose ekuivalente me të, (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

c. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë PAS 99-2012(e vlefshme). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Nuk është kërkuar që certifikatat e mësipërme të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, pika 1 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*.

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 15437/2 prot., datë 03.09.2021 është ngritur komisioni i vlerësimit i përberë nga L.R me profesion juriste, E.O me profesion inxhinier dhe H.G me profesion inxhinier, ku është përcaktuar vlera 45,639,388 lekë, me datë zhvillimi tenderi 22.09.2021 ora 9.00.

Kërkesat për kualifikim dhe specififikimet teknike janë miratuar me procesverbalin e datës 03.09.2021 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga I.G, D.K dhe R.D, tek ky procesverbal nuk janë përcaktuar kriteret e vlerësimit, por janë përcaktuar në dokumente e tenderi të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.), ku është shprehur në mënyrë eksplicite ***“Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”***.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur më sipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përbërë nga I.G, R.D dhe D.K.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët operatorë ekonomike.

Shoqëria “N” Shpk, me ofertë në vlerën 28,265,321 lekë.

-Shoqëria “L C” Shpk, me ofertë në vlerën 30,952,641 lekë.

-Shoqëria “N” Shpk, me ofertë në vlerën 32,176,767 lekë.

-Shoqëria “M” Shpk, me ofertë në vlerën 34,211,662 lekë.

-Shoqëria “E” Shpk, me ofertë në vlerën 35,122,737 lekë.

-Shoqëria “E” Shpk, me ofertë në vlerën 36,029,7111 lekë.

-Shoqëria “KM” Shpk, me ofertë në vlerën 36,237,374 lekë.

-Shoqëria “SF” Shpk, me ofertë në vlerën 37,111,111 lekë.

-Shoqëria “Ka” Shpk, me ofertë në vlerën 37,256,357 lekë.

-Shoqëria “AT” Shpk, me ofertë në vlerën 41,208,956 lekë.

-Shoqëria “A K” Shpk, me ofertë në vlerën 44,886,879 lekë.

-Shoqëria “BS” Shpk, me ofertë në vlerën 32,818,259 lekë.

-Shoqëria “P G” Shpk, me ofertë në vlerën 34,258,519 lekë.

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues Shoqëria “L C” Shpk, me ofertë në vlerën 30,952,641 lekë, duke u s’kualifikuar operatorët “N” Shpk, “E” Shpk dhe “E” Shpk.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit, është hartuar me nr. 15437/4 prot., datë 08.10.2021, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Në datën 28 dhe 29.09.2021 në S.P.E. e A.P.P, është kryer njoftimi i fituesit, nga ku A.P.P e ka bërë aktive publikimin e njoftimit të fituesit në datën 28 dhe 29.09.2021.

Kontrata është lidhur me nr. 15437/2 prot., datë 25.10.2021 ndërmjet UKT përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “L C” Shpk në vlerën 37,143,169 lekë, me afat ekzekutimi 4 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Në dokumentet e tenderit dhe në kontratën e lidhur nuk reflektojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratave, sipas përcaktimeve të dokumenteve të tenderit, nuk reflektohet afati për

mbajtjen e garancisë së punimeve, në kundërshtim me Udhëzim i KM nr. 3, datë 15.2.2001, “Për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësin njësinë e prokurimit të përbërë nga I.G, R.D dhe D.K.

Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar është bërë me nr. 15437/2/9 prot., datë 25.10.2021.

Në datën 25.10.2021 në S.P.E. e A.P.P. është kryer publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës, nga ku A.P.P. e ka bërë aktive këtë publikim në datën 01.11.2021.

Plani i zbatimit të kontratës është bërë me nr. 15,437/11 prot., datë 25.10.2021 i firmosur ndërmjet UKT përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “L C” Shpk me përfaqësues ligjor A.Ç, në të cilën citohet ndër të tjera burimi i financimit “Të ardhurat” me afat 4 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Tek posti A.3.1 “Të dhënat specifike” nuk ka të përcaktuar personat përgjegjës/struktura e ngarkuar për ecurinë e zbatimit të kontratës. Mbikëqyrësi i punimeve është caktuar Shoqëria “EG” shpk.

Me shoqërinë “L C” Shpk nuk është lidhur një kontrata e sigurimit për çdo dëm që mund të shkaktohet, veprim në kundërshtim me: -Ligjin nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se

“1. Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendës apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore.

3. Çdo zbatues punimesh është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale për çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij dhe duhet të mbulojë të paktën çdo shpenzim të nevojshëm e të domosdoshëm për kryerjen e punimeve të reja, si dhe shpenzimet shtesë të kryera nga zhvilluesi ose organet e administratës publike, që kanë rrjedhur si pasojë e zbatimit të punimeve në kundërshtim me kontratën përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit, me dokumentet e planifikimit dhe zhvillimit, si dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit”.

-Ligjin nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “5. Zhvilluesit, krahas dokumentacionit tekniko-ligjor, duhet të dorëzojnë edhe kontratën e sigurimit, me përfitues autoritetin publik përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit. Kontrata e sigurimit duhet të mbulojë çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e kryerjes së punimeve të ndërtimit në kundërshtim me lejen e ndërtimit ose lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit, legjislacionin në fuqi që rregullon fushën e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, si dhe çdo shpenzim të nevojshëm e të domosdoshëm për kryerjen e punimeve të reja ose përfundimin e punimeve në rastet kur zhvilluesi nuk përfundon punimet, sipas lejes së miratuar nga autoriteti publik përgjegjës.

Shoqëria e sigurimit, në rast se ndodh ngjarja e siguruar, është e detyruar të paguajë dëmin brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së autoritetit publik përgjegjës. Në çdo rast, shuma e sigurimit duhet të jetë e barabartë me koston e parashikuar të ndërtimit të objektit, sipas preventivit përkatës”.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësin E.O me detyrë drejtor i departamentit inxhinjerik.

5. Procedura e vend depozitimit të mbetjeve të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike; tubacione, saraçineska etj) te cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë të projekteve të ndryshme.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se:

Për periudhën objekt auditimi mbetjet të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike; tubacione, saraçineska etj) te cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë të

projekteve te ndryshme, depozitohen Landfilli Sharrës, Landfill i administruar nga Shoqëria (I S”.

Për këtë depozitim nuk ka kontratë të lidhur ndërmjet Shoqërisë “UKT” SHA dhe Shoqërisë (I S”, veprim në kundërshtim me VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, pika 9, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Transporti i mbetjeve jo të rrezikshme bëhet në bazë të kontratës ndërmjet palëve, në të cilën përcaktohet detyrimisht përgjegjësia për rastin e kthimit mbrapsht pjesërisht ose plotësisht, të mbetjeve nga pritësi, duke plotësuar seksionin C të aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi”*.

Për vend depozitim dhera dhe inerte tek Landfilli Sharrës për llogari të Shoqërisë (I.E BV SPV”, për vitin 2019 është faturuar vlera 12,879,558 lekë, është likuiduar vlera 11,759,763 lekë, për vitin 2020 është faturuar vlerë 490,315 lekë, është likuiduar vlera 1,602,325 (1,119,805 lekë mbetje nga viti 2019 dhe 490,315 nga viti 2020), për vitin 2021 është faturuar vlera 3,102,964 lekë, është likuiduar vlera 390,583 lekë, mbetur në diferencë pa likuiduar vlera 2,720,175 lekë, për periudhën janar-tetor 2022 është faturuar vlera 1,006,084 lekë, është likuiduar vlera 1,006,084 lekë.

Faturim i është bërë me çmimi 800 lekë/tonë inerte (mbetje nga ndërtimet dhe prishjet) dhe 246.7 lekë/tonë për dhera dhe shtuf.

Këto çmime janë vendosur nga Shoqëria (I.”, pa miratimin e Bashkisë Tiranë, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, pika 15 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Zotëruesit e mbetjeve inerte janë të detyruar të dorëzojnë mbetjet inerte në vend depozitim dhe përkohshëm ose lëndfillet e trajtimit të mbetjeve inerte, kundrejt tarifës për ton/mbetje, të propozuar nga operatori dhe të miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore”*.

Likuidimet janë bërë pa situacion, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011, “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, pika 3.3, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe 26, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/b.

Likuidimet janë bërë me:

- formular vend depozitimi lëshuar (firmosur) nga Lanfilli dhe drejtuesi i mjetit që ka transportuar, pa firmosur prodhuesi i mbetjeve, shoqëruar me fletë peshën e impiantit, në kundërshtim me aneksin “Formati i dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme” të VKM nr. 575, datë 24.06.2015, pika 7, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Zotëruesit e mbetjeve inerte dhe operatorët e lëndfilleve të mbetjeve inerte janë të detyruar të plotësojnë dhe të nënshkruajnë dokumentin e transferimit të këtyre mbetjeve dhe të dhënat regjistruhen në Regjistrin e Transfertave Individuale, sipas vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”*.

Mbetjet nuk janë klasifikuar sipas kodeve përkatëse në kundërshtim me VKM nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, pika 17 “Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (përfshi dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara)” si dhe pika 20, mbetjet urbane (mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë fraksionet e mbledhura veçmas: 20 02 02 “Dhera dhe gurë”; 20 02 03 “Mbetje të tjera

të pabiodegradueshme”; 20 03 “Mbetje të tjera urbane”; 20 03 01 “Mbetjet e përziera urbane”; 20 03 04 “Llumra nga gropat septike”; 20 03 06 “Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza”; 20 03 07 “Mbetjet të vëllimshme”; 20 03 99 “Mbetjet urbane të paspecifikuara”.

-Procesverbalet të firmosura nga shoferët, M.V me detyre përgjegjës i transportit, dhe Enea Koçiasi me detyre përgjegjës i sektorit të investimeve dhe kanalizimeve.

Dokumentacioni shkresor, mbi të cilat janë konstatuar shkeljet si mësipër.

Shkresa e Bashkisë Tiranë (Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike”; Drejtoria e pastrimit dhe Mbetjeve urbane” nr. 38497 prot., datë 15.10.2019, protokolluar në UKT 2710 prot., datë 16.10.2019, Shkresa e UKT Tiranë drejtuar (I S”, nr. 4733 prot., datë 05.03.2019, Shkresa e (IS”, nr. 84/1 prot., datë 11.03.2019, protokolluar në UKT 4733/1 prot., datë 11.03.2019.

Transportimi është bërë nga UKT pa patur Licencën tipit III.2.B e pajisur vet ose nëpërmjet nënkontraktore për transport të mbetjeve në destinacionin e përcaktuar, si dhe mjetet e angazhuara për këtë qëllim, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integrua të mbetjeve”, neni 57 “Transportuesit e mbetjeve”, pika 1 dhe 2.

Për shkeljet e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër ngarkohen me përgjegjësi F.A me detyrë Drejtor i Departamentit Operacional për periudhën 20.11.2020 dhe në vazhdim, O.D me detyrë ish-drejtor i Departamentit Inxhinjerik për periudhën viti 2019 deri 19.11.2020, D.M me detyrë Ish-Drejtor i Drejtorisë Operacionale për periudhën 2019-2021, E.K me detyrë përgjegjës i sektorit të investimeve dhe kanalizimeve.

6. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje automjete teknologjike”, viti 2019.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje automjete teknologjike”.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. nr. 3251 prot., datë 14.02.2019	3. Njësia e prokurimit nr. 3251 prot., datë 14.02.2019 -A.Q; juriste - A.S; inxhinjer mekanik -K T; ekonomist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 3251/1 prot., datë 14.02.2019 -L.R; juriste -F.V; ekonomist -E.T; ekonomist
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 80,497,293 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 78,484,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,013,293 leke
8. Data e hapjes së tenderit 11.03.2019	9. Burimi Financimit Fond nga Te ardhurat e shoqërisë	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>2</u> OE b) S’kualifikuar <u>1</u> OE, c) Kualifikuar <u>1</u> OE
11. Ankimime N C”, “T” Shpk	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik -
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 3251/11 prot., datë 20.03.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 94,180,800 lekë	

Me kërkesën nr. 458 prot., datë 04.02.2019, A.G me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Transportit dhe Oficinës i është drejtuar Drejtorisë së Prokurimeve, për dijëni Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me kërkesë për blerje automjete teknologjike.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 49 prot., datë 06.02.2019, është ngritur grupi i punës për të përllogaritur vlerën e kontratës (testimin e tregut) dhe specifikimeve teknike i përbërë nga E.P, Y.F dhe M.V.

Me dokument (relacion) të protokolluar nr. 49/1 prot., datës 08.02.2019 i grupi i punës ka përllogaritur vlerën e kontratës 80,497,293 lekë. Përllogaritja e vlerës së kontratës është

përcaktuar, pas çmimit mesatar zë për zë (automjetet/urë shërbimi/gjenerator) ofruara nga operatorët “L” Shpk, “AZ” Shpk, “M” Shpk.

Nga grupi për llogaritjen e vlerës së kontratës, ***nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë shoqëria n.q.s ka, ose të ujësjellësve tjerë, si dhe pse një numër kaq i kufizuar operatorësh, pra pse tre dhe jo mbi pesë.***

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: Çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Si konkluzion, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme, çmimet e realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, ujësjellësve të tjerë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2,

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i punës për të përlllogaritur vlerën e kontratës (testimin e tregut) dhe specifikimeve teknike i përbërë E. P., Y. F. dhe M.V.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 3251 prot., datë 14.02.2019, është përcaktuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me vlerë 80,497,293 lekë, njësia e prokurimit e përbërë nga A.Q me profesion juriste, A.S me profesion inxhinier mekanik dhe K.T me profesion ekonomist.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 3251/1 prot., datë 14.02.2019, është ngritur komision i vlerësimit të ofertave i përbërë nga L.R me profesion juriste/kimist, F.V me profesion jurist, E.T me profesion ekonomist.

Kërkesat për kualifikim dhe kriteri i vlerësimit janë miratuar me procesverbalin e datës 14.02.2019 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga A.Q, A.S dhe K.T.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës është bërë me shkresën nr. 3251/3 prot., datë 14.02.2019 nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, publikuar nga APP në buletin nr. 7, datë 18.02.2019, duke përcaktuar si afat të fundit të paraqitjes së ofertave datë 11.03.2019 ora 8.30.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët operatorë ekonomike.

-Shoqëria “T” Shpk, me ofertë në vlerën 73,500,000 lekë.

-Bashkimi i operatorëve “M T” Shpk, me ofertë në vlerën 78,484,000 lekë.

Me shkresën nr. 5567 prot., datë 15.03.2019, është bërë ankesë nga operatori ekonomik “T” Shpk, për rivlerësimin e procedurës së prokurimit për tu shpallur fitues.

Me urdhër nr. 3251/4 prot., datë 15.03.2019 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit.

Me urdhër nr. 3251/5 prot., datë 15.03.2019 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “T” Shpk, i përbërë nga A.S, A.Q dhe K.T.

Me shkresën nr. 3251/6 prot., datë 20.03.2019, komisioni i shqyrtimit të ankesës informon Titullarit të Autoritetit Kontraktor, mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik “T” Shpk.

Me shkresën nr. 3251/6 prot., datë 20.03.2019, i është kthyer përgjigje operatorit ekonomik “T” mbi vendimin e marrë nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën nr. 3251/7 prot., datë 20.03.2019 Titullari i Autoritetit Kontraktor ka bërë heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit, është hartuar me nr. 3251/8 prot., datë 20.03.2019, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, ku është s’kualifikuar operatori ekonomik “T” dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomik “M T” Shpk, me ofertë në vlerën 78,484,000 lekë.

Me shkresën nr. 3251/9 prot., datë 20.03.2019 është bërë njoftimi i “Bashkimit të operatorëve ekonomik “M T” Shpk” si kandidat i suksesshëm për lidhjen e kontratës.

Kontrata është lidhur me nr. 3251/11 prot., datë 20.03.2019 ndërmjet UKT përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “M T” Shpk në vlerën 94,180,800 lekë me TVSH.

Me urdhër transfertë datë 25.10.2019 nëpërmjet C.B është likuiduar Shoqëria “A T” Shpk” për vlerën 8,000,000 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 17, 18, datë 23.07.2019, firmosur për vlerën 4,860,000 lekë.

Fletë hyrje nr. 3 dhe nr. 7, datë 23.07.2019, aktkolaudimi nr.1 dhe nr. 2, datë 23.07.2019 është firmosur nga M.V, N.T dhe D.M. Në këtë aktkolaudim është cilësuar “Malli i lëvruar përputhet me standartet e kërkuara sipas kontratë”.

Me urdhër transfertë datë 29.04.2020 nëpërmjet C B është likuiduar Shoqëria “A T” Shpk” për vlerën 12,000,000 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 44, datë 04.11.2019, për vlerën 14,180,400 lekë.

Fletë hyrje nr. 9, datë 12.11.2019, aktkolaudimi nr. 228/7 prot., datë 12.11.2019 është firmosur nga M.V, N.T dhe D.M. Në këtë aktkolaudim është cilësuar “Malli i lëvruar përputhet me standartet e kërkuara sipas kontratë”.

Me urdhër transfertë datë 03.03.2020 nëpërmjet C B është likuiduar Shoqëria “AT” Shpk” për vlerën 9,000,000 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje numër 20, datë 23.07.2019, për vlerën 4,860,000 lekë, numër 21, datë 23.07.2019, firmosur për vlerën 4,860,000 lekë dhe numër 44, datë 04.11.2019, për vlerën 14,180,400 lekë.

Fletë hyrje nr. 5, dhe nr. 6, datë 23.07.2019, aktkolaudimi nr. 4 dhe nr. 5, datë 23.07.2019 është firmosur nga M.V, N.T dhe D.M. Në këtë aktkolaudim është cilësuar “Malli i lëvruar përputhet me standartet e kërkuara sipas kontratë”.

Me urdhër transfertë datë 10.09.2020 nëpërmjet C B është likuiduar Shoqëria “A T” Shpk” për vlerën 20,000,000 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje numër 47, datë 12.11.2019, për vlerën 51,799,440 lekë.

Fletë hyrje nr. 9, datë 12.11.2019, aktkolaudimi nr. 228/7 prot., datë 12.11.2019 është firmosur nga M.V, N.T dhe D.M. Në këtë aktkolaudim është cilësuar “Malli i lëvruar përputhet me standartet e kërkuara sipas kontratë”.

Me urdhër transfertë datë 06.10.2019 nëpërmjet C B është likuiduar Shoqëria “A T” Shpk” për vlerën 8,000,000 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje numër 20, datë 23.07.2019, për vlerën 4,860,000 lekë.

Fletë hyrje nr. 4, datë 23.07.2019, aktkolaudimi nr. 2 dhe 3, datë 23.07.2019 firmosur nga M.V, N.T dhe D.M. Në këtë aktkolaudim është cilësuar “Malli i lëvruar përputhet me standartet e kërkuara sipas kontratë”.

Me urdhër transfertë datë 02.06.2020 nëpërmjet FB është likuiduar Shoqëria “A T” Shpk për vlerën 12,000,000 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 47, datë 12.11.2019, për vlerën 51,799,440 lekë, numër 44, datë 04.11.2019, për vlerën 14,180,400 lekë.

Fletë hyrje nr. 8, datë 04.11.2019, aktkolaudimi nr. 222/6 prot., datë 04.11.2019 është firmosur nga M.V, N.T dhe D.M. Në këtë aktkolaudim është cilësuar “Malli i lëvruar përputhet me standartet e kërkuara sipas kontratë”.

Me urdhër transfertë datë 04.12.2020 nëpërmjet C B është likuiduar Shoqëria “A T” Shpk” për vlerën 10,000,000 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 47, datë 12.11.2019, për vlerën 51,799,440 lekë.

Fletë hyrje nr. 9, datë 12.11.2019, aktkolaudimi nr. 228/7 prot., datë 12.11.2019 është firmosur nga M.V, N.T dhe D.M. Në këtë aktkolaudim është cilësuar “Malli i lëvruar përputhet me standartet e kërkuara sipas kontratë”.

Me urdhër transfertë datë 10.03.2021 nëpërmjet C B është likuiduar Shoqëria “A T” Shpk” për vlerën 15,180,800 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 17, datë 23.07.2021, për vlerën 4,860,000lekë, numër 47, datë 12.11.2019, për vlerën 51,799,440 lekë, numër 48, datë 12.11.2019, për vlerën 3,900,960 lekë.

Fletë hyrje nr. 2, datë 23.07.2021, nr. 9, 10, datë 12.11.2019, aktkolaudimi nr. 1, datë 23.07.2021 është firmosur nga M.V, N.T dhe D.M. Në këtë aktkolaudim është cilësuar “Malli i lëvruar përputhet me standartet e kërkuara sipas kontratë”.

7. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje reagent dhe pajisje laborator”, viti 2021.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje reagent dhe pajisje laborator”.		
1. Urdhër Prokurimi Nr Nr.29/6 dt.10.06.2020	3. Njësia e prokurimit Urdhër Nr.20469 dt.15.11,2021 -A Q; juriste - I M; juriste -T K; ing. kimiste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 20469/1 datë 15.11.2021 -L.R; juriste -E O; ing. Mjedisi dhe energjie -K L; ing. ndertimi
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 12,943,180 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 9,707,610 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 3,235,570 leke
8. Data e hapjes së tenderit 09.12.2020	9. Burimi Financimit Fond nga Te ardhurat e shoqerise	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 4__OE b) S’kualifikuar 3__OE, c) Kualifikuar 1__OE
11. Ankimime-	12. _-	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik _
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 20469/7 prot., datë 17.01.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 11,649,132 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me kërkesën nr. 4444 prot., datë 28.10.2021, E.O me detyrë Drejtori i Departamentit Inxhinjerik i është drejtuar Drejtorisë së Prokurimeve, për dijëni Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me kërkesë për furnizim me reagent 80,000 tableta DPD nr. 1, për kryerjen e kontrollit të cilësisë së ujit të pijshëm.

Me kërkesën nr. 4444/1 prot., datë 28.10.2021, K.L me detyrë Drejtori i Departamentit Prodhimit dhe Shpërndarës i është drejtuar Drejtorisë së Prokurimeve, për dijëni Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me kërkesë për furnizim me materiale dhe reagent për kryerjen e kontrollit të cilësisë së ujit të pijshëm.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 287 prot., datë 10.09.2021, është ngritur grupi i punës për të përllogaritur vlerën e kontratës (testimin e tregut) dhe specifikimeve teknike i përbërë nga B.N me profesion ing kimist, B.B me profesion ing. kimiste dhe mjedisi, D.X i lart biologji-kimi. Me dokument (relacion) të protokolluar nr. 4,287/1 prot datës 28.10.2021 grupi i punës ka përllogaritur vlerën e kontratës 12,943,180 lekë. Përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar, referuar çmimit mesatar zë për zë (reagent për reagent) ofruara nga operatorët “K” Shpk, “E” Shpk dhe “E” Shpk.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 20469 datë 15.11.2021, është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga A.Q me profesion juriste, Y.M me profesion juriste, T.K me profesion ing. kimiste.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 20469/1 datë 15.11.2021, është përcaktuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur-mallra” me vlerë 12,943,180 lekë me objekt “Blerje reagent dhe pajisje laborator”, komision të vlerësimit të ofertave i përbërë nga L.R me profesion juriste/kimist, E.O me profesion ing. mjedisi, K.L me profesion ing. ndërtimi.

Kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike janë miratuar me procesverbalin e datës 15.11.2021 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga A.Q, I.M dhe T.K, tek ky procesverbal nuk janë përcaktuar kriteret e vlerësimit, por janë përcaktuar në dokumente e tenderi të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.), faqe 6.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës është bërë me shkresën nr. 29469/2, datë 15.11.2021 nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, publikuar në buletin e APP nr. 167 datë 22.11.2021, duke përcaktuar si afat të fundit të paraqitjes së ofertave datë 01.12.2021 ora 10.00.

Është bërë ndryshimi i dokumenteve të tenderit me shtojcën datë 18.11.2021, ku është përcaktuar se dorëzimi i ofertave do të bëhet datë 09.12.2021 ora 10.00.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomike.

-Shoqëria “I” Shpk, me ofertë në vlerën 0 lekë.

-Shoqëria “K” Shpk, me ofertë në vlerën 9,707,610 lekë.

-Shoqëria “V” Shpk, me ofertë në vlerën 11.512.900 lekë.

-Shoqëria “M” Shpk, me ofertë në vlerën 24,064,327lekë.

Pas vlerësimit të KVO, u kualifikua dhe shpall fitues Shoqëria “K” Shpk, me ofertë në vlerën 9,707,610 lekë, duke u s’kualifikuar operatorët e tjerë, të përmendur si më sipër.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit, është hartuar me nr. 20469/4 prot., datë 22.12.2021, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Në datën 22.12.2022 në S.P.E. e A.P.P, është kryer njoftimi i fituesit, nga ku A.P.P e ka bërë aktive publikimin e njoftimit të fituesit në datën 17.01.2022.

Komisioni i vlerësimit të ofertave, me procesverbal të datës 23.12.2021 ka bërë verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “K” Shpk i shpallur fitues.

Kontrata është lidhur me nr. 20469/7 prot., datë 17.01.2022 ndërmjet UKT përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “K” Shpk në vlerën 11,649,132 lekë, me afat ekzekutimi 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar bërë me nr. 29469/8 prot., datë 17.01.2022.

Në datën 17.01.2022 në S.P.E. e A.P.P. është kryer publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës, nga ku A.P.P. e ka bërë aktive këtë publikim në datën 18.01.2022.

Me memo nr. 20469/9 prot., datë 17.01.2022 L.R me detyrë Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Prokurimeve i drejtohet E.C me detyrë drejtor i Drejtorisë Ekonomike me kërkesë për çelje financimi për kontratën “Blerje reagent dhe pajisje laborator”.

Me memo nr. 20469/10 prot., datë 17.01.2022 L.R me detyrë Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Prokurimeve i drejtohet E.O me detyrë Drejtor i Departamentit Inxhinjerik dhe K.L me detyrë drejtor i Departamentit të Prodhim & Shpërndarjes informacion për nënshkrimin e kontratës “Blerje reagent dhe pajisje laborator”.

Plani i zbatimit të kontratës është bërë me nr 20469/11 prot., datë 17.01.2022 i firmosur ndërmjet UKT përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “K” Shpk me përfaqësues ligjor P Z, në të cilën citohet ndër të tjera Burimi i financimit “Fondet e akorduara na UK Tiranë sipas projektbuxhetit me vlerë 9,707,610 me nr. 18016/2 datë 29.10.2020, me afat 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Personat përgjegjës/struktura e ngarkuar për ecurinë e zbatimit të kontratës B.N me detyrë kimist me profesion kimist industrial, E.B me detyrë kimist me profesion kimist industrial, A.K me detyrë biolog, me profesion ing. biolog.

8. Procedura e prokurimit me objekt “Zhbllokim pusetash”, viti 2022.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Zhbllokim pusetash”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. nr. 9311 prot., datë 12.05.2022	3. Njësia e prokurimit Urdhër 15437 prot, datë 03.09.2021 - E K; ingxhinjer hidro - K.T; ekonomiste -D G; juriste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Kacidhja nr. 1094/2 prot., datë 30.05.2019 -L.R; juriste - B N; ing. mjedisi - F A; ekonomist
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur”- marrëveshje kuadër		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 19,993,597 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 19,919,498 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 74,099 leke
8. Data e hapjes së tenderit 05.07.2021	9. Burimi Financimit Fond nga Te ardhurat e shoqërisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 OE b) S’kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik -
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 9311/13 prot., datë 25.08.2022.	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 14,338,233 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me shkresën nr. 1459 prot., datë 15.04.2022, F.A me detyrë Drejtor i Departamentit Operacional, i kërkon Drejtorit të Përgjithshëm, vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Hapje, zhbllokim pusetash”.

Me shkresën nr. 1459/1 prot., datë 20.04.2022, F.A me detyrë Drejtor i Departamentit Operacional, i kërkon L.R me detyrë drejtoreshë e Departamentit Ligjor dhe Prokurimeve, vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Hapje, zhbllokim pusetash”.

Me shkresën nr. 1873/2 prot., datë 02.03.2022, F A me detyrë Drejtor i Departamentit Operacional, i kërkon E.O me detyrë drejtor i Departamentit Inxhinjerik, analizë çmimesh për zërat pastrim pusete me një H-mesat 2.5, pastrim puset shiu dhe zhblllokim kanal kesoni.

Me shkresën nr. 1873/3 prot., datë 02.03.2022, E.O me detyrë drejtor i Departamentit Inxhinjerik, i dërgon F A me detyrë Drejtor i Departamentit Operacional, analizë çmimesh për zërat pastrim pusete me një H-mesat 2.5 në vlerën 11814 lekë/orë , pastrim puset shiu me vlerë 10067 lekë/orë dhe zhblllokim kanal kesoni në vlerën 13917 orë.

Fondi limit për vitin 2022 është llogaritur në vlerën 19,041,415 lekë, i llogaritur nga E.O me detyrë Drejtor i Departamentit Inxhinjerik, pa një analizë teknike për zëra si me poshtë vijon.

-Pastrim pusete me një H-mesat 2.5 në vlerën 11,814 lekë/orë për volumin 950 orë.

Pastrim puseta shiu 290 orë x 10,067 lekë/orë = 2,919,430 lekën për volumin 290 orë dhe zhblllokim kanal kesoni në vlerën 13917 orë për 352 orë.

Fond rezervë 5 % në vlerën 952,076 lekë. Ky fond rezervë ka rritur në mënyrë artificiale vlerën e përlllogaritjes, pasi nuk kemi të bëjmë me punime ndërtimi të ndërtesave, veprim në kundërshtim me Analizat teknike për punimet e ndërtimit të ndërtesave “Ministria e Ndërtimit” maj 1992, Manualin e preventivimit “Udhëzime dhe kriteret dhe analiza ndihmëse vëllimi i I (1976-1980), ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “.....Mbi vlerën e punimeve të preventivuara në këtë fazë parashikohet fond rezervë deri në masën 5 %. Ky fond përdoret nga institucionet projektuese për të përballuar punimet e pa parashikuara në preventivin përfundimtar, që dalin të nevojshme gjatë ndërtimit të veprës. Institucionet projektuese për raste të nevojshme, ka të drejtë të përdori kursimet e fondit rezervë të një vepre apo nënvepre për të bërë shtesë në një vepër tjetër (brenda të njëjtës vepër). Në të dy rastet hartohet shtesë preventivi, të cilën e miraton investitori.”

Përdorimi i fondit rezervë është përcaktuar dhe në VKM nr. 610, datë 22.09.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësit e Tij, kushtet dhe elementët e përgjithshëm të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, neni 23, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë, të preventivuar dhe raporton periodikisht, çdo muaj, zhvilluesit për gjendjen e tij. Zhvilluesi, nëse ka vërejtje në përdorimin e fondit rezervë, njofton zbatuesin e punimeve dhe merr masat e nevojshme për përdorimin e këtij fondi, për të cilin duhet të dakortësohen të dyja palët. Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni nga zhvilluesi për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve të dakortësuara”.

Në opinionin e grupit të auditimit:

Ky shërbim nuk është ndërtim; por shërbim:

-Nuk ka projekt të hartuar nga projektues të liçensuar.

-Nuk ka të caktuar mbikëqyrës të punimeve.

-Preventivi nuk ka të përcaktuar vlerën e pastrimit të pusetave duke u bazuar në numrin e pusetave x çmimin/puset, vlerën e zhblllokim të kanaleve kesoni duke u bazuar në numrin/metrat linear x çmimin/kanal etj.

Referuar sa më sipër preventivimi dhe situacionimi i fondit rezervë ka rritur në mënyrë artificiale vlerën e përlllogaritjes së këtij shpenzimi, si dhe ka renduar koston e këtij shërbimi, në vlerat respektive të trajtuara për çdo urdhër transfertë dhe situacion.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi E.O me detyrë Drejtor i Departamentit Inxhinjerik.

Specifikimet teknike janë hartuar nga M.K, E.N dhe G.S.

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 9311 prot., datë 12.05.2022, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond në vlerën 19,993,597 lekë, procedurë e hapur -shërbimi

(marrëveshje kuadër) njësia e prokurimit e përbërë i përbërë nga E.K me profesion ing. hidro, K.T me profesion ekonomiste dhe D.G, me profesion juriste.

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 9311/1 prot., datë 12.05.2022, është ngritur komisioni i vlerësimit i përberë nga L.R me profesion juriste, B.N me profesion inxhinieri mjedisi dhe F.A, me profesion ekonomist.

Njoftimi i kontratës së shkurtuar është bërë me nr. 9311/2 prot., datë 12.05.2022 me afat të fundit të paraqitjes së ofertave datë 27.05.2022 ora 10.00, publikuar në Buletinin e APP nr. 63, datë 16 maj 2022.

- *Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.*

Kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike janë miratuar me procesverbalin e datës 12.05.2022 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë K.T, D.G dhe E.K, ku nuk është përcaktuar kriteri i përzgjedhjes, kriter që është përcaktuar në dokumentet e tenderit “Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”.

Me shkresën nr. 9311/3 prot., datë 19.05.2022, L.R me detyrë drejtore e Departamentit Ligjor dhe prokurimeve i kërkon F.A me detyrë Drejtor i Departamentit Operacional, sqarim për specifikimet teknike për procedurën “Hapje, zhblllokim pusetash”.

Me shkresën nr. 9311/4 prot., datë 19.05.2022, F.A, me detyrë Drejtor i Departamentit Operacional, i kthen përgjigje L.R me detyrë drejtore e Departamentit Ligjor dhe prokurimeve, për sa kërkuar me shkresën nr. 9311/3 prot., datë 19.05.2022.

Në kriteret e kualifikimit “Kapaciteti teknik”, nuk është përcaktuar që operatori ekonomik duhet të disponojnë licencën tipit III.2.B për transport të mbetjeve në destinacionin e përcaktuar, veprim në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integrua të mbetjeve”, neni 57 “Transportuesit e mbetjeve”, pika 1 dhe 2, neni 59 “Licencimi i veprimtarive” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Licencat për veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj përfshihen në kategorinë III.2 të shtojcës bashkëlidhur Ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.*

-Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit(QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, KREU III “Mjedisi dhe Burimet Mjedisore Bazë”, pika 9, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “*Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.*

- Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 3, pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

Në pikën 2.7, të kriterëve të kualifikimit “Kapaciteti teknik”, Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin 2 makina teknologjike pastrimi dhe transporti për mbetjet e pusetave të shiut me kovë vetëngarkuese të mbyllur dhe vetëshkarkuese.

Në pikën 2.8,të kriterëve të kualifikimit “Kapaciteti teknik”, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin:

-2 sonda teknologjike me presion 170-275 bar me kapacitet mbajtës të ujit 12-13 m³ me depozitë me ndarje të lëvizshme, gjatësia e sondës 80 ml, me Ø 1 pol te pajisura me pompe presioni dhe vakumi.

-2 sonda të vogla me presion nga 100-150 bar (për tubacionet e zgarave të shiut me dimension 400 mm). Kapaciteti mbajtës i ujit 4-5 m³ me tub nga 1/2-3/4 pol.

Njëra nga sondat duhet të jetë e pajisur me pompë vakumi dhe presioni dhe tjetra me pompe vakumi.

Njësia e prokurimit duhet të përcaktonte numri minimal të domosdoshëm 2, për realizimin e punimeve objekt kontrate dhe jo numër fiks 2.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur më sipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përbërë nga njësia e prokurimit e përbërë i përbërë nga E.K, K.T dhe D.G.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët operatorë ekonomike.

Bashkimi i operatorëve ekonomik “O.M” Shpk, me ofertë në vlerën 19,919,498 lekë.

-Shoëria “K K” Shpk, me ofertë në vlerën 0 (zero) lekë.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit, është hartuar me nr. 9311/7 prot., datë 07.07.20122, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, ku është kualifikuar dhe shpallur fitues Bashkimi i operatorëve ekonomik “O M” Shpk, duke u s’kualifikuar 1 operatorët e tjerë.

Në datën 27.06.2022 në S.P.E. e A.P.P, është kryer njoftimi i fituesit, nga ku A.P.P e ka bërë aktive publikimin e njoftimit të fituesit po në këtë datë, si dhe ka bërë shpalljen në buletin e APP nr. 20, datë 04.07.2022.

Marrëveshja kuadër është lidhur me nr. 9311/7 prot., datë 07.07.2022, ndërmjet UKT përfaqësuar nga E.K në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bashkimit të operatorëve ekonomik “O M” Shpk .

Me shkresën nr. 3138 prot., datë 12.08.2022, F.A me detyrë Drejtor i Departamentit Operacional, i kërkon L.R, me detyrë drejtores e Departamentit Ligjor dhe Prokurimeve, kërkesë për lidhje kontrate “Hapje, zhbllokim pusetash”, afati i ekzekutimit të kontratës që nevojitet për një periudhë 6-mujore nga data e nënshkrimit të kontratës me zërat si më poshtë:

-Pastrim pusete me një H-mesat =570 orë.

-Patrim puseta shiu =174 orë

- Zhbllokim kanal kesoni =211 orë.

Me shkresën nr. 93311/11 prot., datë 16.08.2022, Drejtori i Përgjithshëm, i bënë ftesë për ofertë Bashkimit të operatorëve ekonomik “O.M” Shpk .

Bashkimi i operatorëve ekonomik “O.M” Shpk parqet ftesën për ofertë për vlerën 11,379,550 lekë.

-Pastrim pusete me një H-mesat 2.5 për 570 orë x 12,375 lekë/orë = 7,053,750 lekë.

-Patrim puseta shiu 174 orë x 6,550 lekë/orë = 1,139,700 lekë.

-Zhbllokim kanal kesoni 211 orë x 15,100 lekë/orë = 3,186,100 lekë.

Fond rezervë 5 % në vlerën 952,076 lekë.

Me shkresën nr. 93311/12 prot., datë 22.08.2022, Drejtori i Përgjithshëm, njofton për lidhje kontrate Bashkimin e operatorëve ekonomik “O.M” Shpk .

Kontrata është lidhur me nr. 9311/13 prot., datë 25.08.2022 në vlerën 14,338,233 lekë, ndërmjet UKT përfaqësuar nga E.K në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bashkimit të operatorëve ekonomik “O.M” Shpk .

Nuk është siguruar kontrata me siguracion për përgjegjësitë profesionale, veprim në kundërshtim me nenin 14 “Siguracioni i Përgjegjësive Profesionale”, pika 14.1 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Furnizuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Blerësin për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve”.

Pika 14.2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Furnizuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e shërbimeve që po sigurohen”.

Veprim i cili ngarkon F.A me detyrë Drejtor i Departamentit Operacional për periudhën 20.11.2020 dhe në vazhdim,, E.K me detyrë përgjegjës i sektorit të investimeve dhe kanalizimeve.

Viti 2021

Kontrata është lidhur me nr. 9799/13 prot., datë 26.08.2021, për vlerën 13,744,042 lekë ndërmjet UKT përfaqësuar nga E.K në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shoqërisë “O” Shpk.

Zbatimi i kontratës

Me urdhër transfertë datë 15.06.2022 nëpërmjet BKT është likuiduar Shoqëria “O” Shpk për vlerën 2,500,000 lekë.

Me urdhër transfertë datë 13.09.2022 nëpërmjet BKT është likuiduar Shoqëria “O” Shpk për vlerën 4,891,390 lekë. Dokumenti justifikues faturë elektronike numër 9/2022, datë 23.03.2022, për vlerën 5,963,333 lekë. Situacion nr. 1, i pa datuar i firmosur për UKT nga A.N, E.K dhe B.L për vlerën 5,963,333 lekë, si dhe librezë të masave e hartuar në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011, “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, formulari standart, pjesë e këtij udhëzimi. Në librezë janë përcaktuar datat për shërbime 08.01.22-09.03.22, për 435 ore aq sa janë përcaktuar dhe ne situacion. Aktkolaudimi nr. 404/1 prot., datë 23.03.2022 i firmosur nga A.N, E.K dhe B.L.

Faturë elektronike numër 17/2022, datë 06.05.2022, për vlerën 2,782,865 lekë. Situacion nr. 2, i pa datuar i firmosur për UKT nga A.N, EK dhe B.L për vlerën 2,782,865 lekë, për 202 ore, pa librezë të masave. Aktkolaudimi nr. 404/3 prot., datë 06.05.2022 i firmosur nga A.N, E.K dhe B.L.

Faturë elektronike numër 18/2022, datë 06.05.2022, për vlerën 411,516 lekë, pa librezë të masave. Preventiv i fondit rezervë për 23 orë pune x 14,910 lekë/orë = 342,930 lekë x 20 % TVSH (68,586) lekë = 411,516 lekë, i firmosur nga nga A.N, E.K dhe B.L dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Pa situacion dhe pa librezë të masave.

Aktkolaudimi datë 15.05.2021 i firmosur nga E.D, F.M, B.L, pa librezë të masave .

Me urdhër transfertë datë 20.04.2021, nëpërmjet B K është likuiduar Shoqëria “O” Shpk për vlerën 2,500,0000 lekë. Me urdhër transfertë datë 26.06.2021, nëpërmjet B K është likuiduar Shoqëria “O” Shpk për vlerën 2,500,0000 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje numër 16, datë 16.03.2021, për vlerën 7,247,268 lekë. Situacion nr. 1, i pa datuar i firmosur për UKT E.D, F.M, B.L, për vlerën 7,247,268 lekë.

Aktkolaudimi date 15.05.2021 i firmosur nga .D, F.M, B.L, pa librezë të masave.

Me urdhër transfertë datë 06.10.2021, nëpërmjet B K është likuiduar Shoqëria “O” Shpk për vlerën 3,199,952 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje numër 23, datë 07.05.2021, për vlerën 3,903,216 lekë. Situacion përfundimtar, i pa datuar i firmosur për UKT E.D, F.M, B.L për vlerën 11,699,952 lekë, pa librezë të masave.

-Faturë tatimore shitje numër 24, datë 07.05.2021, për vlerën 549,468 lekë, me përshkrimin “Situacion fondi rezervë objekti Shërbimi i pastrimit dhe mirëmbajtës së pusëve, për vlerën 549,468 lekë. Pa përcaktuar zërat, pa preventiv.

Aktkolaudimi date 15.05.2021 i firmosur nga A.N, E.K dhe B.L, pa librezë të masave.

Me urdhër transfertë datë 24.12.2021, nëpërmjet B K është likuiduar Shoqëria “O” Shpk për vlerën 1,500,0000 lekë. Dokumenti justifikues faturë elektronike numër 24/2021, datë 19.10.2021, për vlerën 9,169,543 lekë. Situacion nr. 1, i pa datuar i firmosur për UKT E.D, F.M, B.L për vlerën 7,247,268 lekë.

Aktkolaudimi date 27.08.2021 i firmosur nga A.N, E.K dhe B.L, pa librezë të masave.
Me urdhër transfertë datë 14.01.2022, nëpërmjet B K është likuiduar Shoqëria “O” Shpk për vlerën 6,000,0000 lekë. Dokumenti justifikues faturë elektronike numër 24/2021, datë 19.10.2021, për vlerën 9,169,543 lekë. Situacion nr. 1, i pa datuar i firmosur për UKT A.N, E.K dhe B.L,për vlerën 9,169,543 lekë.

Aktkolaudimi date 27.08.2021 i firmosur nga A.N, E.K dhe B.L, pa librezë të masave .
Me urdhër transfertë datë 30.03.2022, nëpërmjet B K është likuiduar Shoqëria “O” Shpk për vlerën 3,920,021 lekë. Dokumenti justifikues faturë elektronike numër 33/2021, datë 15.11.2021, për vlerën 3,920,021 lekë. Situacion përfundimtar, i pa datuar i firmosur për UKT A.N, E.K dhe B.L,për vlerën 13,733,676 lekë.

Aktkolaudimi date 27.08.2021 i firmosur nga A.N, E.K dhe B.L, pa librezë të masave .
Me urdhër transfertë datë 30.03.2022, nëpërmjet B K është likuiduar Shoqëria “O” Shpk për vlerën 79,979 lekë. Dokumenti justifikues faturë elektronike numër 24/2021, datë 19.10.2021, për vlerën 9,169,543 lekë. Situacion nr.1, i pa datuar i firmosur për UKT A.N, E.K dhe B.L, për vlerën 9,169,543 lekë.

Aktkolaudimi date 27.08.2021 i firmosur nga A.N, E.K dhe B.L, pa librezë të masave.
Me urdhër transfertë datë 11.05.2022, nëpërmjet B K është likuiduar Shoqëria “O” Shpk për vlerën 79,979 lekë. Dokumenti justifikues faturë elektronike numër 24/2021, datë 19.10.2021, për vlerën 9,169,543 lekë. Situacion nr.1, i pa datuar i firmosur për UKT A.N, E.K dhe B.L, për vlerën 9,169,543 lekë.

Aktkolaudimi date 27.08.2021 i firmosur nga A.N, E.K dhe B.L, pa librezë të masave.
Zbatimi i kontratave të mbetje të rezultuara nga Pastrim pusete me një H-mesat 2.5, pastrimi i pusetave të shiut dhe zhbllokim kanaleve të kesonit është bërë pa dokumentacionin përkatës, në kundërshtim me aneksin nr. 1 “Formati i dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme” të VKM nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, pika 4, 5, 6 dhe 9.

Mbetjet nuk janë klasifikuar sipas kodeve përkatëse në kundërshtim me VKM nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, pika 20, mbetjet urbane (mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë fraksionet e mbledhura veçmas: 20 02 02 “Dhera dhe gurë”; 20 02 03 “Mbetje të tjera të pabiodegradueshme”; 20 03 “Mbetje të tjera urbane”; 20 03 01 “Mbetjet e përziera urbane”; 20 03 04 “Llumra nga gropat septike”; 20 03 06 “Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza”; 20 03 07 “Mbetjet të vëllimshme”; 20 03 99 “Mbetjet urbane të paspecifikuara”.

Likuidimet pa situacion dhe p librezë të masave, janë në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011, “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, pika 3.2 dhe 3.3, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4 pika 26, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/b.

Vlera 960,984 lekë (fonde rezervë) është përfutuar padrejtësisht nga Shoqëria Shoqërisë “O” Shpk, si pasojë përllogaritjeve të gabuara dhe përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “UKT” Sha dhe Buxhetin e Shtetit duhet të dëmshpërblehet nga kjo Shoqëri, referuar të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655, ku është shprehur në mënyrë ekslcite se “përcaktohet se: *“Personi që pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose*

ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar brenda caqeve të begatimit pa shkak”.

Veprim i cili ngarkon F.A me detyrë Drejtor i Departamentit Operacional për periudhën 20.11.2020 dhe në vazhdim, E.K me detyrë përgjegjës i sektorit të investimeve dhe kanalizimeve.

9.Proçedura e prokurimit me objekt “Blerje Tuba dhe Rekorderi”, viti 2022.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje Tuba dhe Rekorderi”.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. nr. 23378 prot., datë 30.12.2022	3. Njësia e prokurimit Urdhër 15437 prot, datë03.09.2021 - A Q; jurist - E K; ing. hidro - D G; juriste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Kacidhja nr. 1094/2 prot., datë 30.05.2019 -L.R; jurist - E.O ; ing. mjedisi - F A; ekonomist
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Marrëveshje kuader”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 149,858,642 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 149,858,642 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 07.02.2021	9. Burimi Financimit Fond nga Te ardhurat e shoqërisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër <u>3</u> OE b) S’kualifikuar <u>2</u> OE, c) Kualifikuar <u>1</u> OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik -
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e minikontratave nr. 23378/11 prot., datë 18.03.2022 dhe nr. 23378/18 prot., datë 29.09.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 149,858,642 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.)të A.P.P, u konstatua se:

Me shkresën nr. 3470 prot., datë 06.09.2022, F.A, me detyrë Drejtor i Departamentit Operacional, i kërkon L.R, me detyrë drejtoreshë e Departamentit Ligjor dhe Prokurimeve, prokurimin për blerje tuba dhe rekorderi.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 387, datë 22.12.2021, është ngritur grupi i punës për rritimin e tregut dhe hartimin e specifikimeve teknike të përbërë nga A.N, E.K dhe A.S.

Me relacion të protokolluar nr. 387/1, datë 28.12.2021, grupi i punës për testimin e tregut ka përcaktuar vlerën 149,858,642 lekë pa TVSH. Përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar, pas çmimit mesatar për çdo artikull të ofruar nga operatorët ekonomik “W” Shpk në vlerën 152,982,170 lekë për njësi, materiale hidraulike, “H” Shpk në vlerën 148,186,315 lekë për njësi, “N K” Shpk në vlerën 148,407,441 lekë për njësi.

Si konkluzion, përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i UK te tjera) veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i llogaritjes së vlerës së kontratës i përbërë nga A.N, E.K dhe A.S.

Me urdhrat të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 23378 prot., datë 30.12.2021, është përcaktuar procedura e prokurimit procedura marrëveshje kuadër, njësia e prokurimit; A.Q me profesion juriste, E.K me profesion ing hidro, D.G me profesion juriste.

Me urdhrat të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 23378/1 prot., datë 30.12.2021, është përcaktuar komision të vlerësimit të ofertave i përbërë nga L.R me profesion juriste/kimist, F.A me profesion ekonomist, E.O me profesion ing. Mjedisi.

Specifikimet teknike nuk janë përcaktuar në referencë ne VKM nr.83 datë 10.02.2021 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit për furnizimin me ujë dhe kanalizime. Konkretisht nuk është përcaktuar për tubat e polietilenit dhe PVC përbërja 7.1.1: Materiali i punuar nga tubat e zhveshur me shtresë të hequr nuk duhet përdorur.

Shiritat identifikues : Standardi SSHEN 122001-SSHEN ISO 3126 viti 2005.

7.8.1 : Shënrimi në mënyrë të përhershme dhe të lexueshme, që shënrimi mos të krijojë të çara ose lloje të tjera shkatërruese dhe ruajtjen normale nga moti, trajtimi, instalimi referuar standardit CEN/TR15433 .

Shënrimi minimal i tubave duhet te ketë:

Nr. Standardit SSHEN 122001, emri dhe marka e prodhuesit, përmasat (p.sh 110*10) seritë (SRD përdorim i synuar W(Tub i destinuar për konsum njerëzor) P (i destinuar për kanalizim dhe kullim me presion) W/P për te dyja rastet .

Materiali dhe projektimi PE100, informacioni i prodhuesit (1009), lloji i materialit të përberë me shtresë të heqëshme, shifra e qarte ose kodi qe siguron gjurmëshmërinë për periudhën e prodhimit brenda vitit dhe muajit dhe nëse prodhuesi prodhon në vende të ndryshme, vendi i prodhimit. Jetëgjatësinë mbi afërsisht 50 vite etj.

Referuar këtij vendimi duhet të ishin dhe specifikimet për Tub CE, Rekorderit, reduksionet, Stafat, fashetat, fllanxhat etj.

Kërkesat për kualifikim janë miratuar me procesverbal të datës 30.12.2021 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë A.Q, E.K dhe D.G, tek ky procesverbal nuk janë përcaktuar kriteret e vlerësimit, por janë përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës është bërë me shkresën nr. 23378/2/3 prot., datë 30.12.2021 nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, publikuar nga APP në buletin nr. 192, datë 31.12.2021, duke përcaktuar si afat të fundit të hapjes së ofertave datë 31.01.2022 ora 10.00.

Me shkresën nr. 5385 prot., datë 30.12.2021 nga L.R me detyrë drejtore e Departamentit Ligjor dhe Prokurimeve i është drejtuar A.P me detyrë përgjegjëse pranë sektorit të marrëdhënieve me publiku dhe median për botimin e njoftimit të kontratës.

Me shkresën nr. 5385/1 prot., datë 30.12.2021, është bërë njoftimi i kontratës në gazetë.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët operatorë ekonomike.

-Shoqëria “V” Shpk, me ofertë në vlerën 127,380,089 lekë.

-Shoqëria “A C” Shpk, me ofertë në vlerën 144,907,770 lekë.

-Shoqëria “L” Shpk, me ofertë në vlerën 147,908,345 lekë.

Procesverbali i vlerësimit të operatorëve ekonomik mban datë 07.02.2022, ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik “A C” Shpk, me ofertë në vlerën 144,907,770 lekë, duke s kualifikuar dy operatorët e tjerë.

Raporti përmbledhës nr. 23378/6 prot., datë 24.02.2022, i firmosur nga KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën nr. 23378/5 prot., datë 10.02.2022, është kryer njoftimi i fituesit, butuar në buletin e APP nr.96, datë 14.09.2022.

Marrëveshja kuadër është lidhur me nr. 23378/8 prot., datë 02.03.2022 ndërmjet UKT përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “A C” Shpk në vlerën 149,858,642 lekë.

Me shkresën nr. 892 prot., datë 04.03.2022, F.A me detyrë Drejtor i Departamentit Operacional, i kërkon L.R me detyrë drejtores e Departamentit Ligjor dhe Prokurimeve, lidhjen e kontratës.

Me shkresën nr. 23378/10 prot., datë 10.03.2022, i është bërë ftesë për ofertë operatorit ekonomik “A ” Shpk për lidhje minikontratë për sasinë 453 artikuj.

Operatori ekonomik “A ” Shpk paraqet ofertën e tij në vlerën 130,336,741 lekë p a TVSH dhe 156,404,089 lekë me tvsh, ose 87 % të vlerës së fondit limit, ose 90 të ofertës fituese.

Me shkresën nr. 23378/11 prot., datë 18.03.2022, i është njoftuar operatori ekonomik “A C” Shpk për lidhje minikontratës.

Kontrata është lidhur me nr. 23378/11 prot., datë 18.03.2022 ndërmjet UKT përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “A C” Shpk në vlerën 156,404,089 lekë lekë, pa tvsh në vlerën 130,336,741 lekë.

Me shkresën nr. 23378/16 prot., datë 10.08.2022, i është bërë ftesë për ofertë operatorit ekonomik “A C” Shpk për lidhje minikontratë për sasiën 150 artikuj.

Operatori ekonomik “A C” Shpk paraqet ofertën e tij në vlerën 19,312,225 lekë p a TVSH dhe 123,174,670 lekë me tvsh.

Me shkresën nr. 23378/17 prot., datë 26.09.2022, i është njoftuar operatori ekonomik “A C” Shpk për lidhje minikontratës.

Kontrata është lidhur me nr. 23378/18 prot., datë 29.09.2022 ndërmjet UKT përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “A C” Shpk në vlerën 23,174,670 lekë lekë, në vlerën 19,312,225 lekë.

Referuar sa më sipër vlera e fondit limit (marrëveshja kuadër) është realizuar 100 % brenda 5 muajve.

Lidhja e kontratave është realizuar mbi bazën e marrëveshjes kuadër, e cila pavarësisht se ka ndikuar në uljen e çmimit për njësi, por si shpenzim ka shkuar tek fondi limit, duke rritur numrin e pjesëve/njësive dhe në rastin e audituar asnjëherë uljen e numrit të pjesëve/njësive si dhe pakësimin jo vetëm të fondit limit por edhe as të vlerës së prokuruar, dhe mbart në të ardhmen riskun e lart të përzgjedhjes së pjesëve/njësive me vlerë më të lart, duke mos arritur në këtë mënyrë uljen kostove të blerjeve/shërbimeve. Veprime në kundërshtim me Udhëzim e APP nr. 6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, me ndryshimet vijuese të tij, pikat 7.1,7.2 dhe 7.3.

Në opinionin e grupit të auditimit lidhja e kontratave mbi bazën e marrëveshjeve kuadër, duhet konsideruar si rast i veçantë dhe Autoriteti Kontraktor nuk duhet në asnjë rast të abuzojë me

përdorimin e këtij instrumenti, me qëllim shtrembërimin e konkurrencës. Përdorimi i kësaj forme prokurimi detyrimisht duhet të arrij reduktimin e kostove transaksionale, përmirësimin e vazhdueshëm në harkun e marrëdhënieve afat-gjatë ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Operatorëve Ekonomik, në interes të konsumatorit, në rastin konkret përmirësimin e shërbimit të ujit për qytetarët.

Në dokumentet e tenderit dhe në minikontratat e lidhura nuk është përcaktuar se tubat dhe rekorderit do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqëruar të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Çertifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.*

Duke marr në konsideratë edhe faktin se specifikimet teknike nuk janë përcaktuar në referencë të VKM nr.83 datë 10.02.2021 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit për furnizimin me ujë dhe kanalizime”, me mangësitë e përshkruara si më lartë, grupi i auditimit nuk mund të shprehet për respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë e mallrave(pajisjeve) që janë marr nga Autoriteti Kontraktor, me vlerë të faturuar 156,404,089 leke dhe me vlerë të likuiduar 78,416,906 lekë.

10.Proçedura e prokurimit me objekt “Rinovim i Suportit të Infrastrukturës Qëndrore”, viti 2022.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rinovim i Suportit të Infrastrukturës Qëndrore”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 12469 prot., datë 01.07.2022	3. Njësia e prokurimit Urdhër 15437 prot, datë03.09.2021 - A Q; juriste - K T; ekonomiste - S Ç; ekonomiste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Kacidhja nr. 1094/2 prot., datë 30.05.2019 -L.R; juriste - F.V; jurist - N P; informatik
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedur e hapur”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 20,890,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 19,837,880 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,052,120 leke
8. Data e hapjes së tenderit 07.02.2021	9. Burimi Financimit Fond nga Te ardhurat e shoqërisë	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër __1__OE c) Kualifikuar __1__ OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik -
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 12469/4 prot., datë 27.07.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 23,805,456 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.)të A.P.P, u konstatua se:

Me shkresën nr. 2352 prot., datë 15.06.2022, F.V me detyrë Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse, i kërkon L.R me detyrë drejtores e Departamentit Ligjor dhe Prokurimeve, prokurimin “Rinovim i Suportit të Infrastrukturës Qëndrore”.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 139, datë 04.05.2022, është ngritur grupi i punës për ri testimin e tregut dhe hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga E.I, L.S dhe E.Q.

Me relacion të protokolluar nr. 139/1, datë 10.06.2022, grupi i punës për testimin e tregut dhe hartimin e specifikimeve teknike ka përcaktuar vlerën 20,890,000 lekë pa TVSH. Përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar, pas çmimit mesatar për çdo shërbim të ofruar nga operatorët ekonomik “T S” Shpk në vlerën 21,408,150 lekë për shërbim, “I S” Shpk në vlerën 20,625,000 lekë për shërbim, “C C” Shpk në vlerën 19,926,850 lekë për shërbim, “G S” Shpk në vlerën 21,600,000 lekë për shërbim.

Si konkluzion, përllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i UK te tjera) veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se

1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet” .

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i llogaritjes së vlerës së kontratës i përbërë nga E.I, L.S dhe E.Q.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 12469 prot., datë 01.07.2022, është përcaktuar procedura e prokurimit procedurë e hapur me vlerën 20,890,000, njësia e prokurimit, A.Q me profesion juriste, K.T me profesion ekonomiste , S.Ç me profesion informatik.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 12469/1 prot., datë 01.07.2022, është përcaktuar komision të vlerësimit të ofertave i përbërë nga L.R me profesion juriste/kimist, F.V me profesion jurist, N.P me profesion informatik.

Kërkesat për kualifikim janë miratuar me procesverbal të datës 30.12.2021 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë A.Q, K.T dhe S.Ç, tek ky procersverbal nuk janë përcaktuar kriteret e vlerësimit, por janë përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës është bërë me shkresën nr. 12469/2 prot., datë 01.07.2022 nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, publikuar nga APP në buletin nr. 94, datë 12.07.2022, duke përcaktuar si afat të fundit të hapjes së ofertave datë 19.07.2022 ora 10.00.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët operatorë ekonomike.

-Shoqëria “C S” Shpk në vlerën, me ofertë në vlerën 19,837,880 lekë.

Procesverbali i vlerësimit të operatorëve ekonomik mban datë 22.07.2022, ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik “C S” Shpk në vlerën, me ofertë në vlerën 19,837,880 lekë.

Raporti përmbledhës nr. 12469/5 prot., datë 27.07.2022 , i firmosur nga KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën nr. 12469/4 prot., datë 27.07.2022, është kryer njoftimi i fituesit, butuar në buletin e APP nr.106, datë 01.08.2022.

Kontrata është lidhur me nr. 12469/4 prot., datë 27.07.2022 ndërmjet UKT përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “CCS” Shpk në vlerën 19,837,880 lekë.

11.Procedura e prokurimit me objekt “Blerje Kimikate”, viti 2022.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje kimikate”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. nr. 15912/2 prot, datë 12.09.2022	3. Njësia e prokurimit Urdhër 15437 prot, datë03.09.2021 - A.Q; ingxhinjer hidro - K.T; ekonomiste - T K; kimiste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Kacidhja nr. 1094/2 prot., datë 30.05.2019 -L.R; juriste - E.O ; ing. mjedisi - R K; bio-kimist
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë negociom pa shpallje kontrate”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) Loti 1= 23,200,000 lekë, loti 2= 18,773,333 leke, loti3 = 18,880,000 leke Shuma 60,853,333 leke	6. Oferta fituese (pa tvsh) Loti 1= 22,400,000 lekë, loti 2= 18,560,000 leke, loti3 = 17,920,000 leke Shuma 58,880, 000leke	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,973,333 leke
8. Data e hapjes së tenderit 05.07.2021	9. Burimi Financimit Fond nga Te ardhurat e shoqërisë	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>3</u> OE b) S`kualifikuar <u>2</u> OE, c) Kualifikuar <u>1</u> OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik -
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 15912/8 prot., datë 19.09.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 70,656,000 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.)të A.P.P, u konstatua se:

Me shkresën nr. 3470 prot., datë 06.09.2022, E.O me detyrë Drejtor i Departamentit Inxhinierik, i kërkon L.R me detyrë drejtores e Departamentit Ligjor dhe Prokurimeve, blerje kimikate për UKT Sh.a të ndarë në lote.

Me shkresën nr. 3473 prot., datë 06.09.2022, K.K me detyrë Drejtor i Departamentit të Prodhim Shpërndarjes, i kërkon L.R me detyrë drejtores e Departamentit Ligjor dhe Prokurimeve, blerje kimikate për UKT Sh.a të ndarë në lote.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 261, datë 23.08.2022, është ngritur grupi i punës për testimin e tregut dhe specifikimet teknike i përbërë nga X.H, A.Q dhe B.N.

Me relacion të protokolluar nr. 261/1, datë 02.09.2022, grupi i punës për testimin e tregut dhe specifikimet teknike ka përcaktuar vlerën 60,853,333 lekë pa TVSH.

Pra, përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 60,853,333 lekë, duke cilësuar në preventiv hipoklorit natriumi 13-15%, sasia 400,000 kg x 58 lekë/kg = 23,200,000 lekë, Acid klorhidrik 30-33 % sasia 320,000 kg x 59 lekë/kg = 18,773,333 lekë dhe Poliklorur Alumini 10-0.5 % sasia 320,000 kg x 59 lekë/kg = 18,880,000 lekë.

Pra, përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 60,853,333 lekë, pas ofertës të ofruar nga operatorët “A T” Shpk, hipoklorit natriumi 13-15% në vlerën 56 lekë/kg, Acid klorhidrik 30-33 % në vlerën 58 lekë/kg, Poliklorur Alumini 10-0.5 % në vlerën 56 lekë/kg, “C G” Shpk hipoklorit natriumi 13-15% në vlerën 60 lekë/kg, Acid klorhidrik 30-33 % në vlerën 59 lekë/kg, Poliklorur Alumini 10-0.5 % në vlerën 62 lekë/kg dhe “A” Shpk hipoklorit natriumi 13-15% në vlerën 58 lekë/kg, Acid klorhidrik 30-33 % në vlerën 59 lekë/kg, Poliklorur Alumini 10-0.5 % në vlerën 59 lekë/kg. Llogaritja është bërë me çmim mesatar.

Si konkluzion, përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i UK te tjera) veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 15912 prot., datë 06.09.2022, janë përcaktuar personat përgjegjës për procedurën e prokurimit blerje kimikate, loti i 1 hipoklorit natriumi 13-15%, loti 2, Acid klorhidrik 30-33 % dhe loti 3 Poliklorur Alumini 10-0.5 %, A.Q me profesion jurist, K.T me profesion ekonomist, T.K me profesion ing. kimist.

Me memo nr. 15912/1 prot, datë 06.09.2022, personat përgjegjës duke u miratuar dhe L.R me detyrë drejtor i departamentit Ligjor dhe Prokurimeve, i drejtohen Drejtorit të Përgjithshëm duke argumentuar, nevojën e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 15912/2 prot., datë 12.09.2022, është përcaktuar procedura e prokurimit procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, loti i 1, hipoklorit natriumi 13-15% për vlerën 23,200,000 lekë, loti 2, Acid klorhidrik 30-33 % për vlerën 18,773,333 lekë dhe loti 3 Poliklorur Alumini 10-0.5 % për vlerën 18,880,000 lekë , njësia e prokurimit %, A.Q me profesion juriste, K.T me profesion ekonomist, T.K, me profesion ing. kimiste.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 15912/2 prot., datë 12.09.2022, është përcaktuar procedura e prokurimit procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, loti i 1, hipoklorit natriumi 13-15% për vlerën 23,200,000 lekë, loti 2, Acid Klorhidrik 30-33 % për vlerën 18,773,333 lekë dhe loti 3 Poliklorur Alumini 10-0.5 % për vlerën 18,880,000 lekë,

komision të vlerësimit të ofertave i përbërë nga L.R me profesion juriste/kimist, E.O me profesion ing. mjedisi, R.K me profesion bio-kimist.

Kërkesat për kualifikim dhe specififikimet teknike janë miratuar me procesverbal të pa datuar të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë A.Q, K.T, T.K, tek ky procesverbal nuk janë përcaktuar kriteret e vlerësimit, por janë përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Me shkresën nr. 15912/4 prot, datë 12.09.2022 janë ftuar për pjesëmarrje operatorët ekonomik “AT” Shpk, “C G” Shpk dhe “A” Shpk.

Me shkresën nr. 15912/5 prot, datë 15.09.2022 nga Autoriteti Kontraktor i është kërkuar operatorit ekonomik “AT” Shpk, konfirmim i ofertës ekonomike.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomike.

Loti 1, hipoklorit natriumi 13-15%

-Shoqëria “AT” Shpk, me ofertë në vlerën 22,400,000 lekë.

-Shoqëria “C G” Shpk, me ofertë në vlerën 0 lekë.

-Shoqëria “A” Shpk, me ofertë në vlerën 23,200,000 lekë.

Loti 2, Acid klorhidrik 30-33 %

-Shoqëria “AT” Shpk, me ofertë në vlerën 18,560,000 lekë.

-Shoqëria “C G” Shpk, me ofertë në vlerën 0 lekë.

-Shoqëria “A” Shpk, me ofertë në vlerën 18,752,000 lekë.

Loti 3 Poliklorur Alumini 10-0.5 %

-Shoqëria “AT” Shpk, me ofertë në vlerën 17,920,000 lekë.

-Shoqëria “C G” Shpk, me ofertë në vlerën 0 lekë.

-Shoqëria “A” Shpk, me ofertë në vlerën 18,880,000 lekë.

Pas vlerësimit të KVO, u kualifikua dhe shpall fitues Shoqëria “AT” Shpk, me ofertë për Lotin 1, hipoklorit natriumi 13-15%, në vlerën 22,400,000 lekë, duke u s’kualifikuar dy operatorët e tjerë, Loti 2, Acid klorhidrik 30-33 % në vlerën 18,560,000 lekë dhe Loti 3 Poliklorur Alumini 10-0.5 % në vlerën 7,920,000 lekë, duke u s’kualifikuar dy operatorët e tjerë.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit, është hartuar me nr. 15912/8 prot., datë 19.09.2022, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Kontrata është lidhur me nr. 15912/8 prot., datë 19.09.2022, për Lotin 1, hipoklorit natriumi 13-15%, në vlerën 26,880,000 lekë me TVSH, për Loti 2, Acid klorhidrik 30-33 % në vlerën 22,272,000 lekë me TVSH dhe Loti 3 Poliklorur Alumini 10-0.5 % në vlerën 21,504,000 lekë me TVSH ndërmjet UKT përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “AT” Shpk në vlerën 11,649,132 lekë, me afat ekzekutimi 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar bërë me nr. 29469/8 prot., datë 17.01.2022.

Në datën 17.01.2022 në S.P.E. e A.P.P, është kryer publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës, nga ku A.P.P. e ka bërë aktive këtë publikim në datën 18.01.2022.

Zbatimi i kontratës

1. Hipoklorit natriumi 13-15%

Nuk ka likuidim deri më datën 30.11.2022.

Faturë tatimore shitje me numër 609/2022, datë 17.10.2022 për vlerën 1,697,472 lekë, për 25,260 kg Hipoklorit Natriumi. Fletë hyrje nr. 108, datë 17.10.2022. Aktkolaudimi nr. 15 datë 17.10.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1238, datë 17.10.2022, lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin. Analizë nga impiantit i trajtimit të ujit të pijshëm Bovill, datë 17.10.2022, pa përcaktuar specifikisht analizën por vetë (1,2,3) firmosur nga kimistja A.Q.

Çertifikatë origjine me logo “A” “C” shpk e firmosur nga Administratori N.S. Specifikat (çertifikatë cilësie) pa përcaktuar datën e furnizimit, me logo “A” “C” shpk Korçë e firmosur nga Administratori i N.S, e firmosur nga kimisti/kimistja K.P,

Faturë tatimore shitje me numër 599/2022, datë 12.10.2022 për vlerën 1,700,160 lekë, për 25,300 kg Hipoklorit Natriumi. Fletë hyrje nr. 105, datë 12.10.2022. Aktkollaudimi nr. 13 datë 12.10.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1198, datë 12.10.2022, lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin. Analizë nga impiantit i trajtimit të ujit të pijshëm Bovill, datë 12.10.2022 pa përcaktuar specifikisht analizën por vetëm (1,2,3) firmosur nga kimistja A.Q

Çertifikatë origjine me logo “A” “C” shpk e firmosur nga Administratori N.S. Specifikat (çertifikatë cilësie) me datë furnizimi 12.10.2022, me logo “A” “C” shpk e firmosur nga Administratori i N.S, e firmosur nga kimisti/kimistja K.P.

Faturë tatimore shitje me numër 581/2022, datë 04.10.2022 për vlerën 1,706,880 lekë, për 25,400 kg Hipoklorit Natriumi. Fletë hyrje nr. 102, datë 04.10.2022. Aktkollaudimi nr. 11 datë 04.10.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1159, datë 04.10.2022, lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin. Analizë nga impiantit i trajtimit të ujit të pijshëm Bovill, datë 04.10.2022 pa përcaktuar specifikisht analizën por vetëm (1,2,3) firmosur nga kimistja A.Q.

Çertifikatë origjine me logo “A” “C” Shpk e firmosur nga Administratori N.S. Specifikat (çertifikatë cilësie) datë 04.10.2022, me logo “A” “C” Shpk Korçë e firmosur nga Administratori i N.S, e firmosur nga kimisti/kimistja K.P.

Faturë tatimore shitje me numër 566/2022, datë 28.09.2022 për vlerën 1,706,880 lekë, për 25,400 kg Hipoklorit Natriumi. Fletë hyrje nr. 98, datë 28.09.2022. Aktkollaudimi nr. 8 datë 28.09.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1132, datë 28.09.2022, lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin. Analizë nga impiantit i trajtimit të ujit të pijshëm Bovill, datë 28.09.2022 pa përcaktuar specifikisht analizën por vetëm (1,2,3) firmosur nga kimistja B.B.

Çertifikatë origjine me logo “A” “C” Shpk e firmosur nga Administratori N.S. Specifikat (çertifikatë cilësie) datë 28.09.2022, me logo “A” “C” shpk Korçë e firmosur nga Administratori i N.S, e firmosur nga kimisti/kimistja K.P.

Faturë tatimore shitje me numër 544/2022, datë 22.09.2022 për vlerën 779,520 lekë, për 11,600 kg Hipoklorit Natriumi. Fletë hyrje nr. 95, datë 22.09.2022.

Aktkollaudimi nr. 5 datë 22.09.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1108, datë 22.09.2022, lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin. Analizë nga laborari kimiko-bakterologjik, datë 22.09.2022 pa përcaktuar specifikisht analizën por vetëm (1,2,3) firmosur nga kimistja M.D dhe B.N.

Çertifikatë origjine me logo “A” “C” shpk e firmosur nga Administratori N.S. Specifikat (çertifikatë cilësie) datë 22.09.2022, me logo “A” “C” shpk Korçë e firmosur nga Administratori i N.S, pa firmosur nga Kimisti.

Faturë tatimore shitje me numër 540/2022, datë 21.09.2022 për vlerën 1,697,472 lekë, për 25,260 kg Hipoklorit Natriumi. Fletë hyrje nr. 93, datë 21.09.2022. Aktkollaudimi nr. 2 datë 21.09.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1093, datë 21.09.2022, lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin. Analizë nga impiantit i trajtimit të ujit të pijshëm Bovill, datë 21.09.2022 pa përcaktuar specifikisht analizën por vetëm (1,2,3) firmosur nga kimistja A.Q

Çertifikatë origjine me logo “A” “C S” shpk e firmosur nga Administratori N.S. Specifikat (çertifikatë cilësie) datë 21.09.2022, me logo “A” “C” shpk Korçë e firmosur nga Administratori i N.S, firmosur nga kimistja K.P.

Faturë tatimore shitje me numër 539/2022, datë 21.09.2022 për vlerën 1,692,096 lekë, për 25,180 kg Hipoklorit Natriumi. Fletë hyrje nr. 92, datë 21.09.2022. Aktkolaudimi nr. 1 datë 21.09.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1093, datë 21.09.2022, lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin, **i fotokopjuar**. Analizë nga impiantit i trajtimit të ujit të pijshëm Bovill, datë 21.09.2022 pa përcaktuar specifikisht analizën por vetëm (1,2,3) firmosur nga kimistja A.Q.

Çertifikatë origjine me logo “A” “C” Shpk e firmosur nga Administratori N.S. Specifikat (çertifikatë cilësie) datë 21.09.2022, me logo “A” “C” shpk Korçë e firmosur nga Administratori i N.S, dhe nga kimistja K.P, si dhe skedë sigurie e pa datuar e firmosur nga Administratori N.S.

Faturë tatimore shitje me numër 545/2022, datë 22.09.2022 për vlerën 752,640 lekë, për 11,100 kg Hipoklorit Natriumi. Fletë hyrje nr. 43, datë 22.09.2022. Aktkolaudimi nr. 6 datë 22.09.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1108, datë 22.09.2022, lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin. Analizë nga laboratorit kimiko-bakterologjik, datë 22.09.2022 pa përcaktuar specifikisht analizën por vetë (1,2,3) firmosur nga kimistja M.D dhe B.N.

Çertifikatë origjine me logo “A” “C” Shpk e firmosur nga Administratori N.S, **i fotokopjuar**. Specifikat (çertifikatë cilësie) datë 21.09.2022, me logo “A” “C” Shpk Korçë e firmosur nga Administratori i N.S, dhe nga kimistja K.P, si dhe skedë sigurie e pa datuar e firmosur nga Administratori N.S. Faturë tatimore shitje me numër 541/2022, datë 21.09.2022 për vlerën 564,480 lekë, për 8,400 kg Hipoklorit Natriumi. Fletë hyrje nr. 42, datë 21.09.2022.

Aktkolaudimi nr. 3 datë 21.09.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1093, datë 21.09.2022, lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin. Analizë nga laboratorit kimiko-bakterologjik, datë 22.09.2022 pa përcaktuar specifikisht analizën por vetëm (1,2,3) firmosur nga kimistja M.D dhe B.N. Çertifikatë origjine me logo “A” “C” shpk e firmosur nga Administratori N.S. Specifikat (çertifikatë cilësie) datë 21.09.2022, me logo “A” “C” shpk Korçë e firmosur nga Administratori i N.S, dhe nga kimistja K.P.

Raportet e analizës specifikat (Specifikat (çertifikatë cilësie) lëshuar nga laboratorit “A” “C” Shpk Korçë, janë dokumente të pavlefshme, pasi ky laborator nuk është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme Kalibrimeve, veprim në kundërshtim me:

Ligjin nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 5, pika 1 dhe 4 dhe Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot., datë 16.03.2018.

-Shtojcën 6 “Specifikimet teknike” të dokumenteve të tenderit, pika 5.

-Piken 5 të kontratës së nënshkruar “Dokumentacioni shoqërues i çdo ngarkese të kimikateve të trajtimit të ujit me të cilën do të furnizohet Impianti i Bovillës ”.

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: “1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”.

- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur “Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila

konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguar”.

Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7.

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35.

2. Acid klorhidrik 30-33 %

Faturë tatimore shitje me numër 597/2022, datë 11.10.2022 për vlerën 1,773,408 lekë, për 25,480 kg Acid Klorhidrik. Fletë hyrje nr. 104, datë 11.10.2022.

Atkkollauidimi nr. 12 datë 11.10.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1191, datë 11.10.2022, lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin. Analizë nga impiantit i trajtimit të ujit të pijshëm Bovill, datë 11.10.2022 pa përcaktuar specifikisht analizën, por vetëm (1,2,3) firmosur nga kimistja A.Q.

Çertifikatë origjine me logo “G B” Greqi. Dhe çertifikatë analize lëshuar nga “G B” Greqi.

Faturë tatimore shitje me numër 567/2022, datë 28.09.2022 për vlerën 1,766,448 lekë, për 25,380 kg Acid Klorhidrik. Fletë hyrje nr. 97, datë 28.09.2022.

Atkkollauidimi nr. 9 datë 28.09.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1133, datë 28.09.2022, lëshuar nga Operatori i i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin. Analizë nga impiantit i trajtimit të ujit të pijshëm Bovill, datë 28.09.2022 pa përcaktuar specifikisht analizën, por vetëm (1,2,3) firmosur nga kimistja A.Q.

Çertifikatë origjine me logo “G B” Greqi. Dhe çertifikatë analize lëshuar nga “G B” Greqi.

Faturë tatimore shitje me numër 542/2022, datë 21.09.2022 për vlerën 1,763,664 lekë, për 25,340 kg Acid Klorhidrik. Fletë hyrje nr. 94, datë 21.09.2022. Atkkollauidimi nr. 4 datë 21.09.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1092, datë 21.09.2022, lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin. Analizë nga impiantit i trajtimit të ujit të pijshëm Bovill, datë 21.09.2022 pa përcaktuar specifikisht analizën por vetëm (1,2,3) firmosur nga kimistja A.Q.

Çertifikatë origjine me logo “G B” Greqi, e përkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe. Dhe çertifikatë analize lëshuar nga “G B” Greqi, e përkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe. Identifikimi i substancës/preparati, e përkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe.

Autorizim importi nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale nr. 3, për periudhën 02.07.2021-02.07.2023.

-Shtojcën 6 “Specifikimet teknike” të dokumenteve të tenderit, pika 5.

-Piken 5 të kontratës së nënshkruar “Dokumentacioni shoqërues i çdo ngarkese të kimikateve të trajtimit të ujit me të cilën do të furnizohet Impianti i Bovillës ”.

3. Poliklorur Alumini 10-0.5 %

Faturë tatimore shitje me numër 608/2022, datë 17.10.2022 për vlerën 1,514,688 lekë, për 22,540 kg Poliklorur Alumini 10-0.5 %. Fletë hyrje nr. 107, datë 17.10.2022. Atkkollauidimi nr. 14 datë 17.10.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1231, datë 17.10.2022, lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin. Analizë nga impiantit i trajtimit të ujit të pijshëm Bovill, datë 17.10.2022 pa përcaktuar specifikisht analizën, por vetëm (1,2,3) firmosur nga kimistja A.Q.

Çertifikatë origjine me logo “TS” Greqi, e përkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe dhe çertifikatë analize lëshuar nga “TS” Greqi, e përkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe. Indetifikim i substancës/preparati, e përkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe.

Faturë tatimore shitje me numër 574/2022, datë 30.09.2022 për vlerën 1,532,160 lekë, për 22,800 kg Poliklorur Alumini 10-0.5 %. Fletë hyrje nr. 100, datë 30.09.2022. Aktkollaudimi nr. 10 datë 30.09.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1157, datë 30.09.2022, lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin. Analizë nga impiantit i trajtimit të ujit të pijshëm Bovill, datë 30.09.2022 pa përcaktuar specifikisht analizën, por vetëm (1,2,3) e firmosur nga kimistja B.B.

Çertifikatë origjine me logo “C D”. Çertifikatë analize lëshuar nga “C D”, dhe Indetifikim i substancës/preparati.

Faturë tatimore shitje me numër 553/2022, datë 24.09.2022 për vlerën 2,526,720 lekë, për 37,600 kg Poliklorur Alumini 10-0.5 %. Fletë hyrje nr. 96, datë 24.09.2022. Aktkollaudimi nr. 7 datë 24.09.2022 i firmosur nga A.K, B.N, D.X, A.Q. Raport analize nr. 1121, datë 24.09.2022, lëshuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, vetëm për ngjyrën, densitetin dhe titullin. Analizë nga impiantit i trajtimit të ujit të pijshëm Bovill, datë 30.09.2022 pa përcaktuar specifikisht analizën por vetëm (1,2,3) e firmosur nga kimistja B.B

Çertifikatë origjine me logo “C D” dhe Çertifikatë analize lëshuar nga “C D”, dhe Indetifikim i substancës/preparati.

Autorizim importi nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale nr. 16, për periudhën 22.06.2022-22.06.2024.

Shtojcën 6 “Specifikimet teknike” të dokumenteve të tenderit, pika 5.

-Piken 5 të kontratës së nënshkruar “Dokumentacioni shoqërues i çdo ngarkese të kimikateve të trajtimit të ujit me të cilën do të furnizohet Impianti i Bovillës ”.

Për sa më sipër mbanë përgjegjëgjësi grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga A.K, B.N, D.X, A.Q.

Mbi zbatimin e kontratave të punëve publike.

12. Ndërtim rrjet kanalizimi rruga e Durrësit.

Objekti është kryer sipas kontratës për punë publike me Nr.6091/6 Prot datë 24.06.2020 me objekt “Ndërtim rrjet kanalizimi rruga e Durrësit” të lidhur mes Autoritetit Kontraktor UKT sh.a, të përfaqësuar nga Titullari z. R.M dhe B “V K” shpk me licence Nr. & “B” shpk & “M” shpk . Vlera e kontratës është 113,715,031 lekë pa TVSH ose 136,458,037 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 4(katër) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit Nr.7904/20 prot, datë 24.06.2020, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “E” shpk, me përfaqësues G I, me nr. licence për mbikëqyrje kollaudim punimesh MK.5304/15, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 2,014,484 lekë pa TVSH ose 2,417,380 lekë me TVSH.

Kontratës së punimeve civile i është bërë shtesë kontrate me Nr.13890/6prot. datë 11.09.2020 me vlerë 22,622,254 lekë pa TVSH ose 27,146,704 lekë me TVSH dhe afat përfundimi të punimeve shtesë 20 ditë nga lidhja e kontratës, pra afati i përfundimit të punimeve nga kontrata bazë nuk ndryshon ajo ngelet data 05.11.2020. Gjithashtu, mbikëqyrja e punimeve shtesë është bërë sipas kontratës Nr.13377/7Prot. datë 04.09.2020 të lidhur me OE “E ” shpk me vlerë 387,450 lekë me TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konkretisht, projekti fillestar dhe preventivi i marrë për bazë për llogaritja e fondit limit konstatohet se poshtë tubave të kanalizimeve është vendosur si zë i veçantë nënshtresë zhavorri dhe shtresë beton C7/10.

Referuar manualit të çmimeve për vendosjen e tubave B/A me diametra të ndryshëm nënshtresa e zhavorrit dhe shtresa e betonit janë të përfshira në furnizim vendosjen e tyre si tregohet më poshtë në analizën e çmimit.

2.560	F.V tuba b/a Ø 1500 mm	ml																		
	Sp + p	op	7.1	185	1314															
	Sigurime shoqërore 16.7%	leke	1314	0.167	219															
	Transport	T*km				12.70	21	267												
	Autovinc 50 KN	op							0.4	3100	1240									
	Tuba b/a Ø 1500 mm	ml										1.005	10658	10711						
	Zhavor	m3										0.2	316	63						
	Llaç çimento 1:2	m3										0.024	7921	190						
	Beton C 7/10	m3										0.1	5063	506						
	Shuma :				1533			267			1240			11471	14510	1161	1451			17122

Pra përfshirja e këtyre dy zërave në preventivin fillestar ka rritur fundin limit në mënyrë të pa argumentuar në vlerën 1,057,792 lekë pa TVSH. **Pra vlera prej 1,057,792 lekë pa TVSH konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet.** Gjithashtu referuar preventivit konstatohet se në të është përfshirë puseta e sistemit të ujësjes Nr.2 për ndërtim me vlerë totale 684,186 lekë pa TVSH ku sipas situacionit përfundimtar nuk është kryer asnjë punim. Puseta nr.2 është e përfshirë edhe në projektin e sistemit të ujësjes në rrugën e Durrësit, pra përfshirja në projektin e kanalizimeve rit përlllogaritjen e vlerës së fondit limit. Kjo rritje e fondit limit është në kundërshtim me:

- VKM Nr.914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar, neni 59 pika 2, ku citohet: *Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe*

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

- Parimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të shprehura në nenin 5.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 06.07.2020 dhe sipas kontratës duhet të përfundojnë më 05.11.2020. Sipas njoftimit nga ana e mbikëqyrësit të punimeve ato kanë përfunduar më datë 06.11.2020, pasi njoftimi i sipërmarrësit është pa datë dhe pa nr.prot.

Me shkresën Nr.47/1Prot. datë 11.08.2020 sipërmarrësi i punimeve i është drejtuar mbikëqyrësit për përdorimin e fondit rezerve. Me shkresën datë 12.08.2020 mbikëqyrësi i punimeve i është drejtuar AK për përdorimin e fondit rezervë e cila vjen si pasojë e disa problematikave të hasura gjatë zbatimit të punimeve dhe disa mospërputhje në projek-preventiv me faktin.

Me procesverbalin pa datë , mbajtur ndërmjet kontraktorit, mbikëqyrësit të punimeve dhe AK, është miratuar kërkesa për ndryshime volumesh (+/-), si dhe preventivi i rishikuar në vlerën 5,315,700 lekë pa TVSH, sa vlera e fondit rezervë.

Nga verifikimi i proces verbaleve për punimet e maskuara konstatohet se ato nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike siç kërkohet në kontratën e mbikëqyrjes së punimeve pika 5.2 *“Ky dokumentacion duhet të përmbajë”* Proces verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi **të shoqëruar me fotografi.**

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve OE “E ” shpk me përfaqësues z. G.I.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Projekt preventivi,
- 2) Projekti i azhurnuar,
- 3) Situacioni përfundimtar,
- 4) Librezat e masave,
- 5) Kontrata e sipërmarrjes.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtim rrjet kanalizimi rruga e Durrësit”.			
14.Lidhja e kontratës Nr. 6091/6 prot datë 24.06.2020 Nr.13890/6prot. datë 11.09.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 136,458,037 lekë 27,146,704 lekë Total: 163,604,743 lekë OE fitues B “V.K” shpk & “B” shpk & “M” shpk		16.Likuiduar deri dt
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSH 136,155,140 lekë shtesa -Vlera me TVSH 27,145,387 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 4 muaj, Zbatuar 4 muaj. Fillimi punimeve: 06.07.2020 Përfundimi punimeve: 06.11.2020		19. Zgjatja e kontratës
20. Mbikëqyrësi i punimeve “EG” SHPK	Licenca Nr: MK.	Kontrata Nr. datë 24.06.2020	
21. Kolaudatori. Datë 23.12.2020 O D H G A.M			
22.Akt Kolaudimi Datë 23.12.2020	23.Akt i marrjes në dorëzim.		

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe librezat e masave të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar (vizatimet sipas faktit dhe fotografitë e ndodhura në dosjen teknike), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë në vlerën **484,560 lekë pa TVSH** si dhe shpenzime të fondeve të shoqërisë pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën **1,741,978 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi operatori ekonomik “EG” SHPK” me përfaqësues z. G.I sipas kontratës së shërbimit me objekt “Mbikëqyrje të objektit, ‘Ndërtim rrjet kanalizimi rruga e Durrësit’”, Nr.7904/20 Prot, datë 24.06.2020.

13. Ndërtim linjë transmetimi ujësjellësi nga rruga "V.N"-Depo 4000m3 në Yzberisht.

Objekti është kryer sipas kontratës për punë publike me Nr.16975/9Prot datë 19.10.2018 me objekt *“Ndërtim linjë transmetimi ujësjellësi nga rruga "V.N” të lidhur mes Autoritetit Kontraktor UKT sh.a, të përfaqësuar nga ish-Titullari z. R.M dhe B “B ” shpk & “E ” sh.p.k me licence, përkatësisht, NZ5430/14 dhe NZ4047/1. Vlera e kontratës është 184,114,778 lekë pa TVSH ose 220,937,734 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 4(katër) muaj nga data e lidhjes së kontratës. Kontrata e zbatimit është amenduar dy herë, konkretisht:*

1) Nr.16975/12Prot datë 19.02.2019 ku është ndryshuar afati i përfundimit të punimeve duke e zgjatur me 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e përfundimit të kontratës bazë me arsyen e mos dhënies së lejes nga ARRSH për vazhdimin e punimeve nga shinat e trenit tek sheshi “Shqiponja” e 20 ditë për kushtet e moti të pa favorshme;

2) Nr.16975/13Prot datë 18.04.2019 ku afti i përfundimit të punimeve është zgjatur me 45 ditë nga afati i vendosur në amendamentin e parë me arsyen e rakordimit të punimeve nga shinat e trenit tek sheshi “Shqiponja” dhësi datë e re përfundimtare është 03.06.2019.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit Nr.18824/35prot. datë 11.10.2018, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me B "I D" sh.p.k & "D P" sh.p.k, me përfaqësues përkatësisht D H dhe S K, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 919/9, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 2,715,083 lekë pa TVSH ose 3,258,099 lekë me TVSH.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse, është bërë në datën 19.10.2018 dhe sipas kontratës duhet të përfundojnë më 19.02.2019 por me dy amendimet e kontratës me nga 60 ditë dhe 45 ditë secili afati i përfundimit është data 03.06.2019.

Procesverbali i mbajtura midis sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit për përfundimin e punimeve janë pa datë.

Me shkresën pa Nr.....Prot. pa datë sipërmarrësi i punimeve i është drejtuar mbikëqyrësit për disa ndryshime në projekt në varësi të kushteve të terrenit si dhe për përdorimin e fondit rezerve. Me shkresën Nr.33Prot. datë 05.04.2019 mbikëqyrësi i punimeve i është drejtuar AK për miratimin e ndryshimeve si rezultat i disa problematikave të hasura gjatë zbatimit të punimeve dhe disa mospërputhje në projekt-preventiv me faktin.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, në dosjen teknike nuk gjenden gjurmë që ndryshimet e propozuara nga kontraktori dhe mbikëqyrësi i punimeve si dhe përdorimi i fondit rezervë të jenë të miratuara nga ana e AK.

Nga verifikimi i proces verbaleve për punimet e maskuara konstatohet se ato nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike siç kërkohet në kontratën e mbikëqyrjes së punimeve pika 5.2 “Ky dokumentacion duhet të përmbajë”...Proces verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi **të shoqëruar me fotografi.**

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve B " D" sh.p.k & "D P" sh.p.k me përfaqësues z. D H.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Projektpreventivi,
- 2) Projekti i azhurnuar,
- 3) Situacioni përfundimtar,
- 4) Librezat e masave,
- 5) Kontrata e sipërmarrjes.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtim linjë transmetimi ujësjellësi nga rruga "V.N”.			
14.Lidhja e kontratës Nr.16975/9Prot datë 19.10.2018	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 220,937,734 lekë fitues “B” shpk & “E” sh.p.k		16.Likuiduar deri dt
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSH 220,933,560 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 6 muaj, Zbatuar 7.5 muaj. Fillimi punimeve: 19.10.2018 Përfundimi punimeve: 03.06.2019		19. Zgjatja e kontratës
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “I D” sh.p.k & “D P” sh.p.k	Licenca Nr: MK. 919/9	Kontrata Nr.18824/35prot. datë 11.10.2018	

21. Kolaudatori. Ing. O D; ing. E A; ing. T. K.			
22.Akt Kolaudimi datë 11.07.2019	23.Akt i marrjes në dorëzim.		

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe librezat e masave të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar (vizatimet sipas faktit dhe fotografitë e ndodhura në dosjen teknike), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë në vlerën **8,028,000 lekë pa TVSH** si dhe shpenzime të fondeve të shoqërisë pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën **3,692,640 lekë pa TVSH**.

14. Spostim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime, sheshi Shqiponja, Loti 1.

Objekti është kryer sipas kontratës për punë publike me Nr.14332/8Prot datë 22.10.2020 me objekt “*Spostim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime, sheshi Shqiponja, Loti 1*” të lidhur mes Autoritetit Kontraktor UKT sh.a, të përfaqësuar nga Titullari z. E.K dhe OE “S” shpk me licence Nr.3091/19. Vlera e kontratës është 227,953,868 lekë pa TVSH ose 273,544,642 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6(gjashtë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit Nr.15784/10 prot, datë 22.10.2020, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “A ” shpk, me përfaqësues E Ç, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1476/10, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 2,799,059 lekë pa TVSH ose 3,258,871 lekë me TVSH.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 23.10.2020 dhe sipas kontratës duhet të përfundojnë më 22.04.2021. Sipas njoftimit nga ana e mbikëqyrësit të punimeve ato kanë përfunduar më datë 03.12.2020, njoftimi i sipërmarrësit është me shkresën Nr.609Prot. datë 03.12.2020.

Me shkresën Nr.592Prot. datë 26.11.2020 sipërmarrësi i punimeve i është drejtuar mbikëqyrësit për disa ndryshime në projekt në varësi të kushteve të terrenit si dhe për përdorimin e fondit rezerve. Me shkresën Nr.406Prot. datë 26.11.2020 mbikëqyrësi i punimeve i është drejtuar AK për miratimin e ndryshimeve si rezultat i disa problematikave të hasura gjatë zbatimit të punimeve dhe disa mospërputhje në projekt-preventiv me faktin.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, në dosjen teknike nuk gjenden gjurmë që ndryshimet e propozuara nga kontraktori dhe mbikëqyrësi i punimeve si dhe përdorimi i fondit rezervë të jenë të miratuara nga ana e AK.

Nga verifikimi i proces verbaleve për punimet e maskuara konstatohet se ato nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike siç kërkohet në kontratën e mbikëqyrjes së punimeve pika 5.2 “*Ky dokumentacion duhet të përmbajë*”...*Proces verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi të shoqëruar me fotografi.*

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve OE “A ” shpk me përfaqësues znj. E C.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Projekt preventivi,
- 2) Projekti i azhurnuar,
- 3) Situacioni përfundimtar,
- 4) Librezat e masave,
- 5) Kontrata e sipërmarrjes.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtim rrjet kanalizimi rruga e Durrësit”.		
14.Lidhja e kontratës Nr.14332/8 Prot datë 22.10.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 273,544,642 lekë OE fitues “S” shpk	16.Likuiduar deri dt
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSH 273,541,319 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 6 muaj, Zbatuar 1.5 muaj. Fillimi punimeve: 23.10.2020 Përfundimi punimeve: 03.12.2020	19. Zgjatja e kontratës
20. Mbikëqyrësi i punimeve “A ” SHPK	Licenca Nr: MK. 1476/10	Kontrata Nr.15784/10 prot, datë 22.10.2020
21. Kolaudatori.		
22.Akt Kolaudimi	23.Akt i marrjes në dorëzim.	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe librezat e masave të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar (vizatimet sipas faktit dhe fotografitë e ndodhura në dosjen teknike), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë në vlerën **10,490,433 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi OE “A ” sh.p.k me përfaqësues znj. E Ç sipas kontratës së shërbimit me objekt “Mbikëqyrje të objektit, “Spostim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime, sheshi Shqiponja, Loti 1”, Nr.15784/10 prot, datë 22.10.2020.

15.Rikonstrukcion rrjet ujësjellësi Dn-426mm, Dn-200mm në rrugën ‘Xhanfize Keko’

Objekti është kryer sipas kontratës për punë publike me Nr.10098/2Prot. datë 17.08.2019 me objekt *Rikonstrukcion rrjet ujësjellësi Dn-426mm, Dn-200mm në rrugën ‘Xhanfize Keko’* të lidhur mes Autoritetit Kontraktor UK Tiranë sh.a, të përfaqësuar nga Titullari z. R.M dhe OE “B” shpk. Vlera e kontratës është 50,406,959 lekë pa TVSH ose 60,488,350.8 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 30 (tridhjetë) nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit Nr.10087/42Prot. datë 05.08.2019, është lidhur kontrata përkatëse, për lotët I,IV,VII,XI dhe XII, ku këtij shërbimi i korrespondon loti XI me OE “I” shpk, me përfaqësues F V, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh M.K. 1706/9, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit, Loti XI 1,116,747.76 lekë pa TVSH ose 1,340,097.31 lekë me TVSH.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 19.09.2019 dhe sipas kontratës duhet të përfundojnë më 19.10.2020. Sipas njoftimit të kontraktorit dhe mbikëqyrësit të punimeve ato kanë përfunduar më datë 19.10.2019, pasi njoftimi i sipërmarrësit është pa datë dhe pa nr.prot.

Referuar problematikave të hasura në terren kontraktori propozon që tubat që kalojnë në trotuar të shtrihen në trupin e rrugës si dhe shtresa e asfalti 4cm të mos kryhet në rrugën “Xhanfize Keko” dhe të kryhet asfaltimi i rrugicave në gjithë gjerësinë e tyre pasi janë shumë të amortizuara dhe është e pa mundur asfaltimi i vetëm pjesës së kanalit ku shtrohet tubi. Bashkëlidhur këtij propozimi është planimetria e linjave si dhe skemat e nyjave të rishikuara bashkë me prerjet tërthore për vetë faktin se forma trapezoide e kanalit është e pa mundur të realizohet nga kushtet e rrugës dhe trafiku në të.

Me procesverbalin pa datë , mbajtur ndërmjet kontraktorit, mbikëqyrësit të punimeve dhe AK, është miratuar kërkesa për ndryshime volumesh (+/-), ku të gjitha punimet do të realizohen brenda vlerës së kontratës.

Nga verifikimi i proces verbaleve për punimet e maskuara konstatohet se ato nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike siç kërkohet në kontratën e mbikëqyrjes së punimeve pika 5.2 *“Ky dokumentacion duhet të përmbajë”...Proces verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi të shoqëruar me fotografi.*

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve OE “I” shpk me përfaqësues znj. F V.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 6) Projekt preventivi,
- 7) Projekti i azhurnuar,
- 8) Situacioni përfundimtar,
- 9) Librezat e masave,
- 10) Kontrata e sipërmarrjes.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtim rrjet kanalizimi rruga e Durrësit”.			
14.Lidhja e kontratës Nr.10098/2Prot. datë 17.08.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 60,488,350.8 lekë OE fitues dhe “B” shpk		16.Likuiduar deri dt
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSH 60,486,759 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 30 ditë, Zbatuar 30 ditë. Fillimi punimeve: 19.09.2019 Përfundimi punimeve: 19.10.2019		19. Zgjatja e kontratës
20. Mbikëqyrësi i punimeve “In” SHPK	Licenca Nr: MK. 1706/9	Nr.10087/42Prot. datë 05.08.2019	
21. Kolaudatori.			
22.Akt Kolaudimi datë 20.12.2019	23.Akt i marrjes në dorëzim.		

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbaruar (vizatimet sipas faktit dhe fotografitë e ndodhura në dosjen teknike), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë, në vlerën **3,064,212 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi OE “I” sh.p.k” me përfaqësues znj. F V sipas kontratës së shërbimit me objekt “Mbikëqyrje të objektit, ‘Rikonstruksion rrjet ujësjellësi Dn-426mm, Dn-200mm në rrugën ‘Xhanfize Keko’, Nr.10087/42Prot. datë 05.08.2019.

16.Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depo Kombinat.

Objekti është kryer sipas kontratës për punë publike me Nr. 9525/14 Prot. datë 07.08.2019 me objekt “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depo Kombinat” të lidhur mes Autoritetit Kontraktor UKT sh.a, të përfaqësuar nga ish-Titullari z. R.M dhe BOE “A” sh.p.k & “V E” sh.p.k me licence përkatësisht, NZ.0517/10 dhe NZ.1192/20. Vlera e kontratës është 63,913,231.36 lekë pa T.V.SH ose 76,695,877.63 lekë me T.V.SH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 3 (tre) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës Nr. 10087/59 Prot. datë 08.08.2019, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me “N G” sh.p.k me përfaqësues përkatësisht V B , me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3101/7, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 1,318,039.98 lekë pa TVSH ose 1,581,647.97 lekë me TVSH.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse, është bërë në datën 14.08.2019 dhe sipas kontratës duhet të përfundojnë më 14.11.2019 .

Me shkresën pa Nr.06-IMProt. pa datë 11.11.2019 sipërmarrësi i punimeve i është drejtuar mbikëqyrësit të punimeve dhe autoritetit kontraktor për disa ndryshime të volumeve në preventiv të cilat janë të nevojshme për realizimin e punimeve ku ka paraqitur preventivin e ripunuar, tabelën e volumeve që shtohen dhe zbriten si dhe relacionet përkatëse.

Me shkresën Nr. Extra. Prot. datë 14.11.2019 mbikëqyrësi i punimeve i është drejtuar AK se punimet kanë mbaruar më datë 14.11.2019 kjo e pasqyruar dhe në relacionin përfundimtar të tij. Pra punimet kanë përfunduar brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Nga verifikimi i proces verbaleve për punimet e maskuara konstatohet se ato nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike siç kërkohet në kontratën e mbikëqyrjes së punimeve pika 5.2 **“Ky dokumentacion duhet të përmbajë”...Proces verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi të shoqëruar me fotografi.**

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve OE "N G" sh.p.k me përfaqësues V B.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 11) Projekt preventivi,
- 12) Projekti i azhurnuar,
- 13) Situacioni përfundimtar,
- 14) Librezat e masave,
- 15) Kontrata e sipërmarrjes.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depo Kombinat”.			
14.Lidhja e kontratës Nr. 9525/14 Prot. , datë 07.08.2019	15.Vlera e kontratës (me t.v.sh) 76,695,877.63 lekë BOE "A" sh.p.k & "V E" sh.p.k		16.Likuiduar deri dt.
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me T.V.SH 70,667,081.00 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 3 muaj Fillimi punimeve: 14.08.2019 Përfundimi punimeve: 14.11.2019		19. Zgjatja e kontratës
20. Mbikëqyrësi i punimeve "N G" sh.p.k	Licenca Nr: MK. 3101/7	Kontrata Nr. 10087/59. datë 08.08.2019	
21. Kolaudatori. 1.O.DH 2.H G 3.K L		Nr.479 Prot, dt. 17.12.2019	
22.Akt Kolaudimi datë 17.12.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim.		

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe librezat e masave të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar (vizatimet sipas faktit dhe fotografitë e ndodhura në dosjen teknike), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UKT në vlerën **776,032 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi OE “NG” sh.p.k me përfaqësues z. V.B sipas kontratës së shërbimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin, “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depo Kombinat”, Nr.10087/59Prot. datë 08.08.2019.

17. Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri, Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet i Nxënësve.

Objekti është kryer sipas kontratës për punë publike me Nr.6068/9 Prot. datë 02.07.2020 me objekt **“Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri , Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet i Nxënësve”** të lidhur mes Autoritetit Kontraktor UK Tiranë sh.a, të përfaqësuar nga ish-Titullari z. R.M dhe BOE "K"

sh.p.k & "S" sh.p.k & "I" sh.a & "A " sh.p.k me licence, NZ.4901/12. Vlera e kontratës është 381,811,507.02 lekë pa T.V.SH ose 458,173,808.43 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 4 (katër) muaj nga data e lidhjes së kontratës. Kontrata e zbatimit është amenduar një herë, konkretisht:

1) Nr. 6068/12 Prot., datë 10.11.2020 ku është ndryshuar afati i përfundimit të punimeve duke e zgjatur me 27 (njëzet e shtatë) ditë nga data e përfundimit të kontratës bazë me arsyen e kushteve të pa favorshme të motit .

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës Nr.7904/24 Prot. , datë 02.07.2020 , është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me "N G" sh.p.k me përfaqësues përkatësisht V.B, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3101/7, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 3,476,357. lekë pa TVSH ose 4,171,629.00 lekë me TVSH.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse, është bërë në datën 13.07.2020 dhe sipas kontratës duhet të përfundojnë më 13.11.2020 por me nje amendim të kontratës me shtyrje 27 ditë afati i përfundimit është data 10.12.2020 .

Me shkresën pa Nr.....Prot. pa datë sipërmarrësi i punimeve i është drejtuar mbikëqyrësit për disa ndryshime në projekt në varësi të kushteve të terrenit si dhe për përdorimin e fondit rezerve. Me shkresën Nr.16067 Prot. datë 29.09.2022 mbikëqyrësi i punimeve i është drejtuar AK për miratimin e ndryshimeve si rezultat i disa problematikave të hasura gjatë zbatimit të punimeve dhe disa mospërputhje në projekt-preventiv me faktin.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, në dosjen teknike nuk gjenden gjurmë që ndryshimet e propozuara nga kontraktori dhe mbikëqyrësi i punimeve si dhe përdorimi i fondit rezervë të jenë të miratuara nga ana e AK.

Nga verifikimi i proces verbaleve për punimet e maskuara konstatohet se ato nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike siç kërkohet në kontratën e mbikëqyrjes së punimeve pika 5.2 "Ky dokumentacion duhet të përmbajë"...Proces verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi të shoqëruar me fotografi.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve OE "N G" sh.p.k me përfaqësues V.B.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 16) Projekt preventivi,
- 17) Projekti i azhurnuar,
- 18) Situacioni përfundimtar,
- 19) Librezat e masave,
- 20) Kontrata e sipërmarrjes.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund , Katund i Ri , Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet i Nxënesave".			
14.Lidhja e kontratës Nr. 6068/9 Prot. , datë 02.07.2020	15.Vlera e kontratës (me t.v.sh) 458,173,808.43 lekë BO "K" sh.p.k & "S" sh.p.k & "L" sh.a & "A" sh.p.k		16.Likuiduar deri dt.
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me T.V.SH 458,173,808.00 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 4 muaj, Zbatuar 4 muaj e 27 ditë Fillimi punimeve: 13.07.2020 Përfundimi punimeve: 10.12.2020		19. Zgjatja e kontratës
20. Mbikëqyrësi i punimeve "N G" sh.p.k	Licenca Nr: MK.3101/7	Kontrata Nr. 7904/24. datë 02.07.2020,	

21. Kolaudatori. "G C" sh.p.k		Nr. 401/4 , 07.01.2021 Nr licece. MK.	
22.Akt Kolaudimi datë 11.01.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim.		

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe librezat e masave të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar (vizatimet sipas faktit dhe fotografitë e ndodhura në dosjen teknike), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë në vlerën **864,749 lekë pa TVSH**. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi OE "NG" sh.p.k me përfaqësues V.B sipas kontratës së shërbimit me objekt "Mbikëqyrja e punimeve për objektin, "Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri , Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet i Nxënëseve" Nr. 7904/24Prot. datë 02.07.2020.

1. Titulli i gjetjes:	Mos llogaritje saktë e fondit limit
Situata:	Në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje elektropompa", viti 2019, në vlerën 12,353 mijë, "Blerje automjete teknologjike", viti 2019, në vlerën 80,497 mijë, "Blerje reagent dhe pajisje laborator", viti 2021, në vlerën 12,943 mijë lekë, Blerje tuba dhe rekorderi", viti 2022 në vlerën 149,860 mijë lekë, "Blerje Kimikate", viti 2022 në vlerën 60,853 mijë lekë, "Rinovim i suportit të infrastrukturës qendrore", në vlerën 20,890 mijë lekë, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme, çmime të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj).
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59, pika 2, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar neni 76.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos përdorimin me efektivitete të fondeve publike.
Shkaku:	Keq interpretime të akteve ligjore dhe rregullatorë për prokurimet publike.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, varet saktësia e kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.
2. Titulli i gjetjes:	Kritere të veçanta për kualifikim jo në përshtatshmëri të plot profesionale dhe teknike.
Situata:	Në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje elektropompa", viti 2019 në vlerën 12,353 mijë lekë, Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjellësi dhe

	kanalizimi në zonën e kufizuar nga rrugët Tefta Tashko”, “Luigj Gurakuqi”, viti 2021 në vlerën 45,639 mijë lekë, “Zhbllokim pusetash”, viti 2022 në vlerën 19,994 mijë lekë dhe “Blerje tuba dhe rekorderi”, viti 2022 në vlerën 149,859 mijë lekë, kriteret e veçanta për kualifikim nuk janë vendosur plotësisht konformë akteve ligjore dhe rregullatorë për prokurimet publike.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2009, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 5, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, kreu III, pika 1/a, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 09.02.2011 ”Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar, shkresa e Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos sigurim transparence, trajtim i barabartë i të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike.
Shkaku:	Keq interpretime të akteve ligjore dhe rregullatorë për prokurimet publike.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.
3. Titulli i gjetjes:	Kontrata të pa siguruara për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

Situata:	<p>Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, viti 2021, në vlerën 99,903 mijë lekë, nuk është siguruar kontrata për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta, si dhe deri në datën e hartimit të këtij konstatimi Autoriteti Kontraktor, nuk ka zgjatur periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit, ose nuk ka bërë vet siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.</p> <p>Veprim në kundërshtim me neni 25 të kontratës së lidhur, pika 1 dhe 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se</p> <p>“25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plotë, në shumatat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.</p> <p>25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktonit”.</p>
Kriteri:	Kontrata me nr. 10094/6 prot., datë 02.09.2019 lidhur me Shoqërinë “IT” Shpk.
Ndikimi/Efekti:	Risk për dëmtim shëndeti dhe vjedhje
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në menaxhim e kontratës.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në sigurimin e kontratave, me qëllim jo vetëm lidhja tyre të shoqërohet me policat e sigurimi, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

4. Titulli i gjetjes:	Projekte dhe preventiva të hartuar me inxhinier/specialist të pa licencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
Situata:	Në procedurat e prokurimit “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, viti 2019, për vlerën 99,903 mijë lekë, “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”, viti 2021 për vlerën 999,800 mijë lekë, punimet janë projektuar dhe preventivuar nga inxhinier/specialist pa pasur zotësinë profesionale për të projektuar (teknike dhe ligjore), pasi nuk kanë pasur licencat profesionale përkatëse të dhëna nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
Kriteri:	VKM nr. 759, datë 12.11.2014 ‘Për licencimin profesional të individëve

	dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’, i ndryshuar, pika 1, neni 16/1 “Licenca – kategoritë e punimeve”.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos efektivitetin e fondeve publike
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në hartimin e projekteve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për hartimin e projekteve, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me inxhinier/specialist të licencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

5. Titulli i gjetjes:	Menaxherët e ngarkuar të projekteve/kontratave të prokurimit, nuk kanë menaxhuar profesionalisht kontratën e instalimit të matësve inteligjent.
Situata:	<p>Në procedurën e prokurimit “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, viti 2019, për vlerën 99,903 mijë lekë, në preventiv nuk është pasqyruar pajisja hardware e komunikimit DCU që mundësojnë transmetimin në kohë reale në Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të dhënave, pajisje e cila është në projekt, duke pa mundësuar:</p> <p>-a. Mos eficientë të plotë të fondit publik të përdorur në këtë prokurim në përputhje me qëllimin e tij, që ka të bëjë me “Sistemi matjes në distancë bazohet në ngritjen e një rrjeti komunikimi të njësisë matëse me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të Dhënave”. Kjo lloj teknologji shfrytëzon transmetimet wireless, e cila transformon informacionin mekanik në sinjale elektrike. Përmes instalimit të këtyre ujëmatësve ndërtohet Sistemi i Matjes në Distancë. Sistemi i Matjes në Distance bazohet në ngritjen e një rrjeti komunikimi të njësisë matëse me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të Dhënave. Projekti parashikon që në ofertë të jenë të parashikuara të gjitha kostot në lidhje me programimin e software, zhvillimin me qëllim përfundimtar që të dhënat të përfuara përmes walk-By/Drive-By, ose përmes rrjetit fiks të jenë të disponueshme në sistemin e shfrytëzimit të U.K.T.</p> <p>-b. Mos kalimin e vlerës mbi 100,000,000 lekë, për t’ju nënshtruar projekti, oponentës teknike.</p> <p>-c. Mos shkurtimin e personelit (faturistëve) për faturimin e ujit të pijshëm.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 18.7.2002 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, pika 1, VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponentës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, Urdhri i Ministres së Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit E.GJ nr. 7, datë 20.1.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponentës

	teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.
Ndikimi/Efekti:	Mos efikasiteti të plotë të fondit publik të përdorur, projekti nuk i është nënshtruar opionencës teknike dhe mos shkurtrimin e personelit (faturistëve).
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale në ushtrimin e përgjegjësi në hartimin e projekteve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura në lidhje me instalimin e matësve inteligjent del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

6. Titulli i gjetjes:	Punime publike të kryera pa dokumentacionit të plot tekniko-ligjor.
Situata:	Ne procedurën e prokurimit “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë viti 2019, për vlerën 99,903 mijë lekë “Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjellësi dhe kanalizimi në zonën e kufizuar nga rrugët Tefta Tashko”, “Luigj Gurakuqi”, viti 2021, vlera 45,639 mijë lekë, punimet janë kryer pa deklaratë paraprake punimesh.
Kriteri:	Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 3 pika 21, VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar neni 7.
Ndikimi/Efekti:	Risk për keq administrimin e territorit dhe ruajtjen e mjedisit.
Shkaku:	Keq interpretim të akteve ligjore dhe rregullatore të zbatimit të punëve publike.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Shoqëria të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për ndërtimet dhe rikonstruksionet e objekteve, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me leje ndërtimi/ deklaratë paraprake punimesh, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

7. Titulli i gjetjes:	Instalim i matësve inteligjent është realizuar pa kryer më par vlerësimin ekonomik, si dhe pa miratuar nga ERU formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhet/përzgjidhet.
Situata:	Shoqëria “UKT” Sh.a për periudhën 2021, ka instaluar 4776 matës inteligjent të ujit të pijshëm. Instalim i matësve inteligjent është realizuar pa kryer më par, vlerësim ekonomik, i cili duhet të kishte marrë në konsideratë të gjitha kostot afatgjata dhe përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, duke përfshirë gjithashtu edhe formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhet/përzgjidhet, e cila duhet të jetë ekonomikisht më efektive dhe me afatin kohor më të përshtatshëm për implementimin e këtij sistemi matjeje. Në bazë të vlerësimit ekonomik të përcaktuar si më sipër Shoqëria, duhet

	<p>të kishite propozuar në ERU ndryshimet përkatëse ligjore dhe rregullatore, si dhe mbas miratimit të tyre duhet të përgatiste një kalendar për implementimin brenda një periudhë 10-vjeçare të sistemeve inteligjente të matjes.</p> <p>ERU duhet të sigurojë/ndërveprimin e sistemeve të ndryshme matëse, që do të implementohen në të gjithë territorin e vendit. Në instalimin e matësve nuk është dokumentuar testimi i kryer pas verifikimit periodik, me rezultatin që matësi nuk kryen funksionet e matjes (Verifikimit periodik të ujëmatësve i nënshtrohen të gjithë ujëmatësit që kanë plotësuar kriterin e datës së vendosjes së tyre 60 muaj, dëmtimi/ose jo fizikisht i tij, kalimi/ose jo j jetëgjatësisë së tij, matësi nuk kryen funksionet e tij etj)</p>
Kriteri:	<p>VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve SHA”, pika 2/7, Ligji nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë” i shfuqizuar, neni 26, i ndryshuar me Ligjin nr. 126/2020 “Për metrologjinë”, neni 25; VKM nr. 96, datë 21.2.2007 “Për disa ndryshime në VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, pika 3; Vendimi i Enti Rregullator i Ujit nr. 8, datë 04.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip” ndryshuar me Vendimet nr. 15, datë 09.06.2014 “Për zbatimin e kontratës model të miratuar nga KKRR për të gjithë klientët e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe me Vendimin nr. 25, datë 08.07.2015 ”Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën model të shërbimeve ujësjellës kanalizime” Enti Rregullator i Ujit, neni 7.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Mos shërbim i plotë produktiv dhe eficient i fondeve për rritjen e treguesve të preformancës së administrimit të ujit të pijshëm.</p>
Shkaku:	<p>Mos vëmendje e duhur Institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në furnizimin me ujë të pijshëm.</p>
Rëndësia:	<p>E lartë</p>
Rekomandimi:	<p>Në rastet e vendosjes së matësve inteligjent të ujit të pijshëm nga Shoqëria “UKT” SHA, të merren masa për të përgatitur paraprakisht vlerësimin ekonomik, i cili duhet të marrë në konsideratë të gjitha kostot afatgjata dhe përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, duke përfshirë gjithashtu edhe formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhet/përzgjidhet, e cila duhet të jetë ekonomikisht më efektive dhe me afatin kohor më të përshtatshëm për implementimin e këtij sistemi matjeje. Në bazë të vlerësimit ekonomik të përcaktuar si më sipër Shoqëria, duhet ti propozoj në ERU ndryshimet përkatëse ligjore dhe rregullatore, si dhe mbas miratimit të tyre duhet të përgatit një kalendar për implementimin brenda një periudhë 10-vjeçare të sistemeve inteligjente të matjes.</p> <p>ERU duhet të sigurojë ndërveprimin e sistemeve të ndryshme matëse, që do të implementohen në të gjithë territorin e vendit.</p>

8.Titulli i gjetjes:	Mos dokumentacion i rregullt në marrjen në dorëzim të shërbimeve.
Situata:	Në zbatimin e kontratës “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”, viti 2021, për vlerën 999,800 mijë lekë, për çdo muaj është hartuar akt kolaudimi dhe procesverbali i marrjes në dorëzim. Konkretisht për muajin janar 2022. Aktkolaudimi me nr. 4119/3 prot., datë 20.10.2022 i firmosur nga “P ” Shpk dhe grupi i marrjes në dorëzim R L, D.Q dhe E Q “ Ku është shprehur “Grupi i kolaudimit u njohë me kontratën të kolaudojë dhe të marr në dorëzim shërbimin e kryer sipas faturës nr.8/2022, datë 20.01.2022 (bashkëlidhur) është në përputhje me kërkesat e paraqitura në kontratë dhe në specifikimet teknike sipas kontratës. Operatori “P ” Shpk ka kryer shërbimin sipas dokumenteve bashkëngjitur”. Procesverbal me nr. 1012 prot., datë 20.01.2022 i firmosur Ilir Hoxhallari dhe grupi i punës R L, D.Q dhe E Q, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “PC” Shpk për periudhën 15.12.2021-15.01.2022, ka realizuar me sukses monitorimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të sigurisë për 76 objekte sipas kontratës dhe termave të referencës”, por nuk cilëson çfarë mirëmbajte ka bërë specifikisht. Po ashtu dhe për dy operatorët e tjerë “E .
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 23 gërma g, pika 34.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos kufizim të humbjeve financiare
Shkaku:	Mos zbatim i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhëra me qëllim ndjekjen me përpikmëri të zbatimit të kontratave, duke përfshirë dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, për sasinë, cilësinë, llojin si dhe dokumentacionin shoqëruar të tyre.

9. Titulli i gjetjes:	Marrëveshjeve e ndaluar nga operatorët ekonomikë në procedurën e prokurimit “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”.
Situata:	Në procedurën e prokurimit “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”, viti 2021, për vlerën 999,800 mijë lekë, kanë marr pjesë: -Operatori ekonomik “F S” sh.p.k, i cili nuk ka paraqitur asnjë dokument, përveç bilancit te vitit 2018, as dhe ofertë ekonomike; - Bashkimi i operatorëve “G S” sh.p.k & E S sh.p.k & ”E” sh.p.k & ”PC” sh.p.k & ”E” sh.p.k në vlerën 989.172.392 lekë. Referuar të dhënave si më sipër disa nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, ndonëse paraqesin oferta për vlerësimin e tregut secila më vehte, në procesin e realizimit të procedurës marrin pjesë si bashkim operatorësh ekonomike, duke bërë të mundur

	<p>mospasjen e konkurrencës në tender. Kështu, nga 5 operatorë ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë, 4 janë paraqitur bashkërisht ndërsa njëri ka paraqitur vetëm një dokument.</p> <p>Ligji "Për prokurimin publik" përcakton si të drejtat ashtu edhe detyrimet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit publik, respektimi dhe përmbushja e të cilave duhet të bëhet objekt shqyrtimi nga institucionet kompetente të përcaktuara në këtë ligj</p> <p>Konkluzioni:</p> <p>Referuar sa më sipër vërtetohet katërçipërisht se operatorët ekonomik, kanë përdorur skemën e marrëveshjeve të ndaluara duke rënë dakord që me përpara që të mos paraqiten secili më vehte në procesin e prokurimit, por të gjithë së bashku, si bashkim operatorësh.</p> <p>Për të maksimizuar e eficientë, nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës në procedurat e shërbimeve të integruara, nisur nga problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të kontratave, këtë situatë duhet t'ja kishte bërë prezent Autoritetit të Konkurrencës për ushtrimin e kompetencave të tyre.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9121, datë 28. 07. 2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", neni 4, pika 1/a, dhe Ligji nr. 9643, dt. 20.11.2006, "Për prokurimin publik", neni 1 dhe 2.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos sigurim të mirë në përdorimin të fondeve publike.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale maksimizimit të eficientë, nxitjes së pjesëmarrjes dhe konkurrencës në procedurat e prokurimit, duke marrë masa për bërë t'ja bërë prezent Autoritetit të Konkurrencës, skemën e marrëveshjeve të ndaluara të operatorëve ekonomik në të gjitha rastet e manifestimit të këtyre skemave.

10. Titulli i gjetjes:	Akt kolaudime të hartuar me inxhinier/specialist të pa licencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
Situata:	Në zbatimin e kontratës "Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike", viti 2021, për vlerën 999,800 mijë lekë. Aktkolaudimi është mbajtur datë 07.12.2021 i firmosur nga E.O me detyrë drejtor i Departamentit Inxhinjerik, A.M me detyrë përgjegjëse e sektorit të projektimit, E.A me detyrë përgjegjëse e sektorit të menaxhimit dhe koordinimit të projekteve, L.S me detyrë specialist sektori i IT. Të gjitha anëtarët e grupit të kolaudimit janë të pa pajisur me licencë përkatëse për kolaudimin e punimeve. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 759, datë 12.11.2014 'Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim', e ndryshuar, pika 1, Neni 16/1 "Licenca – kategoritë e punimeve", neni 2/2 "Përkufizimi i termave".
Kriteri:	VKM nr. 759, datë 12.11.2014 'Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të

	zbatimit në ndërtim’, i ndryshuar, pika 1, Neni 16/1 “Licenca – kategoritë e punimeve”, Neni 2/2 “Përkufizimi i termave”.
Ndikimi/Efekti:	Risk për efektivitetin e fondeve publike
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në hartimin e projekteve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korigjuar këtë praktikë për kolaudimin e punëve publike/mallrave/shërbimeve, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me inxhinier/specialist të licencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

11. Titulli i gjetjes:	Mos përcaktim afati për mbajtjen e garancisë së punimeve.
Situata:	Në procedurën e prokurimit “Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjellësi dhe kanalizimi në zonën e kufizuar nga rrugët Tefta Tashko”, “Luigj Gurakuqi”, viti 2021 për vlerën 45,639 mijë lekë, në dokumentet e tenderit dhe në kontratën e lidhur nuk reflektojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratave, sipas përcaktimeve të dokumenteve të tenderit, nuk reflektohet afati për mbajtjen e garancisë së punimeve, në kundërshtim me Udhëzimit i KM nr. 3, datë 15.2.2001, “Për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.
Kriteri:	Udhëzimi i KM nr. 3, datë 15.2.2001, “Për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos efektivitet të fondeve publike.
Shkaku:	Mos zbatimi i Udhëzimit të KM nr. 3, datë 15.2.2001, “Për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhëra me qëllim përcaktimin me përpikmëri të afatit për mbajtjen e garancisë së punimeve, duke përfshirë dhe vlerën përkatëse si garanci.

12. Titulli i gjetjes:	Zbatim kontrate pa lidhur një kontrata të sigurimit të përgjegjësive profesionale.
Situata:	Në procedurën e prokurimit “Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjellësi dhe kanalizimi në zonën e kufizuar nga rrugët Tefta Tashko”, “Luigj Gurakuqi”, viti 2021 për vlerën 45,639 mijë lekë, me shoqërinë “L C” Shpk, nuk është lidhur një kontrata e sigurimit për çdo dëm që mund të shkaktohet.
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 1 dhe 3, Ligji nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 3.
Ndikimi/Efekti:	Risk për dëm të mundshëm që mund të shkaktohet si pasojë e kryerjes së

	punimeve të ndërtimit.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në zbatimin e kontratave.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në sigurimin e kontratave, me qëllim jo vetëm lidhja tyre të shoqërohet me policat e sigurimi, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

13. Titulli i gjetjes:	Vend depozitimit të mbetjeve të tipit inerte pa lidhur kontratë operatorit/operatorëve ekonomik të përzgjedhur për këtë qëllim, pa çmim të miratuar nga Bashkia dhe pa Licencën tipit III.2.B.
Situata:	<p>Për periudhën objekt auditimi mbetjet të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike; tubacione, saraçineska etj) të cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë të projekteve të ndryshme, depozitohen Landfilli Sharrës, Landfill i administruar nga Shoqëria “I E”. Për vend depozitimin dhëra dhe inerte tek Landfilli Sharrës për llogari të Shoqërisë “I E”, për vitin 2019 është faturuar vlera 12,879,558 lekë, është likuiduar vlera 11,759,763 lekë, për vitin 2020 është faturuar vlerë 490,315 lekë, është likuiduar vlera 1,602,325 (1,119,805 lekë mbetje nga viti 2019 dhe 490,315 nga viti 2020), për vitin 2021 është faturuar vlera 3,102,964 lekë, është likuiduar vlera 390,583 lekë, mbetur në diferencë pa likuiduar vlera 2,720,175 lekë, për periudhën janar-tetor 2022 është faturuar vlera 1,006,084 lekë, është likuiduar vlera 1,006,084 lekë.</p> <p>Për këtë depozitim nuk ka kontratë të lidhur ndërmjet Shoqërisë “UKT” SHA dhe Shoqërisë “I E”.</p> <p>Faturim është bërë me çmimi 800 lekë/tonë inerte (mbetje nga ndërtimet dhe prishjet) dhe 246.7 lekë/tonë për dhëra dhe shtuf.</p> <p>Këto çmime janë vendosur nga Shoqëria “I E”, pa miratimin e Bashkisë Tiranë.</p> <p>Transportimi është bërë nga UKT pa patur Licencën tipit III.2.B e pajisur vet ose nëpërmjet nënkontraktore për transport të mbetjeve në destinacionin e përcaktuar, si dhe mjetet e angazhuara për këtë qëllim.</p>
Kriteri:	VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, pika 9, VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, pika 15, Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integrua të mbetjeve”, neni 57 “Transportuesit e mbetjeve”, pika 1 dhe 2.
Ndikimi/Efekti:	Risk për ndotjen e mjedisit dhe mos efektivitet të fondeve publike.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në zbatimin e kontratave
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	-Nga organet drejtuese të merren masa që për vend depozitimi i mbetjeve të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike; tubacione, saraçineska etj) të cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë

	<p>të projekteve të ndryshme, të lidhet kontratë/kontrata ndërmjet Shoqërisë “UKE” SHA dhe operatorit/operatorëve ekonomik të përzgjedhur për këtë qëllim.</p> <p>- Shoqëria “UKT” ti kërkoj Bashkisë Tiranë miratimin e çmimit të faturimit për/tonë inerte (mbetje nga ndërtimet dhe prishjet) dhe për dhera dhe shtuf etj.</p> <p>-Nga organet drejtuese të merren masa që shoqëria të pajisjet vet me Licencën tipit III.2.B, ose nëpërmjet kontraktorëve për transport të mbetjeve në destinacionin e përcaktuar.</p>
--	--

14. Titulli i gjetjes:	Likuidime për vend depozitimin e mbetjeve të tipit inerte pa dokumentacion të plot tekniko-ligjor.
Situata:	<p>Likuidimet për llogari të “I E”, për vend depozitimin e mbetjeve të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike; tubacione, saraçineska etj) te cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë të projekteve të ndryshme, janë bërë pa situacion, pa formular vend depozitimi lëshuar (firmosur) nga Lanfilli dhe drejtuesi i mjetit që ka transportuar, pa firmosur prodhuesi i mbetjeve, shoqëruar me fletë peshën e impiantit, në kundërshtim me aneksin “Formati i dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.</p> <p>Mbetjet nuk janë klasifikuar sipas kodeve përkatëse si, mbetjet urbane (mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë fraksionet e mbledhura veçmas: 20 02 02 “Dhera dhe gurë”; 20 02 03 “Mbetje të tjera të pabiodegradueshme”; 20 03 “Mbetje të tjera urbane”; 20 03 01 “Mbetjet e përziera urbane”; 20 03 04 “Llumra nga gropat septike”; 20 03 06 “Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza”; 20 03 07 “Mbetjet të vëllimshme”; 20 03 99 “Mbetjet urbane të paspecifikuara”.</p> <p>-Procesverbalet të firmosura nga drejtuesit e automjeteve, M.V me detyrë përgjegjës i transportit, dhe E.K me detyrë përgjegjës i sektorit të investimeve dhe kanalizimeve.</p>
Kriteri:	<p>VKM nr. 575, datë 24.06.2015, pika 7, VKM nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011, “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, pika 3.3, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe 26, Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/b, VKM nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, pika 17.</p>
Ndikimi/Efekti:	Risk për keqadministrim të fondeve publike

Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në zbatimin e kontratave.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale adiministrimit të mbetjeve të tipit inerte jo vetëm fizikisht por dhe në mbajtjen e dokumentacion të plot tekniko-ligjor dhe likuidimit konformë këtij dokumentacioni.

15. Titulli i gjetjes:	Rritje në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht të shpenzimeve në fazën e hartimit të preventivit dhe të zbatimit të kontratës në vlerën 960,984 lekë lekë
Situata:	Në procedurën e prokurimit “Zhbllokim pusetash”, viti 2022, për vlerën 19,994 mijë lekë, projekt përfshin edhe Fond rezervë 5 % në vlerën 952,076 lekë. Ky fond rezervë ka rritur në mënyrë artificiale vlerën e përlllogaritjes, duke rënduar koston e këtij shërbimi, në vlerë 960,984 lekë, pasi nuk ka të bëjë me punime ndërtimi të ndërtesave por me shërbim, pasi nuk ka projekt të hartuar nga projektues të liçensuar, nuk ka të caktuar mbikëqyrës të punimeve, preventivi nuk ka të përcaktuar vlerën e pastrimit të pusetave duke u bazuar në numrin e pusetave x çmimin/puset, vlerën e zhbllokimit të kanaleve kesoni duke u bazuar në numrin/metrat linear x çmimin/kanal etj. Vlera 960,984 lekë është përfituar padrejtësisht nga Shoqëria Shoqërisë “O” Shpk, si pasojë përlllogaritjeve të gabuara dhe përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “UKT” Sha dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga kjo Shoqëri, referuar të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655 ku është shprehur në mënyrë ekslicite se “përcaktohet se: “Personi që pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar brenda caqeve të begatimit pa shkak”.
Kriteri:	Analizat teknike për punimet e ndërtimit të ndërtesave “Ministria e Ndërtimit” maj 1992, Manualin e preventivimit “Udhëzime dhe kritere dhe analiza ndihmëse vëllimi i I (1976-1980).
Ndikimi/Efekti:	Është rënduar padrejtësisht kostoja e shërbimit në vlerën 960,984 lekë.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 960,984 lekë, nga Shoqëria “O” Shpk për shkeljet konstatuara në kontratën me objekt “Zhbllokim pusetash”, viti 2022, për arsye se janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht shpenzimet në fazën e hartimit të preventivit dhe të zbatimit të kësaj kontrate, duke rënduar padrejtësisht koston e shërbimit në vlerën 960,984 lekë, vlerë e cila për Shoqërinë “UKT” Sha dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik. Dëmshpërblimi mbështet në Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655 dhe neni

	32.
--	-----

16. Titulli i gjetjes:	Mos maksimalizim me efijçencë të plotë në përputhje me qëllimin e investimit.
Situata:	<p>Në procedurën e prokurimit “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”, viti 2021, në preventiv dhe situacion për 211 objekte është përfshirë zëri “Instalimi i sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit” në vlerën 49,042,692 lekë me TVSH.</p> <p>Në qendrën e monitorimit (Zyrat Qëndrore UKT) instalimi i sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit është në vlerën 54,360,240 lekë me TVSH.</p> <p>Në total vlera për instalimin e sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit është 103,402,932 lekë (49,042,692 + 54,360,240 = 103,402,932).</p> <p>Duke marr në konsideratë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Investimin e bërë për punime rrethimi depo & punime për furnizimin me energji & ndërtim sistem alarm+kamera në vlerën 522,237,830 lekë me TVSH në vlerat respektive 140,407,914 lekë, 46,612,456 lekë dhe 335,253,459 lekë. -Vlerën 103,402,932 lekë për instalimin i sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit. -Personelin e disponueshëm të UKT, pasi në strukturë organizative të shoqërisë është Sektori Call Centër me 9 punonjës në organik, dispeçeria 5 punonjës, IT me personel 8, drejtues mjeti 56, punonjës të taks forcës 31, si dhe automjete 42 autovetura, 30 motor 36 minifugon. -Zbatimin e VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”, SHTOJCA VI “ZONAT E MBROJTJES SANITARE”. Pika 2. Mbrojtja sanitare e burimeve të ujërave nëntokësore (Për furnizim publik ose individual) ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Mbrojtja e saj me roje të armatosur sigurohet nga administratori i ujësjellësit”. Investimi nuk është maksimalizuar me efektivitet të plotë në përputhje me qëllimin e tij.
Kriteri:	VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos efektivitet të fondeve publike.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga organet drejtuese të kësaj shoqërie, të merren masa që investimi të maksimalizohet me efektivitet të plotë në përputhje me qëllimin e tij, duke garantuar edhe mbrojtjen zonave të burimeve të ujërave nëntokësore.

17. Titulli i gjetjes:	Mos arritje të uljes së kostove të blerjeve/shërbimeve me procedurë prokurimi marrëveshje kuadër.
-------------------------------	---

Situata:	Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Tuba dhe Rekorderi”, në vlerën 149,858,642 pa Tvsh, viti 2022, vlera e fondit limit (marrëveshja kuadër) është realizuar 100 % brenda 5 muajve. Lidhja e kontratave është realizuar mbi bazën e marrëveshjes kuadër, e cila pavarësisht se ka ndikuar në uljen e çmimit për njësi, por si shpenzim ka shkuar tek fondi limit, duke rritur numrin e pjesëve/njësive dhe në rastin e audituar asnjëherë uljen e numrit të pjesëve/njësive si dhe pakësimin jo vetëm të fondit limit por edhe as të vlerës së prokuruar, dhe mbart në të ardhmen riskun e lart të përzgjedhjes së pjesëve/njësive me vlerë më të lart, duke mos arritur në këtë mënyrë uljen kostove të blerjeve/shërbimeve. Veprime në kundërshtim me Udhëzim e APP nr. 6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, me ndryshimet vijuese të tij, pikat 7.1,7.2 dhe 7.3. Në dokumentet e tenderit dhe në minikontratat e lidhura nuk është përcaktuar se tubat dhe rekorderit do të jenë të shoqëruara me çertifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqërues të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Çertifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.
Kriteri:	Udhëzi i APP nr. 6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, me ndryshimet vijuese të tij, pikat 7.1,7.2 dhe 7.3, Rekomandimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1.
Ndikimi/Efekti:	Risk i lart në përzgjedhjen e pjesëve/njësive me vlerë më të lart, duke mos arritur në këtë mënyrë uljen kostove të blerjeve/shërbimeve
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore dhe rregullatore
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	-Lidhja e kontratave mbi bazën e marrëveshjeve kuadër, duhet konsideruar si rast i veçantë dhe Autoriteti Kontraktor nuk duhet në asnjë rast të abuzojë me përdorimin e këtij instrumenti, me qëllim shtrembërimin e konkurrencës. Përdorimi i kësaj forme prokurimi detyrimisht duhet të arrij reduktimin e kostove transaksionale, përmirësimin e vazhdueshëm në harkun e marrëdhënieve afat-gjatë ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Operatorëve Ekonomik, në interes të konsumatorit, në rastin konkret përmirësimin e shërbimit të ujit për qytetarët. - Nga autoriteti kontraktor të merren masa që në dokumentet e tenderit dhe në kontratat/minikontratat e lidhura të përcaktohet se mallrat/pajisjet do të jenë të shoqëruara me çertifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë.

18. Titulli i gjetjes:	Mosplotësim i dosjes teknike sipas kushteve të kontratës së shërbimit.
Situata:	Në kontratën me objekt “Ndërtim rrjet kanalizimi rruga e Durrësit”, ku mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga OE “E G” sipas kontratës Nr. 13890/6 prot. datë 11.09.2020, nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se; të gjitha proces verbalet për punimet e maskuara nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike, për secilin prej tyre, siç kërkohet në kontratën e mbikëqyrjes. Materiali fotografik, që ndodhet në dosje, është i përgjithshëm pa përcaktuar pika referimi se në cilën pjesë të projektit janë kryer këto punime. Konkretisht, argumentimet e këtyre pasqyrohen në Akt konstatim.
Kriteri:	- Kontrata e shërbimit me objekt “Mbikëqyrje të objektit, ‘Ndërtim rrjet kanalizimi rruga e Durrësit’”, Nr.7904/20 Prot, datë 24.06.2020, pika 5.2 “Ky dokumentacion duhet të përmbajë”...Proces verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi të shoqëruar me fotografi.
Ndikimi/Efekti:	Mos përcaktim i saktë i punimeve të maskuara me referenca përkatëse të projektit.
Shkaku:	Procesverbale të punimeve të pa shoqëruara me material fotografik për secilin prej tyre.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandimi:	Shoqëria UK Tiranë gjatë marrjes në dorëzim të dosjeve teknike, për kontratat e përfunduara, të kryej një kontroll më të detajuar që këto dosje të jenë të plotësuara në përputhje me kërkesat e kontratës që të bëhet e mundur verifikimi i punimeve të maskuara edhe në një periudhë të mëvonshme nga ana e niveleve të kontrollit.

19. Titulli i gjetjes:	Rritje e fondit limit si rezultat i përfshirjes së zërave jashtë analizës së çmimeve të manualit të ndërtimit.
Situata:	Në kontratën me objekt “Ndërtim rrjet kanalizimi rruga e Durrësit”, nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konkretisht, projekti fillestar dhe preventivi i marrë për bazë për llogaritjen e fondit limit konstatohet se poshtë tubave të kanalizimeve është vendosur si zë i veçantë nënshtresë zhavorri dhe shtresë beton C7/10. Referuar manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit për vendosjen e tubave B/A me diametra të ndryshëm nënshtresa e zhavorrit dhe shtresa e betonit janë të përfshira në furnizim vendosjen e tyre, kjo e pasqyruar në analizën e çmimit të manualeve teknike. Pra përfshirja e këtyre dy zërave në preventivin fillestar ka rritur fondin limit në mënyrë të pa argumentuar në vlerën 1,057,792 lekë pa TVSH. Gjithashtu referuar preventivit konstatohet se në të është përfshirë puseta e sistemit të ujësjellësit Nr.2 për ndërtim me vlerë totale 684,186 lekë pa TVSH ku sipas situacionit përfundimtar nuk është kryer asnjë punim pasi është e përfshirë edhe në projektin e sistemit të ujësjellësit në rrugën e Durrësit, pra përfshirja në projektin e kanalizimeve rit përlllogaritjen e vlerës së fondit limit. Pra vlera prej 1,741,978 lekë pa TVSH konsiderohet shpenzim i fondeve të

	shoqërisë pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet. Konkretisht, argumentimet e këtyre pasqyrohen në Akt konstatim.
Kriteri:	<p>- VKM Nr.914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar, neni 59 pika 2, ku citohet: <i>Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe</i></p> <p>a) çmimet e tregut; ose/dhe</p> <p>b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe</p> <p>ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.</p> <p>- Parimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të shprehura në nenin 5.</p> <p><i>Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike.</i></p> <p>- VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Rritje e fondit limit në vlerën prej 1,741,978 lekë pa TVSH.
Shkaku:	Përfshirje e zërave të punimeve në preventiv jo sipas manualit të çmimeve në ndërtim.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandimi:	Shoqëria UKT të marrë masat e nevojshme për projektet që janë në proces dhe në të ardhmen duke bërë një analizë më të detajuar të llogaritjes së vlerës së fondit limit duke shmangur kështu rritjen e tij e për pasojë edhe kostot shtesë të projekteve.

20. Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara dhe të likuiduara por të pakryera në fakt.
Situata:	<p>Në objektin “Ndërtim rrjet kanalizimi rruga e Durrësit” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UKT sh.a dhe BOE “V K” shpk & “B” shpk & “M” shpk me Nr.6091/6Prot. datë 24.06.2020 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 113,715,031 lekë pa TVSH ose 136,458,037 lekë me TVSH, si dhe shtesë kontrate Nr.13890/6prot. datë 11.09.2020 me vlerë 22,622,254 lekë pa TVSH ose 27,146,704 lekë me TVSH afat të përfundimit të punimeve 4 muaj, dhe mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga OE “EG” sipas kontratës Nr.13890/6prot. datë 11.09.2020 me vlerë 22,622,254 lekë pa TVSH ose 27,146,704 lekë me TVSH dhe shtesë kontrate Nr.13377/7Prot. datë 04.09.2020 me vlerë 387,450 lekë me TVSH, u auditua dokumentacioni;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Projektpreventivi,</i> • <i>Projekti i azhurnuar,</i> • <i>Situacioni përfundimtar,</i>

	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Librezat e masave,</i> • <i>Kontratat e sipërmarrjes dhe shërbimit.</i> <p>ku sipas materialit fotografik, pjesë e dosjes teknike, rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Kategoria e Punimeve</th> <th>Emërtimi i Zërit</th> <th>Vlera (lekë pa TVSH)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Punime gjurmimi + shtresa rrugore</td> <td>Shtresë beton C7/10 (poshtë kolektorit)</td> <td>331,200</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Punime gjurmimi + shtresa rrugore</td> <td>Nënshtresë zhavorri (poshtë kolektorit)</td> <td>153,360</td> </tr> <tr> <td colspan="3">SHUMA</td> <td>484,560</td> </tr> </tbody> </table> <p>Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave pasqyrohen në Akt konstatim.</p>	Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)	1	Punime gjurmimi + shtresa rrugore	Shtresë beton C7/10 (poshtë kolektorit)	331,200	2	Punime gjurmimi + shtresa rrugore	Nënshtresë zhavorri (poshtë kolektorit)	153,360	SHUMA			484,560
Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)														
1	Punime gjurmimi + shtresa rrugore	Shtresë beton C7/10 (poshtë kolektorit)	331,200														
2	Punime gjurmimi + shtresa rrugore	Nënshtresë zhavorri (poshtë kolektorit)	153,360														
SHUMA			484,560														
Kriteri:	<p>Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”</p> <p>- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 <u>ku përcaktohet se:</u> “3.2 Librezat e masave (measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>- Kontrata e shërbimit me objekt “Mbikëqyrje të objektit, ‘Ndërtim rrjet kanalizimi rruga e Durrësit’”, Nr.7904/20 Prot, datë 24.06.2020, Neni 7, “Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit”.</p>																
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë sh.a 484,560 lekë pa TVSH.																
Shkaku:	Certifikimi nga ana e Supervizorit i volumeve të punimeve të pa kryera dhe të pasqyruara në librezën e masave nga ana e sipërmarrësit.																
Rëndësia:	E Lartë																

Rekomandimi:	Shoqëria UK Tiranë të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 484,560 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve BOE "VK" shpk & "B" shpk & "M" shpk me të cilin është realizuar kontrata Nr.6091/6Prot. datë 24.06.2020 për zbatimin e punimeve civile.
---------------------	---

21. Titulli i gjetjes:	Mosplotësim i dosjes teknike sipas kushteve të kontratës së shërbimit.
Situata:	Në kontratën me objekt "Ndërtim linjë transmetimi ujësjellësi nga rruga "V.N", ku mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga BOE "I D" sh.p.k & "D P" sh.p.k sipas kontratës Nr.18824/35prot. datë 11.10.2018, nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se; të gjitha proces verbalet për punimet e maskuara nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike, për secilin prej tyre, siç kërkohet në kontratën e mbikëqyrjes. Materiali fotografik, që ndodhet në dosje, është i përgjithshëm pa përcaktuar pika referimi se në cilën pjesë të projektit janë kryer këto punime. Konkretisht, argumentimet e këtyre pasqyrohen në Akt konstatim.
Kriteri:	- Kontrata e shërbimit me objekt "Mbikëqyrja e punimeve për objektin, "Ndërtim linjë transmetimi ujësjellësi nga rruga "V.N" - Depo 4000m3 në Yzberisht", Nr.18824/35 prot, datë 11.10.2018, pika 5.2 "Ky dokumentacion duhet të përmbajë "Proces verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi <u>të shoqëruar me fotografi.</u>
Ndikimi/Efekti:	Mos përcaktim i saktë i punimeve të maskuara me referenca përkatëse të projektit.
Shkaku:	Procesverbale të punimeve të pa shoqëruara me material fotografik për secilin prej tyre.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandimi:	Shoqëria UK Tiranë gjatë marrjes në dorëzim të dosjeve teknike, për kontratat e përfunduara, të kryej një kontroll më të detajuar që këto dosje të jenë të plotësuara në përputhje me kërkesat e kontratës që të bëhet e mundur verifikimi i punimeve të maskuara edhe në një periudhë të mëvonshme nga ana e niveleve të kontrollit.

22. Titulli i gjetjes:	Mosplotësim i dosjes teknike sipas kushteve të kontratës së shërbimit.
Situata:	Në kontratën me objekt "Ndërtim linjë transmetimi ujësjellësi nga rruga "V.N", ku mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga BOE "I D" sh.p.k & "D P" sh.p.k sipas kontratës Nr.18824/35prot. datë 11.10.2018, nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se; të gjitha proces verbalet për punimet e maskuara nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike, për secilin prej tyre, siç kërkohet në kontratën e mbikëqyrjes. Materiali fotografik, që ndodhet në dosje, është i përgjithshëm pa përcaktuar pika referimi se në cilën pjesë të projektit janë kryer këto punime. Konkretisht, argumentimet e këtyre pasqyrohen në Akt konstatim.
Kriteri:	- Kontrata e shërbimit me objekt "Mbikëqyrja e punimeve për objektin,

	<i>“Ndërtim linjë transmetimi ujësjellësi nga rruga “V.N” - Depo 4000m³ në Yzberisht”, Nr.18824/35 prot, datë 11.10.2018, pika 5.2 “Ky dokumentacion duhet të përmbajë”...Proces verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi të shoqëruar me fotografi.</i>
Ndikimi/Efekti:	Mos përcaktim i saktë i punimeve të maskuara me referenca përkatëse të projektit.
Shkaku:	Procesverbale të punimeve të pa shoqëruara me material fotografik për secilin prej tyre.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandimi:	Shoqëria UK Tiranë gjatë marrjes në dorëzim të dosjeve teknike, për kontratat e përfunduara, të kryej një kontroll më të detajuar që këto dosje të jenë të plotësuar në përputhje me kërkesat e kontratës që të bëhet e mundur verifikimi i punimeve të maskuara edhe në një periudhë të mëvonshme nga ana e niveleve të kontrollit.

23. Titulli i gjetjes:	Rritje e kostos së projektit.
Situata:	Në objektin “V.N” - Depo 4000m ³ në Yzberisht” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UKT sh.a dhe BOE “B S” sh.p.k & “E” sh.p.k me Nr.16975/9Prot datë 19.10.2018 u konstatua se peshat specifike e tubit çelik Ø (1016x8.8 mm) i h/izoluar në fabrikë sipas certifikatës së prodhimit është 10 kg/ml më shumë se ajo e projektuar dhe e kërkuar në specifikimet teknike, kështu që nga llogaritjet ka rritur koston e projektit, për gjithë gjatësinë e tubit 2186.65 ml në vlerën 3,672,480 lekë pa TVSH (21,86 Ton x168,000 lekë/ton), e cila në gjykimin e grupit të auditimit shpenzim i fondeve të shoqërisë pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet.
Kriteri:	- Parimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të shprehura në nenin 5. <i>Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike.</i>
Ndikimi/Efekti:	Rritje e kostos së projektit në vlerën prej 3,692,640 lekë pa TVSH.
Shkaku:	Vendosje e tubit me parametrin e peshës specifike më të madhe nga ajo e kërkuar në specifikimet teknike.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Shoqëria UK Tiranë në bashkëpunim me mbikëqyrësit e punimeve të kryej një kontroll më të detajuar të specifikimeve teknike të kërkuara, të materialeve në realizimin punimeve civile, duke shmangur kështu rritjen e kostove të projekteve në proces dhe atyre që do të zbatohen në vazhdimësi.

24. Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara dhe të likuiduara por të pakryera në fakt.
Situata:	Në objektin “V.N” - Depo 4000m ³ në Yzberisht” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UKT sh.a dhe BOE “BE” sh.p.k & “E” sh.p.k me Nr.16975/9Prot datë 19.10.2018 për zbatimin e punimeve civile me vlerë

184,114,778 lekë pa TVSH ose 220,937,734 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 4 muaj, dhe mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga BOE "I D" sh.p.k & "D P" sh.p.k sipas kontratës Nr.18824/35 prot. datë 11.10.2018 me vlerë 2,715,083 lekë pa TVSH ose 3,258,099 lekë me TVSH, u auditua dokumentacioni;

- *Projektpreventivi,*
- *Projekti i azhurnuar,*
- *Situacioni përfundimtar,*
- *Librezat e masave,*
- *Kontratat e sipërmarrjes dhe shërbimit.*

ku sipas materialit fotografik, pjesë e dosjes teknike, rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Shtresë rëre	2,916,000
2	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Nënshtresë zhavorri	3,621,000
3	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Transport dheu me auto deri në 3km	1,491,000
SHUMA			8,028,000

Kriteri:

Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:

“3.2 Libreza e masave (measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

- Kontrata e shërbimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin, “Ndërtim linjë transmetimi ujësjellësi nga rruga ‘V.N’ - Depo 4000m3 në Yzberisht”, Nr.18824/35 prot, datë 11.10.2018, Neni 7, “Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit”.

Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë sh.a 262,100 lekë pa TVSH.
Shkaku:	Certifikimi nga ana e Supervizorit i volumeve të punimeve të pa kryera dhe të pasqyruara në librezën e masave nga ana e sipërmarrësit.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Shoqëria UK Tiranë të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 8,028,000 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve <i>BOE "BE" sh.p.k & "E" sh.p.k</i> me të cilin është realizuar kontrata Nr.16975/9Prot datë 19.10.2018 për zbatimin e punimeve civile.

25. Titulli i gjetjes:	Mosplotësim i dosjes teknike sipas kushteve të kontratës së shërbimit.
Situata:	Në kontratën me objekt "Spostim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime, sheshi Shqiponja, Loti 1", ku mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga OE "A E" shpk sipas kontratës Nr.15784/10 prot, datë 22.10.2020, nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se; të gjitha proces verbale të punimeve të maskuara nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike, për secilin prej tyre, siç kërkohet në kontratën e mbikëqyrjes. Materiali fotografik, që ndodhet në dosje, është i përgjithshëm pa përcaktuar pika referimi se në cilën pjesë të projektit janë kryer këto punime. Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave pasqyrohen të përshkruara më sipër.
Kriteri:	- Kontrata e shërbimit me objekt "Mbikëqyrje të objektit, "Spostim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime, sheshi Shqiponja, Loti 1", Nr.15784/10 prot, datë 22.10.2020, pika 5.2 "Ky dokumentacion duhet të përmbajë"...Proces verbale të punimeve të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi <u>të shoqëruar me fotografi.</u>
Ndikimi/Efekti:	Mos përcaktim i saktë i punimeve të maskuara me referenca përkatëse të projektit.
Shkaku:	Procesverbale të punimeve të pa shoqëruara me material fotografik për secilin prej tyre.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandimi:	Shoqëria UK Tiranë, gjatë marrjes në dorëzim të dosjeve teknike, për kontratat e përfunduara, të kryej një kontroll më të detajuar që këto dosje të jenë të plotësuara në përputhje me kërkesat e kontratës që të bëhet e mundur verifikimi i punimeve të maskuara edhe në një periudhë të mëvonshme nga ana e niveleve të kontrollit.

26. Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara dhe të likuiduara por të pakryera në fakt.
Situata:	Në objektin "Spostim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime, sheshi Shqiponja, Loti 1" të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe OE "S" sh.p.k me Nr.14332/8Prot datë 22.10.2020 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 227,953,868 lekë pa TVSH ose 273,544,642 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 6 muaj, dhe mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga OE "AE" sh.p.k sipas kontratës Nr.15784/10 prot, datë 22.10.2020 me vlerë 2,799,059 lekë pa TVSH ose

3,258,871 lekë me TVSH, u auditua dokumentacioni;

- *Projektpreventivi,*
- *Projekti i azhurnuar,*
- *Situacioni përfundimtar,*
- *Librezat e masave,*
- *Kontratat e sipërmarrjes dhe shërbimit.*

ku sipas materialit fotografik, pjesë e dosjes teknike, rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Nënshtresë zhavorri për tub kuz (si diferencë me sasinë e manualit)	3,257,800
2	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Shtresë rëre	1,940,633
3	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Mbushje me zhavorr për tub kuz+ ujësjellës	4,116,000
4	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Transport dheu me auto deri në 5 km	753,000
5	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Përforcime gërmimi me lëndë ndërtimi (sipas vizatimeve)	441,000
SHUMA			10,490,433

Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave pasqyrohen në Akt konstatim.

Kriteri:

Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”

- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:

“3.2 Libreza e masave (measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

	<p>3.3 <i>Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</i></p> <p>- Kontrata e shërbimit me objekt <i>“Mbikëqyrje të objektit, “Spotim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime, sheshi Shqiponja, Loti 1”, Nr.15784/10Prot, datë 22.10.2020, Neni 7, “Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit”</i></p>
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UKT sh.a 10,490,433 lekë pa TVSH.
Shkaku:	Certifikimi nga ana e Supervizorit i volumeve të punimeve të pa kryera dhe të pasqyruara në librezën e masave nga ana e sipërmarrësit.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Shoqëria UKT të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 10,490,433 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve OE <i>“S” sh.p.k</i> me të cilin është realizuar kontrata Nr.14332/8Prot datë 22.10.2020 për zbatimin e punimeve civile.

27. Titulli i gjetjes:	Mosplotësim i dosjes teknike sipas kushteve të kontrates së shërbimit.
Situata:	Në kontratën me objekt <i>“Rikonstruksion rrjet ujësjellësi Dn-426mm, Dn-200mm në rrugën ‘Xhanfize Keko’”,</i> ku mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga OE <i>“I” sh.p.k</i> sipas kontratës Nr.10087/42Prot. datë 05.08.2019, nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se; të gjitha proces verbalet për punimet e maskuara nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike, për secilin prej tyre, siç kërkohet në kontratën e mbikëqyrjes. Materiali fotografik, që ndodhet në dosje, është i përgjithshëm pa përcaktuar pika referimi se në cilën pjesë të projektit janë kryer këto punime. Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave pasqyrohen të përsëritura më sipër.
Kriteri:	- Kontrata e shërbimit me objekt <i>“Mbikëqyrje të objektit, Rikonstruksion rrjet ujësjellësi Dn-426mm, Dn-200mm në rrugën ‘Xhanfize Keko’”,</i> Nr.10087/42Prot. datë 05.08.2019, pika 5.2 <i>“Ky dokumentacion duhet të përmbajë”...Proces verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi të shoqëruar me fotografi.</i>
Ndikimi/Efekti:	Mos përcaktim i saktë i punimeve të maskuara me referenca përkatëse të projektit.
Shkaku:	Procesverbale të punimeve të pa shoqëruara me material fotografik për secilin prej tyre.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandimi:	Shoqëria UK Tiranë, gjatë marrjes në dorëzim të dosjeve teknike, për kontratat e përfunduara, të kryej një kontroll më të detajuar që këto dosje të jenë të plotësuara në përputhje me kërkesat e kontratës që të bëhet e mundur verifikimi i punimeve të maskuara edhe në një periudhë të

mëvonshme nga ana e niveleve të kontrollit.

<p>28. Titulli i gjetjes:</p> <p>Situata:</p>	<p>Punime të situacionuara dhe të likuiduara por të pakryera në fakt.</p> <p>Në objektin “Rikonstruksion rrjet ujësjellësi Dn-426mm, Dn-200mm në rrugën ‘Xhanfize Keko’” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe OE “B” sh.p.k me Nr.10098/2Prot. datë 17.08.2019 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 50,406,959 lekë pa TVSH ose 60,488,350.8 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 30 ditë, dhe mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga OE “I” sh.p.k sipas kontratës Nr.10087/42Prot. datë 05.08.2019 me vlerë 1,116,747.76 lekë pa TVSH ose 1,340,097.31 lekë me TVSH, u auditua dokumentacioni;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Projekt preventivi,</i> • <i>Projekti i azhurnuar,</i> • <i>Situacioni përfundimtar,</i> • <i>Librezat e masave,</i> • <i>Kontratat e sipërmarrjes dhe shërbimit.</i> <p>ku sipas materialit fotografik, pjesë e dosjes teknike, rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="479 934 1421 1501"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Kategoria e Punimeve</th> <th>Emërtimi i Zërit</th> <th>Vlera (lekë pa TVSH)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Ndërtim rrjet ujësjellësi</td> <td>Shtresë stabilizanti t=15cm</td> <td>360,962</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Ndërtim rrjet ujësjellësi</td> <td>Ger. dheu me eks. goma 0.25m³,me gjersi 2m,t.z.shk.mj</td> <td>173,880</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Ndërtim rrjet ujësjellësi</td> <td>Transport dheu deri 10 km</td> <td>227,700</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Ndërtim rrjet ujësjellësi</td> <td>Shtresë binder 6cm</td> <td>1,303,390</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Ndërtim rrjet ujësjellësi</td> <td>Nënshtresë zhavorri</td> <td>998,280</td> </tr> <tr> <td colspan="3" style="text-align: center;">SHUMA</td> <td>3,064,212</td> </tr> </tbody> </table> <p>Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave pasqyrohen në Akt konstatim.</p>	Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)	1	Ndërtim rrjet ujësjellësi	Shtresë stabilizanti t=15cm	360,962	2	Ndërtim rrjet ujësjellësi	Ger. dheu me eks. goma 0.25m ³ ,me gjersi 2m,t.z.shk.mj	173,880	3	Ndërtim rrjet ujësjellësi	Transport dheu deri 10 km	227,700	4	Ndërtim rrjet ujësjellësi	Shtresë binder 6cm	1,303,390	5	Ndërtim rrjet ujësjellësi	Nënshtresë zhavorri	998,280	SHUMA			3,064,212
Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)																										
1	Ndërtim rrjet ujësjellësi	Shtresë stabilizanti t=15cm	360,962																										
2	Ndërtim rrjet ujësjellësi	Ger. dheu me eks. goma 0.25m ³ ,me gjersi 2m,t.z.shk.mj	173,880																										
3	Ndërtim rrjet ujësjellësi	Transport dheu deri 10 km	227,700																										
4	Ndërtim rrjet ujësjellësi	Shtresë binder 6cm	1,303,390																										
5	Ndërtim rrjet ujësjellësi	Nënshtresë zhavorri	998,280																										
SHUMA			3,064,212																										
<p>Kriteri:</p>	<p>Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit” - Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 <u>ku përcaktohet se:</u></p>																												

	<p>“3.2 Libreza e masave (measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>- Kontrata e shërbimit me objekt “Mbikëqyrje të objektit, ‘Rikonstruksion rrjet ujësjellësi Dn-426mm, Dn-200mm në rrugën ‘Xhanfize Keko’, Nr.10087/42Prot. datë 05.08.2019, Neni 7, “Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UKT sh.a 3,064,212lekë pa TVSH.
Shkaku:	Certifikimi nga ana e Supervizorit i volumeve të punimeve të pa kryera dhe të pasqyruara në librezën e masave nga ana e sipërmarrësit.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Shoqëria UKT të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 3,064,212 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve OE “B” sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr.10098/2Prot. datë 17.08.2019 për zbatimin e punimeve civile.

29. Titulli i gjetjes:	Mosplotësim i dosjes teknike sipas kushteve të kontrates së shërbimit.
Situata:	Në kontratën me objekt “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depo Kombinat”, ku mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga OE "N G" sh.p.k sipas kontratës Nr.10087/59 Prot. datë 08.08.2019, nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se; të gjitha proces verbalet për punimet e maskuara nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike, për secilin prej tyre, siç kërkohet në kontratën e mbikëqyrjes. Materiali fotografik, që ndodhet në dosje, është i përgjithshëm pa përcaktuar pika referimi se në cilën pjesë të projektit janë kryer këto punime. Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave pasqyrohen të përsëritura më sipër.
Kriteri:	- Kontrata e shërbimit me objekt “Mbikëqyrje të objektit, “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depo Kombinat”, Nr.10087/59 Prot. datë 08.08.2019, pika 5.2 “Ky dokumentacion duhet të përmbajë”...Proces verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi të shoqëruar me fotografi.
Ndikimi/Efekti:	Mos përcaktim i saktë i punimeve të maskuara me referenca përkatëse të projektit.

Shkaku:	Procesverbale të punimeve të pa shoqëruara me material fotografik për secilin prej tyre.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandimi:	Shoqëria UK Tiranë, gjatë marrjes në dorëzim të dosjeve teknike, për kontratat e përfunduara, të kryej një kontroll më të detajuar që këto dosje të jenë të plotësuara në përputhje me kërkesat e kontratës që të bëhet e mundur verifikimi i punimeve të maskuara edhe në një periudhë të mëvonshme nga ana e niveleve të kontrollit.

30. Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara dhe të likuiduara por të pakryera në fakt.																										
Situata:	<p>Në objektin “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depo Kombinat” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UKT sh.a dhe BOE "A" sh.p.k & "V" sh.p.k me Nr.9525/14 Prot. datë 07.08.2019 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 63,913,231.36 lekë pa TVSH ose 76,695,877.63 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 3 muaj, dhe mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga OE “N G” sh.p.k sipas kontratës Nr.10087/59 Prot. datë 08.08.2019 me vlerë 1,318,039.98 lekë pa TVSH ose 1,581,647.97 lekë me TVSH, u auditua dokumentacioni;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Projektpreventivi,</i> • <i>Projekti i azhurnuar,</i> • <i>Situacioni përfundimtar,</i> • <i>Librezat e masave,</i> • <i>Kontratat e sipërmarrjes dhe shërbimit.</i> <p>ku sipas materialit fotografik, pjesë e dosjes teknike, rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt. Këto diferencë rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:</p>																										
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Kategoria e Punimeve</th> <th>Emërtimi i Zërit</th> <th>Vlera (lekë pa TVSH)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime</td> <td>Panele dërrasash për drejtues kanalizimesh</td> <td>47,560</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime</td> <td>Frezim asfalti</td> <td>271,400</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime</td> <td>Gërmim dheu kanal kat III me makineri me shkarkim ne mjet</td> <td>129,850</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime</td> <td>Transport dheu me auto deri në venddepozitimin Sharrë</td> <td>327,222</td> </tr> <tr> <td colspan="3" style="text-align: center;">SHUMA</td> <td>776,032</td> </tr> </tbody> </table>			Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)	1	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Panele dërrasash për drejtues kanalizimesh	47,560	2	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Frezim asfalti	271,400	3	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Gërmim dheu kanal kat III me makineri me shkarkim ne mjet	129,850	4	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Transport dheu me auto deri në venddepozitimin Sharrë	327,222	SHUMA			776,032
Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)																								
1	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Panele dërrasash për drejtues kanalizimesh	47,560																								
2	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Frezim asfalti	271,400																								
3	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Gërmim dheu kanal kat III me makineri me shkarkim ne mjet	129,850																								
4	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Transport dheu me auto deri në venddepozitimin Sharrë	327,222																								
SHUMA			776,032																								
	Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave pasqyrohen në Akt konstatim.																										
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e																										

	<p><i>Punimeve të Ndërtimit</i>”, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.</p> <p>- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 <u>ku përcaktohet se:</u> “3.2 Libreza e masave (measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>- Kontrata e shërbimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin, “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depo Kombinat”, Nr.10087/59Prot. datë 08.08.2019, Neni 7, “Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UKT sh.a 776,032 lekë pa TVSH.
Shkaku:	Certifikimi nga ana e Supervizorit i volumeve të punimeve të pa kryera dhe të pasqyruara në librezën e masave nga ana e sipërmarrësit.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Shoqëria UK Tiranë të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 776,032 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve BOE "A" sh.p.k & "V" sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr.9525/14Prot. datë 07.08.2019 për zbatimin e punimeve civile.

31. Titulli i gjetjes:	Mosplotësim i dosjes teknike sipas kushteve të kontratës së shërbimit.
Situata:	Në kontratën me objekt “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri, Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet i Nxënësave” ku mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga OE "N G" sh.p.k sipas kontratës Nr.7904/24 Prot. datë 02.07.2020, nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se; të gjitha proces verbalet për punimet e maskuara nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike, për secilin prej tyre, siç kërkohet në kontratën e mbikëqyrjes. Materiali fotografik, që ndodhet në dosje, është i përgjithshëm pa përcaktuar pika referimi se në cilën pjesë të projektit janë

	kryer këto punime. Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave pasqyrohen të përshkruara më sipër.
Kriteri:	- Kontrata e shërbimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin, “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depo Kombinat”, Nr.7904/24Prot. datë 02.07.2020, pika 5.2 “Ky dokumentacion duhet të përmbajë”...Proces verbale të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi <u>të shoqëruar me fotografi.</u>
Ndikimi/Efekti:	Mos përcaktim i saktë i punimeve të maskuara me referenca përkatëse të projektit.
Shkaku:	Procesverbale të punimeve të pa shoqëruara me material fotografik për secilin prej tyre.
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandimi:	Shoqëria UK Tiranë, gjatë marrjes në dorëzim të dosjeve teknike, për kontratat e përfunduara, të kryej një kontroll më të detajuar që këto dosje të jenë të plotësuara në përputhje me kërkesat e kontratës që të bëhet e mundur verifikimi i punimeve të maskuara edhe në një periudhë të mëvonshme nga ana e niveleve të kontrollit.

32. Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara dhe të likuiduara por të pakryera në fakt.												
Situata:	<p>Në objektin “ Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri, Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet i Nxënëseve” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UKT sh.a dhe BOE “K” sh.p.k, “S” sh.p.k & “L” sh.a & “A” sh.p.k me Nr.6068/9 Prot. datë 02.07.2020 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 381,811,507.02 lekë pa TVSH ose 458,173,808.43 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 4 muaj, dhe mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga OE “N G” sh.p.k sipas kontratës Nr.7904/24 Prot. datë 02.07.2020 me vlerë 3,476,357 lekë pa TVSH ose 4,171,629.00 lekë me TVSH, u auditua dokumentacioni;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Projekt preventivi, • Projekti i azhurnuar, • Situacioni përfundimtar, • Librezat e masave, • Kontratat e sipërmarrjes dhe shërbimit. <p>ku sipas materialit fotografik, pjesë e dosjes teknike, rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:</p>												
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Kategoria e Punimeve</th> <th>Emërtimi i Zërit</th> <th>Vlera (lekë pa TVSH)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime</td> <td>Panele dërrasash për drejtues kanalizimesh</td> <td>499,000</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Ndërtim ujësjellësit dhe</td> <td>Shtrese rëre nen dhe mbi tub</td> <td>39,349</td> </tr> </tbody> </table>	Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)	1	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Panele dërrasash për drejtues kanalizimesh	499,000	2	Ndërtim ujësjellësit dhe	Shtrese rëre nen dhe mbi tub	39,349
Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)										
1	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Panele dërrasash për drejtues kanalizimesh	499,000										
2	Ndërtim ujësjellësit dhe	Shtrese rëre nen dhe mbi tub	39,349										

		kanalizime		
	3	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Shtrese çakëll mbeturine tre shtresa t=20cm	288,000
	4	Ndërtim ujësjellësit dhe kanalizime	Transport dheu me auto deri në 5 km Transport dheu me auto deri në vend depozitimin sharre	38,400
	SHUMA			864,749
	Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave pasqyrohen të përshkruara në Akt konstatim.			
Kriteri:	<p>Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.</p> <p>- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 <u>ku përcaktohet se:</u> “3.2 Libreza e masave (measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>- Kontrata e shërbimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin, “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri, ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet i Nxënëseve” Nr.7904/24Prot. datë 02.07.2020, Neni 7, “Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit”.</p>			
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UKT sh.a 864,749 lekë pa TVSH.			
Shkaku:	Certifikimi nga ana e Supervizorit i volumeve të punimeve të pa kryera dhe të pasqyruara në librezën e masave nga ana e sipërmarrësit.			
Rëndësia:	E Lartë			
Rekomandimi:	Shoqëria UK Tiranë të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 864,749 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve			

	<i>BOE "K" sh.p.k & "S" sh.p.k & "LI" sh.a & "A" sh.p.k</i> me të cilin është realizuar kontrata Nr.6068/9 Prot. datë 02.07.2020 për zbatimin e punimeve civile.
--	--

2.8. Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë

a. Licencimi i Shoqërisë nga Enti Rregullator i Ujit (ERU).

Për periudhën 06.10.2018-03.03.2021, kjo shoqëri ka zhvilluar aktivitetet të pa licencuar nga Enti Rregullator i Ujit (ERU). Pas datës 04.03.2021 kjo shoqëri është pajisur me Licencë me nr. 19, miratuar me vendim nr. 40, datë 06.10.2017 (afati 06.10.2017-05.10.2018), Licensa nr. 2 miratuar me vendim nr. 84, date 04.03.2021 me afat 04.03.2021 deri me 03.03.2023; Licensa nr. 2, miratuar me vendim nr. 150, date 01.04.2022 me afat 01.04.2022 deri me 03.03.2023.

Në vendim të Entit Rregullator i Uji nr. 84, date 04.03.2021 është përcaktuar drejtues ligjor E.K dhe drejtues teknik E.O dhe E.C, me licensim të shoqërisë me kategori A”, “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”, kategoria B “Për përpunimin e ujit për konsum publik” dhe kategorinë C”, “Për largimin e ujërave të ndotura.

Për licencimin e shoqërisë janë ndjekur procedurat në vijim:

-Me vendimin nr. 40, datë 06.10.2017 të ERRU-së është miratuar licenca e shoqërisë “UKT” SHA me nr.19, për një afat kohor 06.07.2017-05.10.2018, me zonë mbulimi Bashkia Tiranë, Bashkia Kamëz pjesërisht dhe Bashkia Vorë pjesërisht me kategori A”, “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”, kategoria B “Për përpunimin e ujit për konsum publik” dhe kategorinë C”, “Për largimin e ujërave të ndotura.

-Me shkresën nr. 12863 prot., datë 21.06.2017 “Kërkesë për pajisje me akt-miratimi higjeno sanitar”, UKT SHA i është drejtuar Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor Rajonal Tiranë për pajisjen e objekteve me Akt-miratime higjienosanitare. Kjo kërkesë e shoqërisë “UKT” SHA është lënë pa përgjigje deri në Shtator 2019.

-Në këto kushte me shkresën nr. 22884 prot, datë 05.10.2018, UKT SHA i është drejtuar Entit Rregullator të Ujit me “Kërkesë për rinovim liçence,” nëpërmjet të cilës është dërguar aplikimi për rinovim liçence dhe dokumentacioni i kërkuar në bazë të VKM nr. 958, datë 06.05.2009“Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim”, i ndryshuar, pjesë e të cilit ka qenë edhe Akt Miratimi Higjienosanitar nr. 92, datë 26.03.2013.

-Me shkresën nr. 741 prot., datë 14.01.2019 “Kërkesë për konfirmim”, UKT SHA i është drejtuar ISHSH-së për të kërkuar konfirmim zyrtar mbi vlefshmërinë e Akt Miratimi Higjienosanitar nr. 92, datë 26.03.2013, për sa kohë ky akt vijon të jetë në fuqi dhe përderisa nuk është nxjerrë nga ISHSH një tjetër akt që revokon apo ndryshon atë në zbatim të Ligjit nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”, neni 42, pika 3 dhe 4, Ligjit nr.7643, datë 02.12.1992 “Për shëndetin publik dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror” i ndryshuar, neni 7, neni 12 dhe Ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 “Për Liçencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, Udhëzimit nr. 139, datë 14.04.2011 “Për lëshimin e akt-miratimit higjieno-sanitare” dhe nr. 510, datë 13.12.2011 “Për inspektimet higjieno-sanitare në funksion të lëshimit të akt miratimit higjieno-sanitar” të Ministrisë të Shëndetësisë.

- Në përgjigje të kësaj shkrese me shkresën nr. 94/2 prot., datë 28.01.2019 të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor protokolluar në UKT SHA me nr. 741/1 prot., datë 31.01.2019, është dërguar relacioni i grupit të punës i ngritur nga ISHSH në shqyrtim të kërkesës së UKT ShA. Në këtë relacion grupi i punës i ISHSH, referuar përcaktimeve në VKM nr. 379, datë 25.05.2016,

vlerëson se çdo objekt i prodhimit të ujit të pijshëm duhet të pajiset me Akt-miratimi Higjienosantar dhe shprehet se nuk e sheh të mundur të konfirmojë vlefshmërinë e Akt Miratimi Higjienosantar nr. 92, datë 26.03.2013. Gjithashtu në fund të këtij relacioni grupi i ISHSH thekson se: *Në përputhje me Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ISHSH ka për detyrë të planifikojë inspektimin bazuar në vlerësimin e risku si dhe në raportet e monitorimit nga strukturat qendrore dhe rajonale të shëndetit publik.*

-Në vijim të korrespondencës me ISHSH, dhe kërkesës nr. 12863 prot., datë 21.06.2017, me shkresën nr.15115 prot., datë 27.08.2019, UKT SHA i ka kërkuar këtij institucioni të vijojë me procesin e pajisjes së objekteve të UKT SHA me Akt-Miratime Higjienosanitare. Pas kësaj shkrese deri në fund të vitit 2019 strukturat e ISHSH lëshuan tre akt-miratime higjienosanitare.

-Me shkresën nr. K-2348/1 prot., datë 21.11.2019 “Mbi aplikimin për licencë të shoqërisë UKT” SHA, UKT SHA i drejtohet ERRU-së për të sqaruar vijimin e procesit të pajisjes së UKT SHA me Akt-miratime Higjienosanitare nga ISHSH, si dhe marrëdhëniet e përditësuara me Bashkinë Kamëz për bërjen efektive të akteve të ndarjes.

-Me shkresën nr. 15115/2 prot., datë 02.12.2019 “Kërkesë për përshpejtimin e procedurave të pajisjes me Akt-miratimi Higjienosantar”, UKT SHA ka kërkuar përshpejtimin e procesit të lëshimit të akt-miratimeve higjienosanitare.

-Me shkresën nr. 8158 prot., datë 19.05.2020, UKT SHA ka paraqitur sërish kërkesë për rinovim licencë për shkak të ndryshimit të zonës së shërbimit me ndarjen përfundimtare të aksionarit Bashkia Kamëz nga Shoqëria UKT ShA.

-Me shkresën nr.14474, datë 09.09.2020 “Mbi procedurat e pajisjes së UKT SHA me Akt-miratime Higjienosanitare”, UKT SHA i është drejtuar Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor Rajonal, Tiranë dhe për dijeni Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor Qëndror për të kërkuar vijimin dhe përshpejtimin e procesit të pajisjes me Akt-miratime Higjienosanitare të ndërprerë për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e Covid 19.

-Me shkresën nr. 18963 prot., datë 12.11.2020 është njoftuar ERRU për ndryshimin e drejtuesit ligjor të Shoqërisë.

-Po kështu me shkresën nr. 14474/1 prot., datë 18.11.2020, UKT SHA ka kërkuar në vijim të shkresës nr. 14474 vazhdimin e procesit të lëshimit të akt-miratimeve higjienosanitare.

-Me shkresën nr. 2372/1 prot., datë 24.11.2020, ISHSH sqaron se për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e Covid-19, ISHSH në zbatim të Urdhrit nr.1477/1, datë 27.07.2020, ka bërë pezullimin e kërkesave për pajisje me akt-miratime higjienosanitare deri në një urdhër të dytë.

-Me shkresën nr. 8158/2 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për vijimin e procesit të pajisjes me licencë të shoqërisë “UKT” Sh.a, UKT SHA i ka kërkuar ERRU-së të vijojë me procedurën e licensimit, duke parashtruar ecurinë e procesit dhe marrëdhëniet me ISHSH për pajisjen e objekteve me akt-miratime higjienosanitare.

-Me shkresën nr.8158/3 prot., datë 09.12.2020 “Plotësim të dhënash për pajisjen me licencë të shoqërisë “UKT” ShA, UKT SHA ka dërguar dokumentacionin për drejtuesin e ri ligjor të shoqërisë dhe tabelën me të dhënat ku evidentohen njësitë administrative që mbulohen me furnizim me ujë nga burimet dhe objektet e pajisura me akt-miratime higjienosanitare.

-Me shkresën nr. 8158/4, datë 18.01.2021 “Plotësim të dhënash për pajisjen me licencë të shoqërisë “UKT” ShA”, është dërguar sipas kërkesës së ERRU-së, harta e sistemit të furnizimit me ujë, ku evidentohen zonat që mbulohen nga akt miratimi higjienosantar dhe nga furnizimi me ujë 24 orë, sipas legjendës përkatëse.

-Me shkresën nr.2337 prot., datë 10.02.2021 “Njoftim për ndryshimin e drejtuesit teknik të “UKT” SHA dhe plotësim dokumentacioni”, është dërguar dokumentacioni për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë dhe dokumentacioni për kryerjen e pagesës së tarifës së licensimit.

-Me plotësimin e dokumentacionit, Komisioni Kombëtar Rregullator i Ujit me vendimin nr. 84, datë 04.03.2021 “Për liçencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë ”SHA ka vendosur:

1. Liçencimin e Shoqërisë “UKT” Sh.A, me NUIS .P, në kategoritë:

- a) Kategorija A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) Kategorija B - Për përpunimin e ujit për konsum publik;
- c) Kategorija C - Për largimin e ujërave të ndotura;

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë ShA. autorizohet të kryejë veprimtaritë e liçencuara me:

- a) Drejtues ligjor: E.K;
- b) Drejtues teknik: E.O;
- c) Drejtues teknik: E.C.

Zona e shërbimit e Shoqërisë “UKT” ShA, për të cilën është dhënë kjo liçencë përfshin: Njësine administrative nr. 1; Njësine Administrative nr. 2; Njësine Administrative nr. 3; Njësine Administrative nr. 4; Njësine Administrative nr. 5; Njësine Administrative nr. 6; Njësine Administrative nr. 7; Njësine Administrative nr. 8; Njësine Administrative nr. 9; Njësine Administrative nr. 10; Njësine Administrative nr. 11; Njësine Administrative Dajt; Njësia Administrative Kashar; Njësia Administrative Ndroq; Njësia Administrative Petrelë; Njësine Administrative Shëngjergj; Njësine Administrative Vaqarr; Njësine Administrative Zall Bastar; Njësine Administrative Zall Herr.

Kjo liçencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare me qëllim lënien e një afati kohor të arsyeshëm për shkak të pandemisë nga COVID-19, në mënyrë që shoqëria “UKT” ShA. të sigurojë aktet e miratimit higjieno-sanitar dhe për njësitë administrative për të cilat ende nuk është arritur të merret ky akt.

Sipas këtij vendimi nuk janë përfshirë në liçencë, objektet e furnizimit me ujë në Njësitë Administrative Baldushk, Pezë, Farkë, Bërzhitë dhe Krrabë që në kohën e miratimit të saj nuk ishin të mbuluara me akt miratime higjieno-sanitare. Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor ka ndërprerë procesin e dhënies së akt-miratimeve higjieno sanitare për shkak të situatës së krijuar nga pandemia, pasi strukturat e ISHSH ishin të angazhuara për kontrollin e masave për mbrojtjen nga Covid-19.

-Me shkresën nr. 5829 prot., datë 07.04.2021 është kërkuar edhe njëherë nga ISHSH, rifillimi i procesit për pajisjen e objekteve të furnizimit me ujë me akt-miratime higjienosanitare, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi që rregullon fushën e veprimtarisë.

-Gjatë vitit 2021 janë inspektuar në vijim objektet e UKT SHA dhe janë lëshuar nga ISHSH, akt-miratimet higjienosanitare të cilat janë depozituar pranë Entit Rregullator të Ujit me shkresën nr. 4910 prot., datë 11.03.2022 “Kërkesë për modifikimin e liçencës miratuar me Vendimin nr. 84, datë 11.03.2021 të KKRRU-së”. Nëpërmjet kësaj shkrese është kërkuar përfshirja në liçencë e të gjithës zonës së shërbimit që mbulon territorin e Bashkisë Tiranë.

- Me Vendimin nr. 150, datë 01.04.2022 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 84, datë 04.03.2021 “Për liçencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë ”ShA” është miratuar kërkesa e UKT SHA për liçencimin e shoqërisë për zonën e shërbimit që i përket ndarjes territoriale të Bashkisë Tiranë.

Veprimtaria e kësaj shoqërie **për periudhën 06.10.2018-03.03.2021**, është në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” , i ndryshuar, neni 15 dhe VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të liçensimit dhe procedurave për aplikim për liçensë”, pika I/a/b/c.

Deri 30.11.2022, datë që përfundon auditimi drejtuesit teknik të shoqërisë (E.O dhe E.C), nuk zotërojnë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tyre, sipas detyrës që ushtrojnë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Veprim në kundërshtim me Statutin e Shoqërisë të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 1, datë 08.01.2019, neni 19/c “Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit teknik” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimet jetë bërë i mundur. Konstatimi i mos pajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij”*.

Si dhe në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 660, datë 28.09.2018 “Për krijimin dhe zbatimin e programit Kombëtar të Trajnimit dhe Çertifikimit bazuar në testimin në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”, neni 5 pika 2 dhe si dhe E.M me detyrë drejtor i departament të shitjes nuk është e pajisur me certifikatën përkatëse.

Këtë certifikatë nuk e kanë dhe 456 punonjësit që merren me në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve) me shkresën nr. 2529, datë 02.09.2019, kërkon identifikimin e pozicioneve që janë subjekt certifikimi. Me shkresën nr. 2972 prot., datë 08.10.2019 i ka kërkuar listën e punonjësve subjekt certifikimi dhe formularët e deklaramit të punësimit dhe arsimit Shoqërisë “UKT” Sha.

Shoqëria me shkresën nr. K-2355/1 prot, datë 11.09.2019 dhe shkresën nr. K-2645/1 prot, datë 21.10.2019, ka dërguar listën emërore të punonjësve, diplomën/dëftesë e noterizuar ose e njësuar me vulën e institucionit dhe formularin e deklaramit.

Që nga data 21.10.2019 deri më 30.11.2022 datë që përfundoj auditimi, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, nuk ka dërguar asnjë certifikim.

Shoqëria “UKT” SHA ushtron veprimtarinë e saj me Seli në adresën Rruga “Kavajës”, Ndërtesa 133, kodi postar 1027, Njësia Administrative nr.6, Tiranë.

Ndërtesa ku është vendosur Selia e UKT SHA është marrë në përdorim/me qira nga pronari i objektit G. J.

Për përdorimin e objektit/ndërtesës me destinacion Seli/Zyrave qendrore, Shoqëria “UKT” SHA e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, në cilësinë e palës Qiramarrëse ka lidhur me qiradhënësin G.J., kontratën e qirasë nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019, nënshkruar para noter A.Z.M.

Kjo kontratë është ndryshuar me kontratën nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021, ndërmjet palëve, qiramarrësi Shoqëria “UKT” Sh.a, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Qiradhënësi G.J, nënshkruar para noter A.Z.M.

Objekti i kësaj kontrate është marrja me qira e objektit dhe truallit, me vendndodhje në Rrugën e Kavajës, për përdorim Seli (Zyra qendrore) të Shoqërisë “UKT” SHA që përbëhet nga pasuritë : Sipërfaqe truall 2031 m², me numër pasurie 5/335, zona kadastrale 8240, volumi 10, faqe 8; Sipërfaqe truall 100 m², me numër pasurie 5/331, zona kadastrale 8240, volumi 9, faqe 108; Sipërfaqe Garazh 414 m², me numër pasurie 5/254-G1, zona kadastrale 8240, volumi 8, faqe 47;

Sipërfaqe Njësi 485 m², me numër pasurie 5/254-N1, zona kadastrale 8240, volumi 8, faqe 48;
Sipërfaqe Njësi 451 m², me numër pasurie 5/254-N2, zona kadastrale 8240, volumi 8, faqe 49;
Sipërfaqe Njësi 451 m², me numër pasurie 5/254-N3, zona kadastrale 8240, volumi 8, faqe 50;
Sipërfaqe Njësi 451 m², me numër pasurie 5/254-N4, zona kadastrale 8240, volumi 8, faqe 51;
Në total sipërfaqe trualli 2131 m² dhe sipërfaqe ndërtesë 2252 m²

Vlera e Kontratës është 1.826.320 lekë në muaj. Në këtë vlerë përfshihet tatimi mbi qiranë që i mbahet qiradhënësit çdo muaj sipas legjislacionit shqiptar në fuqi (si tatim në burim).

Afati i kontratës nr. 7 rep dhe nr. 5 kol, datë 04.01.2019 është parashikuar të jetë për një periudhë 1 vit (neni 3, pika 3.1). Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të saj, me të drejtë rinovimi nga palët. Me kalimin e 30 ditëve nga data e përfundimit të afatit të kontratës, nëse palët nuk shprehen me shkrim, kontrata konsiderohet e rinovuar në heshtje (neni 7, pika 7.1).

Në shtesën nr. 1 të Kontratës së qirasë të lidhur me nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021, është ndryshuar neni 3 i kontratës nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019. Pas ndryshimeve në këtë nen përcaktohet se: *Kjo kontratë do të jetë e vlefshme nga data e nënshkrimit të saj deri në datën 31.12.2022, me përjashtim të rinovimit/zgjatjes sipas parashikimeve të këtij neni 3 ose zgjidhjes së parakohshme sipas parashikimeve të kësaj kontrate (neni 3, pika 3.1). Palët bien dakord se 90 ditë kalendarike përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë, Qiramarrësi ka detyrimin të informojë me shkresë Qiradhënësin për vullnetin e tij për të rinovuar/shtyrë afatin e vlefshmërisë se kontratës për të njëjtin afat tjetër 1 vjeçar. Nëse Qiradhënësi do të vijojë të japë pronën me qira, dhe kushtet e tregut nuk diktojnë ndryshim të kushteve kontraktore, në përputhje me parashikimet e nenit 804 të Kodit Civil, do të miratojë me shkresë rinovimin/shtyrjen e afatit sipas njoftimit të Qiramarrësit, në rast se ky i fundit ka ekzekutuar në rregull detyrimet që kanë rrjedhur nga kontrata. Korrespondenca shkresore sipas këtij paragrafi 3.3 do të përbejë provë të mjaftueshme dhe procedurë të vlefshme për rinovimin e afatit të vlefshmërisë se Kontratës. (neni 3, pika 3.3).*

Për investimet dhe mirëmbajtjen e pronës së marrë me qira, në kontratën e qirasë nr.7 Rep dhe nr.5 Kol, datë 04.01.2019, në nenin 5 “Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit”, pika 5.1, 5.5 dhe 5.8 dhe nenin 8 “Përgjegjësitë e palëve” janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve me referencë ligjore në nenet 801-825 të Kodit Civil.

Sipas kushteve të kontratës së qirasë të rëna dakort nga palët është parashikuar se: *Qiramarrësi ka të drejtë, që sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë në qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë (neni 5, pika 5.1); Qiradhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga qiramarrësi (neni 5, pika 5.5): Në rast të dëmtimeve qiramarrësi paguan të gjithë riparimet që duhet të bëjë qiradhënësi për të kthyer objektin në gjendjen e dorëzimit (neni 5, pika 5.8); Palët janë të detyruar që në fillim të çdo viti, të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta, për realizimin e detyrimeve në derdhjet e pagesës, në nivelin e investimit dhe kamatat ose gjobat (kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate. Aktet e rakordimit janë pjesë e dosjes së qiradhënies.(neni 8, pika 8.2).*

Nga UKT është shpenzuar vlera 19,000,0000 lekë investime në këtë objekt të marr me qira për kamera survejimi etj, nga këto mund të merren në përfundimin e kontratës pajisje survejimi në vlerën 7,755,400 lekë.

Në këtë kontratë nuk është parashikuar nga palët detyrimi për sigurimin e pronës në rastet e rreziqeve të shkaktuara nga zjarri, rrufetë, tërmeti, stuhitë, përmytjet, shpërthimi ose dëme nga uji, shembje dhe çdo rrezik tjetër të parashikuar nga ligji.

Me shtesën nr. 1, nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021, të Kontratës së qirasë nr.7 Rep dhe nr.5 Kol, datë 04.01.2019, nënshkruar para noter A.Z.M me Qiradhënësin G.J, janë bërë disa shtesa dhe ndryshime të kontratës bazë me të cilat janë përcaktuar detyrimet e palëve lidhur me sigurimin, mirëmbajtjen dhe investimet në pronën objekt i kësaj kontrate qiraje.

Pas pikës 4.5 të nenit 4 është shtuar pika 4.6 ku përcaktohet se Qiradhënësi **ka të drejtë të sigurojë pronën objekt qiraje** (duke përjashtuar zotërimet, përmirësimet ose ndryshimet e Qiramarrësit ose të vizitorëve të tjerë) pranë një shoqërie të licencuar sigurimi me reputacion të mirë nga humbja ose dëmtimi nga Rreziqet e Siguruara për një shumë të vlerësuar nga Qiradhënësi si Kosto e Plotë e Rindërtimit. Për qëllim të këtij paragrafi (4.6) do të konsiderohen: **Rreziqet e Siguruara:** Humbja dhe dëmi nga zjarri, rrufetë, shpërthimi, goditja e objekteve fluturuese dhe pjesëve apo ngarkesave të tyre, tërmeti, stuhitë, përmytjet, shpërthimi ose dëme nga uji, shembje dhe çdo rrezik tjetër kundër të cilit Qiradhënësi vendos të sigurohet herë pas herë (nga të cilat përjashtohen kufizimet dhe përjashtimet e vendosura nga siguruesit) dhe Rrezik i Siguruar është secili prej tyre (neni 1, pika 1.5 paragrafi 1 i shtesës) (pika 4.6).

Ndërsa në pikën 4.7 është parashikuar se: Qiradhënësi merr përsipër të sigurojë përgjegjësinë ndaj palëve të treta, për çdo dëmtim të jetës, shëndetit apo pasurisë së të tretëve në ambientet e dhëna me qira sipas kësaj kontrate, për ngjarje të siguruara që burojnë nga veprime ose mosveprime me faj ose pakujdesi të Qiradhënësit.

Palët bien dakord, se çdo kërkesë e palëve të treta ndaj Qiradhënësit me anë të së cilës kërkohet kompensimi i shpenzimeve, si pasojë e lëndimit të shëndetit dhe/ose të pasurisë, në ambientin e dhënë me qira sipas kësaj kontrate, do t'i drejtohet shoqërisë së sigurimit sipas policës (bashkëngjitur kësaj kontrate) për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, në përputhje me kushtet e sigurimit.

Për të shmangur çdo dyshim, palët pranojnë, se limiti i përgjegjësisë së Qiradhënësit/Shoqërisë së Sigurimit ndaj palëve të treta të dëmtuara në ambientet e dhëna me qira është i kufizuar deri në vlerën e sigurimit të shprehur në policën e bashkëngjitur kësaj kontrate.

Në nenin 5 “Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit”, pika 5.5 është ndryshuar. Pas ndryshimeve në këtë pikë është parashikuar se: *Qiramarrësi, pasi ka marrë më parë miratimin me shkrim nga Qiradhënësi, mund të kryejë investime, rimodelim, shtesë, ndryshim strukturor në objektin e marrë me qira me shpenzimet e tij, dhe në përfundim të kontratës së qirasë nuk ka të drejtë të kërkojë kompensimin e detyrimeve të mundshme me vlerën e shpenzimeve të kryera, apo kthimin e vlerës së investuar. Asnjë instalim, riparim, ose aktivitete të tjera të bëra në objektin e qirasë, nuk do të: a) ndikojnë në integritetin strukturor të objektit të qirasë dhe/ose të godinës; b) mbingarkojnë qarqet apo pajisjet elektrike; c) mbingarkojnë ose pa arsye të rëndojnë facilitetet hidraulike, kanalizimet e ujit e ato sanitare; d) të mbingarkojnë, rëndojnë pa arsye ose të ndikojnë në të kundërt mbi pajisjet apo facilitetet e ngrohjes, kondicionimit, etj.;*

Në rastin e ndonjë shkelje të klauzolave të këtij paragrafi 5.5 nga Qiramarrësi dhe në qoftë se këto shkelje rezultojnë me ndonjë dëmtim, atëherë Qiramarrësi do të paguajë për të gjitha riparimet e dëmit.

Po kështu me shtesën e kontratës së qirasë, në nenin 5 janë shtuar pikat 5.9, 5.10 dhe neni 6 “Mirëmbajtja”.

Me këto dispozita palët kanë përcaktuar se Qiramarrësi në përputhje me nenin 805 të Kodit Civil, mban detyrimin të kryejë në objektin e qirasë mirëmbajtjen e zakonshme dhe të kryejë një monitorim dhe raportim të vazhdueshëm në drejtim të Qiradhënësit për rreziqe, defekte

dhe dëmtime që mund të kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të Qiradhënësit për riparim. Në rast se si pasojë e dështimit të Qiramarrësit për të njoftuar në kohë të arsyeshme nevojën për riparim, objekti i qirasë, palë të treta ose pasuritë e Qiramarrësit do të pësojnë dëme që nuk do të mbulohen nga policat e sigurimit në fuqi, Qiramarrësi do të mbajë përgjegjësi të plotë për mbulimin e shpenzimeve të riparimeve dhe shpërblimin e dëmeve të pësuar (pika 5.10). Qiradhënësi do të kryej me shpenzimet e veta të gjitha riparimet strukturale (të jashtëzakonshme) të nevojshme përgjatë kohëzgjatjes së qirasë, duke kuptuar me të tilla: themelet, strukturat e ngritura (shtylla, mbulime, struktura mbajtëse, fasadat), strukturat horizontale (soletat e pllakat, përfshirë eventualisht edhe ato që shërbejnë si mbulese), ndërsa riparimet e mirëmbajtjes së zakonshme që vijnë nga përkeqësimet, si pasojë e përdorimit të Sendit janë ekskluzivisht në ngarkim të Qiramarrësit me përjashtim të amortizimit të zakonshëm. Në mungesë të një përgjigje në kohë të Qiradhënësit ose me miratim të këtij të fundit Qiramarrësi ka të drejtë të ndërhyjë dhe të kryejë drejtpërsëdrejti të gjitha punimet urgjente, të nevojshme dhe të domosdoshme për të mos lejuar që sendi të pësojë dëme të rënda dhe të riparueshme, duke ia ngarkuar shpenzimet përkatëse Qiradhënësit, kur bëhet fjalë për riparime të nevojshme, duke i zbritur ato prej kësteve të qirave të mëvonshme.

Siç rezulton nga dokumentacioni i bashkëlidhur kontratës qirasë nr.7 Rep dhe nr.5 Kol, datë 04.01.2019, të ndryshuar me kontratën nr.5038 Rep, nr.3707 Kol, datë 19.12.2021, ***Polica e sigurimit nuk është pjesë përbërëse e kontratës, siç përcaktohet në nenin 1, pika 1.5, paragrafi i dytë. Pavarësisht se palët kanë vendosur me vullnet të lirë në kontratë detyrimin e palës Qiradhënëse për sigurimin e pronës objekt i kontratës së qirasë, ky detyrim kontraktual dhe ligjor nuk është përmbushur. Qiradhënësi nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale dhe ato ligjore të përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.*** UKT SHA në cilësinë e qiramarrësit nuk rezulton të ketë mbajtur komunikim shkresor me qiradhënësin për investimet dhe mirëmbajtjen sipas kushteve të vendosura në kontratë.

Sa i përket sigurimit të pronës nga rreziqet Qiradhënësi nuk ka vënë në dispozicion të Qiramarrësit Policën e sigurimit të objektit nga një shoqëri e licencuar sigurimi. Kontratat e sigurimit rregullohen nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (Kreu XXIII – Sigurimi), Ligji nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Në qershor të vitit 2022 në UKT për shkak shkëndijës elektrike ka rënë zjarr duke krijuar dëm të llogaritur në vlerën 28,986,607 leke. Për shkak të mos pasjes së policës së sigurimit nga zjarri kjo vlerë (shpenzim) është përballuar nga UKT, nga këto mund të merren në përfundimin e kontratës pajisje kompjuterike & mobilje në vlerën 11,931,600 lekë.

Me shkresën nr. 10546 prot, datë 01.06.2022 UKT Tiranë ka vënë në dijeni Qiradhësinë se më datën 24.05.2022 në Pronën e tij, ka rënë zjarr, dhe referuar nenit 4, pika 4.6 qiradhënësi ka të drejtë të siguroj pronën objekt qiraje.

Me shkresën pa nr. prot, datë 14.06.2022, protokulluar në UKT me nr. 10546/1 prot, datë 16.06.2022, Qiradhënësi ka njoftuar UKT Tiranë se nuk më keni njoftuar në kohë për ngjarjen, ndërkohë keni kryer punime riparuese, që edhe në rast se do të ishte siguruar prona, ju do të na kishit vendosur në kushte pamundësie që marrim masa për njoftimin e siguresit në kohën e duhur dhe kryerjen e një vlerësimi të pranueshëm nga siguresi.

Nga sqarimet e kërkuara në UKT, termi ka të drejtë, nuk është konsideruar si një e drejtë detyimore e Qiradhënësit, por si një e drejtë evazive (Polica e sigurimit mund të jetë/ose mund të mos jetë pjesë përbërëse e kontratës).

Referuar doktrinën juridike, kodit të procedurës civile, në rastin konkret (përmbajta e kontratës) **termi ka të drejtë** duhet të konsiderohet si një e drejtë detyimore e Qiradhënësit,

dhe jo si një e drejtë evazive (Polica e sigurimit mund të jetë/ose mund të mos jetë pjesë përbërëse e kontratës).Pra polica e sigurimit duhet të jetë pjesë e kontratës dhe vlera 16,600,000 lekë duhet të likuidohet nga shoqëria e sigurimit.

Në opinionin e grupit të auditimit Organet Drejtuese të Shoqërisë, duhet të kishin marr masa për të rinegociuar kontratën/marrëveshjen me Qiradhënësin për të bërë amendimet përkatëse me qëllimin e rikuperimit të vlerës 28,329,607 lekë për investimet e kryera por të pa kthyeshme (47,986,607 lekë gjithsej-19,657,000 lekë që mund të merren= 28,329,607 lekë), vlerë që t'i mbesë qiradhënësit kundrejt kthimit të shpenzimeve, dhe me të drejtën e marrjes nga “UKT Tiranë” SHA të inventarit ekonomik (pajisjeve kompjuterike, kamera survejimi, mobileri , etj) në vlerën 19,657,000 lekë pas përfundimit të kontratës. Në rast se qiradhënësi nuk do të pranonte këto dy kushte duhet të kërkonin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 47,986,607 lekë , ose për diferencë sipas realizimit të kushteve.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi A. C. me detyrë drejtor i Drejtorisë Juridike për periudhën 17.11.2020 dhe në vazhdim.

Në kontratën nr.rep 5554, nr.koleksioni 3559, datë 21.09.2022, lidhur ndërmjet UKT dhe Shoqërisë “K ” Shpk palët kanë ndryshuar paragrafin 5.5 të nenit 5 të Kontratës, ku përcaktohet se :“Qiramarrësi”, pasi ka marrë më parë miratimin nga “Qiradhënësi”, mund të kryejë investime, rimodelim, shtesë, ndryshim strukturor në objektin e marrë me qira me shpenzimet e tij, dhe në përfundim të kontratës së qirasë ka të drejtë të kërkojë kthimin e vlerës së investuar dhe vlerën e shpenzimeve të kryera që i rrisin vlerën objektit dhe parashikohen në akte ligjore e nënligjore.

Sipas këtij paragrafi “Qiramarrësi” ka të drejtë që në përfundim të kontratës së qirasë të kërkojë kthimin e vlerës së investuar apo shpenzimeve të kryera që i rrisin vlerën objektit, për ato investime apo shpenzime që ai i ka kryer pasi ka marrë miratim nga “Qiradhënësi”.

Në nenin 7 “Pagesa e qirasë”, paragrafi 7.2 ku përcaktohet se: Duke filluar nga data 01.01.2023 në çmimin e qirasë mund të reflektohet vetëm norma e inflacionit (në ulje ose ngritje), bazuar në konfirmimin zyrtar të INSTAT.

Në nenin 4, pika 4.6 ku përcaktohet se Qiradhënësi ka të drejtë të siguroj pronën objekt qiraje, pronë një shoqërie të licencuar sigurimi nga humbja ose dëmtimi nga rreziqet e siguruara për një shumë të vlerësuar nga qiradhënësi si kosto e plot e rindërtimi. **Rreziqet e Siguruara:** Humbja dhe dëmi nga zjarri, rrufetë, shpërthimi, goditja e objekteve fluturuese dhe pjesëve apo ngarkesave të tyre, tërmeti, stuhitë, përmbytjet, shpërthimi ose dëme nga uji, shembje dhe çdo rrezik tjetër kundër të cilit Qiradhënësi vendos të sigurohet herë pas herë (nga të cilat përjashtohen kufizimet dhe përjashtimet e vendosura nga siguruesit) dhe Rrezik i Siguruar është secili prej tyre. Deri më 30.11.2022 që përfundoj auditimi, **Polica e sigurimit nuk është pjesë përbërëse e kontratës, siç përcaktohet në nenin 4, pika 4.6. Pavarësisht se palët kanë vendosur me vullnet të lirë në kontratë detyrimin e palës Qiradhënëse për sigurimin e pronës objekt i kontratës së qirasë, ky detyrim kontraktual dhe ligjor nuk është përmbushur. Qiradhënësi nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale dhe ato ligjore të përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.**

Në nenin 9, paragrafi 9.2 të Kontratës së qirasë nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019 të ndryshuar me nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021 dhe nr.5553 rep, nr.kol 3558, datë 21.09.2022 është përcaktuar se: 9.2 Palët janë të detyruar që në fillim të çdo viti, të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta, për realizimin e detyrimeve në derdhjet e pagesës, në nivelin e investimit dhe kamatat ose gjobat (kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate. Aktet e rakordimit janë pjesë e dosjes së qiradhënies.

Në nenin 6, paragrafi 6.5 të Kontratës së qirasë nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019 të ndryshuar me nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021 dhe nr.5553 rep, nr.kol 3558, datë 21.09.2022 është përcaktuar se: 6.5 Qiramarrësi duhet te marre masat e nevojshme qe Sendit t'i mund te behet nje mirëmbajtje e zakonshme ne terma ditore, javore, mujore dhe vjetore, duke përfshirë zëvendësimin e pjesëve të këmbimit në rast dëmtimi nga përdorimi. Për këtë qëllim Qiramarrësi duhet t'i dorëzojë Qiradhënësit një plan mirëmbajtje vjetore të asetit, godinës dhe sistemeve që janë pjesë e godinës (mure, sisteme, oborr, pemë, gjelbërim etj).Plani duhet të përmbajë të detajuar mirëmbajtjen e të gjithë aseteve dhe sistemeve përbërëse të objektit. Qiramarrësi duhet t'i dërgojë çdo muaj procesverbalet e mirëmbajtjes Qiradhënësit, sipas procesverbalit tip bashkëngjitur kësaj shtese kontrate, si Aneksi 3.

Nga verifikimi i dosjes së zbatimit të kontratës së qirasë rezulton se nuk është mbajtur asnjë akt rakordimi mes palëve.

Shoqëria “UKT” Sh.a për tu sistemuar me zyra ka programuar, ka prokuruar dhe ka lidhur kontratë me nr. 8485/10 prot., datë 21.07.2020 me Bashkimin e Operatorëve “V” Shpk në vlerën 564,424,268 lekë, me afat ekzekutimi 12 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, kontratë që është amenduar për afatin me nr. 23458/4 prot., datë 10.03.2022 dhe nr. 11767 prot., datë 21.06.2022.

Deri më datë 30.11.2022, datë në të cilën përfundoj auditimi objekti (godina) nuk ka përfunduar. Këshilli i Administrimit me Vendim nr. 10, datë 28.04.2022, pasi ka shqyrtuar shkresën e Bashkisë Tiranë nr.14673/1 prot., datë 19.04.2022 Për vijimin e procedurës mbi Kërkesën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë protokolluar në UKT 1127 pro., datë 21.04.2022 dhe ka vendosur Shoqëria të hartoj Raportin mbi gjendjen, vlerën kontabël, vlerën e investimit dhe zhvillimin e pasurisë nr. 8/123, zona kadastrale 8330, me adresë rruga “Jordan Misja”.

Asambleja e Përgjithshme me vendim nr. 6, datë 22.06.2022 ka vendosur të kaloj për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak, raportin nr. 178/1 prot, datë 14.06.2022 hartuar gjendjen, vlerën kontabël, vlerën e investimit dhe zhvillimin e pasurisë nr. 8/123, zona kadastrale 8330, me adresë rruga “Jordan Misja”, njësia Administrative nr. 9, Tiranë dhe kërkesën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për sigurimin e ambienteve të përshtatshme të punës për stafin e Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Këshilli Bashkiak me vendim nr. 70, datë 12.07.2022, ka vendosur dhënien e pëlqimit për vijimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për sigurimin e ambienteve të përshtatshme të punës për strukturën e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar në pasuri në pronësi të Shoqërisë “UKT “ Sh.a, identifikuar me pasurisë nr. 8/123, zona kadastrale 8330, me adresë rruga “Jordan Misja”, njësia Administrative nr. 9.

Bashkia Tiranë të komunikoj dhe të zhvilloj korrespondencën e nevojshme me Këshillin e lartë të Prokurorisë dhe Ministrinë e Drejtësisë për modalitet ligjore të kryerjes së kësaj procedure transferimi.

Shoqëria “UKT” Sh.a në përmbushje të parashikimeve të këtij vendimi, të ndjekë të gjitha hapat e nevojshme në përputhje me legjislacion në fuqi “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe Shoqëria e “UKT” Sh.a për zbatimin e këtij vendimi.

2. “Marrja me qira e tokës mbi të cilën është ndërtuar depo uji me vendodhje në Fshatin Surel, njësia administrative Dajt.

Shoqëria “UKT” Tiranë” Sh.a ka lidhur kontratë nr. 10728 prot., datë 12.06.2019 me K.Q me objekt “Marrja me qira e tokës mbi të cilën është ndërtuar depo uji me vendodhje në Fshatin Surel, njësia administrative Dajt” me sipërfaqe 511.65 m² për përdorim toke. Kohëzgjatja 1 vjeçare me të drejt rinovimi, kontrata hynë në fuqi me firmosjen e saj nga palët. Në nenin 5

“Pagesa e qirasë” është shprehur në mënyrë eksplicite se “Qiramarrësi detyrohet t’i paguaj qiradhënësit detyrimin mujor prej 173,961 lekë në muaj. Në këtë përfshihet tatimi mbi qiranë që do ti mbahet qiradhënësit çdo muaj sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Në nenin 6 “Zgjidhja e kontratës” është përcaktuar “6.1. Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 2.1 të saj, me të drejt rinovimi nga palët. Me kalimin e dhjetë ditëve nga data e përfundimit të afatit të kontratës, nëse palët nuk shprehen me shkrim, kontrata konsiderohet e rinovuar ne heshtje”.

Kjo kontratë shoqërohet me: Çertifikatë për vërtetim pronësie”, numri i pasurisë 116/1`7, zona kadastrale 3550, volumi 6, faqe 88, adresa Surell, Tiranë, lloji i pasurisë pemëtoare me sipërfaqe 4,000 m², në emër të K.Q, me datë lëshimi 14.11.2011, kartel pasurie me datë lëshimi 14.11.2011, hartën tregues. Shkresën nr. 7342 prot., datë 12.04.2019 drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, shkresën nr. 516 prot., datë 23.05.2019 e Drejtorisë Vendore ASHK, Rurale 1, Tiranë.

Relacion nr. 116/1 prot., datë 31.05.2019 i firmosur nga R.M me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm dhe grupi i punës i përberë nga S.T, K.I dhe B.H, mbi marrjen e ofertave për studimin e çmimeve të tokës mbi të cilën është ndërtuar depo uji Dajt. Testimi i tregut është bërë duke marr 4 persona konkretisht G.L, në vlerën 350 lekë/m² me ofertën protokolluar me nr. 10088, prot., datë 30.05.2019 (protokoll UKT) Çertifikatë për vërtetim pronësie”, numri i pasurisë 116/14, zona kadastrale 3550, volumi 6, faqe 68, adresa Surell, Tiranë, lloji i pasurisë pemëtoare me sipërfaqe 4,990 m².

S.L 400 lekë/m² me ofertën protokolluar me nr. 10082, prot., datë 30.05.2019 (protokoll UKT), me Çertifikatë për vërtetim pronësie”, numri i pasurisë 116/18, zona kadastrale 3550, volumi 6, faqe 89, adresa Surell, Tiranë, lloji i pasurisë pemëtoare me sipërfaqe 4,250 m², K.Q 340 lekë/m² me ofertën protokolluar me nr. 10086, prot., datë 30.05.2019 (protokoll UKT) Çertifikatë për vërtetim pronësie”, numri i pasurisë 116/17, zona kadastrale 3550, volumi 6, faqe 88, adresa Surell, Tiranë, lloji i pasurisë pemëtoare me sipërfaqe 4,000 m², dhe E.L 380 lekë/m² me ofertën protokolluar me nr. 10083, prot., datë 30.05.2019 (protokoll UKT), Çertifikatë për vërtetim pronësie”, numri i pasurisë 116/17, zona kadastrale 3550, volumi 6, faqe 172, adresa Surell, Tiranë, lloji i pasurisë pemëtoare me sipërfaqe 1450 m². Në përlllogaritje është marr vlera më e vogël 340 lekë/m².

Për të 4 personat, me shkresën nr. 9948 prot., datë 28.05.2019 Drejtori i Përgjithshëm ka kërkuar oferta duke u shprehur në mënyrë eksplicite se “Në kuadër të përbushjes së nevojave të furnizimit me ujë nga Shoqëria UKT sha. Kërkon marrjen me qira të një sipërfaqe tokë/truall në zonën Shkozë, Njësia Administrative Dajt, ku ndodhte pronësia tuaj.

Me memon nr. 1981 prot., datë 28.05.2019 E.B me detyrë Drejtore e Drejtorisë Juridike, nëpërmjet F.V me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, i është drejtuar R.M me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, për dijeni E.G me detyrë Zv/drejtoare e Përgjithshme për çështjes administrative, A.S me detyrë drejtore ekonomike dhe O.D me detyrë drejtor i departamentit inxhinierik me objekt “Informacion për pronën ku kalon projekti “Ndërtim rrjet shpërndarës ujësjellësi në zonën shkozë e sipërme dhe ndërtim depo”, ndër te tjera citohet “...me shkresën nr. 516 prot., datë 23.05.2019, të ZVRPP, informohemi se toka e prekur nga ndërtimi i depos, pjesë e projektit “Ndërtim rrjet shpërndarës ujësjellësi në zonën Shkozës së sipërme dhe ndërtim depo, rezulton në pronësi të z K.Q”.

Me kërkesë K-4947prot, datë 29.01.2019 (prot., UKT) K.Q i drejtohet UKT “Kërkojmë nga institucioni juaj që të shqyrtoni procedurat e ndërtimit të një depo uji e ndërtuar në një pronë private në emër të K.Q, me zonë 3550, nr. pasurisë 116/17, volum 6, faqe 88 me adresë Fshati

Surel, Tiranë. Ju lutem mos vazhdoni ndërtimin e mëtejshëm të depos pa zgjidhur konfliktin më parë.

UKT me shkresën nr. K-4947 kthen përgjigje kërkesës K-4947prot, datë 29.01.2019, "... Shoqëria po merr të gjitha masat juridike për zgjidhjen e kësaj problematike të cilën pas konfrontimit të ZVRPP Tiranë të statusit të pronës, do t'ju njoftoj për procedurat e mëtejshme të vazhdimit mbi vazhdimin e operimit teknik e ligjor të veprës".

Në fakt Drejtoria Vendore e ASHK, Ruralla 1, me shkresën nr. 516, datë 23.05.2019, është shprehur se në zonën kadastrale 3550, nr. pasurisë 116/17, volum 6, faqe 88 me adresë Fshati Surel, Tiranë, 4000 m², janë pemëtore, dhe nuk shprehet se ka ndërtim objekti depo uji. Pra nuk ka asnjë m², në ndryshim destinacioni nga pemëtore në truall për ndërtim. Rrethimi i depos së ujësjellësit (Depo, pusëtë dhe objekt të shërbimit (sistem kamera, manovrator etj) është 401.5 m², qiraja 511 m², diferenca = 109.5 m² x 340 lekë m²/muaj =37,230 lekë në muaj x 41.5 muaj (12.06.19 data e lidhjes kontratës deri më 30.11.2022 që përfundon auditimi= 1,545,045 lekë përfituar tepër.

Vlera 1,545,045 lekë përbën dëm ekonomik për Shoqërinë "UKT" Sha dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga përfituesi.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi S. Th. me detyrë topograf i sektorit të aseteve, me licencë T. 1267/1, datë 30.11.2017, i cili ka hartuar plan rilevimin e pronës, mbi të cilën është lidhur kontrata nr. 10728 prot., datë 12.06.2019.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk ka një (akt marrëveshje, kontratë etje) ndërmjet K Q dhe UKT Tiranë për ndërtimin e depos së ujit, por në kërkesës K-4947prot, datë 29.01.2019 (prot., UK Tiranë) të K.Q që i drejtohet UKT "Kërkojmë nga institucioni juaj që të shqyrtoni procedurat e ndërtimit të një depo uji e ndërtuar në një pronë private në emër të K.Q, me zonë 3550, nr. pasurisë 116/17, volum 6, faqe 88 me adresë Fshati Surel, Tiranë. Ju lutem mos vazhdoni ndërtimin e mëtejshëm të depos pa zgjidhur konfliktin më parë.

Depoja e ujit është asetuar si investim "Depo Shkozë Tiranë" llogaria 231 në vlerën 3,667,587 lekë, referuar relacionit të inventarizimit të trojeve dhe ndërtesave të shoqërisë me shkresën nr. 622 prot., datë 18.02.2022.

Investimi (Depo uji Shkozë viti 2018 dhe godinë shërbimi ", janë kryer pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", me ndryshimet vijuese të tij, neni 29, neni 39 pika 1, VKM nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar neni 9 dhe 11, Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", neni 14 çka ngarkon me përgjegjësi O.D me detyrë ish-Drejtor i Departamentit Inxhinierik.

Me shkresën nr. 1338 prot., datë 05.04.2019 O.D me detyrë drejtor i departamentit inxhinierik i drejtohet F.V me detyrë drejtor i departamenti të shërbimeve mbështetëse , për përgatitjen e dosjes së shpronësimit ju vëmë në dispozicion dokumentet e mëposhtme: Leje ndërtimi, vendim i këshillit teknik për miratimin e projektit. Në fakt ky ndërtim nuk ka leje ndërtimi.

Në relacionin pa numër protokoll të firmosur nga N.D, projektuese "Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjellësi në Shkozën e sipërme dhe ndërtim Depo uji" është shprehur që të ketë mundësi për të furnizuar më presionin e nevojshëm në të gjithë zonën, vendodhja e depos është përcaktuar në pikën më të lartë të terrenit, në kuotën 306.34 m dhe territori i saj është në pronë private. Referuar plan rilevimit të hartuar nga S.T vendodhja e depos është përcaktuar në pikën më të lartë të terrenit, në kuotën 200 m dhe territori i saj është në pronë private.

Studimi gjeologo-inxhinieriki hartuar nga kompania "G C", përshkruan mbizotëron relievi malor kodrinor, lartësia mesatare 521 m mbi nivelin e detit.

c. Mos zbatim i procedurave gjyqësore me penalizim për Shoqërinë, në lidhje me pronësi të marr me qira.

Shoqëria “UKT ” SHA është penalizuar në një raste në vlerën **34,992,188 lekë** nga mos zbatimi i procedurave gjyqësore, konkretisht me përfitues Y.V po në të njëjtën vlerë, për mos respektim të afatit të anikimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, veprim në kundërshtim Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i procedurës Civile”, me ndryshimet vijuese të tij.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka gjykuar çështjen civile me Padi të Y.V, i paditur Shoqëria “UKT” SHA me objekt “Detyrimin e palës së paditur të shpërblejë paditësin për përdorimin e pasurisë së paluajtshme e llojit “Pyll” me sipërfaqe 2200 m² ndodhur në Zonën Kadasrtale 2380, me nr.pasurisë.11/21/163 në Lanabregas Tiranë, në masën 9 062 698 lekë deri me datë 23.12.2015 e në vazhdim në masën 7 232, 8 lekë/ditë”.

Pas gjykimit të kësaj çështje në shkallë të parë me Vendimin nr. 6133, datë 20.09.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: - *Pranimi i kërkesë padisë të paditësit Y.V, si të mbështetur në ligj e në prova; - Detyrimin e palës së paditur, të paguaj për përdorimin që i bën pronës së paditësit “truall” me nr. pasurisë 11/21/207, me sip.3013 m² me vendndodhje në Lanabregas, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë; - Për periudhën nga data 08.07.2012 deri në datë 18.04.2019, pala e paditur detyrohet të paguajë paditësit 24,505,733 lekë; - Për periudhën nga data 18.04.2019 e në vazhdim – deri në datën e ekzekutimit të vendimit që ka marrë formë të prerë, të jetë 301, 300 lekë në muaj, referuar vlerësimit prej 100 lekë/m² .etj.”.*

Ky vendim i është njoftuar palës së paditur Shoqërisë “UKT” e cila ka marrë dijeni në datë 15.10.2019 (sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. akti 85, datë 28.01.2020).

Kundër këtij vendimi, pala e paditur Shoqëria “UKT” ka bërë ankimin nr. 25468, datë 04.11.2019.

Ankimi kundër Vendimit nr. 6133, datë 20.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo gjykatë me vendimin nr. 85 akti, datë 28.01.2020 ka konstatuar se ankimi i paraqitur nga Shoqëria “UKT” SHA është paraqitur tej afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga e nesërmeja e marrjes dijeni të vendimit. Sipas këtij vendimi Ankimi është postuar në datë 05.11.2019 dhe ka mbërritur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 07.11.2022 ndërkohë që sipas dëftesës së komunikimit të firmosur nga pala e paditur në datë 15.10.2019, ky ankim duhet të ishte paraqitur deri në datë 30.10.2019. Gjykata referuar Ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë neni 450/1/a, konstaton se është në kushtet e nenit 450/1/a të K.Pr.C kur ankimi është paraqitur jashtë afatit dhe për këtë arsye ka vendosur mospranimin e ankimit”.

Ky veprim bie në kundërshtim me përcaktimet Ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë” neni 443 “Afatet e ankimit”, paragrafi 1, ku parashikohet se: *Afati i ankimit në Gjykatën e Apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, është 15 ditë.* Ky afat është vendosur edhe në diapozitivin e Vendimit nr.6133, datë 20.09.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pasi vendimi nr.6133, datë 20.09.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka marrë formë të prerë, Përmbaruesi Gjyqësor M.M.K. ka kërkuar nga UKT SHA vënien në ekzekutim të vendimit nr.6133, datë 20.09.2019.

Përmbaruesi gjyqësor M.K ka njoftuar kreditorin Shoqërinë “UKT” Sh.a, me lajmërimin për ekzekutim vullnetar të detyrimit nr. 328/1 prot., datë 16.12.2019, me shkresën nr.328/2, datë 27.12.2020. Vendimin “Për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv” nr.328 prot., datë 27.12.2019. Pas njoftimeve përmbaruesi ka vënë sekuestro ekzekutive në llogaritë e Shoqërisë “UKT” SHA dhe ka ekzekutuar vendimin në datën 10.01.2020, në vlerën 29 592 578 lekë, sipas Statement të R B.

Nga konstatimet në dosjen e këtij procesi gjyqësor të vënë në dispozicion nga shoqëria UKT SHA rezulton se përfaqësuesi i palës së paditur nuk ka depozituar në afat ankimin kundër vendimit nr.6133, datë 20.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke mos ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë sipas përcaktimeve në nenet 442, 442/a, 443, 444, 452, 453 të Ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë”. Këto veprime kanë sjellë si pasojë vënien në ekzekutim të vendimit pa u ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit dhe ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë pa u shqyrtuar çështja në Gjykatën e Apelit.

Përmbauesi për llogari të Y.V ka tërhequr nga Bankat: Datë 06.01.2020 vlera 273,000 lekë, datë 10.01.2020 vlera 29,592,578 lekë, datë 11.06.2020 vlera 1,687,280 lekë, datë 27.10.2020 vlera 1,012,370 lekë, datë 30.12.2020 vlera 1,012,370 lekë, datë 09.01.2021 vlera 224,000 lekë, datë 09.01.2021 vlera 325,000 lekë, datë 21.09.2021 vlera 1,687,280 lekë, datë 15.12.2021 vlera 845,590 lekë.

Nga Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime është bërë kërkesa ankimore në lidhje me kundërshtimin e veprimeve përmbaimore të përmbauesit gjyqësor privat M.K për ekzekutimin e vendimit nr.6133, datë 20.09.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pas shqyrtimit të çështjes, me Vendimin nr.790 datë 07.02.2020 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur:

Rrëzimin e kërkesë padisë/ ankimit të palës paditëse.

Kundër vendimit të mësipërm është bërë ankim nga Shoqëria “UKT” SHAME nr. 4935 prot., datë 27.02.2020 me objekt: Ndryshimin e Vendimit nr.790 datë 07.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e padisë, e cila pritet të gjykohet në Gjykatën e Apelit.

-Me Urdhër “Njoftim për vijimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv” nr. 328/12 prot., datë 21.09.2020 me kërkesë të subjektit kreditor Y.V, është kërkuar vënia në ekzekutim të “Urdhrit të Ekzekutimit” nr. 6133 Akti, datë 20.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lëshuar në zbatim të “Titullit Ekzekutiv” (Vendim Civil) nr. 6133, datë 20.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë” në shumën 1 012 370 lekë, në llogarinë e subjektit debitor shoqëria “UKT” sh.a.

Kundër këtij njoftimi të përmbauesit është bërë kërkesë padi nga Shoqëria “UKT” SHA me nr. 16032 prot., datë 28.09.2020 (detyrim që rrjedh për periudhën nga data 18.06.2020 deri në datën 18.09.2020).

Me vendimin nr. 4094 datë 08.10.2020 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

Rrëzimin e kërkesë padisë.

Kundër këtij vendimi është bërë ankim i veçanët nga Shoqëria UKT SHA nr. 19488 prot., datë 20.11.2020 e cila pritet të shqyrtohet në Gjykatën e Apelit.

-Me Urdhër “Njoftim për vijimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv” nr. 328/16 prot., datë 21.12.2020 me kërkesë të subjektit kreditor Y.V, përmbauesi gjyqësor ka kërkuar pagesën e shumës 903,900 lekë për periudhën nga data 18.09.2020 deri në datë 18.12.2020 si dhe tarifën fikse të subjektit përmbaues, në total vlerën 1.012.370 lekë.

Kundër këtij njoftimi është bërë kërkesë padi nga Shoqëria “UKT” SHA me nr. 21375 prot., datë 24.12.2020 (detyrim që rrjedh për periudhën nga data 18.09.2020 deri në datën 18.12.2020) çështje e cila vazhdon të jetë në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë pasi nuk ka përfunduar gjykimi.

-Me Urdhër “Njoftim për vijimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv” nr. 328/19 prot., datë 18.05.2021 urdhërohet: “Vendosja e masës së sekuestros konservative në shumën 1 687 280 lekë, në llogarinë e subjektit debitor shoqëria “UKT” SHA(nga data 18.12.2020- 18.05.2021).

Kundër këtij njoftimi është bërë kërkesë padi nga Shoqëria UKT SHA me nr. 8405 prot., datë 21.05.2021.

Me vendimin nr. 4539 datë 28.06.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: Pranimin e kërkesë padisë (Fituar nga UKT sha)

Anullimin e veprimit përbarimor nr. 328/19 prot., datë 18.05.2021 “Për vijimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv” si ta pabazuar në ligj nga ana e përbaruesit gjyqësor.

Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Kundër vendimit nr. 4539 datë 28.06.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është bërë ankim nga ana e Përbaruesit Gjyqësor Privat dhe pritet të gjykohet në Gjykatën e Apelit.

-Nga Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime është bërë kërkesa me nr. 12259 prot., datë 14.07.2021 për rishikimin e vendimit nr. 6133, datë 20.09.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pas shqyrtimit të çështjes, me Vendimin nr. 897 datë 27.07.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur:

Kthimin e kërkesës dhe akteve kërkuesit.

Kundër vendimit të mësipërm është bërë ankim nga Shoqëria “UKT” SHA me nr. 16484 prot., datë 21.09.2021 me objekt : “Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e kërkesës për rishikim të vendimit nr. 6133, datë 20.09.2019 e cila pritet të gjykohet në Gjykatën e Apelit.

Gjithashtu, kemi kërkuar pezullimin e procedurave të ekzekutimit deri në përfundim të shqyrtimit të ankimit të veçantë nga Gjykata e Apelit, pasi ankimi i veçantë nr.14121 prot., datë 12.08.2021 i shoqërisë “UKT“ Sh.a. kundër Vendimit nr. 772, datë 23.07.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pezullon çdo procedurë të vijimit të ekzekutimit, deri në përfundim të shqyrtimit të ankimit të veçantë, ndaj vendimit që ka sqaruar dhe interpretuar “Titullin Ekzekutiv“ Vendimin nr. 6133, datë 20.09.2019.

-Me Urdhër “Njoftim për vijimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv” nr. 328/42 prot., datë 14.12.2021 urdhërohet: “Vendosja e masës së sekuestros konservative në shumën 1 687 280 lekë, në llogarinë e subjektit debitor shoqëria “UKT” SHA. (nga data 18.05.2021 – 18.10.2021). Kundër këtij njoftimi është bërë kërkesë ankimore nga Shoqëria “UKT” SHA me nr. 23009 prot., datë 23.12.2021.

Me vendimin nr. 95 datë 17.01.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë. (Fituar nga UKT sha)

Anullimin e veprimit përbarimor nr. 328/42 prot., datë 14.12.2021 “Për vijimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv” të përbaruesit gjyqësor privat Medar M. K si të pabazuar në ligj.

Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Kundër vendimit nr. 95 datë 17.01.2022 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është bërë ankim nga ana e Përbaruesit Gjyqësor Privat dhe pritet të gjykohet në Gjykatën e Apelit.

Ekzekutimi është:

Ekzekutimi i Vendimit nr. 6133, datë 20.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga përbaruesi është kryer pasi veprimet procedurale të Drejtorisë Juridike janë kryer me vonesë duke sjellë si pasojë ekzekutimin e vendimit pa ushtruar detyrimin ligjor për ndjekjen e çështjes në të gjitha shkallëve të gjykimit. Për rrjedhojë mosparaqitja në afat e ankimit në Gjykatën e Apelit i ka dhënë mundësi Paditësit të ekzekutojë vendimin që i ka sjellë shoqërisë “UKT” SHA dhe Buxhetit të Shtetit një dëm ekonomik në vlerën 34,992,188 lekë.

Në këtë mënyrë, nëse gjykata do të pranojë rishikimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, kthimi i shumës së ekzekutuar do të ishte me risk, pasi do të duhej një kohë e gjatë nga përfundimi i procesit për rishikimin e vendimit deri në kërkimin e kthimit të shumës me një tjetër padi dhe çështje gjyqësore.

Për mos kryerjen e ankimit në kohë nga Drejtori i Përgjithshëm është ngarkuar me përgjegjësi juristi i ngarkuar me këtë çështje A. S. me detyrë përgjegjës i përfaqësimit ligjor në Drejtorinë Juridike, ndaj të cilit është dhënë masa disiplinore lirim nga detyra (zgjidhje e kontratës të punësimit) me vendimin të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 129, datë 13.05.2020.

d. Veprime operationale të Drejtorëve të Departamenteve në instanca specifike të vartësisë pa respektuar hierarkinë institucionale dhe në raste të veçanta dhe anasjelltas.

Departamentet Inxhinierik/Operacional nuk kanë zbatuar plotësisht rregulloren e UKT SHA në lidhje me formalizimin e veprimtarisë së përditshme operationale të strukturave të tyre sipas organigramës të Shoqërisë. Konkretisht nga këta departamente është vepruar në kundërshtim me kërkesat rregullatore dhe në mosbatim të detyrave funksionale sipas hierarkisë të përcaktuara në këtë Rregullore.

Kjo vërehet në projektet/preventivat/situacionet/urdhurat/akt kolaudimet/marrjet në dorëzim/korrespondenca ku delegimi/autorizimi/urdhri për zbatim të veprimeve operationale është kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme nga Drejtorët e Departamenteve në instanca specifike të vartësisë, pa respektuar hierarkinë institucionale dhe në raste të veçanta dhe anasjelltas. Kjo krijon risk të lart në mos rakordancë të ndërveprimit zyrtar të zhvilluar ndërmjet tyre lidhur me: Zbatimin, raportimin, monitorimin, duke mos sjellë në vëmendje pranë strukturave të këtyre Departamenteve dhe Titullarit të Shoqërisë, mos realizmin e detyrimeve dhe përgjegjësi ligjore të punonjësve të ngarkuar sipas rregullores.

Veprime në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të UKT SHA me Nr. U-44/1 prot., datë 05.02.2021, të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 12.12.2016, Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 1, datë 24.01.2018, nr. 9, datë 30.04.2019, nr.1, datë 27.01.2021 dhe nr.7, datë 29.06.202, Ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II-“Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 8 pika ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Drejtuesit e të gjitha niveleve të njësisë të varësisë i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, deri tek titullari i njësisë publike, dhe janë përgjegjës për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara nga titullari, duke menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efçencë”, çka ngarkon me përgjegjësi E.O me detyrë drejtor i Departamentit Inxhinierik dhe F.A me detyrë Drejtor i Departamentit Operacional.

1. Titulli i gjetjes:	Për periudhën 06.10.2018-03.03.2021, Shoqëria ka kryer aktivitet pa qenë e licencuar nga Enti Rregullator i Ujit (ERU)
Situata:	Për periudhën 06.10.2018-03.03.2021, Shoqëria ka kryer aktivitet pa qenë e licencuar nga Enti Rregullator i Ujit (ERU).Për këtë periudhë kjo shoqëri ka qenë në proces liçensimi, duke shkëmbyer dokumentacion shkresor të njëpasnjëshëm me ERU. Pas datës 04.03.2021 kjo shoqëri është pajisur me Licencë me nr. 19, miratuar me vendim nr. 40, datë 06.10.2017 (afati 06.10.2017-05.10.2018), Licenca nr. 2 miratuar me vendim nr. 84, date 04.03.2021 me afat 04.03.2021 deri me 03.03.2023; Licensa nr. 2, miratuar me vendim nr. 150, date 01.04.2022 me afat 01.04.2022 deri me 03.03.2023.
Kriteri:	Ligji nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, neni 15 dhe VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të liçensimit dhe procedurave për aplikim për liçensë”, pika

	I/a/b/c.
Ndikimi/Efekti:	Ris për shitje të ujit të pijshëm jo sipas cilësisë së të përcaktuar në VKM nr.379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “cilësia e ujit të pijshëm”.
Shkaku:	Mos akt-miratime higjienosanitare nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi që rregullon fushën e veprimtarisë.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale, rinovimit në kohë të licencave përkatëse sipas objektit të veprimtarisë saj brenda zonës së shërbimit që ushtron aktivitet.

2. Titulli i gjetjes:	Drejtuesit teknik të shoqërisë, drejtori i departamentit të shitjes dhe personeli i angazhuar sipas detyrës që ushtrojnë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura nuk zotërojnë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tyre, sipas detyrës që ushtrojnë.
Situata:	<p>Në vendim të Entit Rregullator i Uji nr. 84, date 04.03.2021 është përcaktuar drejtues ligjor E.K dhe drejtues teknik E.O dhe E.C, me licensim të shoqërisë me kategori A”, “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”, kategoria B “Për përpunimin e ujit për konsum publik” dhe kategorinë C”, “Për largimin e ujërave të ndotura.</p> <p>Deri 30.11.2022, datë që përfundon auditimi drejtuesit teknik të shoqërisë E.O, E.C dhe E.M me detyrë drejtor i departament të shitjes, nuk zotërojnë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tyre, sipas detyrës që ushtrojnë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura.</p> <p>Këtë certifikatë nuk e kanë dhe 456 punonjësit që merren me menaxhimin e ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 2972 prot., datë 08.10.2019, i ka kërkuar listën e punonjësve subjekt certifikimi dhe formularët e deklaramit të punësimit dhe arsimit të Shoqërisë “UKT” Sha.</p> <p>Shoqëria me shkresën nr. K-2355/1 prot, datë 11.09.2019 dhe shkresën nr. K-2645/1 prot, datë 21.10.2019, ka dërguar listën emërore të punonjësve, diplomën/dëftesë e noterizuar ose e njësuar me vulën e institucionit dhe formularin e deklaramit.</p> <p>Që nga data 21.10.2019 deri më 30.11.2022 datë që përfundoj auditimi, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, nuk ka dërguar asnjë certifikim.</p>
Kriteri:	Statuti i Shoqërisë i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 1, datë 08.01.2019, neni 19/c “Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit teknik” dhe Udhëzimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 660, datë 28.09.2018 “Për krijimin dhe zbatimin e programit Kombëtar të Trajnimit dhe Çertifikimin bazuar në testimin në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm,

	grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”, neni 5 pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Risk menaxherial
Shkaku:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë ti prezantohet/kërkohej zyrtarisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë pajisjen me certifikatat përkatëse për aftësimin specifik profesional të stafit menaxherial si dhe për 456 punonjësit, sipas detyrës që ushtrojnë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura, ose të lëshimit nga kjo Ministri të vërtetimit për pamundësinë objektive për pajisjen me këto certifikata.

3. Titulli i gjetjes:	Është rënduar padrejtësisht kostoja e marrjes me qira të objektit në vlerën 47,986,607 lekë.
Situata:	<p>Shoqëria “UKT” SHA ushtron veprimtarinë e saj me Seli në adresën Rruga “Kavajës”. Ndërtesa ku është vendosur Selia e UKT SHA është marrë në përdorim/me qira nga pronari i objektit G.J dhe Shoqëria “K ” Shpk. Ndërtesa 133, kodi postar 1027, Njësia Administrative nr.6, Tiranë, me sipërfaqe trualli 2131 m2 dhe sipërfaqe ndërtese 2252 m2. Vlera e kontratës është 1.826.320 lekë në muaj.</p> <p>Për përdorimin e objektit/ndërtesës Shoqëria ka lidhur me qiradhënësin, kontratën e qirasë nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019, kontratë e ndryshuar me kontratën nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021 dhe nr.rep 5554, nr.koleksioni 3559, datë 21.09.2022. Për investimet dhe mirëmbajtjen e pronës së marrë me qira, në kontratën e qirasë nr.7 Rep dhe nr.5 Kol, datë 04.01.2019, në nenin 5 “Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit”, pika 5.1, 5.5 dhe 5.8 dhe nenin 8 “Përgjegjësitë e palëve”, janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve me referencë ligjore në nenet 801-825 të Kodit Civil.</p> <p>Sipas kushteve të kontratës së qirasë të rëna dakort nga palët është parashikuar se: Qiramarrësi ka të drejtë, që sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë në qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë (neni 5, pika 5.1) Qiradhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga qiramarrësi (neni 5, pika 5.5). Nga UKT është shpenzuar vlera 19,000,0000 lekë investime në këtë objekt të marr me qira për kamera survejimi etj, nga këto mund të merren në përfundimin e kontratës pajisje survejimi në vlerën 7,755,400 lekë. Rreferuar kushteve të kontratës së bashku e amendimin, kjo vlerë mbetet për llogari (pronë) të Qiradhënësit.</p> <p>Në kontratës nr.rep 5554, nr.koleksioni 3559, datë 21.09.2022, palët kanë ndryshuar paragrafin 5.5 të nenit 5 të Kontratës, ku përcaktohet se :“Qiramarrësi”, pasi ka marrë më parë miratimin nga “Qiradhënësi”, mund të kryejë investime, rimodelim, shtesë, ndryshim strukturor në objektin e marrë me qira me shpenzimet e tij, dhe në përfundim të kontratës së qirasë ka të drejtë të kërkojë kthimin e vlerës së investuar dhe</p>

	<p>vlerën e shpenzimeve të kryera që i rrisin vlerën objektit dhe parashikohen në akte ligjore e nënligjore.</p> <p>Sipas këtij paragrafi “Qiramarrësi” ka të drejtë që në përfundim të kontratës së qirasë të kërkojë kthimin e vlerës së investuar apo shpenzimeve të kryera që i rrisin vlerën objektit, për ato investime apo shpenzime që ai i ka kryer pasi ka marrë miratim nga “Qiradhënësi”</p> <p>-Në kontratën nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019 nuk është parashikuar nga palët, detyrimi për sigurimin e pronës në rastet e rreziqeve të shkaktuara nga zjarri, rrufetë, tërmeti, stuhitë, përmbytjet, shpërthimi ose dëme nga uji, shembje dhe çdo rrezik tjetër të parashikuar nga ligji. Me amendamentin nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021 sigurimi i objektit nga rreziqet është parashikuar si e drejte e Qiradhënësit, po polica e sigurimit nuk është pjesë përbërëse e kontratës, siç përcaktohet në nenin 1, pika 1.5, paragrafi i dytë. Pavarësisht se palët kanë vendosur me vullnet të lirë në kontratë detyrimin e palës Qiradhënëse për sigurimin e pronës objekt i kontratës së qirasë, ky detyrim kontraktual dhe ligjor nuk është përmbushur.</p> <p>Në qershor të vitit 2022 në UKT për shkak shkëndijës elektrike ka rënë zjarr duke krijuar dëm të llogaritur në vlerën 28,986,607 leke. Për shkak të mos pasjes së policës së sigurimit nga zjarri kjo vlerë(shpenzim) është përballuar nga UKT, nga këto mund të merren në përfundimin e kontratës pajisje kompjuterike&mobilje në vlerën 11,931,600 lekë.</p> <p>Për shkak të mos pasjes së policës së sigurimit nga zjarri kjo vlerë është përballuar nga UKT. Nga sqarimet e kërkuara ne UKT, termi ka të drejtë, nuk është konsideruar si një e drejt detyrimore e Qiradhënësit, por si një e drejtë evazive (Polica e sigurimit mund të jetë/ose mund të mos jetë pjesë përbërëse e kontratës).</p> <p>Referuar doktrinën juridike, kodit civil, në rastin konkret (përmbajta e kontratës) termi ka të drejtë duhet të konsiderohet si një e drejt detyrimore e Qiradhënësit, dhe jo si një e drejtë evazive (Polica e sigurimit mund të jetë/ose mund të mos jetë pjesë përbërëse e kontratës). Pra polica e sigurimit duhet të jetë pjesë e kontratës dhe vlera 28,986,607 lekë dhe duhet të likuidohej nga shoqëria e sigurimit.</p> <p>Nga investimi i kryer në vlerën 47,986,607 lekë respektivisht në vlerat 19,000,000 dhe 28,986,607 leke, pajisjeve survejimi, kompjutera, mobile etj të zhmontueshme janë në vlerën 19,657,000 lekë.</p> <p>Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” nenet 801-825.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” nenet 801-825.
Ndikimi/Efekti:	Është rënduar padrejtësisht kostoja e marrjes me qira të objektit.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	- Organet Drejtuese të Shoqërisë, të marrin masa për të rin negociuar

	kontratën/marrëveshjen me Qiradhënësin për të bërë amendimet përkatëse me qëllimin e rikuperimit të vlerës 28,329,607 lekë për investimet e kryera por të pa kthyeshme (47,986,607 lekë gjithsej-19,657,000 lekë që mund të merren= 28,329,607 lekë), vlerë që t'i mbesë qiradhënësit kundrejt kthimit të shpenzimeve, dhe me të drejtën e marrjes nga “UKT” SHA të inventarit ekonomik (pajisjeve kompjuterike, kamera survejimi, mobileri , etj) në vlerën 19,657,000 lekë pas përfundimit të kontratës. Në rast se qiradhënësi nuk do të pranojë këto dy kushte duhet të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 47,986,607 lekë , ose për diferencë sipas realizimit të kushteve.
--	---

4. Titulli i gjetjes:	Shoqëria ”K” Shpk nuk ka siguruar pronën objekt qiraje, në një shoqëri të liçensuar sigurimi nga humbja ose dëmtimi nga rreziqet e siguruara.
Situata:	Për përdorimin e objektit/ndërtesës Shoqëria ka lidhur me qiradhënësin kontratën nr.rep 5554, nr.koleksioni 3559, datë 21.09.2022, me Shoqërinë “K” Shpk. Në nenin 4, pika 4.6 ku përcaktohet se Qiradhënësi ka të drejtë të siguroj pronën objekt qiraje, pronë një shoqërie të liçensuar sigurimi nga humbja ose dëmtimi nga rreziqet e siguruara për një shumë të vlerësuar nga qiradhënësi si kosto e plot e rindërtimi. Rreziqet e Siguruara: Humbja dhe dëmi nga zjarri, rrufetë, shpërthimi, goditja e objekteve fluturuese dhe pjesëve apo ngarkesave të tyre, tërmeti, stuhitë, përmytjet, shpërthimi ose dëme nga uji, shembje dhe çdo rrezik tjetër kundër të cilit Qiradhënësi vendos të sigurohet herë pas herë (nga të cilat përjashtohen kufizimet dhe përjashtimet e vendosura nga siguruesit) dhe Rrezik i Siguruar është secili prej tyre. Deri më 30.11.2022 që përfundoj auditimi, Polica e sigurimit nuk është pjesë përbërëse e kontratës, siç përcaktohet në nenin 4, pika 4.6. Pavarësisht se palët kanë vendosur me vullnet të lirë në kontratë detyrimin e palës Qiradhënëse për sigurimin e pronës objekt i kontratës së qirasë, ky detyrim kontraktual dhe ligjor nuk është përmbushur. Qiradhënësi nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale.
Kriteri:	Ligji nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, nenet 801-825.
Ndikimi/Efekti:	Risk për të rënduar padrejtësisht koston e marrjes me qira të objektit
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në zbatimin e kontratave.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Organet Drejtuese të Shoqërisë, të marrin masa për të negociuar me Shoqërinë ”K” Shpk për të siguruar pronën objekt qiraje, në një shoqëri të liçensuar sigurimi nga humbja ose dëmtimi nga rreziqet e siguruara. Në rast mos sigurimi të pronës të zgjidhet kontrata e qirasë.

5. Titulli i	Përfitim i padrejtë i qiradhënësit K.Q në vlerën 1,545,045 lekë.
---------------------	--

gjetjes:	
Situata:	<p>Shoqëria “UKT” Sh.a ka lidhur kontratë nr. 10728 prot., datë 12.06.2019 me K.Q me objekt “Marrja me qira e tokës mbi të cilën është ndërtuar depo uji me vendodhje në Fshatin Surel, njësia administrative Dajt” me sipërfaqe 511.65 m² për përdorim toke. Kohëzgjatja 1 vjeçare me të drejt rinovimi me vlerë qiraje 173,961 lekë në muaj. Në këtë përfshihet tatimi mbi qiranë që do ti mbahet qiradhënësit çdo muaj sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.</p> <p>Rrethimi i depos ujit të ujësjellësit (Depo uji, pusetë dhe objekt të shërbimit (sistem kamera, manovrator etj) është 401.5 m², sipërfaqe sipas planimetrisë 511 m², diferenca = 109.5 m² x 340 lekë m²/muaj =37,230 lekë në muaj x 41.5 muaj (12.06.19 data e lidhjes kontratës deri më 30.11.22 që përfundon auditimi= 1,545,045 lekë përfituar tepër.</p> <p>Vlera 1,545,045 lekë përbënë dëm ekonomik për Shoqërinë “UKT” Sha dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga përfituesi.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, nenet 801-825.
Ndikimi/Efekti:	Është rënduar padrejtësisht kostoja e marrjes me qira të objektit.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në zbatimin e kontratave të qirasë.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 1,545,045 lekë nga K.Q. Kjo është përfituar padrejtësisht nga qiradhënësi K.Q, si pasojë e diferencës ndërmjet planimetrisë së kontratës së qirasë dhe sipërfaqes sipas planimetrisë në fakt.

6. Titulli i gjetjes:	Punime publike të kryera pa dokumentacionit të plot tekniko-ligjor.
Situata:	Investimi (Depo uji Shkozë viti 2018 dhe godinë shërbimi “, është kryer pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 29, neni 39 pika 1, VKM nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar neni 9 dhe 11, Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, neni 14.
Kriteri:	Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 29, neni 39 pika 1, VKM nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar neni 9 dhe 11, Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, neni 14.
Ndikimi/Efekti:	Risk për keq administrimin e territorit dhe ruajtjen e mjedisit.
Shkaku:	Keq interpretim të akteve ligjore dhe rregullatore në ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Shoqëria të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për

	ndërtimet dhe rikonstrukcionet e objekteve, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me leje ndërtimi, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.
--	--

7. Titulli i gjetjes:	Shoqëria është penalizuar në një rast në vlerën 34,992,188 lekë nga mos zbatimi i procedurave gjyqësore.
Situata:	<p>Shoqëria “UKT” SHA është penalizuar në vlerën 34,992,188 lekë nga mos zbatimi i procedurave gjyqësore me përfitues Y.V, po në të njëjtën vlerë, për mos respektim të afatit të anikimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, veprim në kundërshtim Ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë neni 443 dhe 450/1/a.</p> <p>Ky konflikt gjyqësor është krijuar nga përdorimi i pasurisë së paluajshme e llojit “Pyll” me sipërfaqe 2200 m² ndodhur në Zonën Kadastrale 2380, me nr.pasurisë.11/21/163 në Lanabregas Tiranë.</p> <p>Ekzekutimi i Vendimit nr. 6133, datë 20.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga përmbartuesi është kryer pasi veprimet procedurale të Drejtorisë Juridike janë kryer me vonesë duke sjellë si pasojë ekzekutimin e vendimit pa ushtruar detyrimin ligjor për ndjekjen e çështjes në të gjitha shkallëve të gjyqësorit. Për rrjedhojë mosparaqitja në afat e ankimit në Gjykatën e Apelit i ka dhënë mundësi Paditësit të ekzekutojë vendimin. UKT pavarësisht se ka ekzekutuar detyrimin përmbartimor për këtë çështje ka depozituar në gjykatë kërkesë për disponim ankimi dhe kërkesë për rishikim vendimi. Te dy çështje janë në proces për t’u gjykuar nga Gjykata e Apelit.</p> <p>Në këtë mënyrë, nëse gjykata do të pranojë rishikimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, kthimi i shumës së ekzekutuar do të ishte me risk, pasi do të duhej një kohë e gjatë nga përfundimi i procesit për rishikimin e vendimit deri në kërkimin e kthimit të shumës me një tjetër padi dhe çështje gjyqësore.</p> <p>Vlera 34,992,188 lekë përbën efekt financiar negativ për Shoqërinë “UKT” Sh.a dhe Buxhetin e Shtetit.</p>
Kriteri:	Ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë neni 443 dhe 450/1/a.
Ndikimi/Efekti:	Efekt financiar negativ për Buxhetin e Shtetit
Shkaku:	Mos respektim të afatit të anikimit në Gjykatën e Apelit Tiranë.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>-Nga Shoqëria t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale, ndjekjes me përgjegjësi të gjitha procedurat gjyqësore, me përfaqësim tekniko-juridik me profesionist me eksperiencë për minimizuar dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i vendimeve në disfavor të Shoqërisë.</p> <p>Shoqëria “UKT” SHA të analizojë vlerësoj çështjen në tërësi, për të zbatuar në mënyrë vullnetare dhe në marrëveshje me subjektin detyrimin e krijuar, si dhe lidhur kontrata, me qëllim uljen e kostove financiare të cilat mund të krijohen nga vendimi gjyqësor dhe shpenzimet përmbartimore. Në marrëveshje të përcaktohen edhe klauzolat në rast të</p>

	ndryshimit të vendimit gjyqësor duke krijuar garancitë ligjore përkatëse për institucionin.
--	---

8. Titulli i gjetjes:	Mos formalizim i veprimtarisë së përditshme operacionale të strukturave të tyre sipas organigramës të Shoqërisë
Situata:	<p>Departamentet Inxhinierik/Operacional nuk kanë zbatuar plotësisht rregulloren e UKT SHA në lidhje me formalizimin e veprimtarisë së përditshme operacionale të strukturave të tyre sipas organigramës të Shoqërisë. Konkretisht nga këta departamente është vepruar në kundërshtim me kërkesat rregullatore dhe në mosbatim të detyrave funksionale sipas hierarkisë të përcaktuara në këtë Rregullore.</p> <p>Kjo vërehet në projektet/preventivat/situacionet/urdhurat/aktet kolaudimet/marrjet në dorëzim/korrespondenca ku delegimi/autorizimi/urdhri për zbatim të veprimeve operacionale është kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme nga Drejtorët e Departamenteve në instanca specifike të vartësisë pa respektuar hierarkinë institucionale dhe në raste të veçanta dhe anasjelltas. Kjo krijon risk të lart në mos rakordancë të ndërveprimit zyrtar të zhvilluar ndërmjet tyre lidhur me: Zbatimin, raportimin, monitorimin, duke mos sjellë në vëmendje pranë strukturave të këtyre Departamenteve dhe Titullarit të Shoqërisë, mos realizimin e detyrimeve dhe përgjegjësisë ligjore të punonjësve të ngarkuar sipas rregullores.</p>
Kriteri:	Rregullorja e Brendshme të UKT SHA me Nr. U-44/1 prot., datë 05.02.2021, të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 12.12.2016, Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 1, datë 24.01.2018, nr. 9, datë 30.04.2019, nr.1, datë 27.01.2021 dhe nr.7, datë 29.06.202, Ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Kreu II-"Përgjegjshmëria menaxheriale", neni 8.
Ndikimi/Efekti:	Risk për keqmenaxhim të burimeve njerëzore
Shkaku:	Mos zbatim i Rregullores së Brendshme të UKT SHA me Nr. U-44/1 prot., datë 05.02.2021.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	-Nga drejtorët e Departamentit Inxhinierik/Operacional të merren masa për të korriguar këtë praktikë në lidhje me caktimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e detyrave të punonjësve në veprimtarinë e përditshme operacionale, me qëllim jo vetë kryerja e tyre të bëhet sipas hierarkisë institucionale, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të Departamentit, për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

9. Titulli i gjetjes:	Nuk ka akte rakordime të përbashkëta me qiradhënësin, për realizimin e detyrimeve në derdhjet e pagesës
------------------------------	---

Situata:	<p>Shoqëria “UKT” SHA ushtron veprimtarinë e saj me Seli në adresën Rruga “Kavajës”. Për përdorimin e objektit/ndërtesës Shoqëria ka lidhur me qiradhënësin, kontratën e qirasë nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019, kontratë e ndryshuar me kontratën nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021.</p> <p>Në nenin 9, paragrafi 9.2 të Kontratës së qirasë 2, Palët janë të detyruar që në fillim të çdo viti, të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta, për realizimin e detyrimeve në derdhjet e pagesës, në nivelin e investimit dhe kamatat ose gjobat (kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate. Aktet e rakordimit janë pjesë e dosjes së qiradhënies.</p> <p>Në nenin 6, paragrafi 6.5 të Kontratës së qirasë nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019 të ndryshuar me nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021 dhe nr.5553 rep, nr.kol 3558, datë 21.09.2022 është përcaktuar se: 6.5 Qiramarrësi duhet të marre masat e nevojshme që Sendit t’i mund të behet një mirëmbajtje e zakonshme në terma ditore, javore, mujore dhe vjetore, duke përfshirë zëvendësimin e pjesëve të këmbimit në rast dëmtimi nga përdorimi. Për këtë qëllim Qiramarrësi duhet t’i dorëzojë Qiradhënësit një plan mirëmbajtje vjetore të asetit, godinës dhe sistemeve që janë pjesë e godinës (mure, sisteme, oborr, pemë, gjelbërim etj).Plani duhet të përmbajë të detajuar mirëmbajtjen e të gjithë asetëve dhe sistemeve përbërëse të objektit. Qiramarrësi duhet t’i dërgojë çdo muaj procesverbalet e mirëmbajtjes Qiradhënësit, sipas procesverbalit tip bashkëngjitur kësaj shtese kontrate, si Aneksi 3.</p> <p>Nga verifikimi i dosjes së zbatimit të kontratës së qirasë rezulton se nuk është mbajtur asnjë akt rakordimi mes palëve.</p>
Kriteri:	Kontrata nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019 ndryshuar me nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021
Ndikimi/Efekti:	Risk për pasaktësi detyrimeve ndërmet palëve
Shkaku:	Mos zbatimi i Kontratës nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019 ndryshuar me nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria Ekonomike dhe Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa që në zbatim të detyrimeve kontraktuale të mbajnë me qiradhënësin Akt-Rakordime dy palëshe për evidentimin e derdhjeve të qirasë mujore, investimet e kryera dhe kompesimin financiar të tyre nga qiradhënësi, realizimin e planit të mirëmbajtjes së objektit, kamatat ose gjobat nëse ka.

2.9. Trajtimi i ankesës S. B. protokolluar në KLSH me nr. 529 prot., datë 27.05.2022.

Qytetari S.B, banor i Bashkisë Tiranë ka bërë ankesë në KLSH protokolluar me nr. 529 prot., datë 27.05.2022.

Pretendimi i kësaj ankesë është se që Shoqëria “UKT” SHA të mos i faturoj taksat e tarifave vendore, pasi është në kategorinë e përjashtuar nga pagesa e tyre (pensionist).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se ky pretendim është në Gjykatën e Apelit Tiranë. Referuar Ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodit të Procedurës Civile”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 36, kjo ankesë nuk mund të shqyrtohet, pasi në këtë nen është

përcaktuar në mënyrë eksplicite se “Në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta. Juridiksioni gjyqësor civil ushtrohet sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjeve të tjera.

Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata. Është e pavlefshme çdo marrëveshje që lidhet në kundërshtim me këtë dispozitë”.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje elektropompa”, viti 2019 në vlerën 12,353 mijë lekë, Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjellësi dhe kanalizimi në zonën e kufizuar nga rrugët Tefta Tashko”, “Luigj Gurakuqi”, viti 2021 në vlerën 45,639 mijë lekë, “Zhblllokim pusetash”, viti 2022 në vlerën 19,994 mijë lekë dhe “Blerje tuba dhe rekorderi”, viti 2022 në vlerën 19,994 mijë lekë, kriteret e veçanta për kualifikim nuk janë vendosur plotësisht konform akteve rregullatore për prokurimet publike, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2009, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 5, VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, kreu III, pika 1/a, VKM nr. 108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar, shkresën e APP (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, viti 2021, në vlerën 99,903 mijë lekë, nuk është siguruar kontrata për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta, si dhe Autoriteti Kontraktor, nuk ka zgjatur periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit, ose nuk ka bërë vet siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

Veprim në kundërshtim me neni 25 të kontratës së lidhur, pika 1 dhe 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

“25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plotë, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të

kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në sigurimin e kontratave, me qëllim jo vetëm lidhja tyre të shoqërohet me policat e sigurimi, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, viti 2019, për vlerën 99,903 mijë lekë, “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”, viti 2021 për vlerën 999,800 mijë lekë, punimet janë projektuar dhe preventivuar nga inxhinier/specialist pa pasur zotësinë profesionale për të projektuar (teknike dhe ligjore), pasi nuk kanë pasur licencat profesionale përkatëse të dhëna nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 759, datë 12.11.2014 ‘Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’, i ndryshuar, pika 1, neni 16/1 “Licenca – kategoritë e punimeve” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për hartimin e projekteve, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me inxhinier/specialist të licencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, viti 2019, për vlerën 99,903 mijë lekë, në preventiv nuk është pasqyruar pajisja hardware e komunikimit DCU, që mundëson transmetimin në kohë reale në Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të dhënave, pajisje e cila është në projekt, duke sjellë:

-a. Mos efikasitet të plotë të fondit publik të përdorur në këtë prokurim në përputhje me qëllimin e tij, që ka të bëjë me “Sistemi matjes në distancë bazohet në ngritjen e një rrjeti komunikimi të njësisë matëse me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të Dhënave”. Kjo lloj teknologji shfrytëzon transmetimet wireless, e cila transformon informacionin mekanik në sinjale elektrike. Përmes instalimit të këtyre ujëmatësive ndërtohet Sistemi i Matjes në Distancë. Sistemi i Matjes në Distance bazohet në ngritjen e një rrjeti komunikimi të njësisë matëse me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të Dhënave. Projekti parashikon që në ofertë të jenë të parashikuara të gjitha kostot në lidhje me programimin e software, zhvillimin me qëllim përfundimtar që të dhënat të përftuara përmes walk-By/Drive-By, ose përmes rrjetit fikse të jenë të disponueshme në sistemin e shfrytëzimit të U.K.T.

-b. Mos kalimin e vlerës mbi 100,000,000 lekë, për t’ju nënshtruar projekti, oponentës teknike.

-c. Mos shkurtimin e personelit (faturistëve) për faturimin e ujit të pijshëm.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 18.7.2002 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, pika 1, VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponentës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, Urdhrin e

Ministres së Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit nr. 7, datë 20.1.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura në lidhje me instalimin e matësve inteligjent është e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë viti 2019, për vlerën 99,903 mijë lekë, “Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjellësi dhe kanalizimi në zonën e kufizuar nga rrugët Tefta Tashko”, “Luigj Gurakuqi”, viti 2021, vlera 45,639 mijë lekë, punimet janë kryer pa deklaratë paraprake punimesh. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 3 pika 21, VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar neni 7 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Nga Shoqëria të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për ndërtimet dhe rikonstrukcionet e objekteve, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me leje ndërtimi/deklaratë paraprake punimesh, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “UKT” Sh.a për periudhën 2021, ka instaluar 4776 matës inteligjent të ujit të pijshëm. Instalim i matësve inteligjent është realizuar pa kryer më parë, vlerësim ekonomik, i cili duhet të kishte marrë në konsideratë të gjitha kostot afatgjata dhe përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, duke përfshirë gjithashtu edhe formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhet/përzgjidhet, e cila duhet të jetë ekonomikisht më efektive dhe me afatin kohor më të përshtatshëm për implementimin e këtij sistemi matjeje.

Në bazë të vlerësimit ekonomik të përcaktuar si më sipër Shoqëria, duhet të kishte propozuar në ERU ndryshimet përkatëse ligjore dhe rregullatore, si dhe mbas miratimit të tyre duhet të përgatiste një kalendar për implementimin brenda një periudhë 10-vjeçare të sistemeve inteligjente të matjes.

ERU duhet të sigurojë/siguroj ndërveprimin e sistemeve të ndryshme matëse, që do të implementohen në të gjithë territorin e vendit. Në instalimin e matësve nuk është dokumentuar testimi i kryer pas verifikimit periodik, me rezultatin që matësi nuk kryen funksionet e matjes (Verifikimit periodik të ujëmatësve i nënshtrohen të gjithë ujëmatësit që kanë plotësuar kriterin e datës së vendosjes së tyre 60 muaj, dëmtimi/ose jo fizikisht i tij, kalimi/ose jo j jetëgjatësisë së tij, matësi nuk kryen funksionet e tij etj). Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve SHA”, pika 2/7, Ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë” i shfuqizuar, neni 26, i ndryshuar me Ligjin nr. 126/2020 “Për metrologjinë”, neni 25; VKM nr. 96, datë 21.2.2007 “Për disa ndryshime në VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, pika 3; Vendimin e Enti Rregullator i Ujit nr. 8, datë 04.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip” ndryshuar me Vendimet nr. 15, datë 09.06.2014 “Për zbatimin e kontratës model të miratuar nga KKRR për të gjithë klientët e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”

dhe me Vendimin nr. 25, datë 08.07.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën model të shërbimeve ujësjellës kanalizime" Enti Rregullator i Ujit, neni 7 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Në rastet e vendosjes së matëseve inteligjent të ujit të pijshëm nga Shoqëria "UKT Tiranë" SHA, të merren masa për të përgatitur paraprakisht vlerësimin ekonomik, i cili duhet të marrë në konsideratë të gjitha kostot afatgjata dhe përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, duke përfshirë gjithashtu edhe formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhet/përzgjidhet, e cila duhet të jetë ekonomikisht më efektive dhe me afatin kohor më të përshtatshëm për implementimin e këtij sistemi matjeje. Në bazë të vlerësimit ekonomik të përcaktuar si më sipër Shoqëria, duhet ti propozoj në ERU ndryshimet përkatëse ligjore dhe rregullatore, si dhe mbas miratimit të tyre duhet të përgatit një kalendar për implementimin brenda një periudhë 10-vjeçare të sistemeve inteligjente të matjes.

ERU duhet të siguroj ndërveprimin e sistemeve të ndryshme matëse, që do të implementohen në të gjithë territorin e vendit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e kontratës "Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike", viti 2021, për vlerën 999,800 mijë lekë, për çdo muaj është hartuar akt kolaudimi dhe procesverbali i marrjes në dorëzim. Konkretisht për muajin janar 2022. Aktkolaudimi me nr. 4119/3 prot., datë 20.10.2022 i firmosur nga "PC" Shpk dhe grupi i marrjes në dorëzim R.L, D.Q dhe E.Q. Ku është shprehur "Grupi i kolaudimit u njohë me kontratën të kolaudojë dhe të marr në dorëzim shërbimin e kryer sipas faturës nr.8/2022, datë 20.01.2022 (bashkëlidhur) është në përputhje me kërkesat e paraqitura në kontratë dhe në specifikimet teknike sipas kontratës. Operatori "PC" Shpk ka kryer shërbimin sipas dokumenteve bashkëngjitur". Procesverbal me nr. 1012 prot., datë 20.01.2022 i firmosur I H dhe grupi i punës R.L, D.Q dhe E.Q, ku është shprehur në mënyrë eksplicite e "Shpk "P " Shpk për periudhën 15.12.2021-15.01.2022, ka realizuar me sukses monitorimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të sigurisë për 76 objekte sipas kontratës dhe termave të referencës", por nuk cilëson çfarë mirëmbajete ka bërë specifikisht. Po ashtu dhe për dy operatorët e tjerë "E" dhe G.S. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik", me ndryshimet vijuese të tij, pika 23 gërma g dhe pika 34 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhra me qëllim ndjekjen me përpikmëri të zbatimit të kontratave, duke përfshirë dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, për sasinë, cilësinë, llojin si dhe dokumentacionin shoqërues të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit "Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjellësi dhe kanalizimi në zonën e kufizuar nga rrugët Tefta Tashko", "Luigj Gurakuqi", viti 2021 për vlerën 45,639 mijë lekë, në dokumentet e tenderit dhe në kontratën e lidhur nuk reflektojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratave, sipas përcaktimeve të dokumenteve të tenderit, nuk reflektohet afati për mbajtjen e garancisë së punimeve, në kundërshtim me Udhëzim i KM nr. 3, datë 15.2.2001, "Për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtimit", i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhra me qëllim përcaktimin me përpikmëri të afatit për mbajtjen e garancisë së punimeve, duke përfshirë dhe vlerën përkatëse si garanci.

9. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Ndërtim rrjet shpërndarjes ujësjellësi dhe kanalizimi në zonën e kufizuar nga rrugët Tefta Tashko”, “Luigj Gurakuqi”, viti 2021 për vlerën 45,639 mijë lekë, me shoqërinë “L C” Shpk, nuk është lidhur kontrata e sigurimit për çdo dëm që mund të shkaktohet. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 1 dhe 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në sigurimin e kontratave, me qëllim jo vetëm lidhja tyre të shoqërohet me policat e sigurimi, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi mbetjet të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike; tubacione, saraçineska etj) të cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë të projekteve të ndryshme, depozitohen në Landfill-in e Sharrës, i administruar nga Shoqëria “I E”.

Për vend depozitimin dhera dhe inerte tek Landfilli Sharrës për llogari të Shoqërisë (I E”, për vitin 2019 është faturuar vlera 12,879,558 lekë, është likuiduar vlera 11,759,763 lekë, për vitin 2020 është faturuar vlerë 490,315 lekë, është likuiduar vlera 1,602,325 (1,119,805 lekë mbetje nga viti 2019 dhe 490,315 nga viti 2020), për vitin 2021 është faturuar vlera 3,102,964 lekë, është likuiduar vlera 390,583 lekë, mbetur në diferencë pa likuiduar vlera 2,720,175 lekë, për periudhën janar-tetor 2022 është faturuar vlera 1,006,084 lekë, është likuiduar vlera 1,006,084 lekë.

Për këtë depozitim nuk ka kontratë të lidhur ndërmjet Shoqërisë “UKT” SHA dhe Shoqërisë “I E”, veprim në kundërshtim me VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, pika 9. Faturim është bërë me çmimi 800 lekë/tonë inerte (mbetje nga ndërtimet dhe prishjet) dhe 246.7 lekë/tonë për dhera dhe shtuf.

Këto çmime janë vendosur nga Shoqëria (I.E BV SPV”, pa miratimin e Bashkisë Tiranë, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, pika 15. Transportimi është bërë nga UKT pa patur Licencën tipit III.2.B e pajisur vet ose nëpërmjet nënkontraktoreve për transport të mbetjeve në destinacionin e përcaktuar, si dhe mjetet e angazhuara për këtë qëllim, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integrua të mbetjeve”, neni 57 “Transportuesit e mbetjeve”, pika 1 dhe 2 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të merren masa që për vend depozitimi i mbetjeve të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike; tubacione, saraçineska etj) të cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë të projekteve të ndryshme, të lidhet kontratë/kontata ndërmjet Shoqërisë “UKT” SHA dhe operatorit/operatorëve ekonomik të përzgjedhur për këtë qëllim.

10.2. Rekomandimi: Shoqëria “UKT” ti kërkoj Bashkisë Tiranë miratimin e çmimit të faturimit për/tonë inerte (mbetje nga ndërtimet dhe prishjet) dhe për dhera dhe shtuf etj.

10.3. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të merren masa që shoqëria të pajisjet vet me Licencën tipit III.2.B, ose nëpërmjet kontraktorëve për transport të mbetjeve në destinacionin e përcaktuar.

11. Gjetje nga auditimi: Likuidimet për llogari të (I E BV SPV”, për vend depozitim të mbetjeve të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike; tubacione, saraçineska etj) të cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë të projekteve të ndryshme, janë bërë pa situacion, pa formular vend depozitimi lëshuar (firmosur) nga Lanfilli dhe drejtuesi i mjetit që ka transportuar, pa firmosur prodhuesi i mbetjeve, shoqëruar me fletë peshën e impiantit, në kundërshtim me aneksin “Formati i dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme” të VKM nr. 575, datë 24.06.2015, pika 7, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Zotëruesit e mbetjeve inerte dhe operatorët e lëndësive të mbetjeve inerte janë të detyruar të plotësojnë dhe të nënshkruajnë dokumentin e transferimit të këtyre mbetjeve dhe të dhënat regjistrohen në Regjistrin e Transfertave Individuale, sipas VKM nr. 229, datë 23.4.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.

UKM nr. 1, datë 16.06.2011, “Për disa ndryshime në UKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 3.3, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe 26, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/b.

Mbetjet nuk janë klasifikuar sipas kodeve përkatëse në kundërshtim me VKM nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, pika 17 “Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (përfshi dhera të gjëmuara nga zona të kontaminuara)” si dhe pika 20, mbetjet urbane (mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë fraksionet e mbledhura veçmas: 20 02 02 “Dhera dhe gurë”; 20 02 03 “Mbetje të tjera të pabiodegradueshme”; 20 03 “Mbetje të tjera urbane”; 20 03 01 “Mbetjet e përziera urbane”; 20 03 04 “Llumra nga gropat septike”; 20 03 06 “Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza”; 20 03 07 “Mbetjet të vëllimshme”; 20 03 99 “Mbetjet urbane të paspecifikuara”. Procesverbalet të firmosura nga drejtuesit e automjeteve, M.V me detyrë përgjegjëse të transportit, dhe E. K. me detyrë përgjegjëse të sektorit të investimeve dhe kanalizimeve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Nga Shoqëria t`i kushtohet vëmendje e duhur institucionale administrimit të mbetjeve të tipit inerte jo vetëm fizikisht, por dhe në mbajtjen e dokumentacionit të plot teknikoligjor dhe likuidimit konform këtij dokumentacioni.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”, viti 2021, në preventiv dhe situacion për 211 objekte është përfshirë zëri “Instalimi i sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit” në vlerën 49,042,692 lekë me TVSH. Në qendrën e monitorimit (Zyrat Qëndrore UKT) instalimi i sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit është në vlerën 54,360,240 lekë me TVSH. Në total vlera për instalimin e sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit është 103,402,932 lekë.

Duke marrë në konsideratë: Investimin e bërë për punime rrethimi depo & punime për furnizimin me energji & ndërtim sistem alarm+kamera në vlerën 522,237,830 lekë me TVSH në vlerat respektive 140,407,914 lekë, 46,612,456 lekë dhe 335,253,459 lekë; Vlerën 103,402,932 lekë për instalimin e sistemit të ndërlidhjes të objekteve me qendrën e monitorimit; Personelin e

disponueshëm të UKT, pasi në strukturë organizative të shoqërisë është Sektori Call Center me 9 punonjës në organik, dispeçeria 5 punonjës, IT me personel 8, drejtues mjeti 56, punonjës të taks forcës 31, si dhe automjete 42 autovetura, 30 motor 36 minifugon; Zbatimin e VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”, Shtojca VI “Zonat e Mbrojtjes Sanitare”. Pika 2. Mbrojtja sanitare e burimeve të ujërave nëntokësore (Për furnizim publik ose individual) ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “... Mbrojtja e saj me roje të armatosur sigurohet nga administratori i ujësjellësit”. Investimi nuk është maksimalizuar me efektivitet të plotë në përputhje me qëllimin e tij (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të kësaj shoqërie, të merren masa që investimi të maksimalizohet me efektivitet të plotë në përputhje me qëllimin e tij, duke garantuar edhe mbrojtjen zonave të burimeve të ujërave nëntokësore.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Tuba dhe Rekorderi”, në vlerën 149,858,642 pa Tvsh, viti 2022, vlera e fondit limit (marrëveshja kuadër) është realizuar 100 % brenda 5 muajve.

Lidhja e kontratave është realizuar mbi bazën e marrëveshjes kuadër, e cila pavarësisht se ka ndikuar në uljen e çmimit për njësi, por si shpenzim ka shkuar tek fondi limit, duke rritur numrin e pjesëve/njësive dhe në rastin e audituar asnjëherë uljen e numrit të pjesëve/njësive si dhe pakësimin jo vetëm të fondit limit por edhe as të vlerës së prokuruar, dhe mbart në të ardhmen riskun e lart të përzgjedhjes së pjesëve/njësive me vlerë më të lart, duke mos arritur në këtë mënyrë uljen kostove të blerjeve/shërbimeve. Veprime në kundërshtim me Udhëzim e APP nr. 6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, me ndryshimet vijuese të tij, pikat 7.1,7.2 dhe 7.3.

Në dokumentet e tenderit dhe në minikontratat e lidhura nuk është përcaktuar se tubat dhe rekorderit do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të APP nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqëruar të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandimi: Përdorimi i kësaj forme prokurimi detyrimisht duhet të arrij reduktimin e kostove transaksionale, përmirësimin e vazhdueshëm në harkun e marrëdhënieve afat-gjatë ndërmjet AK dhe Operatorëve Ekonomik, në interes të konsumatorit, në rastin konkret përmirësimin e shërbimit të ujit për qytetarët.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.2. Rekomandimi: Nga autoriteti kontraktor të merren masa që në dokumentet e tenderit dhe në kontratat/minikontratat e lidhura të përcaktohet se mallrat/pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë etj.

14. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 06.10.2018-03.03.2021, Shoqëria ka kryer aktivitet pa qenë e licencuar nga Enti Rregullator i Ujit (ERU). Për këtë periudhë kjo shoqëri ka qenë në proces licencimi, duke shkëmbyer dokumentacion shkresor të njëpasnjëshëm me ERU. Pas datës 04.03.2021 kjo shoqëri është pajisur me Licencë, miratuar me vendim nr. 40, datë 06.10.2017 (afati 06.10.2017-05.10.2018), Licenca nr. 2 miratuar me vendim nr. 84, date 04.03.2021 me afat 04.03.2021 deri me 03.03.2023; Licenca nr. 2, miratuar me vendim nr. 150, date 01.04.2022 me afat 01.04.2022 deri me 03.03.2023. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, neni 15 dhe VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të liçensimit dhe procedurave për aplikim për licencë”, pika I/a/b/c (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1. Rekomandimi: Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale, rinovimit në kohë të licencave përkatëse sipas objektit të veprimtarisë saj brenda zonës së shërbimit që ushtron aktivitet.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në vendim të Entit Rregullator i Uji nr. 84, date 04.03.2021 është përcaktuar drejtues ligjor E.K dhe drejtues teknik E.O dhe E.C, me licencim të shoqërisë me kategori A”, “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”, kategoria B “Për përpunimin e ujit për konsum publik” dhe kategorinë C”, “Për largimin e ujërave të ndotura. Deri 30.11.2022, datë që përfundon auditimi drejtuesit teknik të shoqërisë E.O, E.C dhe E.M me detyrë drejtor i departament të shitjes, nuk zotërojnë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tyre, sipas detyrës që ushtrojnë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura.

Këtë certifikatë nuk e kanë dhe 456 punonjësit që merren me menaxhimin e ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 2972 prot., datë 08.10.2019, i ka kërkuar listën e punonjësve subjekt certifikimi dhe formularët e deklaramit të punësimit dhe arsimit të Shoqërisë “UKT” Sha.

Shoqëria me shkresën nr. K-2355/1 prot, datë 11.09.2019 dhe shkresën nr. K-2645/1 prot, datë 21.10.2019, ka dërguar listën emërore të punonjësve, diplomën/dëftesë e noterizuar ose e njësuar me vulën e institucionit dhe formularin e deklaramit.

Që nga data 21.10.2019 deri më 30.11.2022 datë që përfundoj auditimi, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, nuk ka dërguar asnjë certifikim. Veprim në kundërshtim me Statutin e Shoqërisë i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 1, datë 08.01.2019, neni 19/c “Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit teknik” dhe Udhëzimi i MIE nr. 660, datë 28.09.2018 “Për krijimin dhe zbatimin e programit Kombëtar të Trajnimit dhe Certifikimit bazuar në testimin në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”, neni 5 pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë ti prezantohet/kërkohet zyrtarisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë pajisjen me certifikatat përkatëse për aftësimin specifik profesional të stafit menaxherial si dhe për 456 punonjësit, sipas detyrës që ushtrojnë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura, ose të lëshimit nga kjo Ministri të vërtetimit për pamundësinë objektive për pajisjen me këto certifikata.

Brenda datës 30.06.2023

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “W” shpk, me objekt “Blerje elektropompa”, viti 2019, në vlerën 14,383,998 lekë, viti 2019, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, mungesë e cila nuk mundëson grupin e auditimit të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e elektropompave. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690, UMF nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35, Ligjin nr. 10489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1. Rekomandimi: Nga autoriteti kontraktor të merren masa që në dokumentet e tenderit dhe në kontratat/minikontratat e lidhura të përcaktohet se mallrat/pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Për përdorimin e objektit/ndërtesës Shoqëria ka lidhur me qiradhënësin kontratën nr.5554 rep, nr.3559 koleksioni, datë 21.09.2022, me Shoqërinë “K ” Shpk.

Në nenin 4, pika 4.6, përcaktohet se: “Qiradhënësi ka të drejtë të siguroj pronën objekt qiraje, pronë një shoqërie të licencuar sigurimi nga humbja ose dëmtimi nga rreziqet e siguruar për një shumë të vlerësuar nga qiradhënësi si kosto e plot e rindërtimi. Rreziqet e Siguruara: Humbja dhe dëmi nga zjarri, rrufetë, shpërthimi, goditja e objekteve fluturuese dhe pjesëve apo ngarkesave të tyre, tërmeti, stuhitë, përmytjet, shpërthimi ose dëme nga uji, shembje dhe çdo rrezik tjetër kundër të cilit Qiradhënësi vendos të sigurohet herë pas herë (nga të cilat përjashtohen kufizimet dhe përjashtimet e vendosura nga siguruesit) dhe Rrezik i Siguruar është secili prej tyre”. Deri më 30.11.2022 që përfundoj auditimi, Polica e sigurimit nuk është pjesë përbërëse e kontratës, siç përcaktohet në nenin 4, pika 4.6. Pavarësisht se palët kanë vendosur me vullnet të lirë në kontratë detyrimin e palës Qiradhënëse për sigurimin e pronës objekt i kontratës së qirasë, ky detyrim kontraktual dhe ligjor nuk është përmbushur. Qiradhënësi nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, nenet 801-825 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë, të marrin masa për të negociuar me Shoqërinë ”K ” Shpk për të siguruar pronën objekt qiraje, në një shoqëri të licencuar sigurimi nga humbja ose dëmtimi nga rreziqet e siguruar. Në rast mos sigurimi të pronës të zgjidhet kontrata e qirasë.

Brenda datës 30.06.2023

18. Gjetje nga auditimi: Investimi (Depo uji Shkozë viti 2018 dhe godinë shërbimi“, është kryer pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 29, neni 39 pika 1, VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar neni 9 dhe 11,

Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, neni 14 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Rekomandimi: Nga Shoqëria të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për ndërtimet dhe rikonstruksionet e objekteve, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me leje ndërtimi, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Departamentet Inxhinierik/Operacional nuk kanë zbatuar plotësisht rregulloren e UKT SHA në lidhje me formalizimin e veprimtarisë së përditshme operacionale të strukturave të tyre sipas organigramës të Shoqërisë. Konkretisht nga këta departamente është vepruar në kundërshtim me kërkesat rregullatore dhe në mosbatim të detyrave funksionale sipas hierarkisë të përcaktuara në këtë Rregullore.

Kjo vërehet në projektet/preventivat, situacionet, urdhrat, akt kolaudimet, marrjet në dorëzim, korrespondenca ku delegimi/autorizimi/urdhri për zbatim të veprimeve operacionale është kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme nga Drejtorët e Departamenteve në instanca specifike të vartësisë pa respektuar hierarkinë institucionale dhe në raste të veçanta dhe anasjelltas. Kjo krijon risk të lart në mos rakordancë të ndërveprimit zyrtar të zhvilluar ndërmjet tyre lidhur me: Zbatimin, raportimin, monitorimin, duke mos sjellë në vëmendje pranë strukturave të këtyre Departamenteve dhe Titullarit të Shoqërisë, mos realizimin e detyrimeve dhe përgjegjësiive ligjore të punonjësve të ngarkuar sipas rregullores. Veprim në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të UKT SHA me Nr. U-44/1 prot., datë 05.02.2021, të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 12.12.2016, Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 1, datë 24.01.2018, nr. 9, datë 30.04.2019, nr.1, datë 27.01.2021 dhe nr.7, datë 29.06.202, Ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II-“Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 8 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1. Rekomandimi: Nga drejtorët e Departamentit Inxhinierik/Operacional të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në lidhje me caktimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e detyrave të punonjësve në veprimtarinë e përditshme operacionale, me qëllim jo vetë kryerja e tyre të bëhet sipas hierarkisë institucionale, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të Departamentit, për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Shoqëria UKT sh.a funksionon me një strukturë pagash të miratuar nga organet drejtuese të saj nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.17, datë 12.12.2016 dhe nr.1, datë 24.01.2018 dhe Asambleja e Aksionarëve me Vendimin nr.18, datë 14.12.2016.

Në këtë strukturë vendosja e nivelit të pagës për secilin pozicion nuk është vlerësuar bazuar në kritere të mirë përcaktuar si arsimimi (niveli i diplomës si master shkencor, master profesional, bachelor apo diplomë e shkollës së mesme), kualifikimi (njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet etj) përgjegjësia (shkalla e përgjegjësisë në funksion të riskut që mund të ketë puna që kryhet) etj.

Niveli i pagave në aneksin B të Rregullores së brendshme ka përcaktuar një sistem pagash sipas ndarjes së klasave dhe niveleve të kualifikimit duke i ndarë ato në dy shkallë ku kategorizohet paga pa vendosur kritere të mirë përcaktuara. Tabela përbëhet nga pesë klasë (klasifikim) KL, KN, A, B,C. Këto klasa nuk janë të ndara më me nënklasa por vetëm me nivele kualifikimi me nga dy shkallë page. Kriteret e përcaktuara në relacionin shpjegues janë: Eksperiencia në

profesione; Niveli i diplomës dhe i Master-it; Liçencat; Vështirësitë e vendit të punës dhe Gradat shkencore. Këto kritere nuk janë specifikuar për secilin pozicion pune në tabelën e pagave për të bërë diferencën mes niveleve të pagave. Si shembull marrim një specialist të burimeve njerëzore që është përcaktuar tek kategoria KN/2, nëndarja 1, me shkallë page minimale 62,500 lekë/muaj dhe maksimale 65,500 lekë/muaj dhe një specialist të Sektorit të Projekteve të Huaja që përcaktohet tek kategoria KN/2, nëndarja 2, me pagë minimale 60,000 lekë/muaj dhe maksimale 62,500 lekë/muaj. Kjo diferencë vihet re edhe ndërmjet pozicioneve ku një Përgjegjës Sektori në Njësi (faturimi) kategorizohet me nivel page më të ulët se një Specialist i Burimeve Njerëzore. Po kështu konstatohet se në tabelën e pagave ka përcaktime të tilla si specialist i parë, specialist i dytë, specialist i tretë, specialist i kualifikuar në detyrë. Për këto ndarje nuk janë vendosur kriteret që duhet të plotësojë një punonjës që të paguhet si i tillë. Ndërkohë që një punonjës të kategorizohet si “Specialist i parë” duhet minimalisht të ketë përfunduar master shkencor, për nivelin e “specialist i dytë” punonjësi duhet që punonjësi të ketë përfunduar master profesional dhe specialist i tretë punonjësi duhet të ketë përfunduar bachelor-in. Po kështu edhe për “Specialist të kualifikuar në detyrë” duhet të ishin vendosur kriteret të tilla si eksperiencia e gjatë në të njëjtin vend pune etj.

Brenda një Drejtorie, Përgjegjësit e Sektorit që përbëjnë këtë drejtori nuk kanë të njëjtën shkallë page. Kjo vërehet në rastin e Drejtorisë Juridike ku Përgjegjësi i Sektorit të Aseteve dhe Përgjegjësi i Sektorit të Përfaqësimit Ligjor paguhet me pagë bazë 69,500 lekë/muaj ndërkohë që Përgjegjësi i Sektorit të Asistencës Ligjore paguhet me pagë 76,500 lekë/muaj. Në Drejtorinë e Prokurimeve, specialistët nuk paguhet sipas kategorisë së vendosur në tabelë, KN/1, nëndarja 2, me pagë minimale 65,500 dhe pagë maksimale 69,500, por me pagë më të ulët. Ky veprim bie në kundërshtim me tabelën e miratuar të pagave. Nga krahasimi i pagave ndërmjet departamenteve rezulton se specialistët e Departamentit të Shitjes kanë paga më të ulëta se specialistët e departamenteve të tjerë. Edhe ky diferencim nuk është i argumentuar me kritere objektive (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të Shoqërisë të rishikohen dhe llogariten nivelet e pagave të punonjësve duke u bazuar në kritere të mirë përcaktuar si arsimimi (niveli i diplomës si master shkencor, master profesional, bachelor apo diplomë e shkollës së mesme), kualifikimi (njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet etj) përgjegjësia (shkalla e përgjegjësisë dhe vështirësisë në funksion të riskut që mund të ketë puna që kryhet) etj, duke shmangur pagesat me diferenca të konsiderueshme për punonjësit me natyrë të njëjtë pune dhe duke synuar motivimin e tyre.

Brenda datës 30.06.2023

21. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “UKT” SHA ushtron veprimtarinë e saj me Seli në adresën Rruga “Kavajës”. Për përdorimin e objektit/ndërtesës Shoqëria ka lidhur me qiradhënësin, kontratën e qirasë nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019, kontratë e ndryshuar me kontratën nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021.

Në nenin 9, paragrafi 9.2 të Kontratës së qirasë 2, Palët janë të detyruar që në fillim të çdo viti, të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta, për realizimin e detyrimeve në derdhjet e pagesës, në nivelin e investimit dhe kamatat ose gjobat (kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate. Aktet e rakordimit janë pjesë e dosjes së qiradhënies.

Në nenin 6, paragrafi 6.5 të Kontratës së qirasë nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019 të ndryshuar me nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021 dhe nr.5553 rep, nr.kol 3558, datë 21.09.2022 është përcaktuar se: 6.5 Qiramarrësi duhet të marrë masat e nevojshme që sendit t’i mund të behet një mirëmbajtje e zakonshme në terma ditore, javore, mujore dhe vjetore, duke

përfshirë zëvendësimin e pjesëve të këmbimit në rast dëmtimi nga përdorimi. Për këtë qëllim Qiramarrësi duhet t'i dorëzojë Qiradhënësit një plan mirëmbajtje vjetore të asetit, godinës dhe sistemeve që janë pjesë e godinës (mure, sisteme, oborr, pemë, gjelbërim etj). Plani duhet të përmbajë të detajuar mirëmbajtjen e të gjithë aseteve dhe sistemeve përbërëse të objektit. Qiramarrësi duhet t'i dërgojë çdo muaj procesverbalet e mirëmbajtjes Qiradhënësit, sipas procesverbalit tip bashkëngjitur kësaj shtese kontrate, si Aneksi 3.

Nga verifikimi i dosjes së zbatimit të kontratës së qirasë rezulton se nuk është mbajtur asnjë akt rakordim ndërmjet palëve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa që në zbatim të detyrimeve kontraktuale të mbajnë me qiradhënësin akt-rakordime dy palëshe për evidentimin e derdhjeve të qirasë mujore, investimet e kryera dhe kompensimin financiar të tyre nga qiradhënësi, realizimin e planit të mirëmbajtjes së objektit, kamatat ose gjobat nëse ka.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Administrimit nuk ka analizuar raportin për ecurinë e shoqërisë, raport që administratori duhet ta paraqesë një herë në muaj në këshill, si dhe nuk ka kryer verifikim dhe kontroll të llogarive vjetore të shoqërisë brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar. Veprim në kundërshtim me VKM nr.63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” neni 18, pika 7, gërma ç (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22.1. Rekomandimi: Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrës të analizojë një herë në muaj raportin e ecurinë së shoqërisë për realizuar performancën/objektivat në terma vjetorë të parashikuar.

Në vijimësi

22.2. Rekomandimi: Nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrës të merren masa për të bërë verifikimin dhe kontrollin e llogarive vjetore të shoqërisë brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Aksionarëve nuk kanë miratuar brenda afatit 6 mujor nga data e mbylljes së vitit financiar rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinimin e fitimit. Veprim në kundërshtim me Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar neni 33/1, pika 1 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.1.Rekomandimi: Nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrës dhe Asambleja e Aksionarëve të merren masa për të miratuar brenda afatit 6 mujor nga data e mbylljes së vitit financiar, rezultatit financiar të vitit paraardhës dhe destinacionin e fitimit.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Niveli i pagave është miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 1, datë 30.01.2019, por jo nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve (Bashkia Tiranë). Këshilli i Administrimit dhe Drejtori i Përgjithshëm e kanë quajtur të ezauruar miratimin e nivelit të pagave për periudhën kohore 01.09.2018-31.10.2022, referuar Vendimit të Assamblesë së përgjithshme nr. 18, datë 14.12.20216, si dhe me miratimin e programit ekonomik të çdo viti, ku pjesë e tij është edhe fondi i pagave. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë

24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” i ndryshuar, neni 6, pika 11 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit në të ardhmen të merren masat për miratimin e nivelit të pagave nga Asambleja Aksionare (Bashkia Tiranë) duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet ligjore në mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e Shoqërisë.

Brenda datës 30.06.2023

25. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “UKT” sha nuk operon me Drejtor Tregtar, pasi detyrat e tij kryhen nga Drejtoria Ekonomike dhe Departamenti i Shitjes. Veprim në kundërshtim me Nenin 20, pika 2/c të VKM nr.63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, ku citohet: “Drejtori Tregtar harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv” dhe Nenin 20, pika 2/c në Statutin e “UKT” sha me nr. 08/2 prot., datë 13.12.2021, ku citohet: “Drejtori Tregtar harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të Shoqërisë të bëhet unifikimi i strukturës organizative me statutin e Shoqërisë dhe VKM nr. 63, datë 27.01.2016.

Brenda datës 30.06.2023

26. Gjetje nga auditimi: Referuar strukturës organizative të “UKT” sha, të miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 20, datë 29.09.2022 “Për miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të shoqërisë, për vitin 2021” janë punësuar 1382 punonjës dhe ndër ta 105 punonjës janë pompistë/pompist klorinues, 6 prej tyre nuk janë të pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, neni 9, pika 1, gërma “a” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për pajisjen e punonjësve me profesion elektrikistë/elektropompist me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, në përputhje sipas dispozitave ligjore.

Brenda datës 30.06.2023

27. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2018-26.11.2021, periudhë para miratimit të “Manualit të procedurave të Drejtorisë së Burimeve të shoqërisë “UKT” sha” me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 25, datë 26.11.2021, u konstatua se mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Tiranë, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira. Evidentohen që për të njëjtin pozicion pune nuk janë të njehësuar kriteret e nevojshme për punësim. Ndërsa gjatë periudhës 26.11.2021-31.10.2022, u konstatua se Manuali i procedurave të Drejtorisë së Burimeve nuk

parashikon procedura mbi shpalljen e vendeve vakante. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, Statuti dhe Rregullorja e brendshme e UKT Sh.a (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

27.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të bëhen parashikime të detajuara statutores dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

Brenda datës 31.08.2023

27.2. Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë të përcaktohet në deklaratimet për pozicione të lira pune, edhe afati brenda të cilit të interesuarit për pozicionin e punës duhet të shprehin interesin dhe paraqesin dokumentacionin e nevojshëm provues.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi janë shpërblyer punonjësit në vlerën 126,056,093 lekë.

Shpërblimet janë dhënë me Urdhër të Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm, dhe jo me miratim nga Këshilli i Administrimit, pasi janë konsideruar të ezauruara me miratimin e programit ekonomik sipas viteve: Me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 18, datë 12.12.2018 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për vitin 2019, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 16, datë 13.12.2018; me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, datë 19.12.2019 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për vitin 2020, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 11, datë 20.12.2019; me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 9, datë 04.11.2020 është miratuar Buxheti i shoqërisë, për vitin 2021, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 7, datë 05.11.2020 dhe me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, datë 26.11.2021 është miratuar Buxheti i shoqërisë për vitet 2022”, i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr.10, datë 13.12.2021. Veprim në kundërshtim me - Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, i ndryshuar, neni 6, pika 1, gërma b, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 160 “Shpërblimi”, pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

28.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese ti kushtohet vëmendje e duhur Institucionale shpërblimit të punonjësve.

Në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Ka mospërputhje midis kontratës kolektive dhe kontratës individuale të punës në lidhje me shkallëzimin (klasifikimin) e masave disiplinore.

Konkretisht në kontratën individuale të punës, Neni 13 “Masat disiplinore”, të cilat shkallëzohen në: prerje e pagës për ditë pune kur nuk respektohet orari i punës ose largohesh pa leje, vërejtje me shkrim, gjobë nja jo më pak se 1000 (një mijë) lekë deri në një pagë mujore, vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna, transferim nga vendi i punës dhe caktimi në një vend tjetër me pagë më të ulët deri në 6 muaj, pushim nga puna”.

-Në kontratën kolektive, Neni 22 “Masat disiplinore”, pika , “Për të garantuar zbatimin e plotë të kontratës së punës dhe për të siguruar një veprimtari sa më normale e ligjore të marrëdhënieve të punës, për shkeljet e ndryshme të disiplinës dhe për moszbatim të kushteve të kontratës palët ranë dakord të përcaktohen këto masa disiplinore:

Vërejtje me shkrim; Mbajtja e pagës kur punëmarrësi largohet pa leje nga vendi i punës; Transferim nga vendi i punës dhe caktim në një vend tjetër me pagë më të ulët deri në 6 muaj; Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna; Largim nga puna” .

Në manualin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk është e cituar tek llojet e masave disiplinore: “gjobë nja jo më pak se 1000 (një mijë) lekë deri në një pagë mujore”, ndërkohë që në kontratën individuale të punës është një nga llojet e masave disiplinore. Veprim në kundërshtim me Kontratën kolektive e lidhur midis Shoqërisë “UKT” Sha dhe Sindikatës, me nr. 7720/4 prot., datë 16.07.2018e UKT sha, në Nenin 4 “Fusha e zbatimit”, pika 3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

29.1.Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa për të bërë unifikimin e kontratës kolektive dhe kontratës individuale të nëpunësve në lidhje me klasifikimin (shkallëzimin) e masave disiplinore.

Brenda datës 30.09.2023

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se vlerësimet e performancës së punonjësve ruhen jashtë dosjeve të personelit dhe në asnjë nga rastet e kontrolluara nuk ishin të firmosura nga Drejtori i Përgjithshëm i UKT sha. Veprime në kundërshtim me manualin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të shoqërisë së “UKT” sha, pika 1.11 “Vlerësimi i performancës në punë”, faqe 38 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

30.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që vlerësimet e performancës në punë të punonjësve të bëhen çdo vit dhe të firmosen nga Eprori Direkt dhe Drejtori i Përgjithshëm, pasi ato janë tregues mjaft të rëndësishëm për performancën e shoqërisë.

Në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019 dhe 2020 nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit të Administrimit dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve. Konkretisht: Për vitin 2019 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr.18, datë 12.12.2018 "Mbi miratimin e Buxhetit të shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2019". Ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim nr. 16, datë 13.12.2018 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve.

Për vitin 2020 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 24, datë 19.12.2019 "Mbi miratimin e Buxhetit të shoqërisë UKT sh.a, për vitin 2020".

Ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim nr. 11, datë 20.12.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

31.1. Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë të miratojnë në kohë programin ekonomik financiar (buxhetin vjetor) për një menaxhim me një efektivitet më të lartë të shoqërisë.

Në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i hartimit, shqyrtimit, zbatimit dhe raportimit të programit ekonomik-financiar u konstatua se ka zëra të cilët kanë patur mosrealizim të vlerave të miratuara.

Konkretisht zërat: -Arkëtimi nga shërbimet e tjera për vitin 2018 është planifikuar 4,780.18 mln lekë dhe është realizuar 4,546.40 mln lekë, pra kemi një realizim në masën 95.1% kundrejt planifikimit vjetor; për vitin 2019 është planifikuar 4,841.26 mln lekë dhe është realizuar 4,312.24 mln lekë, pra kemi një realizim me 89.07%; për vitin 2020 është planifikuar 4,772.17

mln lekë dhe është realizuar 4,176.69 mln lekë, pra kemi një realizim me 87.52% kundrejt planifikimit vjetor.

-Zëri Roje Objektsh: për vitin 2018 Plani 489.28 mln lekë, fakti 518.34 mln lekë ose realizuar në masën 105.94 %; për vitin 2019 Plani 489.28 mln lekë, fakti 518.34 mln lekë ose realizuar në masën 105.94%; për vitin 2021 Plani 45.70 mln lekë, fakti 286.45 mln lekë ose realizuar në masën 626.8%.

-Zëri Qira zyra: për vitin 2018 Plani 27.82 mln lekë, fakti 34.66 mln lekë ose realizuar në masën 124.59%.

-Zëri Konsulencë tekniko-ekonomike: për vitin 2018 Plani 37.35 mln lekë, fakti 76.34 mln lekë ose realizuar në masën 204.39%; për vitin 2019 Plani 23.35 mln lekë, fakti 45.11 mln lekë ose realizuar në masën 193.16%; për vitin 2020 Plani 13.20 mln lekë, fakti 18.15 mln lekë ose realizuar në masën 137.48%; për vitin 2021 Plani 12.15 mln lekë, fakti 16.58 mln lekë ose realizuar në masën 136.46%.

-Zëri Shpenzime postare: për vitin 2018 Plani 0.30 mln lekë, fakti 0.33 mln lekë ose realizuar në masën 109.33%; për vitin 2020 Plani 0.2 mln lekë, fakti 0.22 mln lekë ose realizuar në masën 109.59%; për vitin 2021 Plani 0.2 mln lekë, fakti 0.27 mln lekë ose realizuar në masën 135%.

-Zëri Shpenzime të përgjithshme: për vitin 2018 Plani 4.5 mln lekë, fakti 184.58 mln; për vitin 2019 Plani 38.68 mln lekë, fakti 153.87 mln lekë ose realizuar në masën 397.8%; për vitin 2020 Plani 18.05 mln lekë, fakti 65.86 mln lekë ose realizuar në masën 364.9%; për vitin 2021 Plani 19.8 mln lekë, fakti 77.24 mln lekë ose realizuar në masën 390.1%.

-Zëri taksa vendore dhe pasurie: për vitin 2018 Plani 3 mln lekë, fakti 3.73 mln lekë ose realizuar në masën 124.33%; për vitin 2021 Plani 3 mln lekë, fakti 5.98 mln lekë ose realizuar në masën 199.3%.

-Zëri Gjoha penalitete dhe dëmshpërblime: për vitin 2018 Plani 38.01 mln lekë, fakti 73.77mln lekë ose realizuar në masën 194.08%; për vitin 2019 Plani 22.59 mln lekë, fakti 52.09 mln lekë ose realizuar në masën 230.54%; për vitin 2020 Plani 40 mln lekë, fakti 51.02 mln lekë ose realizuar në masën 127.55%.

Mosrealizimi i treguesve ekonomik në raport me programin tregon se shoqëria nuk ka arritur të plotësojë objektivat e saj (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

32.1. Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë të marrin masa në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të programit ekonomik, për hartimin e një programi real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Në vijimësi

32.2. Rekomandimi: Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e programeve ekonomike paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet sipas zërave përkatës.

Në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e auditimit, përqindjet e arkëtimit vjetor total krahasuar me faturimin vjetor, janë në rritje nga viti në vit krahasuar me vitin 2018 (fillimi i periudhës së auditimit). Megjithatë arkëtimi korrent është ai që tregon arkëtimin e faturimit të viteve përkatëse, dhe në fakt pavarësisht rritjes progresive është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU etj.

Përsa i përket arkëtimit të debive të prapambetura, shoqëria ka akoma një vlerë të konsiderueshme të debisë për të mbledhur, pavarësisht përpjekjeve të saj për lidhjen e

aktmarrëveshjeve me debitorët apo dërgim në përmbarim. Shoqëria duhet të ketë në konsideratë se norma e arkëtimit është një nga treguesit më të rëndësishëm të shoqërisë e cila lidhet me qëndrueshmërinë financiare të Shoqërisë dhe me aftësinë e saj paguese.

Konkretisht në vitin 2018 arkëtimet totale janë në vlerën 3,580,578.7 lekë, ku arkëtimet korrente janë në vlerën 3,050,137.19 lekë ose 85.19% dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 530,441.51 lekë ose 14.81%. Në vitin 2019, arkëtimet totale janë në vlerën 3,677,567.58 lekë, ku arkëtimet korrente janë në vlerën 3,285,232.98 lekë ose 89.33% dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 392,724.88 lekë ose 10.67%. Në vitin 2020, arkëtimet totale janë në vlerën 3,294,391.56 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 3,127,150.78 lekë ose 94.92%, ndërsa arkëtimet e prapambetura në vlerën 167,240.78 lekë ose 5.08%. Në vitin 2021, arkëtimet totale janë në vlerën 3,617,808.51 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 3,226,312.65 lekë ose 89.18%, ndërsa arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 391,495.87 lekë ose 10.82 %. Në periudhën 01.01.2022-31.10.2022, arkëtimet totale janë në vlerën 3,054,052 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 2,793,901.41 lekë ose 91.48 %, ndërsa arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 260,150.59 lekë ose 8.52 % Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UK”, pjesa II pika 4, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, neni 1, Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, pika 6, Kontratën e Shërbimeve Ujësjellës Kanalizime, miratuar me vendim të KKRR Nr. 25, datë 08.07.2015 “Kontratë për shërbime Ujësjellës-Kanalizime e përditësuar” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

33.1. Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë “UKT” SHA, (Drejtori i Përgjithshëm, Këshilli i Administrimit, Asambleja e Përgjithshme) të marrin masa për rritjen e arkëtimeve duke reduktuar humbjet menaxheriale të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i regjistrave të parashikimit dhe realizimit për periudhën objekt auditimit konstatohet se në 80% të rasteve fondi limit i parashikuar që në hartimit e regjistrat ka qenë 800,000 lekë, pra në kufirin maksimal të lejimit të zhvillimit të kësaj procedure, çka tregon se nuk kemi një planifikim nevojë të mirëfilltë i cili duhet të vijë nga nevoja konkrete. Gjithashtu konstatohet se ka një copëzim fondesh me qëllim e përdorimit të procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla duke anashkaluar procedurat e tjera. Veprim në kundërshtim me VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 1,2 dhe 3 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 65-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

34.1. Rekomandimi: UKT Sha dhe njësia përkatëse e planifikimit të procedurave të prokurimit të marrin masa që në të ardhmen të parashikojnë saktë dhe përzgjedhin procedurat e duhura duke rritur konkurrencën dhe përdorimin me efektivitet të fondeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

35. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha kontratat e audituara, nga dokumentacioni i administruar në dosjet teknike, konstatohet se; të gjitha proces verbalet për punimet e maskuara nuk janë të shoqëruara me pamje fotografike, për secilin prej tyre, siç kërkohet në kontratat e mbikëqyrjes së punime civile. Materiali fotografik, që ndodhet në dosje, është i përgjithshëm pa përcaktuar pika referimi se në cilën pjesë të projektit janë kryer këto punime. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të

Ndërtimi”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe Kontratat e Mbikëqyrjes së punimeve, pika 5.2 (në të gjitha kontratat e audituara) (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92- 181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

35.1. Rekomandimi: Shoqëria UK Tiranë gjatë marrjes në dorëzim të dosjeve teknike, për kontratat e përfunduara, të kryej një kontroll më të detajuar që këto dosje të jenë të plotësuara në përputhje me kërkesat e kontratës që të bëhet e mundur verifikimi i punimeve të maskuara edhe në një periudhë të mëvonshme nga ana e niveleve të kontrollit.

Menjëherë e në vijimësi

36. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “UKT” SHA është penalizuar në vlerën 34,992,188 lekë nga mos zbatimi i procedurave gjyqësore me përfitues Y.V, po në të njëjtën vlerë, për mos respektim të afatit të ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, veprim në kundërshtim Ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë neni 443 dhe 450/1/a. Ky konflikt gjyqësor është krijuar nga përdorimi i pasurisë së paluajtshme e llojit “Pyll” me sipërfaqe 2200 m² ndodhur në Zonën Kadastrale 2380, me nr.pasurisë.11/21/163 në Lanabregas Tiranë.

Ekzekutimi i Vendimit nr. 6133, datë 20.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga përmbartuesi është kryer pasi veprimet procedurale të Drejtorisë Juridike janë kryer me vonesë, duke sjellë ekzekutimin e vendimit pa ushtruar detyrimin ligjor për ndjekjen e çështjes në të gjitha shkallëve të gjyqësorit. Për rrjedhojë mosparaqitja në afat e ankimit në Gjykatën e Apelit i ka dhënë mundësi Padiçës të ekzekutojë vendimin. UKT pavarësisht se ka ekzekutuar detyrimin përmbartimor për këtë çështje ka depozituar në gjykatë kërkesë për disponim ankimi dhe kërkesë për rishikim vendimi. Te dy çështje janë në proces në Gjykatën e Apelit.

Në këtë mënyrë, edhe nëse gjykata do të pranojë rishikimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, kthimi i shumës së ekzekutuar do të ishte me risk, pasi do të duhej një kohë e gjatë nga përfundimi i procesit për rishikimin e vendimit deri në kërkimin e kthimit të shumës me një tjetër padi dhe çështje gjyqësore (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 92- 181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

36.1. Rekomandimi: Nga Shoqëria t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale, ndjekjes me përgjegjësi të gjitha procedurat gjyqësore, me përfaqësim tekniko-juridik me profesionist me eksperiencë për minimizuar dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i vendimeve në jo në favor të Shoqërisë.

Shoqëria “UKT” SHA të analizojë vlerësoj çështjen në tërësi, për të zbatuar në mënyrë vullnetare dhe në marrëveshje me subjektin detyrimin e krijuar, si dhe të lidhet kontrata, me qëllim uljen e kostove financiare të cilat mund të krijohen nga vendimi gjyqësor dhe shpenzimet përmbartimore. Në marrëveshje/kontratë të përcaktohen edhe klauzolat në rast të ndryshimit të vendimit gjyqësor duke krijuar garancitë ligjore përkatëse për institucionin.

Menjëherë e në vijimësi

37. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “UKT” Sh.a, nuk ka zbatuar dhe realizuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH-së të dhëna nga auditimet e mëparshme. Konkretisht janë rekomanduar 9 masa organizative, janë pranuar 9, prej të cilave 5 janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht, dhe 3 masa janë në proces zbatimi.

Janë rekomanduar 4 masa për shpërblim dëmi me vlerë totale 603,629 lekë, nga të cilat nuk janë pranuar dhe zbatuar 2 masa në vlerën 218,388 lekë, 1 masë në vlerën 42,000 lekë është pranuar dhe nuk është zbatuar, 1 masë në vlerën 343,241 lekë e cila është zbatuar pjesërisht.

Për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike janë rekomanduar 4 masa në vlerën 11,911,884 lekë, prej të cilave nuk janë pranuar dhe zbatuar 2 masa në vlerën 2,619,880 lekë, janë pranuar 2 masa në vlerën 9,292,000 lekë, të cilat janë zbatuar plotësisht.

Janë rekomanduar 2 masa për dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi me vlerë totale 26,712,000 lekë nga të cilat 1 masë në vlerën 9,110,000 lekë është pranuar dhe zbatuar plotësisht dhe 1 masë në vlerën 17,602,000 lekë është pranuar dhe është në proces zbatimi. Theksojmë se për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera 78,400,727 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 26-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

37.1. Rekomandimi: Nga Shoqëria “UKT” Sh.a, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimet kanë rezultuar të pazbatuara, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “UKT” SHA ushtron veprimtarinë e saj me Seli në adresën Rruga “Kavajës”. Ndërtesa ku është vendosur Selia e UKT SHA është marrë në përdorim/me qira nga pronari i objektit G.J. Ndërtesa 133, kodi postar 1027, Njësia Administrative nr.6, Tiranë, me sipërfaqe truall 2131 m² dhe sipërfaqe ndërtese 2252 m². Vlera e Kontratës është 1.826.320 lekë në muaj.

Për përdorimin e objektit/ndërtesës Shoqëria ka lidhur me qiradhënësin, kontratën e qirasë nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019, kontratë e ndryshuar me kontratën nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021 dhe nr. 5554 rep, nr. 3559 koleksioni, datë 21.09.2022. Për investimet dhe mirëmbajtjen e pronës së marrë me qira, në kontratën e qirasë nr.7 Rep dhe nr.5 Kol, datë 04.01.2019, në nenin 5 “Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit”, pika 5.1, 5.5 dhe 5.8 dhe nenin 8 “Përgjegjësitë e palëve”, janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve me referencë ligjore në nenet 801-825 të Kodit Civil.

Sipas kushteve të kontratës së qirasë të rëna dakort nga palët është parashikuar se: Qiramarrësi ka të drejtë, që sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë në qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë (neni 5, pika 5.1) Qiradhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga qiramarrësi (neni 5, pika 5.5). Nga UKT është shpenzuar vlera 19,000,0000 lekë investime në këtë objekt të marr me qira për kamera survejimi etj, nga këto mund të merren në përfundimin e kontratës pajisje survejimi në vlerën 7,755,400 lekë. Referuar kushteve të kontratës së bashku e amendimin, kjo vlerë mbetet për llogari (pronë) të Qiradhënësit. Investimi është kryer në kamera survejimi.

-Në kontratën nr.7 rep dhe nr.5 kol, datë 04.01.2019 nuk është parashikuar nga palët, detyrimi për sigurimin e pronës në rastet e rreziqeve të shkaktuara nga zjarri, rrufetë, tërmeti, stuhitë, përmytjet, shpërthimi ose dëme nga uji, shembje dhe çdo rrezik tjetër të parashikuar nga ligji. Me amendamentin nr.5038 rep, nr.3707 kol, datë 19.12.2021 sigurimi i objektit nga rreziqet është parashikuar si e drejte e Qiradhënësit, po polica e sigurimit nuk është pjesë përbërëse e kontratës, siç përcaktohet në nenin 1, pika 1.5, paragrafi i dytë. Pavarësisht se palët kanë vendosur me vullnet të lirë në kontratë detyrimin e palës Qiradhënëse për sigurimin e pronës objekt i kontratës së qirasë, ky detyrim kontraktual dhe ligjor nuk është përmbushur. UKT SHA

në cilësinë e qiramarrësit nuk rezulton të ketë mbajtur komunikim shkresor me qiradhënësin për investimet dhe mirëmbajtjen sipas kushteve të vendosura në kontratë.

Sa i përket sigurimit të pronës nga rreziqet Qiradhënësi nuk ka vënë në dispozicion të Qiramarrësit Policën e sigurimit të objektit nga një shoqëri e licencuar sigurimi. Kontratat e sigurimit rregullohen nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (Kreu XXIII – Sigurimi), Ligji nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Në qershor të vitit 2022 në UKT për shkak shkëndijës elektrike ka rënë zjarr duke krijuar dëm të llogaritur në **vlerën 28,986,607 leke**. Për shkak të mos pasjes së policës së sigurimit nga zjarri kjo vlerë (shpenzim) është përballuar nga UKT, nga këto mund të merren në përfundimin e kontratës pajisje kompjuterike & mobilje në vlerën **11,931,600 lekë**.

Për shkak të mos pasjes së policës së sigurimit nga zjarri kjo vlerë është përballuar nga UKT. Nga sqarimet e kërkuara në UKT, termi ka të drejtë, nuk është konsideruar si një e drejtë detyrimore e Qiradhënësit, por si një e drejtë evazive (Polica e sigurimit mund të jetë/ose mund të mos jetë pjesë përbërëse e kontratës).

Referuar doktrinën juridike, kodit civil, në rastin konkret (përmbajta e kontratës) termi ka të drejtë duhet të konsiderohet si një e drejtë detyrimore e Qiradhënësit, dhe jo si një e drejtë evazive (Polica e sigurimit mund të jetë/ose mund të mos jetë pjesë përbërëse e kontratës). Pra polica e sigurimit duhet të jetë pjesë e kontratës dhe vlera 28,986,607 lekë dhe duhet të likuidohej nga shoqëria e sigurimit.

Nga investimi i kryer në vlerën 47,986,607 lekë respektivisht në vlerat 19,000,000 dhe 28,986,607 leke, pajisjeve survejimi, kompjutera, mobile etj të zhmontueshme janë në vlerën 19,657,000 lekë.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” nenet 801-825 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë, të marrin masa për të rinegociuar kontratën/marrëveshjen me Qiradhënësin për të bërë amendimet përkatëse me qëllimin e rikuperimit të **vlerës 28,329,607 lekë** për investimet e kryera por të pa kthyeshme (47,986,607 lekë gjithsej-19,657,000 lekë që mund të merren= 28,329,607 lekë), vlerë që t'i mbesë qiradhënësit kundrejt kthimit të shpenzimeve, dhe me të drejtën e marrjes nga “UKT Tiranë” SHA të inventarit ekonomik (pajisjeve kompjuterike, kamera survejimi, mobileri, etj) në vlerën 19,657,000 lekë pas përfundimit të kontratës. Në rast se qiradhënësi nuk do të pranojë këto dy kushte duhet të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e **vlerës 47,986,607 lekë**, ose për diferencë sipas realizimit të kushteve.

Brenda datës 30.06.2023

2. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “UKT” Sh.a ka lidhur kontratë nr. 10728 prot., datë 12.06.2019 me subjektin K.Q me objekt “Marrja me qira e tokës mbi të cilën është ndërtuar depo uji me vendodhje në Fshatin Surel, njësia administrative Dajt” me sipërfaqe 511.65 m² për përdorim toke. Kohëzgjatja 1 vjeçare me të drejtë rinovimi me vlerë qiraje 173,961 lekë në muaj. Në këtë përfshihet tatimi mbi qiranë që do ti mbahet qiradhënësit çdo muaj sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Rrethimi i depos ujit të ujësjellësit (Depo uji, pusët dhe objekt të shërbimit (sistem kamera, manovrator etj) është 401.5 m², sipërfaqe sipas planimetrisë së kontratës është

511 m², diferenca =109.5 m² x 340 lekë m²/muaj =37,230 lekë në muaj x 41.5 muaj (12.06.19 data e lidhjes kontratës deri më 30.11.22 që përfundon auditimi = 1,545,045 lekë përfituar tepër. Vlera 1,545,045 lekë përbënë dëm ekonomik për Shoqërinë “UKT” Sha dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga përfituesi. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, nenet 801-825 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 181-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 1,545,045 lekë** nga K.Q. Kjo është përfituar padrejtësisht nga qiradhënësi, si pasojë e diferencës ndërmjet planimetrisë së kontratës së qirasë dhe sipërfaqes sipas planimetrisë në fakt.

Brenda datës 30.06.2023

3. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Zhbllokim pusetash”, viti 2022, për vlerën 19,994 mijë lekë, projekt përfshin edhe fond rezervë 5 % në vlerën 952,076 lekë. Ky fond rezervë ka rritur në mënyrë artificiale vlerën e përlllogaritjes, duke rënduar koston e këtij shërbimi, në vlerë 960,984 lekë, pasi nuk ka të bëjë me punime ndërtimi të ndërtesave por me shërbim, pasi nuk ka projekt të hartuar nga projektues të licencuar, nuk ka të caktuar mbikëqyrës të punimeve, preventivi nuk ka të përcaktuar vlerën e pastrimit të pusetave duke u bazuar në numrin e pusetave x çmimin/puset, vlerën e zhbllokimit të kanaleve kesoni duke u bazuar në numrin/metrat linear x çmimin/kanal etj. Veprim në kundërshtim me Analizat teknike për punimet e ndërtimit të ndërtesave “Ministria e Ndërtimit” maj 1992, Manualin e preventivimit “Udhëzime dhe kritere dhe analiza ndihmëse vëllimi i I (1976-1980).

Vlera 960,984 lekë është përfituar padrejtësisht nga Shoqëria Shoqërisë “O” Shpk, si pasojë përlllogaritjeve të gabuara dhe përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “UKT” Sha dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga kjo Shoqëri, referuar të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655, ku është shprehur në mënyrë eksklucive se “përcaktohet se: “Personi që pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar brenda caqeve të begatimit pa shkak” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 960,984 lekë**, nga Shoqëria “O” Shpk për shkeljet konstatuara në kontratën me objekt “Zhbllokim pusetash”, viti 2022, për arsye se janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht shpenzimet në fazën e hartimit të preventivit dhe të zbatimit të kësaj kontrate, duke rënduar padrejtësisht koston e shërbimit në vlerën 960,984 lekë, vlerë e cila për Shoqërinë “UKT” Sha dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik. Dëmshpërblimi mbështet në Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 655 dhe neni 32.

Brenda datës 30.06.2023

4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “V.N” - Depo 4000 m³ në Yzberisht” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe BOE “BE-” sh.p.k & “E” sh.p.k me Nr.16975/9Prot datë 19.10.2018 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 184,114,778 lekë pa TVSH ose 220,937,734 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 4 mua, nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezultuan se; në librezat dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt për 3 (tre) zëra punimesh të cilat janë të pa verifikueshme në terren pasi janë punime të maskuara, në shumën 262,100 lekë pa TVSH e cila

përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafët 3.2 dhe 3.3.;- Kontratën e shërbimit Nr.18824/35 Prot. datë 11.10.2018 me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin, ‘Ndërtim linjë transmetimi ujësjellësi nga rruga ‘V.N’ - Depo 4000m3 në Yzberisht’”, Neni 7 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e arkëtimin e vlerës **262,100 lekë** pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve BOE “BE” sh.p.k & “E” sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr.16975/9Prot datë 19.10.2018 për zbatimin e punimeve civile.

Brenda datës 30.06.2023

5. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Spostim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime, sheshi Shqiponja, Loti 1” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UKT sh.a dhe OE “S” sh.p.k me Nr.14332/8Prot datë 22.10.2020 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 227,953,868 lekë pa TVSH ose 273,544,642 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 6 muaj, nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezultuan se; në librezat dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt për 5 (pesë) zëra punimesh të cilat janë të pa verifikueshme në terren pasi janë punime të maskuara, në shumën 10,490,433 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UKT. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafët 3.2 dhe 3.3.;- Kontratën e shërbimit Nr.15784/10Prot. datë 22.10.2020 me objekt “Mbikëqyrje të objektit, “Spostim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime, sheshi Shqiponja, Loti 1”, Neni 7 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 10,490,433 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve OE “S” sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr.14332/8Prot datë 22.10.2020 për zbatimin e punimeve civile.

Brenda datës 30.06.2023

6. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion rrjet ujësjellësi Dn-426mm, Dn-200mm në rrugën ‘Xhanfize Keko’” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe OE “B” sh.p.k me Nr.10098/2Prot. datë 17.08.2019 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 50,406,959 lekë pa TVSH ose 60,488,350.8 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 30 ditë, nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezultuan se; në librezat dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt për 5 (pesë) zëra punimesh si diferencë e krahasimit të projektit fillestar dhe atij të propozuar të cilat janë të pa verifikueshme në terren pasi janë punime të maskuara, në shumën 3,064,212 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i

ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.;- Kontratën e shërbimit Nr.10087/42Prot. datë 05.08.2019 me objekt “Mbikëqyrje të objektit, ‘Rikonstruksion rrjet ujësjellësi Dn-426mm, Dn-200mm në rrugën ‘Xhanfize Keko’, Neni 7 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: UK Tiranë të kryej verifikimin e zbatimit të projektit si dhe të llogarisë diferencat midis projektit fillestar dhe atij të propozuar në rast se janë kryer këto ndryshime ku sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion janë në vlerën 3,064,212 lekë pa TVSH e cila deri na këtë fazë konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë.

Brenda datës 30.06.2023

7. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depo Kombinat” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe BOE “A” sh.p.k & “V” sh.p.k me Nr.9525/14 Prot. datë 07.08.2019 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 63,913,231.36 lekë pa TVSH ose 76,695,877.63 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 3 muaj, nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezultuan se; në librezat dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt për 4 (katër) zëra punimesh të cilat janë të pa verifikueshme në terren pasi janë punime të maskuara, në shumën 776,032 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.;- Kontratën e shërbimit Nr.10087/59Prot. datë 08.08.2019 me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin, “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depo Kombinat”, Neni 7 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **776,032 lekë** pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve BOE “A” sh.p.k & “V” sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr. 9525/14 Prot. datë 07.08.2019 për zbatimin e punimeve civile.

Brenda datës 30.06.2023

8. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri, Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet i Nxënësave” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe BOE “K” sh.p.k & “S” sh.p.k & “L” sh.a & “AR” sh.p.k me Nr.6068/9 Prot. datë 02.07.2020 për zbatimin e punimeve civile me vlerë 381,811,507.02 lekë pa TVSH ose 458,173,808.43 lekë me TVSH, me afat të përfundimit të punimeve 4 muaj, nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezultuan se; në librezat dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt për 4 (katër) zëra punimesh të cilat janë të pa verifikueshme në terren pasi janë punime të maskuara, në shumën 864,749 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë UK Tiranë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II,

Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3.- Kontratën e shërbimit Nr.7904/24Prot. datë 02.07.2020 me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin, “Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri , Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet i Nxënësave”, Neni 7 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **864,749 lekë** pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve BOE "K" sh.p.k & "S" sh.p.k & "L" sh.a & "AR" sh.p.k me të cilin është realizuar kontrata Nr.6068/9 Prot. datë 02.07.2020 për zbatimin e punimeve civile.

Brenda datës 30.06.2023

D. MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICËNCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Në kontratën me objekt “Ndërtim rrjet kanalizimi rruga e Durrësit”, nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konkretisht, projekti fillestar dhe preventivi i marrë për bazë për llogaritjen e fondit limit konstatohet se poshtë tubave të kanalizimeve është vendosur si zë i veçantë nënshtrësë zhavorri dhe shtresë beton C7/10. Referuar manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit për vendosjen e tubave B/A me diametra të ndryshëm nënshtrësë e zhavorrit dhe shtresa e betonit janë të përfshira në furnizim vendosjen e tyre, kjo e pasqyruar në analizën e çmimit të manualeve teknike. Pra përfshirja e këtyre dy zërave në preventivin fillestar ka rritur fondin limit në vlerën 1,057,792 lekë pa TVSH. Gjithashtu referuar preventivit konstatohet se në të është përfshirë puseta e sistemit të ujësjellësit Nr.2 për ndërtim me vlerë totale 684,186 lekë pa TVSH pasi është e përfshirë edhe në projektin e sistemit të ujësjellësit në rrugën e Durrësit, pra përfshirja në projektin e kanalizimeve rit për llogaritjen e vlerës së fondit limit. **Vlera 1,741,978 lekë** pa TVSH konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me: Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të shprehura në nenin 5; VKM Nr.914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar, neni 59 pika 2; dhe VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Shoqëria UK Tiranë të marrë masat e nevojshme për projektet që janë në proces dhe në të ardhmen duke bërë një analizë më të detajuar të llogaritjes së vlerës së fondit limit duke shmangur kështu kostot shtesë të projekteve.

Menjëherë e në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në objektin “V.N” - Depo 4000 m³ në Yzberisht” të realizuar sipas kontratës të lidhur midis UK Tiranë sh.a dhe BOE “B” sh.p.k & “E” sh.p.k me Nr.16975/9Prot datë 19.10.2018 u konstatua se pesha specifike e tubit çelik Ø (1016x8.8 mm) i h/izoluuar në fabrikë sipas certifikatës së prodhimit është 10 kg/ml më shumë se ajo e projektuar dhe e kërkuar në specifikimet teknike, kështu që nga llogaritjet ka rritur koston e projektit, për gjithë gjatësinë e tubit 2186.65 ml në **vlerën 3,672,480 lekë** pa TVSH (21,86 Ton x168,000 lekë/ton), e cila në

gjykimin e grupit të auditimit shpenzim i fondeve të shoqërisë pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me parimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të shprehura në nenin 5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 92-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Shoqëria UK Tiranë në bashkëpunim me mbikëqyrësit e punimeve të kryej një kontroll më të detajuar të specifikimeve teknike të kërkuara, të materialeve në realizimin punimeve civile, duke shmangur në këtë mënyrë rritjen e kostove të projekteve në proces dhe atyre që do të zbatohen në vazhdimësi.

Menjëherë e në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Kontratës kolektive nr. 7720/4 prot, datë 16.07.2018, e amenduar me nr. 5166/3 prot, datë 28.04.2019, neni 22, kontratave individuale të punës neni 13, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë, marrjen/ose jo të masave disiplinore ndaj personelit duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësit respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të performancës së punës së tyre.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

F.I

R. X.

I.S

S.H

K.S

B.SH